UNIVERSITETI I TIRANËS

FAKULTETI I EKONOMISË

DEPARTAMENTI I EKONOMIKSIT

Liberalizimi tregtar, impakti në rritjen ekonomike. Rasti i Shqipërisë

Disertacion për marrjen e gradës shkencore "DOKTOR"

Kandidati:

Msc.Holta Kora (Bako)

Udhëheqës shkencor:

Prof.Dr. Servete Gruda

Tiranë , 2015

DEKLARATË

"Unë, Holta Kora (Bako), deklaroj se punimi im për marrjen e gradës Doktor i Shkencave i titulluar*"Liberalizimi tregtar, impakti ne rritjen ekonomike. Rasti i Shqiperise"* është më shumë se 70000 fjalë duke përfshirë figurat, tabelat, bibliografinë, referencat dhe citimet. Kjo temë përmban materiale që nuk janë publikuar më parë , për marrjen e ndonjë diplome tjetër apo grade akademike të mëparshme. Pra kjo tezë është tërësisht fryt i punës sime"

Firma……. Data……

DEDIKIM

Ky punim i dedikohet Bashkëshortit dhe dy vajzave të mia Michelle dhe Nicole, dhe mbi të gjitha Prindërve të mi

FALENDERIM

Do të doja të jap vlerësimin tim sinqertë të gjithë atyre që më ofruan mbështetje, motivim, inkurajim, ndihmë dhe asistencë gjatë studimeve të mia për marrjen e gradës "Doktor".
Pa dyshim që ky studim nuk do të ishte kompletuar pa suportin e rëndësishëm të bashkëshortit dhe prindërve të mi të cilët gjithmonë më kanë nxitur dhe entuziazmuar për përfundimin e këtij studimi.

Kam qenë shumë me fat që kam takuar dhe jam drejtuar nga një pedagoge e shkëlqyer Prof.Dr. Servete Gruda, e cila më ka siguruar udhëheqje të vlefshme dhe të dobishme, komente dhe sugjerime dhe e ka mbikëqyrur punën time me profesionalizën gjatë gjithë kohës që më ka udhëhequr. Eksperienca e saj akademike në çështjet që lidhen më temën time i zgjeroi njohuritë e mia në këtë fushë. Sigurisht e gjithë kjo do të më ndihmojë shumë për tu bërë një ekonomiste më e mirë dhe për të promovuar rrugën e karrierës sime të nisur si një pedagoge në fushën e ekonomiksit. Ky hulumtim nuk do të ishte konkluduar plotësisht dhe në mënyrë të kënaqshme e të suksesshme pa ndihmën e saj të kujdesshme dhe të devotshme.

Falenderimi im shkon dhe për të gjithë ata që më kanë ndihmuar për gjetjen e të dhënave dhe përpunimin e tyre. Mirënjohje e thellë dhe për miqtë dhe mbi të gjitha kolegët e mi me të cilët kam ndarë ide dhe eksperienca shumë relevante për hulumtimin tim.

Mbështjetja e tyre bëri që punimi im të shkonte mirë dhe të finalizohej.

Tabela e Përmbajtjes

Lista e Tabelave……10
Lista e Figurave……11
Shkurtimet……13
Abstrakt……..…..15

NJË VËSHTRIM MBI KORNIZËN KONCEPTUALE TË KËTIJ STUDIMI……..18

Hyrje…… 18
Kuadri Konceptual…… 19
Propozimet e studimit…….....22
Pyetje kërkimore, hipoteza , implikime**……..**……..23
Pyetjet kryesore të Kërkimit……23
Hipotezat e Studimit…….....24
Zhvillimet e reja metodologjike……...…24
Të gjeturat dhe implikimet e politikës……..25
Objektivat e studimit…….....26
Rëndësia e studimit dhe rezultatet e pritura……...28
Kufizimet e studimit…….....29
Struktura e hulumtimit……....30
Përmbledhje…… 32

KAPITULLI 1

RISHIKIMI I LITERATURËS MBI FENOMENIN E LIBERALIZIMIT TË TREGJEVE...33

1.1 Literatura teorike mbi proçesin e liberalizimit tregtar…….....35

1.1.1 Liberalizimi tregtar--Përkufizimi……...….35

1.1.2 Pse liberalizim tregtar ---…… ……...……..…39

1.1.3 Tërheqje ekonomike apo hapje ekonomike.…… ..43

1.2 Literatura empirike- Efektet e liberalizimit në agregatët makroekonomik……..46

1.2.1 Impakti i liberalizimit në treguesit e varfërisë.……..…...47

1.2.2 Impakti në punësim.…….....49

1.2.3 Impakti në papunësi.…….....51

1.2.4 Impakti në konkurrencë ,rritje ekonomike dhe faktorët e tjerë……...56

1.3 Rishikimi i literaturës mbi modelet e vlerësimit të impaktit të tregtisë ndërkombëtare dhe MTL-ve……..…….....60

1.3.1 Tregtia dhe rritja ekonomike në modelin Klasik të rritjes……..……61

1.3.2 Tregtia dhe rritja ekonomike në modelin Neoklasik të rritjes……..….63

-Teorema Hecksher-Ohlin.……..….64

-Teorema e barazimit të çmimeve të faktorëve…….,,……..…65

-Teorema Stolper- Samuelson.…….....…66

1.3.3 Teoritë e reja të tregtisë ndërkombëtare.……..…....66

1.3.4 Konkurrenca jo perfekte dhe eksternalitetet e tregtisë.……..…..70

KAPITULLI 2

REFORMAT E POLITIKAVE TREGTARE……..…….……..71

2.1 Tregtia e lirë Globalisht…….....72

2.1.1 Globalizimi një fenomen shumëdimensional……...……72

2.2 Integrimi ekonomik…….……75

2.2.1 Avantazhi konkurrues…….....77

2.3 Liberalizimi tregtar shumëpalësh—një vështrim historik……78

2.3.1 Tregtia ndërkombëtare dhe ekonomia botërore- Liberalizimi tregtar shumëpalëshe…….....……..……..79

2.3.2 Integrimi rajonal dhe Marrëveshjet rajonale……..….....83

KAPITULLI 3

SHQIPËRIA NË KUADRIN E LIBERALIZIMIT TREGTAR…….….....86

3.1 Reformat e politikave tregtare në Shqipëri-Kronologji…….…….87

3.2 Marrëveshjet bilaterale dhe integrimi rajonal—CEFTA…….....92

3.2.1 Dobësitë që kanë shfaqur MTL-të……..….96

3.2.2 Përfitimet e Shqipërisë nga CEFTA…….....97

3.3 Politika dhe regjimi tregtar në kuadër të integrimit në BE……...99

3.4 Performanca ekonomike e Shqipërisë përballë performancës së rajonit (EJL) gjatë krizës financiare…….....101

3.4.1 Tregtia……105

3.4.2 Kërkesa e brendshme e rajonit…… ...…..107

3.4.3 Rritja ekonomike…….....108

3.4.4 IHD- Flukset e kapitalit…….....109

3.4.5 Evidenca në barrierat tarifore…….....110

3.4.6 Rimëkëmbja e EJL-Nxitja e perspektivës afatgjatë……...……111

3.5 Karakteristikat e treguesve makroekonomik në Shqipëri……115

3.5.1 Dinamika e eksport-importeve……...…117

3.5.2 Ecuria ekonomike Shqipëtare vitet e fundit……...…120

-Eksportet ……..121

-Importet……124

-Defiçiti Buxhetor……...125

-Pozicioni i konkurrueshmërisë të ekonomisë Shqiptare……...126

-IHD……128

-Tregues të tjerë……..131

KAPITULLI 4

VLERËSIMI I HAPJES TREGTARE PËR SHQIPËRINË ---Modelimi ekonometrik…….135

4.1 Metodat kryesore për matjen e impaktit makroekonomik të MTL-ve……..136

4.1.1 PEM……136

4.1.2 CGE……137

4.1.3 EGT……139

4.2 Arsyet e zgjedhjes së modelit EGT për modelimin ekonometrik……..141

4.3 Aplikimi në mënyrë teorike të modelit të zgjedhur EGT për analizën e Shqipërisë……143

4.3.1 Sukseset e modelit……..……145

4.3.2 Përmbledhje dhe përpunimi i të dhënave historike……...……147

4.3.3 Metodat e vlerësimit të modelit……148

4.4 Derivimi teorik i modelit ekonometrik…….....149

4.5 Analiza e rezultateve empirike……...…….....156

4.6 Metodologjia---……156

4.6.1 Operacionalizimi i koncepteve në variabla……...……156

4.6.2 Statistika përshkruese e variablave.....162

4.6.3 Kontrolli i stacionaritetit të serive: Testi rrënja unitare.....169

4.7 Modelimi i rritjes ekonomike me hapjen ekonomike.....170

4.7.1 Rritja ekonomike dhe hapja tregtare me Greqinë.....170

4.7.2 Rritja ekonomike dhe hapja tregtare me Italinë.....175

4.7.3 Rritja ekonomike dhe hapja tregtare me vendet e rajonit.....178

4.7.4 Rritja ekonomike dhe hapja tregtare me BE-në.....181

4.8 Krahasime dhe konsiderata për modelet e trajtuar.....184

4.9 Interpretimi ekonomik.....185

4.10 Interpretimi ekonometrik.....189

KAPITULLI 5

KONKLUZIONE.....190

5.1 Hyrje.....190

5.2 Diskutimi i rezultateve teorike të gjetura.....191

5.3 Implikimet e rezultateve empirike nga zbatueshmëria e modelit EGT.....199

5.4 Rekomandime për perspektivën.....203

5.5 Kontributi në njohuri.....204

5.6 Sugjerime për hulumtime të mëtejshme.....205

Referenca.....207

Aneksi i punimit.....213

LISTA E TABELAVE

Tabela 1 **:** Statusi i MTL-ve bilaterale midis vendeve të EJL……..……..94

Tabela 2 : Rritja reale e PBB-së për Evropën Juglindore……....112

Tabela 3 : Indeksi i konkurrueshmërisë 2006-2013……....127

Tabela 4 : Karakteristikat e modeleve për matjen e efektivitetit të politikave tregtare……142

Tabela 5. Koeficientet e korrelacionit për variablat sasior.....168

Tabela 6. Testi i rrënjës unitare për seritë që janë përdorur në modelimet ekonometrike....169

Tabela 7. Rezultatet e modelit të hapjes së tregtisë me Greqinë.....171

Tabela 8. Testi i heteroskedasticitetit për modelin lidhur me Greqinë.....173

Tabela 9. Testi për korrelacion serial të termit të gabimit të modelit të Greqisë.....173

Tabela 10. Koeficientet e autokorrelacioneve të modelit të Greqisë.....174

Tabela 11. Rezultate e modelit për rastin e Italisë.....175

Tabela 12. Produkti i modelit për vendeve e rajonit.....179

Tabela 13. Rezultatet kryesore të modelit me vendet e Bashkimit Evropian.....181

Tabela 14. Përmbledhja e modeleve sipas partnerëve tregtar të Shqipërisë.....184

Tabela 15. Përmbledhja e karakteristikave të modeleve të impaktit të tregtisë Ndërkombëtare……198

LISTA E FIGURAVE

Figura. 1: Detaje të hulumtimit……...18

Figura.2 : Korniza konceptuale e studimit……..19

Figura.3: Rritja e tregtisë botërore…….80

Figura. 4: Dimensionet e Marrëveshjeve Tregtare Shumëpalëshe……91

Figura. 5: Import-Eksporti i vendeve të Evropës Juglindore……...106

Figura. 6: Indeksi i hapjes tregtare 1996-2014……116

Figura. 7: Indeksi i hapjes tregtare me vendet më të mëdha partnere 1993-2014……117

Figura. 8: Ecuria e tregtisë së Jashtme 2005-2013……...118

Figura. 9: Ritmet vjetore të rritjes së eksporteve 2001-2014……...119

Figura. 10 : Import Eksporti i grupmallrave 2013……...120

Figura. 11 : Qarkullimi i mallrave në tregtinë e Jashtme 2014……...121

Figura. 12 : Eksporti sipas vendit të destinacionit 2013……..122

Figura. 13: Qarkullimi i mallrave në tregtinë e Jashtme 2014-2015……...123

Figura. 14: Importi sipas vendit të origjinës 2013……...124

Figura. 15: Ecuria e sektorit të Shërbimeve dhe IHD-ve 1993-2014……...129

Figura. 16: Ecuria e GDP-së për Shqipërinë 1996-2014……..…132

Figura. 17: Operacionalizimi i koncepteve në variabla……160

Figura. 18: Skema e operacionalizimit të koncepteve në variabla, matja dhe simboli i tyre……...161

Figura . 19: Statistika përshkruese e variablave sasior……162

Figura. 20: Ecuria në vite e rritjes ekonomike shqiptare……....163

Figura . 21: Ecuria në vite e treguesve të hapjes ekonomike me vendet partnere……164

Figura 22: Ecuria në vite i fdi_gdp dhe sherbime_gdp, bashkë me grafikët e densitetit.....165

Figura 23: Paraqitja grafike e ind_korr dhe ind_konk bashkë me histogramat e tyre.....165

Figura 24: Performanca e modelit përballë vlerave aktuale të rritjes ekonomike.....172

Figura 25: Testi i shpërndarjes normale për termin e gabimit për modelin lidhur me Greqinë.....172

Figura 26: Performanca e modelit të Italisë.....177

Figura 27 :Performanca e modelit përballë vijës së vlerave aktuale të rritjes ekonomike për vendet e rajonit.....180

Figura 28: Pamja grafike e vlerave faktike përkundrejt atyre të vijës së modelit bashkë me termin e mbetjes.....182

SHKURTIMET

ACIT	Albanian Centre of International Trade (Qëndra Ndërkombëtare e Tregtisë)
ADF	Test Augumented Dickey Fuller Test
BE	Bashkimi Europian
BP	Ballkani Perëndimor
BSH	Banka e Shqipërisë
CEFTA	Zona e Tregtisë së Lirë të Europës Qendrore
CGE	Computable General Equilibrium
EFTA	Europian Free Trade Association
EGT	Endogenous Gravity Theory
EJL	Europa Juglindore
EJL6	Shqipëri, Bosnie dhe Herzegovina, Maqedoni, Mal i Zi, Serbi, Kosovë
GATT	General Agreement on Tariffs an Trade
GCI	Global Competitiveness Index (Indeksi Global i Konkurrueshmërisë)
GDP	General Domestic Product
H-0	Modeli Heckscher Ohlin
IE	Integrimi Ekonomik
IHD	Investime të Huaja Direkte
IMF	International Monetary Fund
INSTAT	Instituti i Statistikave
KE	Komuniteti Europian
METE	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës
MENA	Middle East and North Africa
MERCOSUR	MTL mes Argentinës, Brazilit, Paraguayt, Uruguayt,Venezuelës
MFN	Most Favoried Nation (Vendi më i favorizuar)
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
MTL	Marrëveshje të Tregtisë së Lirë
MTR	Marrëveshjeve të Tregtisë Rajonale
NAFTA	North American Free Trade Agreement
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
OECD	Organizata për Kooperim dhe Zhvillim Ekonomik
OLS	Ordinary Least Square

OPEC	Organization of the Petroleum Exporting Countries
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PEM	Partial Equilibrium Model
PJK	Punë e jokualifikuar
PK	Punë e kualifikuar
PSA	Proçesi i Stabilizim Asociimit
PTA	Preferential Trade Agreement (Marrëveshje Tregtare Preferenciale)
SPS	Masat Sanitare dhe Fitosanitare
TBT	Barrierat Teknike të Tregtisë

ABSTRAKT

Shqipëria është aktualisht shumë e fokusuar në rritjen dhe promovimin e liberalizimit tregtar në kuadrin e objektivit final atij të integrimit në familjen europiane. Nën kuadrin e liberalizimit vendi jonë ka zbatuar dhe vazhdon të implementojë politika ekonomike që promovojnë rritjen ekonomike në afatgjatë në përputhje me integrimin aktual ekonomik rajonal, me detyrimet që vijnë si rezultat i marrëveshjeve me Organizatën Botërore të Tregtisë dhe me përqafimin e procesit të globalizimit. Megjithatë, disa faktorë të fundit brendshëm dhe të jashtëm të tilla si: kriza ekonomike e vitit 1997, kriza financiare që preku botën apo dhe,shifrat e larta të nivelit të informalitetit dhe korrupsionit , mungesa e një tregu të zhvilluar pune, teknologjia në nivele të ulëta dhe mbi të gjitha mungesa e stabilitetit politik kanë ndikuar në efikasitetin dhe suksesin e kësaj politike.

Ndërsa këto çështje kanë qenë të rëndësishme për Shqipërinë dhe janë problematika të përgjithshme kryesisht për vendet në zhvillim siç janë vendet e rajonit, janë bërë vetëm studime hulumtimi sasior ose kërkime bazuar në evidenca për të hetuar impaktin e këtyre politikave ekonomike. Si pasojë,është shumë interesante të ndërmerret një kërkim i bazuar në politika dhe i modeluar për këtë çështje. Prandaj, ky studim synon të zhvillojë një model të përshtatshëm ekonometrik për Shqipërinë për të studiuar ndikimin e hapjes ndaj tregtisë mbi bilancin tregtar dhe mbi agregatë të tjerë makroekonomikë si rritja ekonomike e vendit, për të siguruar implikime të besueshme të politikave dhe rekomandime të vlefshme.

Ky hulumtim kryen një studim substancial sasior për të kontribuar mbi investigimin dhe analizimin e liberalizimit tregtar dhe mbi çështjet e politikave të rritjes ekonomike me të cilat ballafaqohet aktualisht vendi ynë. Është përdorur në këtë studim një metodë e re ekonometrike për modelimin e politikave të duhura, e quajtur teoria e gravitetit endogjen (endogenous gravity theory -EGT) për të zhvilluar një ekuacion simultan të thjeshtë dhe fleksibël të modelit të hapjes tregtare të Shqipërisë me partnerët e saj më të mëdha tregtarë si Italia, Greqia, Bashkimi Europian dhe Vendet e rajonit (CEFTA).

Të dhënat sasiore janë marrë nga baza e të dhënave në publikimet e INSTAT, Banka Botërore,BSH,IMF, etj. Madhësia e mostrës për vlerësimin e këtij modeli është nga viti 1993

deri 2014 për shkak të disponueshmërisë së të dhënave në këtë periudhë. Është përdorur teknika e vlerësimit, OLS, për të marrë rezultatet e studimit dhe për të provuar për besueshmërinë e modelit. Përveç kësaj, shumë statistika të dobishme diagnostike të tilla si t-statistic, Fstatistic,ADF, R^2, R^2 i rregulluar dhe Durbin-Watson janë përdorur për të vlerësuar rëndësinë dhe efikasitetin e gjetjeve empirike.

Studimi zbulon gjetje efikase dhe të besueshme empirike mbi lidhjen shkak-pasojë të elementëve tregti-rritje, përfshirë edhe ndikimin e goditjeve (si krizat e jashtme) dhe të reformave të politikave të tregtisë midis Shqipërisë dhe partnerëve të saj të mëdha të tregtisë gjatë dy dekadave të fundit. Studimi gjithashtu ofron dëshmi mbi lidhjen midis tregtisë së mallrave, investimeve të huaja direkte (IHD), shërbimeve dhe integrimit ekonomik rajonal për politikën më të besueshme në promovimin e rritjes ekonomike. Janë diskutuar edhe implikimet për politikën e hapjes në aspektin e mundësive dhe sfidave nën kontekstin e marrëveshjeve shumëpalëshe, rajonale dhe dypalëshe të tregtisë së lirë për të arritur rritje ekonomike të ndërsjelltë për periudha afatgjata.

Gjetjet empirike sugjerojnë se vetëm hapja midis Shqipërisë dhe partnerit më të madh aktual Bashkimit Europian, është pozitive dhe statistikisht domethënëse për rritjen ekonomike të Shqipërisë, ndërsa shumica e efekteve të vendeve të tjera janë pozitive me rëndësi të ndryshme statistikore. Variabli i liberalizimit të shërbimeve është i vogël dhe negativ, dhe statistikisht i rëndësishëm për treguesit e rritjes. Për më tepër, kriza financiare e botërore pati një ndikim të madh negativ që ishte statistikisht me lidhje pozitive dhe domethënëse[1]. Në anën tjetër, IHD-të[2], sistemi financiar dhe reforma e institucioneve, si dhe Liberalizimi i flukseve të kapitalit ishin pozitive dhe të rëndësishme për rritjen dhe zhvillimin e vendit.
Më konkretisht, rekomandimi më i rëndësishëm sugjeron se hartuesit e politikave të tregtisë në Shqipëri duhet të zbatojnë politikën e hapjes tregtare, në përputhje me marrëveshjet rajonale shumëpalëshe dhe dypalëshe të tregtisë së lirë (MTL) për të arritur rritje të qëndrueshme afatgjatë. Për të arritur këtë qëllim, është thelbësore të garantohet se të dyja llojet e marrëveshjeve si rajonale ashtu edhe bilaterale të liberalizimit tregtar do ta çojnë vendin drejt liberalizimit multilateral tregtar për të arritur qëllimin final , integrimin në BE.

[1] Vetëm në lidhje me Greqinë impakti del negativ por statistikisht i parëndësishëm
[2] Vetëm IHD-të nga rajoni kanë impakt negativ mbi rritjen tonë ekonomike por del statistikisht i parëndësishëm

Për më tepër, janë të nevojshme edhe politika makroekonomike të tjera fiskale, monetare dhe industriale të përshtatshme dhe efektive për të mbështetur dhe përshpejtimin e rritjes afatgjatë si rezultat i liberalizimit tregtar në Shqipëri. Megjithatë, paqëndrueshmëria politike aktuale, treguesit makroekonomik ende larg atyre të dëshiruara të bilancit tregtar kanë kontribuar në uljen e besimit nga ana e investitorëve të huaj dhe prandaj këto zhvillime mund të paraqesin një pengesë të plotë në negociatat e mëtejshme të MTL-ve për shkak të ndryshimeve në politikën tregtare të çdo qeverie.

Pra më konkretisht në këtë studim analizohet ndikimi i liberalizimit tregtar së bashku me secilin nga treguesit makroekonomik (të konsideruar relevantë në rritjen ekonomike si psh kontributi i shërbimeve, IHD, privatizimi i sistemit financiar, konkurrueshmëria dhe korrupsioni) në rritjen ekonomike. Pra është kryer studim në lidhje me impaktin e secilit tregues ekonomik dhe joekonomik të kombinuar me hapjen e mëtejshme tregtare (reduktim të barrierave) me secilin nga 4 partnerët tregtarë. Për ta bërë studimin më gjithëpërfshirës dhe më të vlefshëm apo më të kompletuar për të rritur dhe besueshmërinë e tij.

Nga rezultatet e modelit vihet re dhe një konkluzion tjetër i rëndësishëm që është dhe përcaktimi i partnerit tregtar që e ndikon më shumë këtë rritje ekonomike dhe që këtej rrjedh dhe një sugjerim për potencialet tregtare të vendit tonë apo për partnerin potencial më eficient në rritjen ekonomike[3] .

[3] Rezultat ky në përputhje dhe me bazën teorike të modelit gravitacional që në thelb mat potencialet tregtare

NJË VËSHTRIM MBI KORNIZËN KONCEPTUALE TË KËTIJ STUDIMI ------- *Projekt Propozimi*

HYRJE

Ka shumë studime të shumë ekonomistëve nëpër botë që sugjerojnë së Liberalizimi tregtar si fenomen shumë i rëndësishëm i globalizimit është bërë tashmë një pjesë integrale e reformave ekonomike që ndërmarrin kryesisht vendet në zhvillim.

Për të filluar këtë studim, korniza konceptuale do të parashtrohet në këtë kapitull. Në këtë kornizë do të përfshihen pjesë të rëndësishme si tema kërkimore, metodologjia që do të përdoret, rezultatet e pritura ku përfshihet dhe lidhja që ekziston midis elementëve kyç të cilët kanë një impakt të rëndësishëm në tregti dhe në rritjen e një vendi, më konkretisht për rastin e Shqipërisë. Dhe pikërisht kjo kornizë e propozuar do të sigurojë elementët mbështetës për komponentët e modelit ekonometrik dhe të vlerësimit në kapitujt në vazhdim. Dy janë elementët kyç të cilët do të vihen re në studim se ndikojnë në tregti dhe në rritjen e Shqipërisë: marrëveshjet e tregtisë së lirë dhe karakteristikat e ekonomisë së vendit. Ka edhe disa faktorë të jashtëm ekonomikë si kriza financiare, reformat në sistemin financiar; dhe faktorë joekonomikë si indeksi i korrupsionit. Një shpjegim më i hollësishëm rreth të gjithë detajeve të kuadrit konceptual do të jepet në seksionet në vazhdim.

Figura.1: Detaje të hulumtimit



KUADRI KONCEPTUAL

Është mjaft thelbësore për këtë studim që të paraqesim një kornizë konceptuale të përshtatshme si në fig.2 për të përmbledhur në mënyrë më të thjeshtuar lidhjen midis integrimit ekonomik, politikave të hapjes së vendit për tregtinë e jashtme, liberalizimit tregtar dhe faktorëve endogjene / ekzogjene të cilët e influencojnë shumë tregtinë dhe mbi të gjitha rritjen ekonomike të Shqipërisë.

Figura.2: **Korniza konceptuale e studimit**



Burimi: zhvilluar nga kërkimet dhe literatura e autorit

Më konkretisht në këtë paraqitje të kornizës konceptuale bëhet një shpjegim i variablave të përfshira në studim për të treguar arsyen se pse janë konceptuar me impakt relevant në ekonominë e Shqipërisë.

Nga i gjithë ky arsyetim arrijmë në konkluzionin se dy janë faktorët më gjithëpërfshirës që kanë ndikuar në bilancin tregtar dhe në rritjen ekonomike sigurisht marrëveshjet e kryera nga vendi jonë për tregtinë e lirë (MTL) dhe karakteristikat e ekonomisë ku përfshihen në to faktorë të brendshëm dhe të jashtëm. Implementimi i politikave të ndryshme tregtare duhet të pajtohen dhe me marrëveshjet shumëpalëshe, rajonale dhe dypalëshe të tregtisë së lirë sipas nënshkrimit të marrëveshjeve si anëtare të OBT-së.

Prandaj, rëndësia dhe përfitimet që rrjedhin nga liberalizimi tregtar mund të shpjegohen si të bazuara rrënjësisht në teoritë bashkëkohore tregtare dhe derivatet e këtyre teorive , në avantazhet krahasuese, në konkurrencë, në hapje tregtare dhe globalizim , me gati çdo vend apo të zhvilluar duke u bërë një anëtar i të paktën një blloku tregtar rajonal[4].

Sic e dimë vendi ynë është një vend i vogël (në madhësi relative ekonomike) në zhvillim, ecuria ekonomike dhe rritja e të cilit janë të prekur kryesisht nga disa faktorë të brendshëm. Ka faktorë të tjerë që përfshijnë politikat fiskale, monetare dhe industriale që janë të domosdoshme për të mbështetur politikën e tregtisë për të rritur aftësinë konkurruese të industrive vendase të cilat përshpejtojnë rritjen afatgjatë. Përveç kësaj,tregtia dhe rritja si faktorë mund të ndikojnë edhe tek faktorët e brendshëm. Prandaj ndër vite janë ndërmarrë një sërë reformash intensive financiare dhe në sistemin bankar, që u realizuan nëpërmjet rritjes së efikasitetit të institucioneve financiare të brishta dhe jo konkurruese shqiptare.

Në fillim të viteve 2004, u zbatua dhe proçesi i privatizimeve. Kjo kishte për qëllim në nxitjen e rritjes ekonomike për të nxitur investimet e huaja në tregjet e kapitaleve. Ky projekt ishte plotësisht produktiv për të minimizuar pamjaftueshmërinë e likuiditeteve që kishin qenë prezente pas viteve 1990 dhe sidomos pas krizës së vitit 1997. Në të njëjtën kohë, kishin filluar paraprakisht rreth viteve 2000 përpjekjet intensive të implementimit të reformave në bazë të marrëveshjeve tregtare me OBT-në. Objektivi kryesor i kësaj skeme u përqendrua në problematikat e bilancit tregtar dhe në pamjaftueshmërinë e vendit për ti siguruar tregjeve produkte të cilat nuk prodhoheshin me resurset e vendit. Ajo që besohej fuqimisht ishte se

[4] Në rastin e Shqipërisë është (CEFTA).

këto marrëveshje ekonomike do të çonin në rritjen e përgjithshme ekonomike të vendit; megjithatë, kjo e fundit është ende në debat.

Një ekonomi e hapur në zhvillim si Shqipëria është prekur gjithashtu nga disa faktorë të tjerë, siç janë ekonomitë e partnerëve të saj të mëdha tregtare dhe krizat financiare që ata po përjetojnë. Meqënëse vendi ynë nuk prodhon mallra të mjaftueshëm për të plotësuar konsumin e saj të brendshëm dhe kërkesat për prodhim duke e kthyer ekonominë tonë të varur nga importi, atëherë krizat e vendeve partnere kanë rezultuar të ndikojnë në masë të madhe në aftësinë konkurruese në plan ndërkombëtar të industrive të saj, në performancën ekonomike dhe në rritjen ekonomike. Gjithashtu dhe të ardhurat nga eksporti janë një motor i rritjes për vendin tonë dhe varen nga ekonomitë e partnerëve të saj të mëdha të tregtisë.

Përveç kësaj, investimet e huaja direkte (IHD) janë një tjetër faktor i jashtëm që kontribuon në punësim, teknologji dhe transferimin e njohurive dhe gjeneron rritjen, veçanërisht në industrinë e prodhimit.

Më e rëndësishmja, kriza financiare 2008-2009 që preku botën ka prekur negativisht edhe rritjen e ekonomisë në Shqipëri. Kjo ishte më e qartë në 2008-2009 si rezultat i përhapjes së ndikimit rajonal. Gjatë periudhës së pas krizës, GDP-ja ka qenë vazhdimisht në zbritje duke arritur vlerën prej 1.4% në vitin 2013[5].

Mund të konkludohet se integrimi ekonomik (IE) dhe MTL-të drejtpërdrejt ndikojnë në liberalizimin tregtar. Vendet në zhvillim, duke përfshirë Shqipërinë e kanë detyrim për të liberalizuar politikat e tyre tregtare dhe praktikën e hapjes sipas marrëveshjet dypalëshe, rajonale dhe shumëpalëshe. Meqënëse tregtia është gjithashtu një nga përcaktuesit e rritjes veçanërisht në vendet në zhvillim, për këtë janë përdorur tre kritere në kuadrin e propozuar konceptual të këtij studimi: themelimi i integrimit ekonomik dhe MTL-të, liberalizimi tregtar(përfaqësuar nga hapja tregtare[6]) dhe ndikimi i tregtisë në rritje. Këto do të jenë të shpjeguara në hollësi të plotë në kapitujt e ardhshëm.

[5] Efektet e krizës së 2008-2009 janë ndierë më vonesë në Shqipëri.

[6] Hapja tregtare në modelin ekonometrik në këtë studim është llogaritur si volum tregtar/GDP, sipas sugjerimeve të teorive empirike për modelin EGT të përdorur , i cili si variabël të varur ka flukset tregtare të cilat përfaqësohen nga një agregat më i zgjeruar si ai i hapjes tregtare.

PROPOZIMET E STUDIMIT

Propozimet janë në përputhje me kornizën konceptuale mbështetur në ndërtimin e një modeli ekonometrik që do të japë përgjigje kërkimore për objektivat e tezës.

Për këtë arsye , propozimet e mëposhtme që do të shqyrtohen në këtë hulumtim janë:

Propozimi 1 : Aspekte të ndryshme të teorisë dhe praktikës së tregtisë ndërkombëtare mund të përdoren për të shpjeguar themelimet e MTL-ve . Këto aspekte janë teoritë e tregtisë bashkëkohore dhe zgjerimet e saj[7] , si teoria e gravitetit[8] , avantazhet krahasuese[9], hapja tregtare[10] dhe globalizimi .Bazuar në këto aspekte , liberalizimi tregtar ka efekt pozitiv në vend si një motor zhvillimi .

Propozimi 2 : Është obligim për një vend që të zbatojë skema të liberalizimit tregtar si subjekt i marrëveshjeve shumëpalëshe , rajonale dhe dypalëshe . Angazhimet e shumëanshme janë vijnë si rezultat i sugjerimeve të OBT . Për nivelin rajonal , praktikat tregtare rajonale si CEFTA (nësnshkruar midis Shqipërisë, Bosnje-Hercegovinës, Kosovës, Moldavisë, Serbisë , Malit të Zi Shqipërisë, Maqedonisë,dhe Kroacisë) janë shumë të rëndësishme për vendin tonë me qëllim kryesor të kësaj marrëveshjeje përshpejtimin e tregtisë brenda rajonit dhe integrimi i tyre drejt tregut europian dhe më tej drejt atij global. Ajo do ti siguronte eksporteve shqiptare një treg të madh pa taksa. Në rastin e marrëveshjeve dypalëshe , vendi ka detyrim të zbatojë liberalizimin tregtar në proçedura të ndryshme dhe periudha të ndryshme kohore sipas marrëveshjeve me partnerët e saj . Për këtë arsye, një marrëdhënie pozitive pritet mes intensifikimit të marrëveshjeve tregtare dhe promovimit të rritjes ekonomike. Pritet gjithashtu nga vlerësimi teorik dhe empirik të përcaktohet se cila MTL është me impakt më të madh pozitiv në treguesit e rritjes ekonomike.

Propozimi 3 : Shqipëria është vend i vogël (në raport me përmasat ekonomike) në zhvillim, performanca e saj ekonomike dhe rritja është ndikuar nga impakti i faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm (shih figurën 2.) . Faktorë të brendshëm përfshijnë, politikat tregtare dhe reformat në sistemin financiar. Faktorët e jashtëm janë ekonomitë e partnerëve më të mëdhenj

[7] Në kapitujt e mëvonshëm bëhet një praqitje e detajuar të zgjerimeve të modelit gravitacional kur aplikohet në tregtinë ndërkombëtare bashkë. Paraqiten dhe autorët me zhvillimet empirike që i kanë zgjeruar modelit të Gravitetit

[8] Si pjesë e konceptit të modeleve të përshtatshme për vlerësimin e impaktit të liberalizimit tregtar dhe si mjet analitik i lidhjes Tregti-Rritje ekonomike.

[9] Si indikator i tregtisë

[10] Hapja tregtare konsiderohet si pjesë e procesit të globalizimit dhe së bashku me liberalizimin tregtar janë komplementare për të finalizuar integrimin në ekonominë globale

të tregtisë[11], rritja e shërbimeve të tregtuara, IHD, aftësia konkurruese dhe indeksi i korrupsionit . Të gjithë këta faktorë pritet të kenë impakte të ndryshme në promovimin e performancës ekonomike të vendit tonë.

PYETJE KËRKIMORE, HIPOTEZA, IMPLIKIME

Ky seksion trajton pyetjet kërkimore , hipotezat ,zhvillimet e reja metodologjike , rezultatet e hulumtimit dhe implikimet e politikës duke përfshirë çështjet për kërkime në të ardhmen të cilat janë përdorur si udhëzimet kryesore për kapitujt pasues.

Pyetjet kryesore të Kërkimit

Është e nevojshme të ndërtohet një model ekonometrik që mbulon pyetjet kërkimore kyçe në përputhje me objektivat e hulumtimit, për të përfunduar studimin. Këto pyetje kyçe kërkimore të mëposhtme janë përdorur si bazë për të shpjeguar proçesin e studimit .

1 . Cilat janë bazat e themelimit të MTL-ve ?

2 . Si e ndikojne marrëdhëniet shumëpalëshe , rajonale dhe dypalëshe të liberalizimit tregtar, performancën ekonomike në Shqipëri?

3 .Cili është modeli i ri dhe i përshtatshëm ekonometrik i lidhjes shkakësore hapje - tregti-rritje në Shqipëri për të akomoduar edhe zhvillimet e fundit në Europë ?

4 . A ndikon politika e hapjes në tregti dhe rritje,nëse po në cilën mënyrë ?

5 .Cili është roli i krizës dhe i reformave politike në hapjen tregtare dhe zhvillimin ekonomik?

6 . Cilat janë pasojat dhe rekomandimet e duhura dhe të mundshme të politikës nga gjetjet empirike në treg të MTL-ve dypalëshe, rajonale dhe shumëpalëshe ?

[11] Përfaqësuar nga variabli dummy: krizat që kanë prekur ekonomitë e BE-së dhe të Rajonit

Hipotezat e Studimit

Pas prezantimit të kuadrit konceptual dhe propozimeve në nën- seksionin e mëparshëm , hipotezat e studimit janë përshkruar në këtë nën- seksion .

Këto hipoteza janë ndërtuar për të parashikuar rezultatet e llogaritura sic janë raportuar në kapitujt e ardhshëm. Hipotezat e mëposhtme janë formuluar në përputhje me tre propozimet e përmendura më lart.

Hipoteza 1 : Efekti i hapjes tregtare në Shqipëri pritet të jetë pozitiv dhe i rëndësishëm për tregtinë e tij dhe rritjen ekonomike .

Hipoteza 2 : Çdo variabël i brendshëm ekonomik dhe tregtar pritet të ketë një ndikim dhe rëndësi të ndryshëm në rritjen ekonomike . Disa prej këtyre variablave janë kualitative dhe variabla të politikës

1) Reformat në politikat tregtare (hapja ekonomike) me partnerët e tregtisë priten të jenë pozitiv dhe të rëndësishëm për tregtinë dhe rritjen.

Hipoteza 3 :Secili nga variablat e faktorëve të jashtëm (të tilla si IHD , shërbimet ,kriza financiare në vitin 2008-2009,reformat në sistemin financiar) janë parashikuar të kenë ndikim dhe rëndësi të ndryshëm në rritjen ekonomike . Disa nga këto variabla janë variabla cilësore dhe të politikave.

1) IHD dhe shërbime pritet të jenë pozitivë dhe të rëndësishëm në tregti dhe rritje .

2) Kriza financiare pritet të jetë negative dhe e rëndësishme në tregti dhe rritje .

3) Politikat e privatizimit pritet të jenë pozitiv dhe të rëndësishëm për tregtinë dhe rritjen .

4) Indeksi i korrupsionit pritet të jetë pozitiv dhe me rëndësi në tregti dhe rritje.

Zhvillimet e reja metodologjike

Ky studim përdor përparimet e kohëve të fundit në teoritë e modelimit të politikave ekonomike dhe tregtare për të zhvilluar një qasje të re metodologjike për të shqyrtuar

ndikimin e hapjes matur nga vlera e tregtisë totale /GDP[12] mes Shqipërisë dhe partnerëve të saj nëpërmjet zhvillimit të një ekuacioni simultan modeli tregti-rritje për Shqipërinë. Modeli është një model endogjen[13] tregti–rritje dhe vlerësohet për katër skenarë të ndryshëm midis Shqipërisë dhe blloqeve të tregtisë më të mëdha të saj. Mund të vihet re gjithashtu se përfshirja e reformave politike , krizat dhe goditjet, apo treguesit e konkurrueshmërisë dhe korrupsionit janë një tjetër tipar i ri i zhvillimit të modelimit në krahasim me studimet të tjera të mëdha ekzistuese që së bashku dhe njëkohësisht me MTL-të sjellin rezultate të kënaqshme. Si pasojë , ky studim është zgjeruar për të hetuar ndikimin e këtyre faktorëve në rritje përveç hapjes tregtare që përfshihet në modelet standarte të tregtisë ndërkombëtare .

Të gjeturat dhe implikimet e politikës

Bazuar në zhvillimet e reja metodologjike të modelit teorik të gravitetit endogjen të zgjeruar me variabla të tjerë si kriza apo tronditjet në ekonomi dhe reformat e politikave financiare ; për më tepër dhe bazuar në literaturat e mëdha ekzistuese, kryesisht pritet që ndikimi i hapjes ekonomike dhe i reformës së politikave të jetë pozitiv dhe me rëndësi për rritjen . Nga ana tjetër ,efekti i krizës pritet të jetë negativ dhe domethënës për rritjen . Implikimet e propozuara të politikave janë të besueshme në se ato janë të bazuara në teorinë e tregtisë ndërkombëtare ,në integrimin ekonomik dhe në gjetjet empirike . Mund të thuhet se për gjetjet empirike të mundshme , liberalizimi tregtar, veçanërisht MTL –të dypalëshe[14] duhet të jenë më efektive në rritjen dhe përshpejtimin e përfitimeve të vendit . Objektivat e MTL-ve duhet të shtrihen për fushën e investimeve , shërbimeve dhe çdo bashkëpunimi tjetër ekonomik në një fazë të mëvonshme[15] . Për më tepër , politika reformash efikase janë të nevojshme për të nxitur rritjen afatgjatë mbështetur nga tingujt makroekonomik dhe menaxhimi i politikave tregtare. Menaxhimi efektiv i krizës është thelbësore për shërim dhe

[12] Flukset tregtare dhe potenciali i tregtisë janë dhe gjithmonë variabli kryesor në modelet e gravitetit ,dhe nëpërmjet variablit shpjegues hapje tregtare modeli ekonometrik në këtë studim është zgjeruar (sipas dhe sugjerimeve të literaturës për modelet e zgjeruara gravitacionale) me konceptin flukse tregtare(volum tregtar=EX+IM) pjesëtuar me GDP për të përfituar një analizë më të kompletuar të objektivave të këtij punimi.Pra është kryer një shkrirje e modelit tregti-rritje me modelin gravitacional, bazuar dhe në hulumtimet e mëparshme nga autorë të ndryshëm

[13] Panvarësisht endogjenitetit të këtyre variablave që njihen mjaft në literaturën e teorive të tregtisë ndërkombëtare, në modelin e gravitetit të aplikuar jo pa qëllim është përdorur metoda OLS për ta eliminuar këtë endogjenitet (Frankel, Romer and Cyrus (1996))meqënëse lidhja tregti-rritje është qëllimi i analizës në këtë punim, ndërsa lidhja rritje-tregti kështillohet si subjekt i hulumtimeve të mëtejshme

[14] Marrëveshjet tregtare dypalëshe konsiderohen ato me Vendet e BE-së duke i supozuar si një bllok apo një shtet më vete që është Bashkimi Europian

[15] Nënkuptohet integrimi në BE

parandalimin e efekteve negative nga kriza aktuale globale financiare , duke përfshirë luhatjen e treguesve makroekonomik të vendit tonë dhe të atyre që e ndikojnë në mënyrë të tërthortë si Korrupsioni dhe Konkurrueshmëria .

OBJEKTIVAT E STUDIMIT

Dy objektiva kryesore janë hulumtuar në këtë studim që përfshijnë objektiva të përgjithshme dhe specifike. Për qëllim të analizës përshkruese , ky studim shqyrton dhe analizon në më shumë detaje politikat ekonomike dhe tregtare të Shqipërisë gjatë vitit 1993-2014. Kjo periudhë është zgjedhur si koha kur janë ndërmarrë politikat tregtare më të rëndësishme ekonomike. Hapja e vendit përmes liberalizimit tregtar ishte një nga politikat e zgjedhura për të arritur rritje të qëndrueshme ekonomike për Shqipërinë . Prandaj , studimi e zgjedh këtë çështje si objektiv të përgjithshëm që është analizuar duke përdorur qasje cilësore . Për objektivat specifike të analizës sasiore , është ndërtuar një model ekonometrik i ri dhe i përshtatshëm për politikat ekonomike dhe tregtare në Shqipëri pas një hulumtimi dhe rishikimi të studimeve përkatëse të mëparshme që janë kryer . Qasje të përshtatshme ekonometrike janë përdorur për të analizuar dhe interpretuar rezultatet.

Variabla të jashtëm apo ekzogjene makroekonomike janë politikat ekonomike , politikat tregtare, financiare së bashku me krizat dhe goditjet ndërsa variabli i varur është rritja ekonomike e Shqipërisë .

Për më tepër , rekomandimet janë bërë për politikat ekonomike dhe tregtare në Shqipëri sidomos në kontekste të shumëpalëshe , rajonale dhe dypalëshe . Kështu , janë përdorur si analiza cilësore ashtu dhe sasiore për të arritur këto objektiva .

Në përmbyllje, objektivat e këtij studimi janë:

1. Analizim i hollësishëm i teorive pro dhe kundër përqasjes së proçesit të liberalizimit tregtar duke paraqitur një panoramë të avantazheve dhe disavantazheve të këtij fenomeni për vendet e zhvilluara dhe atyre në zhvillim dhe impaktin që sjell në zhvillimet tregtare.

2. Evidentim teorik i debatit se cilat janë vendet që përfitojnë më shumë nga liberalizimi i tregtisë[16] dhe sa është masa e përfitimit si nga vendet e zhvilluara ashtu dhe nga ato në zhvillim.

3. Të hidhet një vështrim mbi rezultatet empirike të impaktit që ka sjellë në vendet e ndryshme në zhvillim , fenomeni i liberalizimit tregtar. Bazuar në këto eksperienca në gjithë botën të arrihet një paraqitje e plotë e impaktit të këtij fenommeni në treguesit makroekonomikë dhe masën e ndikimit.

4. Evidentimi teorik dhe historik i proçeseve liberalizuese me anë të reformave të politikave tregtare në ekonominë Botërore së bashku me përfitimet apo humbjet që sjell ky proçes.

5. Analizë e hollësishme empirike e reformave tregtare në vitet e tranzicionit për Shqipërinë duke përfshirë marrëveshjet bilaterale, rajonale dhe multilaterale nën kuadër të integrimit në BE, si dhe analizimi i kostove dhe përfitimeve.

6. Analizë e detajuar për efektet e krizës financiare në performancën ekonomike të rajonit (EJL6) duke e krahasuar këtë impakt në Shqipëri përballë vendeve të rajonit

7. Analizë e hollësishme e ecurisë së tregtisë së jashtme të Shqipërisë si dhe vlerësimi i marrëdhënieve tregtare të saj, veçanërisht lidhur me vendet e rajonit dhe Bashkimin Europian;

8. Evidentimi i teorive dhe modeleve të vlerësimit të impaktit të MTL-ve mbi rritjen ekonomike të vendeve që kryejnë proçesin e liberalizimit tregtar dhe efektivitetin e këtyre modeleve për të zgjedhur më të përshtashmin për analizën e Shqipërisë.

9. Analizë teorike e përdorimit të modelit endogjen të gravitetit (EGT), për të vlerësuar impaktin e hapjes tregtare të Shqipërisë me vendet partnere në tregti në bazë të MTL-ve të nënshkruara nën kuadrin e liberalizimit të mëtejshëm të tregtisë;

10.Analiza empirike e modelit EGT , për vlerësimin e hapjes tregtare me vendet partnere në tregti nën ndikimin e liberalizimit tregtar dhe për të përcaktuar vendin me të cilin hapja ekonomike sjell impakt më të rëndësishëm në treguesit e rritjes ekonomike, aplikuar për rastin e Shqipërisë.

[16] Hapja tregtare e vendeve në zhvillim në favor të tregjeve të vendeve të zhvilluara

11. Arritja e përfundimeve dhe dhënia e disa rekomandimeve për politikat e tregtisë së jashtme në Shqipëri më të favorshme që sjellin impakt në rritjen ekonomike dhe në treguesit e tjerë makroekonomikë.

RËNDËSIA E STUDIMIT DHE REZULTATET E PRITURA

Si anëtar i OBT-së , i TREGUT EUROPIAN dhe shumë MTL-ve bilaterale , Shqipëria ka për detyrë të reformojë politikën e saj ekonomike dhe të tregtisë në përputhje me detyrimet e këtyre organeve . Për më tepër , rajonalizimi me BE-në është bërë ndikimi më i madh në jetën ekonomike dhe politikave tregtare të vendeve në këtë rajonin e Europës Juglindore. Rajonalizimi mund të përshkruhet në terma të një rritjeje të konsiderueshme në numrin integrimeve të reja ekonomike dhe marrëveshjeve të tregtisë së lirë të zhvilluara në vitet e fundit. Ka disa shembuj të MTL-ve bilaterale dhe shumëpalëshe nën rajonalizimin europian , si p.sh. CEFTA.

Detyrime të rëndësishme të vëna nga këto organe janë të njëjta për sa i përket hapjes së vendit. Në këto detyrime janë të përfshira tregtia dhe liberalizimi i investimeve, zhvillimi ekonomik dhe bashkëpunimi për vendet anëtare. Përveç kësaj, Shqipëria ka zbatuar reforma të politikës ekonomike dhe tregtisë në mënyrë më intensive për të zgjidhur problemet ekonomike të saj gjatë periudhës së tranzicionit . Politikëbërësit besojnë se liberalizimi tregtar është një mënyrë efikase alternative për të korrigjuar këto probleme .

Si rezultat , janë realizuar reforma të ndryshme të politikës ekonomike dhe tregtare .

Eksperienca e parë e ristrukturimit të tarifave ka filluar në vitin 1992 por më intensivisht në vitin 2000 që korrespondon dhe me momentin e përqasjes në OBT dhe ristrukturimi i këtyre tarifave është kompletuar në 2009 kohë kur dhe u ratifikua Marrëveshja e Stabilizim Asocimit. Kufizimi i kontrollit të eksportit është politika tjetër që është miratuar për të gjeneruar një ekonomi të udhëhequr nga eksporti . Disa produkte , të tilla si Makineri Paisje dhe pjesë këmbimi janë nën kontroll për shkak të marrëveshjeve dypalëshe midis Shqipërisë dhe partnerëve të saj tregtarë .

Përveç kësaj,Shqipëria gjithashtu ka detyrë për të vazhduar reformat në skemat e tarifave dhe kuotave në mënyrë që të përputhenme kërkesat e OBT-së.

Për më tepër , MTL-të e ndryshme bilaterale janë padyshim një pjesë e rëndësishme e politikave tregtare të Shqipërisë. Këto politika janë përdorur për të rritur mundësitë e eksportit në tregjet potenciale dhe përmirësimin e konkurrencës, thithjen e sa më shumë tv IHD-ve . MTL-të bilaterale të Shqipërisë përfshijnë përveç atyre të parashikuara të CEFTA-s edhe ato me vende si Turqia, Rumania, Kroacia, Bullgaria.

Rezultatet e pritshme të këtij studimi janë ndërtimi dhe vlerësimi i një modeli të përshtatshëm për politikat ekonomike e tregtare në Shqipëri dhe implikimet e gjetjeve empirike për politikat ekonomike e tregtare , marrëdhëniet rajonale dhe ndikimet e krizave dhe goditjeve në treguesit e rritjes ekonomike . Implikimet për ndikimet e krizave dhe tronditjeve janë të përfshira në këtë seksion , sepse kriza dhe goditjet ishin faktorët kryesorë që ndikuan ekonominë gjatë këtyre viteve të reformave të ndryshme tregtare. Përveç kësaj, propozohen implikimet e politikave dhe rekomandimeve për tregun e vendit tonë dhe për ekonominë në tërësi . Për më tepër , politika e implikimet janë propozuar për MTL-të e përgjithshme dhe individuale . Këto implikime të politikave mund të përdoren si udhëzime për arritjen e politikave tregtare më efikase në kontekstin e liberalizimit tregtar me anë të marrëveshjeve shumëpalëshe , rajonale dhe dypalëshe të tregtisë.

KUFIZIMET E STUDIMIT

Ky studim ka disa kufizime .

Së pari , ajo merret vetëm me një rast studimor atë të Shqipërisë edhe pse ka disa vende në rajonin tonë që kanë reformuar politikat e tyre ekonomike dhe tregtare . Pra , ka një mungesë të krahasimit të ndikimit të reformave të natyrës së politikës ekonomike dhe tregtare mes vendit tonë dhe vendeve të tjera të rajonit të cila kanë përjetuar të njëjtën ecuri ekonomike .

Së dyti ,qëllimi i studimit përfshin periudhën nga fillimet e tranzicionit deri në vitin 2014 kohë në të cilën rezulton të jenë aplikuar politika të ndryshme tregtare. Problemi kryesor është se disa politikave tregtare u duhet një kohë e gjatë në dispozicion që të mund të japin impakt pozitiv në një ekonomi[17].

[17] Ndoshta kjo është dhe arsyeja se pse me vendet e rajonit rezultatet nuk janë shumë positive, për më shumë shih Brock and Durlauf (2001)

Së treti, ky studim ka përfshirë vetëm disa variabla në kontekstin e hulumtimit ndërkohë që Shqipëria ka dhe shumë faktorë të tjerë që mund të merren në konsideratë dhe që janë relevantë për rritjen ekonomike si faktorë ekonomikë ashtu edhe joekonomikë.

STRUKTURA E HULUMTIMIT

Kjo tezë është e përbërë nga pesë kapituj dhe përmbajtja e çdo kapitulli është e detajuar si më poshtë:

Si hyrje shërben një pasqyrë e kuadrit konceptual të studimit . Ky kuadër konceptual përshkruan variablat e brendshëm dhe të jashtëm ekonomikë dhe tregtarë që janë përdorur për të ndërtuar modelin ekonometrik të paraqitur në një kapitull të mëvonshëm . Ky kapitull gjithashtu propozon pyetjet kyçe të kërkimit të studimit dhe objektivat për realizimin në mënyrë sa më të plotë të analizës së impaktit të liberalizimit tregtar mbi rritjen ekonomike .

Kapitulli 1 shpjegon sfondin teorik dhe empirik lidhur me studimin dhe mbulon rishikimin e literaturës me gjithë debatet që ekzistojnë mbi fenomenin e liberalizimit të tregtisë me anë të marrëveshjeve shumëpalëshe , rajonale dhe dypalëshe duke përfshirë hapjen dhe politikat e tregtisë. Gjithashtu hedh dritë mbi impaktin që ka sjellë ky fenomen në agregatët e ndryshëm makroekonomik të një vendi në zhvillim, bazuar dhe në eksperiencat e vendeve të ngjashëm nëpër botë. Në këtë kapitull paraqiten dhe teoritë e ndryshme tregtare ndër vite në lidhje me përcaktimin e modelit të përshtatshëm për të matur efektivitetin e hapjes tregtare të një vendi në zhvillim.

Kapitulli 2 shqyrton literaturën në lidhje me globalizimin si fenomen dhe rëndësinë e marrëveshjeve tregtare midis vendeve në gjithë botën, si dhe ato që lidhen me cështjen e integrimit ekonomik rajonal. Këto çështje janë shqyrtuar në mënyrë që të sigurohet një sfond i lidhjes dhe i rëndësisë së tyre për zhvillimin dhe rritjen ekonomike, veçanërisht për vendet në zhvillim .

Kapitulli 3 diskuton kronologjinë që lidhet me cështjen e integrimit ekonomik rajonal, dhe mbi të gjitha për integrimin e Shqipërisë, zhvillimet e fundit në OBT dhe në ekonominë tonë , këtu gjithashtu paraqiten objektivat, shpjegimi dhe kuptimi i tyre , rezultatet e pritura dhe njohja e studimit .Në këtë kontekst hidhet dritë dhe mbi marrëveshjen rajonale CEFTA ku bën pjesë Shqipëria me gjithë problematikat dhe rezultatet e zhvillimit ekonomik të vendeve

të rajonit. Duke paraqitur qartë dhe impaktin e kësaj marrëveshje në përmirësimin e treguesve ekonomik (sidomos në terma tregtarë) të këtyre vendeve përfshirë dhe të dhënat për Shqipërinë. Këtu gjithashtu do të analizohen të gjithë treguesit ekonomikë për vendet e rajonit pas krizës financiare të vitit 2008-2009 dhe një paraqitje më e detajuar do ti rezervohet ecurisë së tregtisë dhe agregatëve të tjerë makroekonomik në Shqipëri për gjithë periudhën e tranzicionit deri në ditët e sotme. Këtu propozohen implikimet politike bazuar në rezultatet e kapitullit të mëparshëm , për tregtinë e brendshme dhe dypalëshe me partnerët e mëdhenj tregtar të vendit .

Kapitulli 4 përshkruan proçedurën e ndërtimit të një modeli tregti – rritje ekonomike me anë të një ekuacioni ekonometrik simultan, duke u bazuar dhe mbi teoritë e ndryshme tregtare në lidhje me përcaktimin e modelit të përshtatshëm për të matur efektivitetin e hapjes tregtare të një vendi në zhvillim. Ky model është zhvilluar duke përdorur modelin endogjen te teorisë së gravitetit(EGT) dhe është përshtatur për studimin e rastit të Shqipërisë . Përfshihet gjithashtu dhe krahasimi i këtij modeli me modele të tjera të hapjes dhe rritjes ekonomike. Kjo përmbajtje e kombinuar dhe me kapitutujt e mëparshëm të shqyrtimit të literaturës paraqet metodologjinë e ndërtimit të modelit të vlerësuar ekonometrik. Për më tepër , justifikimi teorik dhe karakteristikat e modelit janë ilustruar për të mbështetur përdorimin e modelit . Gjithashtu në këtë kapitull paraqitet dhe procesi i vlerësimit të modelit. Këtu shpjegohen dhe teknikat e vlerësimit të OLS (si vlerësues i variablit instrumental) ,duke përfshirë statistikat e përdorura për të interpretuar gjetjet empirike . Më pas kryhet edhe interpretimi i gjetjeve të vlerësuara në të dy perspektivat statistikore dhe ekonomike. Përveç kësaj , në këtë kapitull përfshihet edhe shpjegimi e besueshmërisë së modelit. Janë ndërmarrë hulumtime shtesë të literaturës nga burime vendore dhe ndërkombëtare për të lehtësuar përshtatshmërinë dhe besueshmërinë e këtyre implikimeve të politikave. Kryhen teste ekonometrike për të vërtetuar hipotezat e parashtruara në këtë studim.

Kapitulli 5 do të jetë dhe kapitulli përmbledhës dhe përmbyllës, ku do të diskutohen rezultatet e gjetura me interpretim ekonomik dhe ekonometrik. Do të jepet një konkluzion në lidhje me faktorët që kanë impakt më të fortë në treguesit e rritjes ekonomike, bazuar në gjetjet statistikore nga aplikimi i modelit EGT. Këtu propozohen dhe rekomandime të politikës për tregti plurilaterale të Shqipërisë me partnerët e saj të mëdha , bazuar në të gjetjet dhe implikimet e politikës. Dhe së fundi ofrohen konkluzionet kërkimore e këtij studimi dhe sugjerime për studime të mëtejshme .

PËRMBLEDHJE

Në përmbledhje , në këtë seksion janë paraqitur korniza konceptuale , propozimet , dhe pyetjet hulumtuese kyçe përfshirë hipotezat e studimit.

Kuadri konceptual është ndërtuar duke përdorur tre elemente thelbësore të ekonomiksit dhe politikave tregtare ndërkombëtare,të quajtur :integrimi ekonomik dhe MTL-të , Liberalizimi tregtar, dhe Faktorë të brendshëm dhe të jashtëm . Mund të thuhet se hapja e një vendi dhe rritja është ndikuar kryesisht nga liberalizimi tregtar dhe implementimi i angazhimeve të MTL-ve shumëpalëshe ,rajonale dhe dypalëshe . Faktorët e brendshëm dhe të jashtëm janë përfaqësuar nga disa variabla . 11 pyetje të rëndësishme kërkimore janë zhvilluar për të procesuar të dhënat , për të marrë vlerësime të besueshme , konkluzione dhe për të kompletuar studimin . Janë shpjeguar gjithashtu propozimet dhe hipotezat e studimit. Ata mbështesin ndërtimin e modelit të vlerësuar ekonometrik dhe gjetjet empirike në kapitujt e ardhshëm . Hapja pritet të jetë pozitive dhe domethënës për rritjen . Kriza financiare pritet të ketë peshë (të jetë domethënëse) dhe masivisht negative ndërsa reforma e sistemit financiar bankar pritet të jetë pozitiv dhe i rëndësishëm për rritjen .

Përveç kësaj, një objektiv kryesor i kësaj teze është për të provuar hipotezat konceptuale më sipër nësë janë kundër të dhënave historike të vërtetë të jetës . Përgjigjet finale do të bazohen në gjetjet e studimit empirik që do të ndërmerren në kapitujt në vijim . Në këto gjetje do të bazohen dhe implikimet politike dhe rekomandimet , pasi këto të fundit ti nënshtrohen efikasitetit ekonomik dhe testeve të ndryshme të bindshmërisë.

RISHIKIMI I LITERATURËS MBI FENOMENIN E LIBERALIZIMIT TREGTAR.

Qëllimi kryesor i këtij kapitulli është të shqyrtojë dhe analizojë në mënyrë kritike literaturën që ka të bëjë me marrëdhënien apo lidhjen që ekziston midis fenomenit të liberalizimit tregtar dhe rritjes ekonomike. Ekzistojnë evidenca që të gjitha vendet që i kanë hapur tregjet e tyre ndaj tregtisë ndërkombëtare dhe investimeve, kanë përjetuar prosperitet dhe rritje ekonomike (OECD 2011). Edhe pse një numër i konsiderueshëm studimesh kanë hulumtuar impaktin potencial që mund të ketë hapja e tregtisë në rritje ekonomike ,gjithsesi nuk ka rezultuar e lehtë përpjekja për të përcaktuar lidhjen që kanë këta dy tregues substancialë të ekonomisë . Studimet e adresuara tek rritja ekonomike kanë konstatuar probleme të tilla si endogjeniteti i disa variablave të caktuar , ndërsa studimet empirike nuk kanë qenë në gjendje për të ofruar rezultate të qarta në lidhje me ndikimin e tregtisë në treguesit e rritjes ekonomike (McCombie dhe Thirlwall , 1996; Grossman dhe Helpman , 1990 , 1991 ; Rodrik , 1999 ; Rodriguez dhe Rodrik , 1999 ; Sachs dhe Warner , 1995 ; ndër të tjera).

Rezultate të shumta tregojnë se tregtia kontribuon në përmirësimin e rritjes ekonomike (Frankel and Romer 1999). Megjithatë, nëse tregtia nuk është e kombinuar me politika adekuate për të balancuar importet kundrejt eksporteve, ajo mund të gjenerojë defiçite të bilancit tregtar dhe të bilancit të pagesave, duke krijuar në këtë mënyrë shkak për ngadalësim ose përkeqësim në rritjen e të ardhurës reale (Ocampo, Antonio , Taylor , 1998). Parë nga ana e importeve, studime të shumta pohojnë se vihet re një impakt i fortë pozitiv i liberalizimit tregtar në rritjen e importeve, dhe ky impakt rrjedh kryesisht nëpërmjet ndjeshmërisë së çmimeve dhe ndryshimeve të të ardhurave .Nga ana tjetër, studime të tjera kanë gjetur evidenca të varfëra në lidhjen midis liberalizimit dhe rritjes ekonomike .

Ky kapitull përpiqet të adresojë pyetjet përreth marrëdhënieve midis tregtisë ndërkombëtare dhe rritjes ekonomike në teori. Literatura për çështjet e tregtisë dhe rritjes ekonomike fillojnë që nga zgjerimi dinamik i modelit Heckscher-Ohlin (Hechscher, 1919; Ohlin, 1933). Disa

modele e kanë qartësisht të demonstruar se si rritja ekonomike mund të ndikojnë në modelin e tregtisë ndërkombëtare, si për shembull, Frankel dhe Romer , (1999). Modelet e fundit të

tregtisë dhe të rritjes kanë përfshirë në mënyrë innovative produktin endogjen në kuadër të ekuilibrit të një bote të integruar.

Kështu, zhvillimi i literaturës teorike mbi tregtinë dhe rritjen ekonomike duket se ka kaluar nëpër dy faza të dallueshme të përkohshme. Në vitet 1960 dhe 1970 shumë ekonomistët hulumtuan teorinë neoklasike të rritjes në kontekstin e modelit të tregtisë Heckscher-Ohlin. Pas lindjes së teorisë së re të rritjes, në fund të viteve 1980, ekonomistët filluan të përdornin më shumë teorinë endogjene të rritjes për të zhvilluar modele të tregtisë me konkurrencë jo të plotë (jo perfekte). Një numër i madh ekonomistësh kanë zbatuar modelin endogjen të rritjes për të treguar ndikimin e politikave të tregtisë në rritjen ekonomike. Pra, mund të themi se ende nuk ekziston një evidencë bindëse dhe një gjuhë e përbashkët ndërmjet studiuesve rreth efekteve në ekonomi të liberalizimit tregtar.

Prandaj në pjesën e dytë do hidhet një vështrim i përgjithshëm mbi ecurinë e teorive mbi tregtinë botërore me dinamikën dhe impaktin e liberalizimit tregtar. Pjesa e tretë do ti kushtohet avantazheve që sjell liberalizimi tregtar dhe arsyeve se pse duhet zgjedhur strategjia e hapjes ekonomike.Pra do të bëhet krahasimi nëpërmjet avantazheve dhe disavantazheve të strategjive “hapje ekonomike” dhe “tërheqje ekonomike”. Dhe së fundi do të hidhet në vështrim mbi të dhënat empirike për efektet që ka patur liberalizimi tregtar në treguesë të ndryshëm ekonomik si niveli i varfërisë, punësimi, konkurrencë dhe mbi të gjitha rritja ekonomike. Kjo do të bazohet në rezultate konkrete nga eksperienca e vendeve në zhvillim.

1.1 LITERATURA TEORIKE MBI PROÇESIN E LIBERALIZIMIT TREGTAR

1.1.1. Liberalizimi tregtar- Përkufizimi

Një nga mësimet më pak të diskutueshme të ekonomisë neoklasike është se tregtia e lirë rrit mirëqenien aggregate duke alokuar në mënyrë eficiente burimet brenda vendeve. Përkrahësit e liberalizimit tregtar kanë pritshmërinë se heqja e barrierave tregtare do të çojë në përfitime statike të larta në mirëqenie apo në afatshkurtër (ose në nivele të ardhurash më të larta) dhe si rezultat në një nivel të reduktuar të varfërisë[18]. Fitimet nga tregtia rezultojnë nga fakti se vendet e ndryshme janë të pajisur me burime të ndryshme (natyrore dhe të fituara); prandaj,kosto opportune e prodhimit të produkteve ndryshon nga njëri vend në tjetrin.

Argumentet që mbështesin teorinë se tregtia gjeneron përfitime në mirëqenien totale janë të bazuara në mënyrë tipike në teoritë afatgjata ku studimi nis vetëm me një shtet (zakonisht autarki) dhe përfundon me një shtet me tregti plotësisht të lirë , pa parashikuar në të vërtetë cfarë ndodh me vendet që ndodhen në mes [19].

Nga ana tjetër, teoritë që theksojnë konfliktet në shpërndarje që vijnë nga liberalizimi tregtar mbështetet në supozimin ekstrem lidhur me lëvizshmërinë e faktorëve të prodhimit në mënyrë që të identifikohen fituesit dhe humbësit. Për shembull, në afatgjatë modeli Heckscher-Ohlin me faktorë plotësisht të lëvizshëm, thekson se fituesit dhe humbësit janë karakterizuar nga faktorët që zotërojnë më shumë (p.sh. punë e kualifikuar kundrejt asaj të pakualifikuar dhe puna kundrejt kapitalit). Në afatshkurtër sipas modelit Ricardo-Viner,me faktorë të palëvizshëm, fituesit dhe humbësit janë karakterizuar nga zotërimet përkatëse në industritë e tyre (p.sh., industri që konkurrojnë importet kundër industrive të orientuara nga eksporti).

Në të njëjtën kohë, tregtia e lirë është larg nga të qenit e praktikuar gjerësisht, veçanërisht në vendet në zhvillim.

[18] Teoria neoklasike ekonomike ka pretenduar gjatë se tregtia rrit mirëqenien dhe rritjen ekonomike--.Adam Smith 1776

[19] Pra për vendet në fazat e tranzicionit si Shqipëria.

Edhe vendet që zbatuan reforma të rëndësishme tregtare në vitet 1980 dhe 1990, të tilla si Brazili,Kolumbia dhe India, ende zbatojnë tarifa të larta importi në shumë industri(Anderson and Martin, 2005). Ekzistenca e konflikteve në shpërndarje është me të vërtetë një konsideratë e rëndësishme që kufizon miratimin e tregtisë së lirë [Rodrik (1995) dhe Limão dhe Panagariya (2007)]. Megjithatë, një numër i konsiderueshëm burim shqetësimi për politikë-bërësit është se ende na mungon një kuptim i mirë të asaj se si ekonomia do të sillet në periudha afatshkurtër dhe afatmesme si pasojë e liberalizimit tregtar. Kjo është e rëndësishme për të përcaktuar se sa shpejt mund të realizohen fitimet nga tregtia, dhe për të karakterizuar më mirë se kush në të vërtetë janë fituesit dhe humbësit nga liberalizimi tregtar.

Megjithatë tregtia e lirë ndihmon për të përhapur vlerën e lirisë, të përforcojë sundimin e ligjit dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik në vendet e varfra. Për të kuptuar se si tregtia e lirë krijon një treg të mirë le të hedhim një vështrim në përfitimet e saj.

Më konkretisht **AVANTAZHET** do ti listojmë në këtë mënyrë:

1. ***Avantazh krahasues:*** Sipas teorisë së përparësive krahasuese vendet kanë mundësi që të kenë mallra me kosto më të ulët, në mënyrë që të çojnë në një rritje të mirëqënies ekonomike të të gjitha vendeve. Çdo vend bën atë që është më e mira dhe tregton me vendet e tjera për nevojat e saj. Në këtë mënyrë tregu përfaqëson furnizimin e vërtetë të kërkesës dhe mbi të gjitha lejon përfitime nga tregtia për të gjitha vendet.

2. ***Ekonomia e shkallës:*** Kur vendet janë specializuar në mallra të caktuar që ata mund të prodhojnë, ato mund të përfitojnë nga ekonomia e shkallës për të prodhuar këto mallra me kosto mesatare më të ulët. Kjo është më e dobishme për industritë ku kostoja fikse e prodhimit është shumë e lartë ose ku investimet e nevojshme janë të larta. Nga specializimi në produkte të tilla, industria mund të fitojë nga ekonomia e shkallës kosto më të ulta të prodhimit. Këto do të transferohen për konsumatorin si çmime më të ulta për mallrat përfundimtare.

3. ***Rrit konkurrencën e shëndetshme***: Kur kërkesat rriten nga jashtë, industritë do të përgjigjen për kërkesat duke ulur kostot dhe rritjen e efikasitetit. Kjo do të parandalojë krijimin e monopoleve në tregun e brendshëm, të cilat çojnë në çmime të larta. Kështu tregtia e lirë sjell një konkurrencë të shëndetshme në kuadër të industrisë vendase.

4. ***Përdorim efektiv të lëndëve të para:*** tregtia e lirë jo vetëm që sjell rritjen ekonomike, por edhe i përdor lëndët e para në mënyrë efektive, kjo vlen sidomos për ato materiale që janë shumë të vlefshme dhe shumë të kufizuara.

5. ***Kosto më e ulët jetese:*** tregtia e lirë me ndërhyrjet e qeverisë me anë të subvencioneve , tarifave dhe taksave, ka siguruar që produktet dhe shërbimet të prodhohen në mënyrë efikase dhe me një kosto më të ulët duke çuar në cmime më të vogla për produktet dhe në këtë mënyrë kosto më të vogël të jetesës.

6. ***Rritja e zgjedhjes***: Tregtia e lirë çon në rritjen e eksporteve dhe importeve duke sjellë një sasi më të madhe në dispozicion të produkteve në treg, dhe më shumë mundësi zgjedhje për konsumatorin. Një konsumator ka mundësi të blej mallra bazuar në kërkesat e cilësisë dhe buxhetit.

7. ***Qeverisje të mirë dhe lidhje paqësore ndërkombëtare:*** Tregtia e lirë parandalon nevojën për politika proteksioniste nga ana e qeverisë duke promovuar kështu një qeverisje të shëndetshme. Historia ka provuar se tregtia e lirë ka disa përfitime në krahasim me një ekonomi proteksioniste. Ajo ka përfitime në lidhje me industrinë, konsumatorin, ekonominë dhe botën si një e tërë. Edhe pse tregtia e lirë ka shumë përparësi ose avantazhe ajo prap ka disa kosto dhe kundërshtarë që janë kundër saj.

Pra **DISAVANTAZHET** e saj, do ti listojmë në këtë mënyrë:

1. ***Varësia ekonomike***: Tregtia e lirë shton varësinë ekonomike me vendet e tjera për produkte të caktuara themelore të tilla si ushqimi, materiale të papërpunuara; varësi të tilla dëshmojnë se janë të dëmshme, në veçanti gjatë kohës së luftës.

2. ***Skllavëria politike:*** Tregtia e lirë çon në varësi ekonomike dhe varësia ekonomike çon në skllavëri politike. Për lirinë politike, është e nevojshme pavarësia ekonomike. Kjo shpjegon dhe arsyen e braktisjes e tregtisë së lirë nga ana e disa vendeve.

3. ***Zhvillimi i paekuilibruar:*** Tregtia e lirë dhe rezultatet e saj çojnë në zhvillimin ndërkombëtar të specializimit të çekuilibruar të ekonomisë kombëtare. Sipas këtij sistemi, janë zhvilluar vetëm ata sektorë në të cilat vendi ka avantazh krahasues. Sektorët e tjerë mbeten të pazhvilluar.

4. ***Produktet e dëmshme:*** Sipas tregtisë së lirë, mund të prodhohen dhe të tregtohen edhe produktet e dëmshme. Prandaj janë të nevojshme kufizimet e tregtisë, pikërisht për të kontrolluar importin e produkteve të tilla.

5. ***Monopolet ndërkombëtare***: Tregtia e lirë mund të çojë në monopole ndërkombëtare. Ajo inkurajon krijimin e koorporatave multinacionale. Këto koorporata kanë tendencë për të marrë postin monopol dhe kështu dëmtojnë interesin e popullsisë vendase.

6. ***Reduktimi i mirëqënies së grupeve të caktuara:*** Ndërsa tregtia e lirë ka tendencë për të maksimizuar prodhimin botëror të mallrave dhe shërbimeve, në të njëjtën kohë ajo mund të dëmtojë mirëqënien e grupeve të caktuara në çdo vend. Sipas tregtisë së lirë, prodhimi i mallrave ka tendencë të rritet për të përmbushur tendencën e eksportit dhe prodhimit të mallrave në të cilat vendi ka kontrata krahasuese. Kështu të ardhurat reale të grupeve të angazhuara në industrinë e eksportit do te rriten, dhe në industrinë e importit konkurrenca do të bjerë.

7. ***Politika reale:*** Politika e tregtisë së lirë është e bazuar në supozimin lassez-faire ose qeveri jondërhyrëse. Suksesi i tij kërkon gjithashtu parakushte të konkurrencës perfekte megjithatë kushte të tilla janë jorealiste dhe nuk eksistojnë në botën aktuale.

8. ***Të dëmshme për vendet më pak të zhvilluara:*** Tregtia e lirë është e dëmshme për vendet më pak të zhvilluara për arsyet e mëposhtme[20]:

a. Vendet më pak të zhvilluara e kanë të vështirë për të konkurruar në vendet ekonomikisht më të përparuara.

b. Fitimet e tregtisë janë të shpërndara në mënyrë të pabarabartë varësisht nga shkalla e zhvillimit të vendeve të ndryshme. Kushtet e tregtisë janë të favorshme për vendet e zhvilluara dhe jo të favorshme për vendet e varfra.

c. Vendet më pak të zhvilluara në përgjithësi përjetojnë bilanc e pagesash të pafavorshëm.

d. Vendet më pak të zhvilluara nuk mund të mbrojnë industrinë e tyre të mitur në kuadrin e politikës së tregtisë së lirë.

[20] Sipas një analize në një revistë ekonomike të autorit “Kaplinsky, R”, 2000,

e. Tregtia e lirë mund të rrezikojë pavarësinë ekonomike dhe politike të kombeve. Tregtia e lirë është shumë subjektive kjo për shkak të mendimit mbi avantazhet e tregtisë së lirë, që varet kryesisht nga bindjet personale, përvoja dhe mendimi.

1.1.2 Pse Liberalizim Tregtar?

Liberalizimi tregtar luan një rol të rëndësishëm në zhvilllimin ekonomik të një vendi, për faktin se një nga avantazhet kryesore është eliminimi i barrierave tarifore midis vendeve. Padyshim që lëvizja e tregtisë së lirë janë bërë terma të ditës pothuajse për të gjithë opinionin ekonomik, politik, gazetaresk dhe administrativ në të gjitha vendet.

Liberalizimi tregtar pritet të veprojë pozitivisht në zhvillimin ekonomik botëror dhe zbutjen e varfërisë, të cilat të dyja janë bërë prioritete të larta të komunitetit ndërkombëtar. Ky theksim shpjegon pse studime të shumta të autorëve të ndryshëm si Dollar (1992), Sachs and Warner (1995), Edwards (1998) ,Frankel and Romer (1999); janë përqendruar në vlerësimin e përfitimeve e pritshme të liberalizimit tregtar në zhvillimin e vendeve dhe në rritjen ekonomike.

Sipas FMN në një studim për vendet në zhvillim politikat që e bëjnë një ekonomi të hapur për tregtinë dhe investimet me pjesën tjetër të botës janë të nevojshme për rritjen e qëndrueshme ekonomike. Dëshmia për këtë është e qartë. Asnjë vend në dekadat e fundit nuk ka arritur suksesin ekonomik , në aspektin e rritjes substanciale në standardet e jetesës për popullin e saj , pa qenë e hapur për pjesën tjetër të botës (OECD 2013) . Në të kundërt, hapja tregtare së bashku me hapjen ndaj investimeve të huaja direkte ka qenë një element i rëndësishëm në suksesin ekonomik të Azisë Lindore , ku tarifa mesatare e importit ka rënë nga 30 përqind në 10 përqind gjatë 20 viteve të fundit.

Hapja e ekonomive të tyre në ekonominë globale ka qenë thelbësore në mundësimin që shumë vende në zhvillim të zhvillojnë avantazhe konkurruese në prodhimin e produkteve të caktuara. Në këto vende , të përcaktuar nga Banka Botërore si " globalizuesit e rinj," ka rënë numri i njerëzve në varfëri absolute me mbi 120 milion (14 përqind) midis viteve 1993 dhe 1998[21].

[21] Shih " World Bank, Globalization, Growth, and Poverty: Facts, Fears, and an Agenda for Action, forthcoming".

Hapja ekonomike tregon se ka efekte pozitive të shumëfishta nëpërmjet shumë kanaleve

- P.sh,firmat përballen me konkurrencën e cila rrit presionet për përmirësime cilësore të produkteve përfundimtare por përballen dhe me efektet e ekonomizimeve të shkallës që vijnë nga zgjerimi i tregjeve.
- Gjithashtu tregjet e faktorëve, e lëndëve të para dhe produkteve gjysëm të gatshëm alokojnë burimet në ato sektorë ekonomike ku vlera e shtuar është më e lartë dhe burimet shpërblehen më shumë.
- Nëpërmjet shkëmbimeve tregtare dhe financiare vendet tregojnë dhe mësojnë nga njëri-tjetri duke eksternalizuar sjellje dhe forma më efiçente drejt optimizimit.

Kontratat në marrëveshjet ekonomike dhe financiare me firmat e huaja si dhe IHD, mundësojnë aksesin jo vetëm në njohuri të reja të trupëzuara në produktet e tregtuara dhe kapitalin fizik por dhe në rregulla dhe praktika menaxhimi efiçente të biznesit. Të gjitha këto tregojnë se ekonomitë po krijojnë një lidhje funksionale midis tyre si dhe njohin e kuptojnë më mirë njëri-tjetrin duke bërë të mundur kohezionin social.

Ka dëshmi të konsiderueshme (IMF,1997; Jeffrey Frankel and David Romer, 1999) që vendet më shumë të orientuara nga jashtë (drejt eksporteve) kanë tendencë të vazhdueshme të rriten më shpejt se ato që janë të orientuara brenda (drejt importeve). Në të vërtetë, një konstatim është se përfitimet e liberalizimit tregtar mund të tejkalojnë kostot me një faktor prej më shumë se 10 (Steven Matusz and David Tarr ,1999). Vendet që kanë hapur ekonomitë e tyre në vitet e fundit, kanë përjetuar rritje më të shpejtë dhe më shumë reduktim varfërie. Mesatarisht, ato vende në zhvillim që ulën tarifat ndjeshëm në vitin 1980 u rritën shumë më shpejt në vitet 1990 se sa ato që nuk e bënë dot (Dollar, 2001 ; Peter Lindert and Jeffrey Williamson, 2001).

Liberalizimi tregtar shpesh u jep përfitime vendeve të varfëra në veçanti. Potenciali i liberalizimit tregtar për të nxitur rritjen ekonomike kombëtare është pranuar ndërkombëtarisht (Harrison ,1996; Paulino ,2002; Wacziarg , 2001). Ky proçes mund të ndihmojë vendet për të shfrytëzuar avantazhin e tyre krahasues në prodhimin e mallrave rajonal-specifik dhe të përfitojnë nga tregjet më të mëdha për produktet që e kanë të kufizuar kërkesën lokale. Vlerësimet e fitimeve nga eliminimi i të gjitha pengesave për tregtinë e mallrave shkojnë nga 250 billion US $ në US $ 680 bilion në vit . ***Rreth dy të tretat e këtyre fitimeve vërtet do të grumbullohen në vendet industriale, por shuma e akumuluar për vendet në zhvillim***

do të jetë më shumë se dyfishi i nivelit të ndihmës që ata aktualisht marrin[22]. Për më tepër , vendet në zhvillim do të fitojnë nga liberalizimi tregtar global si një përqindje e GDP-së së tyre më shumë sesa vendet industriale , për shkak se ekonomitë e tyre janë shumë më të mbrojtura dhe për shkak se ata përballen me barriera të larta.

Vendet në zhvillim mund të keq- përballojnë subvencione të mëdha të nënkuptuara që i siguron mbrojtja e tregtisë,të cilat shpesh kanalizohen për interesa të ngushta . Sipas survejimit të OECD[23], vende të reja pune krijohen për punëtorët e pakualifikuar , duke i ngritur ato në klasën e mesme . Edhe në një situatë të papunësisë relativisht të lartë, në qoftë se ekonomitë e G20[24] reduktojnë pengesat tarifare dhe jo tarifore (të tilla si procedurat administrative) me 50%, punësimi i punëtorëve me nivel të ulët kualifikimi mund të rritet në peridheën afat të shkurtër me 0.3% - 3.3%, në varësi të vendit, dhe punësimi i punëtorëve të kualifikuar me 0.9% -3.9%. Për periudhën afat të gjatë, rritja e punësimit mund të jetë rritet nga 0.9% deri në 3.9% për punëtorët më pak të kualifikuar dhe 0.1% deri në 4% për punëtorët me kualifikim të lartë, në varësi të vendit.

Gjithashtu edhe liberalizimi i investimeve të huaja direkte sjell përfitime afatgjata në tregun e punës për vendet e G20.Studimi nxjerr në pah se efekti ndihet edhe në paga reale më të larta. Një reduktim 50% të barrierave tregtare gjithashtu mund të sjellë një rritje të pagave reale në të gjitha ekonomitë e G20. Pagat reale të punëtorëve me kualifikim të ulët mund të rriten me 1.8% - 8% në varësi të vendit; ato të punëtorëve të kualifikuar mund të përjetojnë një rritje prej 0.8% - 8.1%.

Të gjitha ekonomitë e G20 do të mund të përjetojnë një rritje të konsiderueshme në eksportet e tyre në qoftë se barrierat tregtare përgjysmohen. Në afat të gjatë, shumë vende të G20 do të mund të shohin eksportet e tyre të rriten me mbi 20% dhe në Eurozonë me më shumë se 10%. Nëpërmjet hapjes tregtare dhe tregtisë ndërkombëtare, firmat kanë qasje në inputet e ndërmjetme dhe shërbime, të cilat e rrisin produktivitetin dhe konkurrencën e tyre. Përfitimet e mundshme nga eliminimi i barrierave tregtare të mbetura janë të konsiderueshme. Liberalizimi gjithashtu mund të gjenerojë ekonomitë e shkallës, rritjen e efikasitetit dhe të ulë

[22] Të dhënat e publikuara në faqën e Komisionit Europian http://madb.europa.eu/madb/statistical_form.htm

[23] "TRADE LIBERALISATION: BOOSTING EMPLOYMENT AND GROWTH", OECD Trade Policy Working Paper no. 107, January 2011

[24] Argjentina, Australia, Brazili, Kanadaja, Kina, Franca, Gjermania, India, Indonezia, Italia, Japonia, Meksika, Rusia, Arabia Saudite, Afrika e Jugut,Korea e Jugut, Turqia, Mbretëria e Bashkuar, SHBA dhe BE(si një shtet i vetëm).

kostot e prodhimit. Vendet mund të mbeten konkuruese -duke fituar të njëjtin akses tek partnerët për tregti më të madhe sa konkurrentët e tyre rajonalë.

Nëse të gjitha vendet i reduktojnë tarifat me 50%, vendet më pak të zhvilluara të Azisë dhe Afrikës do të mund të shohin një rritje në eksporte dhe në punësimin e punëtorëve me aftësi të lartë në të njëjtën masë me ata me aftësi të ulët. Masat e liberalizimit tregtar do të lejojnë që këto përfitime të jenë të mundshme për t'u realizuar. Këto masa duhet të merren në baza multilaterale përmes përfundimit të negociatave tregtare me OBT-në dhe të plotësohen me politika të përshtatshme të punësimit, punës dhe arsimit, në mënyrë që përfitimet e tregtisë të mund të ndahet në mënyrë të barabartë midis vendeve. Në përgjithësi , pabarazia mes vendeve ka qenë në rënie që nga viti 1990 , duke reflektuar rritjen më të shpejtë ekonomike në vendet në zhvillim , pjesërisht si rezultat i liberalizimit tregtar.

Në fakt, pavarësisht se përfitimet nga eliminimi i barrierave tarifore, mbështetja ndaj produktit vendas, dhe subvencionet e eksportit kanë rezultuar kohët e fundit në rënie, megjithatë, liberalizimi tregtar është i dobishëm dhe mund të kontribuojë edhe në zbutjen e varfërisë. Argumenti tradicional në favor të një marrëdhënie pozitive midis liberalizimin e tregtisë dhe varfërisë përqendrohet në dy lidhjet:

1. Shumë njerëz të varfër punojnë në sektorin e bujqësisë, ku shtrembërimet e tregtisë janë veçanërisht të larta.

2. Liberalizimi mund të nënkuptojë çmime më të larta botërore bujqësore dhe mund të rrisë aktivitetin dhe shpërblimet në këtë sektor në Botën e Tretë .

Rezultate të njëjta të dobishme mund të ndodhin edhe në sektorët e tekstileve dhe të veshjeve, ku mbrojtja mbetet e lartë dhe ku vendet në zhvillim kanë një avantazh krahasues.

Edhe pse ka shumë përfitime nga aksesi i përmirësuar në tregjet e vendeve të tjera , vendet mund të përfitojnë më shumë nga liberalizimi i vetë tregjeve të tyre . Përfitimet kryesore për vendet e industrializuara do të vijë nga liberalizimi i tregjeve të tyre bujqësore . Vendet në zhvillim do të fitojnë në mënyrë të barabartë nga liberalizimi i manifakturës dhe bujqësisë. Grupi i vendeve me të ardhura më të ulëta , megjithatë, do të fitojnë më shumë nga liberalizimi i bujqësisë në vendet industriale , për shkak të rëndësisë më të madhe relative të bujqësisë në ekonomitë e tyre

1.1.3 Tërheqje ekonomike apo hapje ekonomike

Strategjia e ***"tërheqjes ekonomike"*** ka të bëjë me tërheqjen për pak kohë të një ekonomie nga pjesëmarrja në ekonomitë botërore nëpërmjet zëvendësimit të importeve me produkte të prodhuara brenda vendit. Duke zhvilluar në vend ato degë që mund të zëvendësojnë importet, sipas kësaj strategjie do të zhvillohej industria përpunuese dhe do të rritej aftësia eksportuese e vendit në produktet e përpunuara.

Mjetet që mund të përdoren në këtë strategji janë tarifat, kuotat e importit, subvencionet për degët e produkteve zëvendësuese të importit etj. Por firmat vendase duke qenë të mbrojtura nëpërmjet subvencioneve të ndryshme nga konkurrenca e huaj, nuk janë të nxitura për të qenë efiçente. Ato nuk mund të përfitojnë nga ekonomizimet e shkallës për të konkurruar në tregjet globale apo rajonale. Procesi i zëvendësimit të produkteve të importit bëhet më i kushtueshëm sa më të larta të jenë normat tarifore të mbrojtjes dhe sa më e avancuar të jetë teknologjia që duhet të përdoret. Gjithsesi, strategjia e "tërheqjes ekonomike" ka edhe **AVANTAZHET** e saj:

- Degët që prodhojnë produktet zëvendësuese të importit kanë risk të ulët për ngritjen dhe vazhdimësinë e tyre, përderisa ka kërkesë importi.
- Është më e lehtë për vendet në zhvillim që të mbrojnë tregun e brendshëm nga konkurrenca e huaj sesa të imponojnë vendet e zhvilluara që të ulin pengesat ndaj eksporteve të përpunuara të tyre.
- Do të ketë investime të firmave nga vendet e zhvilluara në këto vende për të shmangur detyrimet tarifore.

Strategjia tjetër është ajo e ***"hapjes ekonomike",*** e cila synon pjesëmarrjen aktive në tregtinë ndërkombëtare. Sipas kësaj strategjie alokimi i burimeve do të bazohet nga sinjalizimi i çmimeve të tregut dhe do të reflektojë në avantazhet krahasuese të vendit.Tregjet e lira, me barriera minimale të hyrjes, janë të një rëndësie kryesore. Ndryshe kjo strategji quhet edhe strategji e orientimit nga eksporti pasi ajo e vë theksin në masat politike që çojnë në nxitjen e eksporteve.

Disa nga masat politike që do të çonin në nxitjen e eksporteve do të ishin:

- subvencionimi i degëve e sektorëve të produkteve të eksportit, sidomos të produkteve të industrisë përpunuese që përdorin intensivisht punë.

- nxitja e investimit në kapitalin human, nxitja e përdorimit të teknologjive të përparuara etj.

Këto konsiderata theksojnë nevojën për liberalizimin të mëtejshëm tregtar. Edhe pse mbrojtja ka rënë ndjeshëm gjatë tre dekadave të fundit , ajo mbetet e konsiderueshme si në vendet e industrializuara ashtu dhe në ato në zhvillim , veçanërisht në fusha të tilla si produkte bujqësore apo manifaktura dhe shërbimet që kërkojnë punë-intensive (p.sh. , ndërtimi), ku vendet në zhvillim kanë përparësi krahasuese.

Nëpërmjet strategjisë së "hapjes ekonomike", firmat vendase nuk janë të detyruara të mbështeten vetëm në tregun e kufizuar të brendshëm, por ato do të përfitojnë nga ekonomizimet e shkallës të tregjeve globale apo rajonale. Prodhimi i produkteve të përpunuara për eksport nxit efiçencën në të gjithë ekonominë.

Vendet industriale mbajnë mbrojtje të lartë në bujqësi përmes një rrjeti tarifash shumë të larta, duke përfshirë tarifat mbi 15 për qind , eskalimin e tarifave (tarifat që rriten me nivelin e përpunimit) , dhe kuotave tarifore kufizuese (kufizime në sasinë që mund të importohet me një normë tarifore të ulët) . Mbrojtja mesatare e tarifës në bujqësi është rreth nëntë herë më e lartë sesa në manifakturë . Përveç kësaj , subvencionet bujqësore në vendet industriale , të cilat janë ekuivalente me 2/3 e totalit të PBB- së së Afrikës minojnë zhvillimin e sektorëve bujqësor dhe eksportet e vendeve në zhvillim duke deformuar çmimet botërore dhe duke i falimentuar tregjet[25]. Për shembull ,një rast i vecantë është ai i Komisionit Evropian i cili është duke shpenzuar 2.7 bilion € në vit duke e bërë sheqerin fitimprurës për fermerët evropiane në të njëjtën kohë është dhe duke eliminuar importet me kosto të ulët të sheqerit tropikal.

Në vendet industriale , mbrojtja e prodhimit në përgjithësi është e ulët, por mbetet e lartë për shumë produkte të prodhuara nga vendet në zhvillim . Për shembull ,Shtetet e Bashkuara , e kanë tarifën mesatare të importit prej vetëm 5 për qind , por kanë tarifa të larta në pothuajse 300 produkte individuale . Këto janë kryesisht në tekstile dhe veshje , të cilat përbëjnë 90 për qind të $ 1 miliard në vit që shpenzon SHBA për importet nga vendet më të varfra.

Pra edhe kjo strategji ka kostot e saj. Prodhimi më i stabilizuar dhe më efiçent në vendet e zhvilluara bën që ngritja e industrive për eksport në vendet në zhvillim të jetë i vështirë.

[25] Të dhënat e publikuara në faqën e Komisionit Europian http://madb.europa.eu/madb/statistical_form.htm

Vendet e zhvillluara përdorin mjete të larta mbrojtëse për industrinë përpunuese, aty ku vendet në zhvillim mund të kenë edhe avantazhet e tyre krahasuese.

Pra siç e shikojmë të dyja strategjitë kanë si synim zhvillimin e industrisë përpunuese vendase, por secila nëpërmjet rrugëve të ndryshme. Mjaft ekonomistë sugjerojnë se politika e zëvendësimit të importeve mund të jetë një politikë mjaft e favorshme në hapat e para të zhvillimit të ekonomisë në vendet në zhvillim dhe në ato të tranzicionit. Gjithashtu në hapat e mëvonshëm të zhvillimit është i nevojshëm orientimi nga eksporti. Pra të dyja strategjitë ,si ajo e "tërheqjes ekonomike" ashtu dhe ajo e" hapjes ekonomike " nuk mund t'i quajmë thjesht si alternativa të njëra-tjetrës , por edhe si strategji komplementare.

Shumë vende në zhvillim vetë kanë tarifa të larta. Mesatarisht , tarifat e tyre mbi produktet industriale të importit janë tre deri në katër herë më të larta sa ato të vendeve industriale , dhe shfaqin të njëjtat karakteristika të tarifave tavan dhe të atyre progresive . Tarifat për bujqësinë janë edhe më të larta rreth 18 përqind (IMF and World Bank ,2001) më të larta sesa për produktet industriale.

Masat jotradicionale që pengojnë tregtinë janë të vështira për t'u matur dhe vlerësuar , por janë duke u bërë gjithmonë e më domethënëse aq sa dhe mbrojtja tarifore tradicionale si dhe kuotat në rënie të importit. Masat antidumping janë në rritje si në vendet e industrializuara ashtu edhe në ato në zhvillim , por vendet në zhvillim janë përballur me to në mënyrë disproporcionale . Rregulloret që kërkojnë që importet të jenë në përputhje me standardet teknike dhe sanitare përbëjnë një pengesë të rëndësishme. Ato imponojnë kosto mbi eksportuesit që mund të tejkalojnë përfitimet për konsumatorët .

Për një sërë arsyesh, skema preferenciale e aksesit për vendet e varfëra nuk ka rezultuar të jetë shumë efektive në rritjen e aksesit në tregje të tjera për këto vende . Skema të tilla shpesh përjashtojnë , ose sigurojnë më pak përfitime për produktet e mbrojtura të cilat janë me shumë interes për eksportuesit në vendet më të varfra . Ato shpesh janë komplekse, jotransparente , dhe i nënshtrohen përjashtimeve dhe kushteve të ndryshme (duke përfshirë edhe ato joekonomike) që kufizojnë benefitet që janë arritur nga aksesi në tregje.

Liberalizimi i mëtejshëm (nga të dy vendet si ato industriale dhe vendet në zhvillim) , do të jetë i nevojshëm për ta bërë potencialin e Tregtisë si një forcë shtytëse për rritjen dhe zhvillimin ekonomik . Përpjekjet më të mëdha nga vendet industriale , dhe nga bashkësia ndërkombëtare e më gjerë, janë bërë për të hequr barrierat tregtare me të cilat përballen

vendet në zhvillim, veçanërisht vendet më të varfra . Nga ana tjetër, vendet në zhvillim do të arrijnë të forcojnë ekonomitë e tyre (dhe partnerët e tyre tregtarë) në qoftë se bëjnë një përpjekje të vazhdueshme për të reduktuar pengesat e veta të tregtisë më tej.

Aksesi i rritur në tregje ndërkombëtare për vendet më të varfra (në zhvillim) do tu sigurojë atyre mjete për të shfrytëzuar tregtinë për zhvillimin e vendit dhe reduktimin e varfërisë. Duke i ofruar vendeve më të varfra akses dhe kuota falas në tregjet botërore do tu japë këtyre vendeve përfitime të mëdha me kosto të ulët për pjesën tjetër të botës . Që të jetë plotësisht efektiv , një akses i tillë duhet të bëhet i përhershëm , i zgjeruar për të gjitha mallrat , dhe i shoqëruar me rregulla të thjeshta , transparente. Kjo do t'u jepte vendeve më të varfra besim të vazhdojnë me reforma të brendshme të vështira për të siguruar përdorimin efektiv të lehtësimit të borxhit dhe përdorimin efektiv të flukseve të ndihmës .

1.2 LITERATURA EMPIRIKE-------*EFEKTET E LIBERALIZIMIT NË AGREGATËT MAKROEKONOMIKË*

Kjo çështje përqëndrohet në një kërkim empirik mbi efektet e proçesit të liberalizimit tregtar në sistemin e pagave, në uljen e papunësisë , në konkurrencën e lirë, në treguesit e varfërisë dhe mirëqënien e individëve, pra në rritjen ekonomike në tërësi. Liberalizimi tregtar si pjesë e procesit të globalizimit ka një impakt të pabarabartë në vende të ndryshme. Impakti pozitiv në tregun e punës që rezulton me ulje papunësie, do të rriste mirëqënien apo të reduktonte varfërinë në vendet në zhvillim. Efektet në mirëqënie maten kryesisht nëpërmjet ndryshimeve në çmime duke u fokusuar në efektet në kërkesën relative për faktorë prodhimi vendas dhe në vecanti në kërkesën relative për punë të kualifikuar.

Sipas analizës agregate impakti i globalizimit dhe rrjedhimisht i integrimit ekonomik është i lidhur ngushtë me mekanizmin e transmisionit të çmimeve dhe operon nëpërmjet dy kanaleve kryesore.

Së pari impakti ndjehet në cmimet e brendshme të të mirave dhe të faktorëve të prodhimit siç janë pagat, përfitimet, kthimet nga kapitali dhe toka; rrjedhimisht literatura

tregon se për vendet që kanë kapital fizik dhe human relativisht të lartë, një ekspansion në lirinë tregtare do të tentojë të ulë pagat relative për punëtorët e pakualifikuar duke cuar kështu në një pabarazi më të madhe në tregun e punës dhe në shpërndarjen e të ardhurave.

Së dyti impakti do të varet nga masa e varësisë së individëve nga varieteti i të mirave dhe i faktorëve të prodhimit dhe nga tipi i sektorit ku këta individë janë të punësuar (psh: sektorë kompetitivë të import-eksportit).

Këtu shtrohet një pyetje e thjeshtë empirike: A mund të supozojmë se liberalizimi tregtar do të prodhojë rezultate mesatarisht të dobishme në tregun e punës për të gjitha vendet pjesëmarrëse në tregun global? Fokusi mbetet në impaktin që ka liberalizimi në reformimin e tregut të punës dhe sa do të ndikojë një reformë në punësimin e punëtorëve në një vend apo sa do të ndihmojë në uljen e papunësisë si një fenomen shumë i rëndësishëm në uljen e varfërisë (Dollar and Kraay, 2002) së vendeve në zhvillim apo dhe në rritjen ekonomike.

Njëri interpretim ai dhe më konservativi i gjetjeve është se një treg pune i liberalizuar si rezultat i liberalizimit të tregjeve në mallra dhe shërbime, nuk mund të gjenerojë impakte pozitive në rritjen e punësimit apo në reduktimin e normës së papunësisë (Wood 1994).

Nëse janë gjetur efekte pozitive të reformave liberalizuese, ka të ngjarë të jenë të kushtëzuar nga faktorë të tjerë (p.sh. politikat fiskale apo sociale, variablat makroekonomikë, institucionale ose politike).

1.2.1 Impakti i liberalizimit në treguesit e varfërisë

A ka efekt liberalizimi tregtar në reduktimin e varfërisë?

Pyetja është mjaft e rëndësishme dhe relevante . Ishte në majën e objektivave në agjendën në fund të viteve 1990, dhe pas një dekadë apo më shumë qetësie, kjo çështje ka filluar përsëri të shqetësojë politikëbërësit . Për fat të mirë , ndërsa ka qartë përjashtime , përgjigja është se: në afat të gjatë dhe mesatarisht, pothuajse gjithmonë , **"PO"**, liberalizimi tregtar redukton varfërinë [Frankel dhe Romer (1999), Sachs dhe Warner(1995)].
Proçesi i liberalizimit tregtar i ndërmarrë nga shumë vende në zhvillim gjatë viteve të kaluara ka qenë i shoqëruar nga shqetësimet e përhapura se hapja e tregut të brendshëm në vendet në

zhvillim do të ndikojë negativisht të varfërit dhe do të përkeqësojë shpërndarjen e të ardhurave. Ndërsa shumica e ekonomistëve janë dakord mbi faktin se ekonomitë e hapura performojnë më mirë se ato të mbyllura, dhe politikat e hapura sigurojnë një kontribut domethënës për zhvillimin ekonomik dhe rritjen ekonomike. Shumë komentues kanë frikë se, si në afat të shkurtër ashtu edhe në afat të gjatë, liberalizimi tregtar mund të jetë i dëmshëm për agjentët më të varfër në ekonomi (Oxfam International, 2003 dhe 2005).

Në fakt, mund edhe të jetë, siç argumentohet nga Aisbett (2005), që interpretimi që i bëjnë njerëzit evidencës së disponueshme mbi ndikimet e liberalizimit tregtar në varfëri është ndikuar fuqimisht nga vlerat e tyre dhe nga besimet e tyre rreth procesit të globalizimit.
Winters et al. (2004), kanë studiuar punën empirike mbi liberalizimin tregtar dhe mbi varfërinë. Ata theksojnë se ka shumë dëshmi që liberalizimi tregtar ndikon çdo shtresë të shoqërisë, dhe se aftësia e ekonomive familjare për t'iu përgjigjur impaktit që sjell liberalizimi ndryshon nga njëra shtresë në tjetrën. Teoria sugjeron se liberalizimi tregtar mund të zbusë varfërinë në afat më të gjatë dhe mbi mesatare, dhe ka dëshmi empirike që përkrah këtë pikëpamje. Megjithatë, ata gjithashtu paralajmërojnë se kjo pikëpamje nuk pohon se politikat tregtare janë gjithmonë ndër përcaktuesit më të rëndësishëm të reduktimit të varfërisë ose se efektet e liberalizimit tregtar janë gjithmonë të dobishme për të varfërit.

Në vend të kësaj liberalizimi tregtar nënkupton domosdoshmërisht disa ndryshime në shpërndarje dhe, të paktën në periudhë afatshkurtër , mund të zvogëlojë mirëqenien e disa individëve dhe disa nga këta mund të jenë të varfërit.
Winters et al. (2004) gjithashtu theksojnë se, duke pasur parasysh një sërë faktorësh që duhet të merren në konsideratë, vështirë se do të jetë e habitshme që nuk ka rezultate statike krahasuese për ndikimin e liberalizimit tregtar në varfëri. Megjithatë, në një studim të veçantë të OBT-së, Winters (1999) arrin në përfundimin se liberalizimi tregtar në përgjithësi kontribuon fort për zbutjen e varfërisë. Ai gjithashtu pranon se shumica e reformave mund të krijojë disa humbës, madje edhe në afat më të gjatë, dhe se disa reforma mund të kenë përkohësisht një impakt negativ në varfëri.

Pra ka dëshmi të forta se rritja ekonomike normalisht redukton varfërinë në të ardhura, veçanërisht në afat të gjatë, ka dhe (disi më e diskutueshme) prova se tregtia më e lirë çon në rritjen më të shpejtë ekonomike, kanal ky shumë i rëndësishm në rritjen e mirëqënies dhe

rrjedhimisht në uljen e varfërisë. Ka mjaft kritikë të liberalizimit që shprehin shqetësimin se shtresat e varfra janë ato që do të penalizohen më shumë nga ky proçes; psh: fermerët e varfër do të vuajnë nëse tregtia e lirë do tua uli çmimet e ushqimeve kryesore që potencialisht prodhojnë (në këndvështrimin e shitësit). Megjithatë, të dhënat tregojnë se shumica e fermerëve në të vërtetë janë blerësit neto të këtyre ushqimeve kryesore, dhe kështu do të përfitojnë nga çmimet më të ulëta në blerje. Për më tepër, transporti i brendshëm dhe shpenzimet e marketingut shpesh i izolojnë fermerët më të varfër në zonat më të largëta nga ndryshimet në çmimet kufitare pra u leverdis më shumë të shesin jashtë kufijve për shkak të afërsisë, ku sipas MTL-ve që nënshkron vendi ulja e barrierave tregtare, ia ul dhe koston e prodhimit duke e bërë më konkurrent .

Pra konteksti VEND është shumë i rëndësishëm. Në veçanti, efektet e reformës së tregtisë mbi sektorë të ndryshëm dhe grupe me të ardhura të ndryshme varen nga evidencat se cili ishte ai që fillimisht përfitoi nga mbrojtja e tregtisë, çështje të cilat ndryshojnë nga një vend në tjetrin. Në këtë kuptim , se si ndikon rritja e tregtisë tek të varfërit kërkon një analizë të mëtejshme si në nivel mikro ashtu dhe në makro [26].

1.2.2. Impakti në punësim

Të gjitha vendet që ndjekin integrimin ekonomik si pjesë të liberalizimit tregtar kanë një shumëllojshmëri shumë të gjerë të mallrave dhe shërbimeve nga të cilat ata mund të zgjedhin. Hyrja në këtë proces do ta ndihmojë vendin në marrjen e mallrave dhe shërbimeve me kosto shumë të ulët, do ta ndihmojë në tarifa të reduktuara dhe çmime më të ulëta si për shpërndarësit dhe konsumatorët pasi, qëllimi përfundimtar i integrimit ekonomik është që të rrisë tregtinë në të gjithë botën.

Kjo strategji jetike përdoret kryesisht për trajtimin e efekteve të paqëndrueshmërisë politike dhe konflikteve njerëzore që mund të ndikojnë në një rajon. Gjithashtu kjo strategji ndihmon sidomos vendet në zhvillim për të rritur sasinë e parave në investimet e huaja të drejtpërdrejta. Pasi firmat të fillojnë IHD-të, nëpërmjet operacioneve të reja ose nga bashkimi me ndërmarrjet e vendit ku investojnë, mund të bëhen një ndërmarje ndërkombëtare. Kështu kjo është një situatë e favorshme për të gjitha firmat, biznesmenët dhe ekonomitë e përfshira ne proçes sepse impakti kryesor ndjehet më shumë në treguesit e rritjes ekonomike të cilët

[26] Por kjo çështje nuk është objekt i këtij studimi

pasqyrojnë rritjen e mirëqënies dhe të standartit të jetesës vecanërisht për vendet e tranzicionit të cilat konsiderohen si vende në zhvillim, ndonëse studimet tregojnë qartë për një përfitim shumë të madh (ndoshta edhe më të madh në kurriz të vendeve në zhvillim) për vendet e zhvilluara nga hapja e tregjeve me vendet në zhvillim[27].

Këto ndërmarrje ndërkombëtare do të krijojnë mundësi më të larta për punësimin e njerëzve nga e gjithë bota, duke lëvizur nga një vend në tjetrin në kërkim të punës.

Punësimi është analizuar nga literaturat e ndryshme si një mjet shumë efektiv për të gjeneruar rritje ekonomike dhe rrjedhimisht rritje të mirëqënies së popullësisë duke cuar kështu në reduktim të varfërisë. Në fakt punësimi cilësohet dhe përshkruhet si faktori lidhës më i rëndësishëm midis rritjes ekonomike dhe reduktimit të nivelit të varfërisë së një vendi . Megjithë lidhjen pozitive që ekziston midis reduktimit të papunësisë dhe reduktimit të varfërisë, ekzistojnë faktorë strukturorë, individualë dhe kulturorë të cilët gjithashtu kanë impaktin e tyre mbi këtë lidhje.

Në vende të zhvilluara (psh USA) fenomeni i hapjes së tregjeve sjell ndryshime ne çmime relative sektoriale të cilat shoqërohen dhe me diferencime të vogla në paga për sektorët e brendshëm dhe me ndryshime të mëdha neto në punësim për të njëjtët sektorë .

Në kontrast me provat për Shtetet e Bashkuara (Collins, Susan M., 1998), përvoja në vendet në zhvillim e vë gishtin në drejtim të rialokimit të vogël të punësimit nëpër sektorë të ndryshëm dhe pagat e sektorëve specifik lëvizin në të njëjtin drejtim me tarifat e këtyre sektorëve specifikë .

Në zemër të argumenteve më të mëdha në favor të liberalizimit tregtar, është pohimi se ky i fundit do të shkaktojë një rialokim të burimeve drejt sektorëve në të cilat vendet kanë përparësi krahasuese. Megjithatë, rialokimi i burimeve dhe procesi i përshtatjes ndaj një tregu global sidomos për vendet që kanë dalë së fundi nga tranzicioni, merr kohë dhe është i kushtueshëm (Brock and Durlauf ,2001). Si rezultat, është ndoshta e çuditshme që nuk ka të dhëna që të mund të kuptohen implikimet e këtyre kostove dhe të këtyre vonesave, jo vetëm për mirëqenien e punëtorëve individuale, por edhe për ekonominë si një e tërë.

[27] Për më tepër , sipas një studimi të Bankës Botërore , më shumë se 70 për qind e fitimeve nga liberalizimit i plotë të tregtisë do tu shkojnë vendeve të pasura.(Anderson and Martin, 2005)

Ndoshta pikërisht për këtë arsye , çuditërisht, ekonomistët nuk janë ende në një pozitë të rehatshme për t'iu përgjigjur pyetjeve të tilla si: Sa kohë duhet të presim që tranzicioni në tregun e punës të zgjasë? Deri në çfarë mase përfitimet e mundshme nga tregtia do të reduktohen për shkak të përshtatjes së ngadaltë të ekonomisë ndaj ekuilibrit të ri të tregtisë së lirë? Cilat janë karakteristikat e punëtorëve të cilët do të humbasin më shumë nga tregtia e liberalizuar? Cilat janë politikat e tregut të punës më premtuese për të reduktuar kostot rregulluese, për shpejtimin e përshtatjes dhe kompensimin e humbësit?

Për të ofruar një kuptim më të mirë të këtyre çështjeve duhet vlerësuar një dinamikë strukturore të një modeli ekuilibrit të tregut të punës brenda një ekonomie të vogël të hapur me të dy sektorët: të tregtueshëm dhe jo të tregtueshëm . Kërkesa për punë do të varet nga tre faktorët e prodhimit - kapitali njerëzor nga punëtorët e pakualifikuar, kapitali njerëzor nga të punëtorët e kualifikuar dhe kapitali fizik. Nëse supozojmë tregje të konkurrencës perfekte edhe në produkte dhe në faktorë prodhimi, analizat e ndryshme konfirmojnë (Alarcon, Diana and Eduardo Zepeda, 1997), se do të ekzistojë një mbivendosje brezash për shkak se brezat e vjetër janë më pak të lëvizshëm ndërsa brezat e rinj kanë karakteristikën e përshpejtimit në rialokim pas reformës së tregtisë.

Vendet në zhvillim për shkak të tranzicionit i kanë më të ngurtë brezat e vjetër që përbëjnë pjesën më të madhe dhe më domethënëse të fuqisë punëtore, për këtë arsye adaptimin me kushtet e tregut global apo të liberalizuar e kanë më të ngadaltë, krahasuar me vendet e zhvilluara të cilat kanë më shumë fleksibilitet në lëvizje pasi kanë qënë tashmë të prezantuar me tregun global. Për këtë arsye mendohet se impakti i liberalizimit të tregjeve në vendet në zhvillim duhet të analizohet në periudha më të gjata kohore sepse efektin e ka më të ngadaltë sesa në vendet e zhvilluara, kjo dhe për shkak të kostove që mbart procesi në vetvete.

1.2.3 Impakti në papunësi

Nuk mund të shihen qartë efektet pozitive apo negative të liberalizimit sepse varet shumë nga strukturimi i tregut të punës.

Shumë ekonomistë besojnë se ngurtësia e tregut të punës është përgjegjëse për nivelin e lartë të papunësisë në Evropë. Ngurtësi të tilla përfshijnë, ndër të tjera, pagat e larta minimale, përfitimet e papunësisë bujare, legjislacioni për mbrojtjen e punësimit në sektorin e punëve të

rënda, etj. Literatura argumenton se mbrojtja e punësimit rrit kostot e rregullimeve që lidhen me pushimet nga puna, duke reduktuar rritjen dhe produktivitetin (Wood, 1995). Rregullat strikte mbi punësimin dhe pushimin nga puna gjithashtu dekurajojnë punësimin nga firmat e punonjësve të rinj gjatë një zgjerimi.

Arsyeja themelore është se firmat e dinë se do të jetë e vështirë për të hequr punëtorët nga puna kur kushtet ekonomike përkeqësohen. Mbrojtja e rreptë e punësimit, pra, çon në nivele të ulëta të punësimit. Për më tepër, mbrojtja e punësimit gjithashtu ndikon në sasinë e përpjekjeve që punëtorët vënë në punët e tyre. Meqënëse punëtorët janë të mbuluar nga rregullat e mbrojtjes, frika se mos pushohen është e reduktuar, ndoshta duke çuar dhe në një përpjekje për të reduktuar punën e tyre . Kjo nga ana tjetër e ul produktivitetin e tyre në firma ku punojnë ;gjë e cila con rrjedhimisht në reduktim edhe të rritjes ekonomike (IMF,1997).

Sipas teksteve ekonomike (ILO, 1995); sistemet e sigurimit të papunësisë janë gjithashtu shkaktarë të papunësisë të lartë dhe të një norme rritjeje më të ulët. Sa më e lartë shkalla e zëvendësimit, aq më e lartë kohëzgjatja e papunësisë , pasi punëtorët nuk janë në presion për të dalë nga papunësia. Në fakt në vendet ku përfitimet [28]e papunësisë janë të larta është vënë re një tendencë e fuqisë punëtore për të reduktuar përpjekjet për të kërkuar një punë, dhe për të rritur pagën e rezervimit (minimale), sikundër dhe për të ushtruar një presion real mbi pagën. Këto efekte përforcojnë tendencën për të rritur kohëzgjatjen e papunësisë.

Megjithatë këto argumente kanë dhe skeptikët e tyre .

Së pari, reduktimi i ngurtësitë në tregun e punës do të çojë në një performancë më të mirë ekonomike , veçanërisht në qoftë se tregjet e produkteve janë liberalizuar në të njëjtën kohë me reduktimin e ngurtësisë së tregut të punës,dhe në qoftë se ndryshimet në tregun e punës janë mbështetur më tej nga ristrukturimi i mirëqenies së një vendi. Si rrjedhojë, rezultatet pozitive të reformimit të tregut të punës nga liberalizimi mund të dështojnë në përpjekjen për tu materializuar në qoftë se reforma në fjalë është shoqëruar nga reforma në fusha të tjera kundërbalancuese, ose nëse ajo zhvillohet në një mjedis institucional në të cilin nuk mbizotëron koordinimi pro liberalizues. Për më tepër, do të duhet disa kohë para se të materializohenn efektet e reformave (Annett 2007).

Së dyti, ka argumente bindëse teorike edhe që ngurtësia mund të shoqërohet me rezultate të favorshme ekonomike. Për shembull, kur përfitimet(ndihmat sociale) nga shteti

[28] Në formën e ndihmës sociale

për të papunët janë të larta, punë-kërkuesit mund të jenë shumë selektiv në lidhje me llojin e punës që ata pranojnë; gjë e cila do të përmirësojë përshtatjen e vendeve të punës. Kjo mund të shërbejë shumë mirë si formë për ruajtjen e kapitalit njerëzor, gjë e cila bën që produktiviteti të jetë më i lartë . Ekonomia politike, ka argumentuar se në ekonomitë në të cilat suksesi konkurrues është i bazuar në industri me aftësi specifike, përfitimet bujare të papunësisë dhe mbrojtja e punësimit krijon stimuj për punëtorët që të investojnë në të tilla aftësi (Hall dhe Soskice 2001).

Së treti, evidencat empirike në favor të një lidhje shkakësore ndërmjet ngurtësisë së tregut të punës dhe rezultateve negative ekonomike janë ende të paqarta. Efektet e vlerësuara ndryshojnë në varësi të specifikimit dhe të kornizës kohore , dhe efektet shpesh janë të kushtëzuara nga karakteristika të tjera institucionale në tregjet e punës.

Analizat e ndryshme (Wood, Adrian, 1998), kanë arritur në përfundime të shumëllojshme si për shembull, duke reduktuar mbrojtjen e punës në kontratat e rregullta afatgjata nuk është gjetur asnjë efekt domethënës në nivelet e punësimit agregat apo më tej në reduktimin e papunësisë. Ndërsa kur këto ligje mbrojtjeje janë reduktuar për kontratat e përkohshme është vënë re një rënie në papunësi në vitet pasuese të reformës e cila është shoqëruar dhe me GDP më të ulët, me konsum më të vogël , dhe me reduktim edhe në normat e rritjes së investimeve. Për këtë mund të themi se vëzhgimet e ndryshme kanë rezultuar me efekte kontradiktore, në disa raste liberalizimi i tregut të punës ka ndihmuar në rritjen e punësimit dhe uljen e papunësisë, dhe në raste të tjera ajo nuk ka ndihmuar fare në këto tregues.

Pavarësisht pranisë së kualifikimeve teorike dhe kundër-argumenteve, mungesa e provave empirike nuk lë vend për të dhënë një definicion të saktë nëse liberalizimi ndihmon apo jo në tregun e punës sepse varet shumë nga kushtet e një vendi.

Shtrohet për këtë arsye dhe një pyetje me rëndësi të konsiderushme : ***Atëherë pse fajësohet liberalizimi për tregun e punës?***

Kur Organizata Botërore e Tregtisë u takuan në Seattle në vitin 1999, aktivistët antiglobalistë fajësuan politikat e liberalizimit tregtar në vendet në zhvillim për një shumëllojshmëri të sëmundjeve. Pretendimet e tyre ishin se politikat e liberalizimit kanë një ndikim negativ mbi normën e rritjes së vendeve , dhe se tregtia e liberalizuar çon në tronditje të sektorit të punësimit për shkak të zhvendosjes së një numri të madh të punëtorëve nga njëri vend në

tjetrin, ndodh braktisja e mënyrave tradicionale të jetës, e cila con në një përkeqësim të mjedisit, dhe papunësi masive.

Ekonomistët e Tregtisë sipas modelit Rikardian të avantazhit të krahasuar kanë predikuar gjatë se "një vend i hapur ndaj tregtisë do të specializohet në disa sektorë, duke vënë gjithë burimet e prodhimit të mallrave dhe shërbimeve në sektorët ku ai vend është më efikas, dhe duke braktisur prodhimin e atyre të mirave ku vendi është relativisht joefikas". Kjo është dhe arsyeja pse disa instanca strukturore në tregun e punës mund të pritet te vijnë në fuqi në një vend pas liberalizimit tregtar.

Gjatë një kërkimi shkencor(OBT 2003), të kohëve të fundit janë gjetur prova pak ose aspak të lëvizjes së punëtorëve si pasojë e liberalizimit tregtar, duke mos qënë në gjendje të përcaktojnë sasinë e sektorëve që janë rritur ose zvogëluar .

Studimi kishte të bënte me krahasimin e statistikave të tilla si para dhe pas liberalizimit për 26 vende në zhvillim që kishin prishje të qarta dhe të dukshme në politikat e tyre tregtare. Nuk u përfshinë vendet e zhvilluara në kampionin e studimit, sepse përpjekjet e liberalizimit tregtar nuk mund të izolohen nga politikat e tjera të tilla si politika monetare, privatizimi i industrive, ose incidentet para liberalizimit. Ndërsa për vendet në zhvillim që papritmas shkojnë nga të qenit i mbyllur në hapje ndaj tregtisë mendohet që duhet të evidentohen rezultate të rëndësishme dhe të kthjellëta.

Megjithatë pavarësisht informatave të qëndrueshme në të gjithë vendet nga sondazhet në tregun e punës, u gjet shumë pak ndryshim në strukturën e sektorëve të punës brenda pesë viteve të para të liberalizmit; ndryshimet në këtë sektor ishin ose të vogla ose jo statistikisht domethënëse. Në përgjithësi, vendet si Polonia që kanë tregje pune shumë fleksibël ku punëtorët kanë më shumë mundësi për të lëvizur përreth kanë një tendencë që të kenë më shumë lëvizje. Ndërsa vende si Spanja, kanë tendencë të kenë më pak lëvizje punëtorësh në vende të tjera meqë në këtë vend janë krijuar shumë rrjeta sigurie me anë të rregullave të ndryshme, për shembull, rregulla për të parandaluar punëtorët të pushohen nga puna [UNCTAD (United Nations Conference on Trade and Development), 1999, New York and Geneva].

Politikat vendore të dekretuara për të kompensuar goditjet potenciale në tregun e punës janë një shpjegim për mungesën e papritur të migrimit të punës. Këto masa gjithashtu u kundërvihen në mënyrë aktive efekteve pozitive të liberalizimit.

Për shembull ,nëse një vend heq një tarifë për një të mirë; atëherë vendi do të fillojë të konkurrojë me mallrat nga vendet e huaja, sepse malli i huaj tani mund të hyjë në vend me një çmim konkurrues. Pra, për të korrigjuar këtë, qeveritë miratojnë subvencionet e brendshme në këtë industri për të rivendosur avantazhin konkurrues, i cili kishte humbur në kohën kur ekzistonte tarifa si në rastin e Filipineve në 1988 dhe Turqisë në vitin 1990.

Mbrojtësit e proçesit të globalizimit pretendojnë se efektet negative nuk mund të ndjehen për kaq pak vite liberalizim sepse impakti është i plotë pas një periudhe të gjatë psh 20 vjecare, por dhe kjo nuk përbën problem pasi në këto vite u jepet mundësia dhe punëtorëve të riaftësohen (Brock and Durlauf , 2001).

Në studime të veçanta, lidhur me këtë, janë gjetur evidenca se vendet që patën adoptuar politika të tregtisë së hapur kanë patur përfitime të matshme në formën e rritjes ekonomike më konkretisht duke analizuar lidhjen midis politikave tregtare dhe rritjes ekonomike në 57 vende[29] u gjet se çdo rritje prej 10 pikë përqindje në raportin e TREGTI / GDP si rezultat i ndryshimeve në politikën tregtare është shoqëruar me një rritje 0.67 pikë përqindjeje në normën vjetore të rritjes së një vendi.

Nëse analiza shtrihet për më shumë vite, pasojat në mesataren e të ardhurave për frymë të një vendi mund të jenë shumë më të gjera. Implikimet për një vend si Kina janë edhe më të mëdha, vetëm për shkak të madhësisë së saj .Po të shtojmë dhe Indinë, një vend me potencial të madh, rreth katër të dhjetat e popullsisë së botës ende mund të përfitojnë nga hapja më e madhe në tregtinë ndërkombëtare (Harrison, Ann and Gordon Hanson, 1999).

Disa autorë përveç liberalizimit tregtar të mallrave, një rëndësi të vecantë i kushtojnë edhe liberalizimit tregtar të **shërbimeve.** Zgjerimi i preferencave të tregtisë së shërbimeve sipas teorisë konvencionale shtrihet në dy mënyra: ***së pari***, tregtia në shërbime shpesh kërkon që prodhuesi të jetë afër konsumatorit dhe ***së dyti***, trajtimi profesional në ofrimin e shërbimeve është dhënë rrallë përmes tarifave por nëpërmjet zbatimit diskriminues të rregullave dhe rregulloreve. Përveç liberalizimit tregtar të mallrave dhe shërbimeve, në integrimin rajonal përfshihet edhe lëvizja e pakufizuar e punës, kapitalit, ose burimeve të tjera prodhuese parësore.

[29]Studim i vitit 2005 nga World Bank: "DOES OPENNESS IMPLY GREATER EXPOSURE?"César Calderón,Norman Loayza, Klaus Schmidt-Hebbel

Edhe në sektorët ku një vend në zhvillim ka avantazhe krahasuese, përsëri ka probleme: konkurrueshmëria e këtyre sektorëve është bazuar mbi pasurinë e faktorëve ose mbi ofertën e punës së lirë dhe vlera e shtuar e produkteve eksportuese është mjaft e ulët. Niveli i ulët i diversifikimit i bën eksportet më të prekshme ndaj ndryshimeve të kushteve të tregjeve ndërkombëtare, sidomos ne situata krizash. Tregu i BE-së është tepër konkurrues dhe shumë kërkues në lidhje me cilësinë, sigurinë dhe efiçiençën e ofertës. Gjithashtu, këto tregje janë në ndryshim të vazhdueshëm, dhe eksportuesit duhet të adaptohen ndaj kushteve të reja të tregut si dhe rritjes së konkurrencës ndërkombëtare në këto tregje.

Në teorinë standarde (Modeli Hecscher-Ohlin) sugjerohet se shërbimet që tregtohen lirisht ndërkombëtarisht gjenerojnë pabarazi në të ardhurat globale sidomos në vendet në zhvillim, për shkak të pabarazisë në aftësinë e punëtorëve gjë që reflektohet në çmime të ndryshme në nivel internacional; rezultate këto të përshpejtuara edhe nga globalizimi si fenomen.

Përpos shqetësimeve të teoricienëve të tregtisë së lirë, në bazë të avantazheve dhe disavantazheve të tregtisë së lirë arrijmë në perfundimin se, liberalizimi tregtar ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin e ekonomisë në vendet në zhvillim. Duke nxitur konkurrencën ajo bën që mallrat të krijohen me cilësi më të lartë dhe me kosto më të ulët, si dhe vendet të përdorin burimet e tyre në mënyrë më eficente.

1.2.4 Impakti në konkurrencë , rritje ekonomike, dhe faktorë të tjerë

Evidencat e viteve të fundit që janë gjithmonë e më në rritje mbështesin pohimin se tregtia ndërkombëtare stimulon inovacionin dhe rritjen e produktivitetit përmes rritjes së konkurrencës[30]. Meqënëse supozohet se vendet prodhojnë të njëjtin grup të varieteteve , hapja tregtare i bën tregjet më konkurruese , duke ulur çmimet dhe duke rritur sasitë . Nën konkurrencën Cournot , tregtia është pro - konkurruese . Meqënëse firmat marrin iniciativa në inovacion për reduktimin e kostos , prodhimi i rritur si pasojë i një tregu më konkurrues i shtyn firmat për të bërë inovacion akoma më shumë . Si pasojë, një reduktim i barrierave tregtare stimulon rritjen duke zvogëluar fuqinë e tregut të firmave vendase . Ky ndikim

[30] Siç Freeman vëren, " Në vitet 1960 dhe 1970 , shumë në botën e tretë kishin frikë se tregtia do ti varfëronte ata, apo do ti shtynte ato në periferi të ekonomisë botërore ; praktikisht askush në vendet e përparuara nuk ishin të shqetësuar rreth konkurrencës nga vendet më pak të zhvilluara . Në vitet 1980 dhe 1990 , për kontrast, shumica e botës së tretë e kishte përqafuar ekonominë globale ; ndërsa shumë njerëz në botën avancuar u vunë në merak për efektet e mundshme negative të tregtisë . " Freeman , 1995 , f.15 .

ndryshon sipas destinacionit dhe origjinës së eksporteve dhe importeve , dhe nëse vendet janë në zhvillim apo të industrializuara. Kjo është e rëndësishme pasi një nga argumentet e mbrojtjes është bazuar në supozimin se ekziston një asimetri në elasticitetin e produkteve të tregtuara midis vendeve në zhvillim dhe atyre industriale ,dhe se kjo asimetri çon në pabarazi në rritjen ekonomike .

Ka pak dëshmi se bilanci tregtar përkeqësohet (vuan një rritje të deficitit) nga tregtia me vendet në zhvillim , por ka një fakt që bilanci tregtar përmirësohet nga tregtia me vendet industriale. Gjithsesi ekzistojnë kontradikta në politikat tregtare të vendeve të zhvilluara , sepse ndërsa përpiqen të bindin vendet e varfëra për të hequr barrierat e tregtisë , ata miratojnë procedura anti- dumping dhe politika proteksioniste për produktet e importuara nga vendet në zhvillim .

Është thelbësore për të kuptuar se pse kaq shumë vende , në pjesë kaq shumë të ndryshme të botës , me të tilla ndryshime në sistemet e tyre ekonomike , në faza shumë të ndryshme zhvillimi , janë drejtuar të gjithë në të njëjtin drejtim . Ka natyrisht rrethana të ndryshme kombëtare që shpjegojnë strategjitë detajuara dhe kohën e iniciativave individuale. Forca kryesore , megjithatë , ka qenë procesi i liberalizimit konkurrues.

Kur vendet hapin kufijtë e tyre ndërkombëtare ndaj vendeve anëtare në të njëjtën zonë të tregtisë së lirë , ata gjithashtu e hapin veten deri në mundësinë e konkurrencës së ashpër që mund të vijë nga kombet e tjera në të njëjtën zonë të tregtisë së lirë . Të gjitha vendet brenda zonës do të garojnë me njëri-tjetrin për të njëjtët konsumatorë.

Për më tepër, suksesi në ekonominë e sotme globale i kërkon vendeve që të konkurrojnë në mënyrë efektive në tregjet ndërkombëtare dhe jo thjesht në tregjet e brendshme. Kjo është e vërtetë edhe sikur tregu i brendshëm të jetë i madh: shumica e ekonomive të vetë-përmbajtura të botës duke u përfshirë këtu edhe Brazili, Kina, India, Rusia dhe ndoshta sidomos Shtetet e Bashkuara , të gjitha u bashkuan me garën konkurruese të liberalizimit (Ajit K. Ghose, 2000).

Gjatë viteve, vëmendje i është kushtuar avantazheve të liberalizimit tregtar dhe të globalizimit në dëm të disavantazheve. Rritja e shpejtë e ndërvarësisë globale i ka detyruar të gjitha vendet, çfarëdo qofshin politikat apo filozofitë e tyre të mëparshme, për të liberalizuar tregtinë e tyre (dhe zakonisht të investimeve). Suksesi ekonomik në botën e sotme u kërkon vendeve të konkurrojnë në mënyrë agresive për investimin ndërkombëtar për të përcaktuar shpërndarjen e prodhimit global dhe në këtë mënyrë vendet e punës, për të përcaktuar

shpërndarjen e fitimeve dhe të teknologjisë. Shumica e vendeve ofrojnë stimuj të drejtpërdrejta për investitorët e huaj, por një regjim i hapur tregtar dhe i investimeve është thelbësor për këtë qëllim. Për shkak të konkurrencës në rritje, disa vende mund të kenë fituar një shkallë të përparësisë konkurruese ndaj të tjerëve. Një mënyrë për të arritur përparësi të tillë mund të jetë e lidhur me teknologjinë e përparuar. Për shembull, Zona e Tregtisë së Lirë të Amerikës së Veriut përfshin Shtetet e Bashkuara, Kanada dhe Meksikë. Për shkak të superioritetit teknologjik e Shteteve të Bashkuara mbi një vend si Meksika, nivelet e papunësisë në Meksikë mund të jenë më të larta se në Shtetet e Bashkuara(Feenstra, Robert C. and Gordon H. Hanson, 1997).

Në një studim prej 69 vendesh në një hark kohor prej 2 dekadash[31], sipas gjetjeve ekonometrike, investimet nga të gjitha vendet partnere kanë një ndikim negativ por të parëndësishëm në rritjen ekonomike. Këto rezultate mund t'i atribuohet paqëndrueshmërisë dhe pjesës e vogël të investimeve gjatë periudhës së vlerësimit, dhe që IHD-të e brendshme janë drejtuar kryesisht në sektorin e prodhimit. Mund të vërejmë që rezultatet empirike të modelit të aplikuar kanë mbështetur parashikimet e spektikëve në lidhje me impaktin që kanë IHD në vendet në zhvillim (Alfaro,2003;Loyroydi et al.2004; Stanisic dhe Jankovic,2007). Ata shprehen se për vendet në zhvillim këto efekte janë të paqarta, si në sektorin e shërbimeve dhe atyre manifakturor efektet mund të jenë jopozitive. Kjo për shkak të klimës së biznesit ku në rast të një klime të dobët investimesh, për shkak të taksave, tarifave, gjobave, korrupsionit dhe nevojës për shërbime shtesë (avokatë, financierë, konsulentë etj.) rriten kostot e transaksionit investues . për më tepër që IHD-të në Shqipëri janë më të përqëndruar në sektorin e tregtisë, dhe stimulojnë kryesisht eksportet që përkeqëson bilancin tregtar dhe rrjedhimisht edhe të dhënat e rritjes ekonomike. Impaktin negativ e kanë kryesisht në performancën e firmave e më specifikisht tek firmat e mëdha të vendit. Pra, ndikimi i IHD-ve të brendshme në prodhim mund të shihet më qartë se sa në GDP totale. Hyrjet e kapitalit të huaj në përmasa që tejkalojnë deficitin e llogarisë korrente , megjithë kontributin pozitiv në përiudha afatshkurtra, mund të sjellin edhe kontribut negativ në tregues të ndryshëm ekonomikë si në konkurrueshmërinë, në diferencimin e pagave të punonjësve, mbiçmimin e valutës vendase që së bashku nuk e favorizojnë rritjen ekonomike(A.Mançellari, S.Xhepa). Si konkluzion edhe autorë si Carkovic dhe Levine (2002) janë shprehur se faktorët janë ekonomikë dhe socialë psh : IHD mund të sjellin

[31]International Monetary Fund, Research Department, Washington DC 20431 USA --"How does foreign direct investment affect economic growth?"E. Borensztein , J. De Gregorio , J-W. Lee, Journal of International Economics 45 (1998) 115–135

falimentimin e industrive vendase të cilat nuk disponojnë teknologjinë dhe nuk e përballojnë konkurrencën e firmave të huaja që investojnë në vendet në zhvillim.Për shkak të efektit spillover, know-how dhe domestic crowding out firmat tkurren në një moment afatshkurtër duke shkaktuar një korrelacion negativ me rritjen ekonomike.

Në literaturë një shkollë mendimi e konsideron tregtinë e lirë si shumë të rëndësishme në zhvillimin ekonomik, sepse ajo maksimizon prodhimin e produktit shoqëror. Argumenti kundërshtar pretendon se përfitimet e tregtisë së lirë janë të lavdërueshme, por vetëm nën kushtet e punësimit të plotë, ndarjen e plotë të burimeve dhe të konkurrencës së lirë në ekonomi. Për shembull, Singh (1985) ka argumentuar se vlera e tregut të lirë është e kufizuar për shumicën e vendeve në zhvillim meqënëse një pjesë e madhe e burimeve të tyre prodhuese janë ende të pashfrytëzuar dhe ata në përgjithësi kanë papunësi masive. Prandaj një regjim i tregtisë së lirë i shton problemet e tyre duke dobësuar industritë vendase, sidomos ato me kompetenca të pamjaftueshme konkurruese.

Megjithatë, tregtia jo vetëm në shërbime dhe investime, por edhe në mallra mund të konsiderohet si element i rëndësishëm i pothuajse të gjitha negociatave aktuale (MTL-ve), në mënyrë që të rritet performanca ekonomike e Shqipërisë dhe partnerëve të tjerë të MTL-ve.

Ndërmarrjet ndërnacionale parapëlqejnë të investojnë në vende me klimë të shëndetshme biznesi ku kostot, vonesat dhe risku janë të minimizuar. Investuesit kërkojnë kthim (fitim) të parashikueshëm dhe të pranueshëm për investimin e bërë: "Paraja është frikacake" është një shprehje e njohur. Në mënyrë që të arrijë në fitime konkurruese, një investues përpiqet të shmangë tri pengesa kryesore: kostot, vonesat dhe riskun. Në rast të një klime të dobët investimesh, për shkak të taksave, tarifave, gjobave, korrupsionit dhe nevojës për shërbime shtesë (avokatë, financierë, konsulentë etj.) rriten kostot e transaksionit investues dhe investuesi mund të hedhë sytë diku tjetër, pavarësisht se kostot e krahut të punës, transportit dhe energjisë në atë vend janë konkurruese. IHD ka potencialin për të gjeneruar punësim, rritje të prodhueshmërisë, aftësi transferuese dhe teknologji të re, rritjen e eksporteve, si dhe kontribuon në zhvillim afatgjatë ekonomik të vendeve të zhvillim.

1.3 RISHIKIMI I LITERATURËS MBI MODELET E VLERËSIMIT TË IMPAKTIT TË TREGTISË NDËRKOMBËTARE DHE MTL-VE

Nuk ka absolutisht asnjë metodologji superiore për të analizuar tregtinë ndërkombëtare kjo sepse bota e tregtisë ndërkombëtare është pafundësisht komplekse, duke përfshirë qindra vende me karakteristika të ndryshme (në zotërimin e faktorëve), me preferenca të ndryshme të konsumatorëve, me mijëra llojesh produktesh, dhe një varietet shumë të madh të instrumentave politike kombëtare. Ti shtojmë kësaj dhe faktin që kjo botë është për më tepër dhe dinamike në kohë. Por ekonomistët kudo nëpër botë përpiqen të zhvillojnë modele për të kuptuar realitetin.

Modelet për liberalizimin tregtar parashikojnë që ky fenomen të veprojë pozitivisht në zhvillimin ekonomik botëror, rritjen e mirëqënies së vendeve pjesëmarrëse dhe si rrjedhim zbutjen e varfërisë, të cilat janë bërë prioritete të larta të komunitetit ndërkombëtar. Ky theksim shpjegon pse studime të shumta janë përqendruar në vlerësimin e përfitimeve të pritshme të liberalizimit tregtar në zhvillimin ekonomik të vendeve.
Mjetet kryesore empirike për këto vlerësime kanë qenë përdorimi i modeleve të ekuilibrit të pjesshëm(Partial Equilibrium Model--PEM), ekuacionet e gravitetit(Endogenous Gravity Theory--EGT), dhe modelet e ekuilibrit të përgjithshëm të llogaritshëm për një realitet të shumë vendeve(Computable General Equilibrium Multicountry-CGEM) për një vend të vetëm por dhe për disa vende. CGEM ,megjithatë, ka prodhuar rezultate të habitshme divergjente. Siç demonstrohet nga studimet e fundit[32], rritja në mirëqenien botërore nga liberalizimi tregtar i plotë varion nga 0,2-3,1 për qind-rezultatet që ndryshojnë nga një faktor 15!. Modelet e ekuilibrit të pjesshëm analizojnë parcialisht ekonominë, ndërsa EGT është model që ka sjell rezultate mjaft të besueshme për lidhjen e agregatëve endogjen në proçesin e liberalizimit tregtar në rritjen ekonomike sidomos të vendeve në zhvillim.

Qëllimi i këtij studimi është që të shqyrtojë efikasitetin e modelimit të tregtisë për të arritur përfitime nga liberalizimi tregtar. Do të ofrohet një studim i metodologjive të përdorura për të

32

vlerësuar ndikimin e liberalizimit tregtar, dhe do të shqyrtohet edhe shkalla në të cilën këto vlerësime ndryshojnë.

Hulumtimi gjithashtu tregon përfitimet e "analizës komplementare", e cila përdor metodologjitë e ndryshme për të studiuar një temë të veçantë. Raporti prezanton rezultatet e modelimit global duke përdorur një model graviteti EGT . Duke përdorur modelin EGT është gjetur se liberalizimi i plotë ka bërë të rriten të GDP real në një ekonomi pas disa viteve të zbatimit. Kjo reformë tregtare përqafon zhvillimin,meqënëse ajo përfshin një normë më të madhe të rritjes reale të të ardhurave për vendet në zhvillim dhe veçanërisht për vendet më pak të zhvilluara .

Përkrahësit e liberalizimit mbrojnë tezën se politika e hapjes tregtare çon padiskutim në rritje ekonomike, ndërkohë që avokatët e tezës proteksioniste tregohen ende skeptikë lidhur me këto rezultate. Për të tilla arsye, impakti i liberalizimit tregtar veçanërisht në elementët e tregtisë së jashtme, është ende një çështje e cila kërkon studim të mëtejshëm teorik dhe empirik, kryesisht për vendet në zhvillim.

Doktrina që tregtia rrit mirëqenien dhe rritjen ekonomike ka një histori të gjatë dhe të shquar që daton të paktën që nga Adam Smith (1723-1790) . Smith, në librin e tij të famshëm , "Një hetim në Natyrën dhe Shkaqet e Pasurisë së Kombeve (1776) ,ku ai theksoi rëndësinë e tregtisë si një e çarë e xhaketës për të shpjeguar se si teprica në prodhim është një mjet për zgjerimin e tregut duke përmirësuar ndarjen e punës dhe nivelin e produktivitetit . Gjithsesi ka shumë teori të cilat e lidhin tregtinë me rritjen ekonomike të cilat do të paraqiten më poshtë.

1.3.1 Tregtia dhe Rritja ekonomike në Modelin Klasik të Rritjes

Teoritë klasike përfshijnë kontributin e Smith (1776), i cili zhvilloi konceptin e përparësisë absolute dhe atë të Ricardos (1817), i cili zhvilloi konceptin e avantazh krahasues. Në shekullin e 19 , doktrina e Smith-it rreth përfitimeve të tregtisë së zhvilloi një argument në favor të eksporteve, sidomos në kolonitë , fakt që shpjegon pse teoria klasike e tregtisë shpesh është e lidhur me kolonializmin .

Në vijim të Smith-it , David Ricardo (1772-1823) ka zhvilluar teorinë e përparësisë krahasuese dhe tregoi me rigorozitet në Parimet e tij të Ekonomisë Politike dhe Tatimeve (1817) se nën supozimin e konkurrencës të përsosur dhe punësimin e plotë të burimeve (edhe pse nuk e bëri eksplicite), vendet mund të mbledhin përfitime në mirëqenie nga specializimi në prodhimin e atyre mallrave me kosto oportune më të ulët dhe tregtimin e tepricës së prodhimit (sasia e mbetur e outputit më e madhe se kërkesa e brendshme). Këto janë fitimet statike që lindin nga rishpërndarja e burimeve nga njëri sektor në tjetrin si pasojë e rritjes dhe e specializimit , në bazë të përparësive krahasuese. Këto janë fitimet e tregtisë që lindin brenda bashkimeve doganore apo zonave të tregtisë së lirë,pasi pengesat ndaj tregtisë janë hequr në mes të anëtarëve,pra përfitimet janë të njëkohshme për të gjithë . Pasi barrierat tarifore janë hequr , dhe nuk ndodh më rishpërndarje , fitimet janë statike.

Modeli i tregtisë sipas Rikardos konsideron dy vende, dy mallra dhe një faktor prodhimi (punën). Teknologjia supozohet të jetë fikse (në terma të njësive të punës të nevojshme për të prodhuar një njësi të mallit) në proçesin e prodhimit të çdo malli. Prandaj, produktiviteti relativ i punës përcakton modelin e tregtisë ndërkombëtare në mes të dy vendeve. Në mungesë të kostove të transportit, tregtia ndërmjet dy vendeve do të përcaktohet nga kostoja krahasuese e prodhimit. Nëse secili vend specializohet në mallra për të cilat ka përparësi krahasuese, të dy vendet do të arrijnë përfitime në mirëqenie dhe rrjedhimish edhe mirëqenia botërore gjithashtu do të përmirësohet. Përfitimet në efiçiencë të tregtisë ndërkombëtare në modelin Rikardian janë diskutuar gjerësisht në shumë libra apo dhe tekste të tregtisë ndërkombëtare (shih për shembull, Gandolfo, 1994 dhe Borkakoti, 1998).

Modeli i Rikardos shpjegon përfitimet e mirëqenies në qoftë se një vend do të jetë i specializuar vetëm në prodhimin e asaj të mire për të cilin ky vend ka një avantazh krahasues. Sipas Ricardo-s, kombet progresive janë ato me kursime të larta, me nivele të larta të prodhimit dhe akumulimit të kapitalit, të produktivitetit dhe të kërkesës për punë duke detyruar rritjen e pagave dhe rritjen demografike. Produktiviteti i punës është dhe shkaku kryesor i tregtisë midis vendeve sipas modelit Rikardian.

Megjithatë, produktiviteti i punës përcaktohet nga faktorë të tjerë, të tilla si ndryshimet teknologjike dhe kapital për punëtor, të cilët gjithashtu mund të konsiderohen si burimet e tregtisë ndërkombëtare. Edhe pse modeli i tregtisë sipas Ricardo-s nuk merret me ndikimin e tregtisë në rritje, gjithsesi mund të thuhet që përfitimet e larta nga tregtia çojnë në të ardhura

më të larta, këto të ardhura më të larta do të thonë që edhe kursimet dhe investimet gjithashtu do të rriten. Kështu, në këtë kuptim, tregtia ndërkombëtare kontribuon në rritjen ekonomike.

1.3.2 Tregtia dhe Rritja ekonomike në Modelin Neoklassik të Rritjes

Pas punën së Heckscher (1919) dhe Ohlin (1933), Samuelsoni (1948 dhe1949) ka zhvilluar modelet neoklasike të ekuilibrit të përgjithshëm për të shpjeguar se si tregtia e lirë bën që vendet të specializohen në të mirën (ose të mirat) që përdorin relativisht intensivisht faktorin i cili është relativisht më i bollshëm në vend. Modeli Hecksher-Ohlin-Samuelson (HOS) demonstron se si përmirësohet mirëqenia në modelin dy-shtete, dy-faktorë, dy- të mira dhe tregon se si secili vend specializohet në bazë të faktorit që disponon më me shumicë. Sipas modelit HOS, tregtia ndërkombëtare të çon drejt një ekuilibri Pareto-efiçient që jep mirëqenie më të lartë përmes efektit të tij në shpërndarjen e burimeve midis sektorëve. Lëvizjet në çmimet relative krijojnë diferencime në shpërblimet e faktorit ndërsektorial. Prandaj sipërmarrësit inkurajohen për të lëvizur çmimet deri sa këto dallime në shpërblimet e faktorëve të prodhimit të jenë eliminuar.

Modeli favorizon hapjen ndaj tregtisë duke lënë të kuptohet se hapja është e dobishme për të dyja palët që kryejnë tregti, dhe rrjedhimisht edhe e favorshme për të gjithë botën. E gjithë analiza, megjithatë, është kufizuar deri në masën e fitimeve statike në mirëqenie nga tregtia. "

Baza e teorive të Rikardos dhe HOS është se tregtia ndërkombëtare është rruga për të arritur efikasitet statik në shifrat e produktivitetit dhe konkurrencës globale. Edhe pse efiçienca në produktivitet dhe konkurrenca ndërkombëtare janë të arritshëm nëpërmjet tregtisë, të dyja teoritë klasike (e Rikardos dhe HOS) nuk kanë treguar nëse dhe se sa tregtia e lirë ndikon në rritje ekonomike për periudhat afat-gjata.

Në letrat e tij pasuese , Schumpeter (1912, 1942 dhe 1954) i përmblodhi dhe një herë argumentet e mëparshme në lidhje me drejtimin e fitimit për të arritur nivelin e tij minimal dhe se si akumulimi i kapitalit përcakton normën e rritjes së ekonomisë. Për më tepër, ai diskutoi faktorin kryesor që përcakton rritjen ekonomike, duke bërë dallimin mes 2 koncepteve "shpikje" (zhvillimi i një ideje të re) dhe "risi" (aktivitet ekonomik, duke eksploruar ide të reja për qëllim produktiviteti). Ai konsideroi " risinë" si faktor kryesor që

mund të shpjegojë rritjen ekonomike dhe sqaroi aspektet kryesore për inovacion fitimprurës duke përfshirë dhe hapjen ndaj tregtisë ndërkombëtare.

Young (1928) është ndoshta ekonomisti i parë i cili konsideroi rritjen ekonomike në analizën e tij e cila ka të bëjë me madhësinë e tregut që përcakton punësimin e faktorit punë dhe rrjedhimisht përcakton edhe produktivitetin. Për më tepër, ai shqyrtoi marrëdhënien midis industrive të vendit në proçesin e rritjes ekonomike, lindjen e industrive të reja për shkak të specializimit të produktit si rezultat i zgjerimit të tregut, efikasitetin e specializimit në një treg më të madh global dhe ndikimi i një tregu të tillë në avancimin teknologjik.

Ekonomistët, që mbrojtën politikat proteksioniste filluan të demonstrojnë efektin negativ të tregtisë ndërkombëtare [Prebisch, 1949 - i cili ishte sekretar ekzekutiv i UNCTAD; dhe Singer, 1950 - i cili ishte kreu i Komisionit Ekonomik për Amerikën Latine (ECLA)]. Ata sugjeruan se tregtia ndërkombëtare ka pasur një ndikim negativ në rritjen afat-gjatë për vendet më pak të zhvilluara meqënëse këto vende mund të specializohen vetëm në mallrat për të cilat kishin elasticitet të ulët të ardhurash, perspektiva të ulëta të rritjes së eksportit dhe terma vazhdimisht në rënie të tregtisë.

Në mbështetje të teorisë tradicionale të tregtisë mund të argumentojnë se teoria tradicionale e tregtisë ende tregon mënyrën më të mirë për të kuptuar tregtinë dhe rritjen. Është një gabim të kritikohet impakti i tregtisë në rritjen ekonomike sipas modelit tradicional të tregtisë sepse hapja ndaj tregtisë i lejon vendet të zbulojnë avantazhin e tyre krahasues, të zbulojnë dhe inovacionin si fenomen, për më tepër që hapja ndaj flukseve të tregtisë,kapitalit dhe teknologjisë do të kontribuojë në burimet e rritjes ekonomike.

- Teorema Hecksher-Ohlin

Kjo teori u zhvillua dhe u propozua nga Hecksher (1919) dhe Ohlin (1933). Kjo teoremë kategorizohet si teoremë që merret me anën e ofertës në teorinë e përgjithshme tregëtare sepse ajo shpjegon efektet e sasisë së faktorëve në tregëtinë ndërkombëtare. Ajo përdor shumë supozime për të thjeshtëzuar aplikimin e saj. Baza e kësaj teoreme mund të përshkruhet shkurtimisht si më poshtë. Ka vetëm dy vende dhe dy faktorë homogjenë prodhimi, psh puna dhe kapitali. Përcaktimi fizik dhe përcaktimi i çmimit përdoren për të përcaktuar faktorët relativë të tepricës. E njëjta teknologji përdoret në të njëjtat proçese teknologjike në të dy vendet sikurse dhe një shkallë e njëjtë fitimi.

Këto dy të mira ndryshojnë në intensitetin e faktorëve. Në të dy vendet ka konkurrencë perfekte që sjell si rezultat lëvizshmërinë e faktorëve në secilin vend por palëvizshmërinë ndërmjet dy vendeve. Ndërmjet dy vendeve nuk ka barrierë tarifore apo të ndonjë natyre tjetër.

Bazat dhe skemat e tregtisë janë përfundimet e rëndësishme të dhëna nga kjo teoremë. Ajo përcakton se një vend do të prodhojë dhe eksportojë një produkt që përdor faktorin e tij relativisht më të bollshëm. Meqë kjo e mirë mund të prodhohet me çmim të ulët, prodhimi i saj do të rritet. Në kontrast me sa më sipër, një vend nuk do të prodhojë dhe do të importojë një produkt që përdor faktorin e tij më të rrallë sepse prodhimi i tij në vend do të kushtojë shumë. Kjo teoremë beson se në qoftë se vendet kanë skemën e lartëpërmendur të tregëtisë ata do të përfitojnë maksimumin e mundshëm nga tregëtia ndërmjet tyre. Këto përfitime rrjedhin nga kontributi i avantazheve relative të eksportit të mallrave dhe mungesës së kostove të trasportit ndërmjet dy vendeve.

- Teorema e barazimit të çmimeve të faktorëve.

Kjo teoremë është zgjatim i rëndësishëm i teoremës Hecksher-Ohlin. Sipas kësaj teoreme tregtia shkakton një rritje në çmimin e produktit që është prodhuar nga faktorët relativisht të bollshëm dhe një zbritje të çmimit të produktit të prodhuar nga faktorët relativisht të rrallë. Samuelson (1949) mendon se ndryshimi në çmimin final të të mirave ka lidhje dhe implikime për faktorin çmim në të dy vendet tregëtuese.

Sipas kësaj teoreme, zgjerimi i tregëtisë që paraqet skemën e parashikuar nga teorema Hecksher-Ohlin mund të kontribuojë në barazimin e çmimeve të faktorëve. Nën ekuilibër, çmimet absolute dhe relative të faktorëve do të barazohen si pasojë e faktit që produktet do të kenë të njëjtin çmim relativ dhe absolut, të njëjtën teknologji dhe të njëjtin fitim. Lëvizja e faktorëve ndërmjet vendeve është kushti kryesor për tregëtinë finale të produkteve. Tregëtia con në rritjen e çmimit të faktorit me bollëk dhe uljen e cmimit të faktorit në mungesë ndërmjet vendeve tregëtuese derisa këto çmime të barazohen.

Konkurrenca për barazimin e çmimeve të faktorëve nuk do të ndodhë sepse tregëtia nuk mund të barazojë çmimet e produkteve. Mundell (1957) beson se në rastet e lëvizjes së faktorëve dhe palëvizshmërisë së të mirave ndërmjet vendeve,mund të arrihet i njëjti rezultat në çmimet e të mirave dhe faktorëve. Si pasojë, faktori relativisht i bollshëm do të lëvizë nga

vendi me çmim relativisht më të ulët në vendin me çmim relativisht të lartë derisa të dyja edhe çmimet e të mirave edhe të faktorëve të barazohen për aq kohë sa lëvizja është pa kosto.

- Teorema Stolper-Samuelson

Kjo teori ka një zbatim tjetër të teoremës Hecksher-Ohlin përsa i përket shpërndarjes së të ardhurave nga tregëtia. Çmimi për faktorin e bollshëm rritet dhe çmimi për faktorin e mangët ulet për aq kohë sa ndodh punësimi i plotë përpara dhe pas tregëtisë. Kjo vjen si pasojë e implikimit të faktit se zotëruesit e faktorit në bollëk realizojnë rritjen e të ardhurave të tyre dhe zotëruesit e faktorit të mangët realizojnë uljen e të ardhurave të tyre si pasojë e zgjerimit të prodhimit. Ka pasur shumë debate lidhur me këtë teori kur ajo u publikua nga Stolper dhe Samuelson ne vitin 1941. Argumenti i tyre bazohen në prezumimin se nuk ka asnjë lidhje ndërmjet prodhimit dhe konkurrencës perfekte që çon në barazimin e çmimit të produktit dhe të kostove fillestare. Ndryshimi mesatar i faktorit çmim do të barazojë çmimin e produktit. Kjo mund të konsiderohet si shkaku i efektit zmadhues. Ky efekt ndodh sepse përqindja e ndryshimit në çmimin e të mirave që përdorin intensivisht një faktor është më e vogël se përqindja e ndryshimit në çmimin e atij faktori. Për këtë arsye, tregëtia do të shkaktojë ndryshimin e drejtimit të shpërndarjes së të ardhurave në drejtim të zotëruesve të faktorit të bollshëm për shkak të rritjes së prodhimit.

1.3.3 Teoritë e reja të tregtisë ndërkombëtare

Implikimi i përgjithshëm i modeleve të diskutuara më lart, është që tregtia ndërkombëtare çon potencialisht në mirëqenie më të lartë. Bazuar në këto analiza implikimi i politikës për t'u theksuar është se hapja ndaj tregtisë është një alternativë më e mirë,meqënëse politikat e liberalizimit tregtar kanë tendencë për të përmirësuar, të paktën, mirëqenien në modelin e efiçiencës statike. Megjithatë, shumica e modeleve bëjnë supozime të forta se modelet tradicionale të tregtisë kanë një mbështetje të dobët empirike (Rodrik, 1999). Disa nga këto kufizime janë të trajtuara në teorinë e re të tregtisë.

Dhe janë pikërisht fitimet dinamike nga tregtia, fokusi i teorisë moderne të tregtisë (shih Helpman dhe Krugman , 1985) dhe i teorisë së " Re " të rritjes (shih Grossman dhe Helpman , 1991). Fitimet dinamike përbëjnë një lidhje vitale në zinxhirin shkakësor midis eksporteve neto dhe rritjes .

Nuk mund të ketë dyshim se , historikisht , tregtia ka vepruar si një motor i rëndësishëm i rritjes për vendet në faza të ndryshme të zhvillimit , jo vetëm duke kontribuar në një shpërndarje më të efektshme të burimeve brenda vendeve , por edhe duke e transmetuar këtë rritje nga një pjesë e botës në një tjetër . Jo të gjitha vendet , megjithatë , domosdoshmërisht janë të ndarë në mënyrë të barabartë në rritjen e tregtisë ose të përfitimeve të saj . Kjo do të varet nga prodhimi dhe kërkesa apo karakteristikat e mallrave që prodhon dhe tregton një vend , politikat e brendshme ekonomike të ndjekura , dhe regjimi tregtar që miraton[33] . Në fakt të dhënat kanë treguar së pjesa tregtisë së kryer (volumit tregtar) nga vendet në zhvillim në totalin e tregtisë botërore ka rënë nga 30% në 20% gjatë 20 viteve të periudhës 1965-1985. Prandaj çështja adresonte një shqetësim të rëndësishëm që ska të bëjë më pyetjen "Sa të tregtojmë?" por me pyetjen thelbësore ***" Çfarë të tregtojmë?"***

Teoria e re e tregtisë që ka nisur që në fillim të viteve 1980 nga autorë si (V.Norman (1980), Ethier 1982; A. Dixit dhe Krugman 1984,1986; Brander and Spencer 1985; Eaton and Grossman 1986; Grossman and Horn 1988; and Grossman and Helpman 1991, Coe Helpman and Hoff maister 1997), përpiqet të gjejë një shpjegim në këtë drejtim. Kjo teori merr parasysh disa elementë të rëndësishëm si efektet e përhapjes së njohurive përmes tregtisë, diferencimin e produktit, ekonomitë e shkallës, konkurrencën joperfekte, dhe fokusohet në tregtinë brendadegësore, megjithëse puna empirike në lidhje me to është e bazuar në korniza më eklektike dhe më pak koherente. Nuk është për t'u habitur, pra, se testimi empirik i lidhjes midis tregtisë dhe rritjes ekonomike ka shkaktuar disa polemika dhe ka dalë shumë larg nga rezultatet përmbyllëse (shih, p.sh., Rodriguez dhe Rodrik, 1999; Baldëin, 2003; Rodriguez, 2007).

Evidenca empirike mbi rolin e tregtisë ose hapjes në vetvete , në nxitjen e rritjes ekonomike është e rrethuar nga disa polemika . Rodriguez dhe Rodrik (1999) , për shembull, argumentojnë se lidhjet pozitive midis hapjes dhe rritjes së të ardhurave janë të ekzagjeruara në masë të madhe dhe që puna empirike është e dyshuar duke parë cilësinë e përzierë të të dhënave dhe problemeve që lidhen me matjen dhe metodologjinë empirike . Për më tepër , shumica e eksternaliteteve të tregtisë janë të bazuara në marrëdhëniet makro mes masës së

[33] Për shembull , duke marrë vendet në zhvillim, vëllimi i eksporteve neto është rritur më ngadalë se sa për vendet e zhvilluara që nga viti 1950 (5 për qind në vit për vendet në zhvillim krahasuar me 8 për qind-shin e vendeve të zhvilluara), për shkak se vendet në zhvillim vazhdojnë të prodhojnë dhe eksportojnë mallra parësore me një elasticitet relativisht të ulët të kërkesës ndaj të ardhurave në tregjet botërore .

hapjes dhe masës së të ardhurave ose të rritjes së produktivitetit . Në vend të hapjes dhe zgjerimit të tregtisë , Rodrik , et al . (2004) argumenton për prioritetin e institucioneve në shpjegimin e rritjes ekonomike. Ata vlerësojnë së efekti i tregtisë mbi të ardhurat , pasi kontrollohet për institucionet dhe gjeografinë, është pothuajse gjithmonë insinjifikant, edhe pse i lidhur pozitivisht me institucionet efektive. Reformat tregtare në përgjithësi, dhe MTL-të në veçanti, janë parë shpesh si mjete për të aplikuar reforma të tjera që e bëjnë mjedisin e investimeve më tërheqës për të thithur IHD nga vendet e zhvilluara përmes të cilit mund të ndodhë potencialisht një transferim i teknologjisë globale dhe produktivitet më i lartë. Waldkirch (2006) tregon se investimet e huaja janë gjithashtu subjekt i rrezikut sovran dhe MTL-të mund të shërbejnë si një mekanizëm për të arritur nivele më të larta të qëndrueshme të IHD-ve. Raff (2004) madje argumenton se MTL-të ndikojnë vendndodhjen e IHD-ve meqënëse qeveritë mund të rregullojë taksat dhe tarifat e jashtme për të konkurruar për IHD – të dhe çështja nëse kjo ngre apo e ul mirëqenien është treguar se varet nga madhësia relative e përfitimit në efiçiencë nga integrimi dhe nga humbja e të ardhurave e lidhur me konkurrencën e taksave. Këto gjetje përforcojnë pikën se përfitimet në mirëqenie nga tregtia dhe tërheqja e investimeve të huaja përmes MTL-ve janë specifike në kontekst, si dhe se përfitimet ka të ngjarë të jenë më të mëdha për ekonomitë që tashmë kanë ekonomi të brendshme më të integruara. Së fundi, teoria e vjetër tregtisë fokusohet në përfitimet në efiçiencë përmes tregtisë duke u përqëndruar në konceptin e përparësive krahasuese. Megjithatë, ekonomitë që disponojnë në sasi të bollshme burime natyrore, për shembull, janë gjetur të kenë norma më të ulëta rritje në mënyrë sistematike në periudhat afatgjata për një shumëllojshmëri të mekanizmave që janë ose jo të lidhura me tregtinë (shih, për shembull, Murshed, 2006 për një rishikim).

Vendet në zhvillim me të ardhura të ulëta shpesh kanë edhe një bollëk relativ. të punës dhe burimeve natyrore, por kryesorja këto vende mbeten të specializuar në një faktor të bollshëm në përgjithësi. Specializimi në këto vende ka të njëjta dobësi kur bën një perspektivë më të gjerë krahasuese: Varësia e tregtisë në aktivitete me integrim të dobët me pjesën tjetër të ekonomisë, nivel i ulët i sofistikimit teknologjik në prodhim (prandaj përhapje e ulët e dijes) dhe dobësi në vend të luhatshmërisë për tju përgjigjur shënuesve përkatës të mallrave. Siç është analizuar dhe në Anketën Botëror Ekonomike dhe Sociale të Kombeve të Bashkuara të vitit 2006, dobësi të tilla janë të lidhura në thelb normat e ulëta të rritjes për frymë në periudhat afatgjata në krahasim me vendet me lidhje të forta të brendshme dhe të cilat kanë diversifikuar në eksport mallrat me përmbajtje më të lartë të teknologjisë (United Nations

2006) .Ka gjasa që në fakt më me rëndësi është lloji i mallit që eksporton (çfarë eksportohet) sesa sasia e tregtisë që kryen (sa shumë tregtohet).

Coe, Helpman, dhe Hoff maister (1997), për shembull, vlerësuan lidhjen tregti-produktivitet për vendet në zhvillim, duke gjetur përfitime të konsiderueshme në fushën e kërkim-zhvillimit në vendet në zhvillim përmes eksporteve të makinerive dhe pajisjeve drejt vendeve të zhvilluara. Ata vlerësuan se një për qind rritje në importin e makinerive dhe pajisjeve do të rezultonte me një rritje 0,3 për qind në produktivitetit e faktorit të përgjithshëm.

Konkluzionet pozitive për hapjen tregtare në këto modele është e varur shumë nga hipotezat specifike rreth naturës së modelit të implementuar.

Sipas modelit të rritjes endogjene që ka përdorur Rivera-Batizand Romer (1991), nxirren rezultate që tregojnë se efektet e rritjes së aksesit në mallra kapitale të huaja në treguesit e produktivitetit dhe rritjes do të jenë afatshkurtra vetëm po të mos rriten kapacitetet me një normë më të shpejtë gjatë periudhës së reformave tregtare. Në afat të gjatë, norma e rritjes së outputit tërhiqet poshtë nga norma e rritjes së kapitalit njerëzor.

Në dritën e dëshmive të kohëve të fundit , hapja tregtare çon investimet në kapitalin njerëzor në nivelet sekondare dhe terciare (Wood dhe Ridao-Cano 1999). Kjo nënkupton se të gjitha fitimet për vendet e varfra nga aksesi në importet e teknologjisë mund të jetë limituara. Një përfundim negativ për efektet e hapjes është arritur edhe nga disa modele të fundit endogjene të tregtisë që i rikthehen sërish argumenteve të industrisë foshnjore nga që kanë të bëjnë në mënyrë të qartë me rolin e të mësuarit nga situatat e mbrojtjes në vendet me nivel të ulët të industrializimit. Këto modele, kanë treguar se vendet e varfra janë specializuar në produktet me teknologji të ulët kur u lejohej tregtia e lirë ndërsa shtrëngimet tregtare i bënin këto vende të zhvillonin industritë komplekse (Reddy 1999). Këto rezultate të paqarta të modeleve të rritjes/tregtisë endogjene janë komplikuar edhe më tej nga fakti se politikat tregtare që synojnë norma të larta të rritjes ekonomike jo gjithmonë e kanë përmirësuar mirëqenien. Për një ekonomi të vogël të hapur, Osang dhe Pereira (1996) gjejnë se të gjitha tarifat janë të dëmshme për rritjen afatgjatë, por mund të ketë rritje në mirëqenie në periudha afatshkurtra . Përveç kësaj, nuk ka asnjë arsye për të vendosur që tarifat duhet të jenë unifome për të gjithë mallrat që të kemi maksimizim mirëqënieje.

Dallimi thelbësor midis teorive të vjetra dhe të reja të tregtisë është se teoria e re e tregtisë merr në konsideratë strukturën e tregut, domethënë,të ashtuquajturën konkurrencë joperfekte (jo e plotë). Një nga karakteristikat kryesore të teorisë së re të tregtisë, është se ajo konsideron edhe ekonomitë e shkallës. Për më tepër, ajo hulumton dhe gjithashtu justifikon lidhjen që mungon që avantazhi krahasues apo faktori ndihmës nuk e shpjegon. (Helpman dhe Krugman, 1985, dhe Krugman, 1990).

1.3.4 Konkurrenca joperfekte dhe eksternalitetet e tregtisë

Teoria Hecksher-Ohlin supozon një treg me konkurrencë perfekte, në fakt ky përbën dhe supozimin më të rëndësishëm të kësaj teorie, supozim ky që bie ndesh me situatat reale ku konkurrenca nuk është perfekte. Megjithatë ky supozim është i domosdoshëm për të garantuar realitetin tjetër që çmimet e produkteve dhe të faktorëve do të barazohen me anë të tregtisë. Panvarësisht se në botën reale informacioni joperfekt, barrierat për të hyrë të cilat mund të jenë natyrale ose jo , bëjnë që konkurrenca të jetë jo perfekte në shumë forma të ndryshme. Efektet që vijnë si pasojë e kësaj konkurrence jo të plotë kontribuojnë për të krijuar të ashtuquajturat eksternalitete të tregtisë.

Monopolisti i cili e ruan pozicionin e tij në tregun vendas, zgjedh të eksportojë me çmime ndërkombëtare. Në të njëjtën mënyrë monopolisti vazhdon të sillet si çmim përcaktues në vend dhe shndërrohet në çmim pranues në tregun e jashtëm.Pra ka një ndryshim të pozicionit të tij ku sillet si monopolist në tregun vendas ndërsa me tregun e jashtëm sillet si Konkurrent i Plotë.

REFORMAT E POLITIKAVE TREGTARE

Në dekadat e fundit është parë një rritje e shpejtë e ekonomisë botërore. Kjo rritje ka qenë e nxitur pjesërisht nga rritja e shpejtë edhe në tregtinë ndërkombëtare. Rritja e tregtisë ka ardhur si rezultat i zhvillimeve teknologjike dhe i përpjekjeve të bashkërenduara për të reduktuar barrierat e tregtisë. Disa vende në zhvillim kanë hapur ekonomitë e tyre për të përfituar plotësisht nga mundësitë për zhvillimin ekonomik nëpërmjet tregtisë, por shumë të tjera nuk e kanë ndërmarrë këtë iniciativë . Barrierat e mbetura të tregtisë në vendet industriale janë të përqendruara në produktet bujqësore dhe në prodhimin e atyre produkteve që kërkojnë punë krahu intensive, sektor në të cilin vendet në zhvillim kanë një avantazh krahasues. Liberalizimi tregtar më tej në këto zona veçanërisht, nga të dy si vendet e industrializuara dhe ato në zhvillim, do të ndihmojnë arratisjen nga varfëria ekstreme, ndërsa edhe vetë vendet industriale mund të përfitojnë nga kjo iniciativë e vendeve në zhvillim.

Përfitimet e mundshme nga eliminimi i barrierave tregtare të mbetura janë të konsiderueshme. Rreth dy të tretat e këtyre fitimeve do të grumbullohen në vendet industriale. Por shuma e grumbulluar për vendet në zhvillim do të jetë më shumë se dyfishi i nivelit të ndihmës që ata aktualisht marrin[34], për shkak se ekonomitë e tyre janë shumë më të mbrojtura dhe për shkak se ata përballen me barriera të larta .

Edhe pse ka shumë përfitime nga aksesi i përmirësuar në tregjet e vendeve të tjera, vendet përfitojnë më shumë nga liberalizimi i vetë tregjeve të tyre.

[34] Të dhënat e publikuara në faqën e Komisionit Europian http://madb.europa.eu/madb/statistical_form.htm

2.1 TREGTIA E LIRË GLOBALISHT

Tregtia e lirë është një shpatë me dy tehe . Në sipërfaqe duket si mundësi e barabartë për të gjithë pjesëmarrësit në marrëveshjet e ndryshme tregtare që bën një vend . Ndërsa kjo tregti ka disa avantazhe , gjithashtu mbart edhe disa disavantazhe . Shkalla e disavantazhit për çdo vend në zonën e tregtisë së lirë është e lidhur drejtpërdrejt me nivelin e arritur së teknologjisë në atë vend . Kjo do të thotë se vendet anëtare më pak të industrializuara në një zone të tregtisë së lirë mund të jenë në disavantazh ndaj vendeve të tilla për të kapërcyer pengesat e tyre teknologjike .

2.1.1 Globalizimi- një fenomen shumëdimensional

Globalizimi është një proces i ndryshimit social, një fenomen shumëdimensional. Ai është i aplikueshëm ndaj formave të ndryshme të aktivitetit social, ekonomik, politik, legal, kulturor, teknologjik etj. Globalizimi dhe efektet e tij mbi zhvillimin ekonomik kanë qenë subjekt i një debati intensiv dhe të pasionuar gjatë dekadës së fundit.Pikëpamja optimiste argumenton se liberalizimi tregtar, dhe eliminimini i barrierave i nënkuptuar për konkurrencë, është rruga e drejtë për vendet në zhvillim për të nxitur rritjen dhe për të zhdukur varfërinë [shih, për shembull, Dollar dhe Kray (2001, 2002), Frankel dhe Romer (1999), Sachs dhe Warner(1995) dhe Banka Botërore (2001)]

Hiperglobalistët (Kenichi Ohmae, 1995)e shohin globalizimin si një epokë të re në historinë njerëzore. Për ta prodhimi dhe konsumi në ekonomitë kombëtare janë të ndara, pasi konsumatorët mund të blejnë tani edhe jashtë vendit. Me rritjen e konkurrencës së bazuar mbi avantazhin teknologjik, vendet nuk mund të mbështeten gjatë mbi avantazhin krahasues natyror. Ato duhet të gjenerojnë avantazhe teknologjike të vazhdueshme për të mbajtur pozicionin e tyre tregtar. Pra, rezultatet tregojnë se përparimet në shkencë dhe teknologji kanë lejuar bizneset lehtësisht të kalojnë mbi vijat kufizuese territoriale siç mund të përmendim integrimin e tregjeve apo zvogëlimin e barrierave ndërkombëtare. Nga një këndvështrim amerikan, "tregtia globale e lirë" do të sigurojë një hapje të tregjeve drejt ekonomive më të mëdha dhe me rritje më të shpejtë ekonomike në botë dhe në këtë mënyrë

mund të stimulojë rritjen e shpejtë të eksporteve dhe punët e mira që vendet e tjera prodhojnë. Nga pikëpamja evropiane, rritja e tillë e eksportit mund të sjellë si efekt të padëshiruar papunësinë.

Në kundërshtim me perspektivat që mbështesin rritjen globale të kapitalizmit, skeptikët (Held and Thompson, 1989)theksojnë faktin se investimet e huaja do të vihen nën kontrollin e disa ekonomive më të përparuara. Skeptikët deklarojnë që tregtia botërore në lidhje me produktin është rikthyer në nivelet e Standartit të Arteve Klasike, ka prirje rajonale dhe rritja e saj është kufizuar nga rritja e proteksionizmit. Prandaj sipas tyre ekonomitë kombëtare mbeten të rëndësishme.

Si hiperglobalistët edhe skeptikët e shikojnë ekspansionin e sotëm të tregtisë si pasojë e rënies së proteksionizmit dhe kostove të transportit. Kostot e transportit dhe ato të telekomunikacionit kanë rënë vazhdimisht që në 1930-ën, duke reduktuar kostot e tregtisë dhe duke i bërë të mirat dhe veçanërisht shërbimet më të tregtueshme e më të konkurueshme. Por tregtia është rritur edhe nga shfaqja e tregjeve globale dhe natyra e impaktit të tyre mbi ekonomitë kombëtare.

Një nga fushat kryesore të fokusit të letërsisë së globalizimit ishte ndikimi i globalizimit në vendet në zhvillim . Dhe kjo është një fushë ku ka shumë perspektiva alternative dhe nuk ka konsensus të qartë se cili është ndikimi i këtij fenomeni . Nga kjo lindin tre çështjet kyçe në lidhje me vendet në zhvillim :

Së pari, **globalizimi** thjesht ka kaluar nëpër vendet në zhvillim.

Argumentet kryesore në kuadër të kësaj çështje janë të lidhura me pamjaftueshmërinë e vendeve në zhvillim për t'u përshtatur me proceset e globalizimit për shkak të problemeve institucionale dhe strukturore të qenësishme brenda këtyre vendeve. Perspektiva që globalizimi thjesht ka kaluar nëpër vendet në zhvillim pranon përfitime tregtare të njohura edhe nga ekonomistët klasikë dhe neoklasike, por pretendon se këto përfitime nuk janë të shtrira deri tek vendet në zhvillim.

Së dyti, **globalizimi** ka pasur pasoja negative për vendet në zhvillim.

Më konkretisht, vendet në zhvillim janë kryesisht jo në gjendje për të prodhuar atë që është duke jua kërkuar ekonomia ndërkombëtare, disa vende në zhvillim janë në disavantazh nga pozita e tyre gjeografike, por edhe burimet apo infrastruktura në vendet në zhvillim bën që

këto vende të mos jenë në gjendje për të adoptuar atë trend prodhimi që është i lidhur rëndom me fenomenin e globalizimit. Ndërsa globalizimi ka sjellë nivele të larta të tregtisë dhe investimeve, shumë vende në zhvillim nuk kanë parë ndryshime domethënëse në vëllimet e tyre të tregtisë dhe investimeve (Eswar S. Prasad, Kenneth Rogoff, Shang-Jin Wei, and M. Ayan Kose (2003), ndërkohë që herë pas here kanë përjetuar edhe një rënie, dhe për shkak të këtij fakti tregtia dhe investimet janë ridrejtuar në vende që janë më shumë në gjendje të marrin pjesë në ekonominë ndërkombëtare. Perspektiva që globalizimi ka qenë i dëmshëm për vendet në zhvillim analizon ndryshimet që ekzistojnë midis ekonomisë së tanishme ndërkombëtare dhe ekonomisë ndërkombëtare që ekzistonte që nga koha që u propozuan teoritë tradicionale ekonomike që mbështetën përfitimet e tregtisë..

Së treti, **globalizim**i ka qenë një përvojë pozitive për vendet në zhvillim.

Ekziston një lidhje në masë të madhe mes teorisë ekonomike dhe letërsisë së globalizimit në vendet në zhvillim. Shumica e argumenteve që globalizimi ka qenë i dobishëm për vendet në zhvillim ka gjetur origjinën në teoritë klasike dhe neoklasike.

Në fakt, ekziston një hendek i qartë në letërsinë aktuale që ofron një studim të plotë të vendeve të veçanta, në mënyrë që të kuptojmë nëse këto janë prekur nga proceset e globalizimit, dhe nëse jo, apo edhe nëse efekti neto në këto vende ka qenë pozitiv apo negativ. Globalizimi është një term shumë i përdorur në shekullin e njëzetë. Kjo thjesht do të thotë se bota është integruar ekonomikisht, shoqërisht, politikisht dhe kulturalisht përmes përparimeve të teknologjisë, transportit dhe komunikimit.

Duke përdorur këto analiza mund të zbulojmë një korrelacion të fortë midis globalizimit dhe rritjes ekonomike, kështu që globalizimi nxit rritjen dhe disa vende në zhvillim aktualisht gëzojnë norma të ulëta rekord të papunësisë.

Tregtia globale e lirë do të rrisë prosperitetin e të gjithë vendeve duke nënshkruar dhe suksesin e fundit për liberalizimin konkurrues. Këtu përjashtohet rreziku që marrëveshjet rajonale mund të zhvillojnë dy blloqe armiqësore jashtë çdo kornize gjithëpërfshirëse globale. Në këtë sens me anë të globalizimit i jepet fund çdo rreziku konflikti duke angazhuar të dy vendet në një ndërmarrje bashkëpunuese shumëpalëshe.

Kompanitë në zonat e lira tregtare janë gjithmonë në konkurrencë me njëri-tjetrin. Kjo konkurrencë është mjaft pozitive dhe në aspektin e ristrukturimit. Nëse kompanitë që janë në

disavantazh konkurrues ristrukturojnë operacionet e tyre, mund të fitojnë pozicione konkurruese me konkurrentët e tyre.

Ideja për globalizim nuk është i kohëve të fundit, por gjithkush flet për këtë intensivisht dhe sistematikisht që nga shekulli i kaluar. Globalizimi, si pikënisje është i bazuar në konkurrencën dhe shoqëritë pluraliste demokratike, ekonomi të hapur dhe të tregut, duke respektuar të drejtat dhe liritë. Globalizimi zvogëlon rolin e kufijve kombëtar dhe bashkon tregjet kombëtare në një treg të vetëm të përbashkët dhe unike në botë. Karakteristikat kryesore të globalizimit janë rritja e tregtisë ndërkombëtare, duke rritur dhe përqendrimin e flukseve hyrëse të kapitalive ndërkombëtare dhe migrimit të popullsisë, zhvillimin e teknikës dhe teknologjisë dhe industrializimit. Shumë analistë në botë, kur flasim për globalizimin, shpesh theksojnë se globalizimi është një proces i perspektivës njerëzore dhe si një i tillë është i pashmangshëm. Megjithatë, si çdo fenomen i madh, gjithashtu ka dobësitë e veta dhe problemet, të cilat i kategorizon njerëzit në mbështetësve dhe kundërshtarëve të globalizimit. Globalizimi, si pikënisje dhe si bazë, ka konkurrencën, si një kategori e zhvillimit progresiv të shoqërisë bashkëkohore globale.

2.2 INTEGRIMI EKONOMIK

Liberalizimi tregtar është një pasojë e drejtpërdrejtë e integrimit ekonomik (IE) dhe koncepti i integrimit ekonomik mund të na ofrojë një arsyetim teorik për liberalizimin tregtar. Është e nevojshme gjithsesi që të cilësohet si background dallimi i qartë që ekziston ndërmjet liberalizimit dhe integrimit ekonomik dhe mbi të gjitha ky dallim është me vlerë për konceptet bazë të studimit.

Liberalizim do të thotë akses në më shumë tregje të hapura , tregti e lirë dhe liberalizim investimesh në përputhje me qëllimet e OBT-së .

Integrimi ekonomik (IE) përfshin marrëveshjet preferenciale të tregtisë (MTL-të) në procesin e zhvillimit si pasojë e tregtisë dhe investimeve apo dhe liberalizimit financiar (Obstfeld dhe Taylor , 2004) . Ka shumë koncepte themelore të përfshira në integrimin

ekonomik . Një nga konceptet themelore është se vendet anëtare lëvizin drejt tregtisë më të lirë dhe drejt hapjes më shumë të ekonomive të tyre për të përfituar avantazhe ekonomike (Appleyard dhe Field , 1998 , fq . 353). Integrimi ekonomik nuk mund të matet me aktivitete të tjera të tilla si investimet dhe bashkëpunimi lidhur me ekonominë .

Ka disa lloje themelore të integrimit ekonomik . Shkalla e ekonomike e integrimit ndryshon sipas llojit të marrëveshjes së tregtisë në fuqi (Appleyard dhe Field , 1998 , f . 353) .

Së pari , në nivelin fillestar , Marrëveshjet preferenciale tregtare (PTAs) që ulin barrierat tregtare midis anëtarëve . Tregtia e tillë preferenciale është e kufizuar zakonisht në pjesën futjes së flukseve tregtare nga vendet më pak të zhvilluara , dhe shpesh është jo- reciproke .
Së dyti , në bazë të një Marrëveshje e Tregtisë së Lirë. MTL-ja , është një marrëveshje reciproke ku barrierat tregtare (zakonisht tarifat) midis kombeve pjesëmarrëse shfuqizohen pra të gjithë anëtarët duhet të heqin tarifat për produktet që tregtojnë me njëri tjetrin . Megjithatë , çdo anëtar mund të aplikojë tarifa të pavarura për tregtinë që kryen me vende të tjera jo-anëtarë . Më gjerësisht, barrierat e tregtisë janë ulur me kalimin e kohës , por në shumicën e rasteve , jo e gjithë tregtia është plotësisht i lirë nga barrierat kombëtare. Një shembull i shquar i një MTL të tillë është Marrëveshja e Amerikës së Veriut e Tregtisë së Lirë (NAFTA) .
Së treti, në rastin e një unioni doganor . Në një Bashkimin Doganor , barrierat tregtare midis anëtarëve janë plotësisht të eliminuara pra vendet anëtare i heqin të gjitha tarifat midis tyre . Është e rëndësishme që grupi të veprojë si një trup i vetëm në aspektin e negociatave që do të kryejë për marrëveshjet tregtare me vendet jo-anëtare .Prandaj kombet pjesëmarrëse miratojnë një politikë të përbashkët të tregtisë së jashtme (p.sh. regjimi i zakonshëm i jashtëm tarifor ose CET) Tarifa që do të aplikohet për vendet jo - anëtare është tarifa e zakonshme e jashtme . Një Bashkimi Doganor është ekuivalent me një MTL plus një politike të përbashkët të tregtisë së jashtme . Bashkimi Doganor i Southern Cone (Mercosur) - përfaqëson një marrëveshje të tillë .

Së katërti , një treg i përbashkët formohet nga kombinimi i një MTL-je dhe një bashkimi doganor Ky nivel i integrimit ekonomik është Tregut i Përbashkët. Në kuadër të tregut të përbashkët , të gjitha pengesat për lëvizjen e faktorit e mallrave dhe faktorëve do të duhet të hiqen dhe vendet mbajnë një politikë të përbashkët për tregtinë e jashtme . Kjo do të thotë se puna dhe kapitali si faktorë prodhimi mund të rrjedhin lirisht në midis vendeve anëtare. Një

shembull i Tregut të Përbashkët është ai i Tregut të Përbashkët për Afrikën Lindore dhe Jugore (COMESA),por shembulli më i shquar i një tregu të përbashkët është Komuniteti Europian (KE) që filloi në vitin 1958 dhe ka tani është transformuar në Bashkim Europian (BE) .

Së pesti forma më e plotë e integrimit ekonomik është një bashkim ekonomik. Në një Bashkim Ekonomik , përveç lëvizjes së lirë të mallrave dhe faktorëve të prodhimit , vendet anëtare të miratojnë edhe politika të përbashkëta makroekonomike .Pra anëtarët duhet të realizojnë bashkimin e institucioneve ekonomike dhe duhet të përmbushin bashkëpunimin nëpërmjet politikës uniforme ekonomike . Ky është qëllimi afatgjatë i pothuajse të gjitha vendeve e veçanërisht i atyre që janë në procesin e formimit të një bashkimi ekonomik , edhe pse kjo është një procedurë shumë e vështirë dhe një rrugë e gjatë . Një shembull i Bashkimit Ekonomik është Bashkimi Evropian (BE) .

2.2.1 Avantazhi konkurrues

Avantazhi konkurrues i shteteve mund të konsiderohet si themeli i IE-ve dhe MTL-ve. Një objektiv themelor i IE-ve dhe MTL-ve është të stimulojë konkurrencën e anëtarëve me qëllim arritjen e rritjes ekonomike. Porter (1990) beson se teoria e avantazhit konkurues nuk është e mjaftueshme për të shpjeguar konkurrencën, Bazuar në këtë model, besohet se avantazhi konkurrues i shteteve është një pasojë direkte e aftësisë konkurruese të firmave (subjekteve tregëtare) të tyre (Porter 1990). Më qartësisht, risitë mund të kontribuojnë në aftësinë konkurruese të firmave. Përmirësimet teknike të produkteve dhe të procesit të prodhimit konsiderohen si një risi. Katër janë faktorët që i atribuohen avantazhit konkurues kombëtar: kushtet e faktorëve; kushtet e kërkesës;kushtet e lidhura dhe strategjia e firmave; struktura dhe rivaliteti.

Kushtet e faktorëve përfshijnë të gjithë elementët që përdoren si faktorë të prodhimit, psh, puna, toka, burimet natyrore, kapitali dhe infrastruktura. Këto faktorë i atribuohen avantazhit konkurues të qëndrueshëm për shkak të vështirësisë së mbajtjes së investimeve të qëndrueshme në të njëjtin nivel. Më tej theksohet se kompleksiteti i tregut të brendshëm është një faktor tjetër që kontribuon në konkurrencë (Porter 1990). Nëse firmat konkurrojnë në një treg të sofistikuar, atëherë ato duhet tu ofrojnë konsumatorëve produkte të cilësisë së lartë.

Përveç kësaj firma duhet të jetë në gjendje të kuptojë kërkesat ekzakte të konsumatorit duke mbajtur një marrëdhënie të ngushtë me ta. Sa më shumë një shtet i jep vlerë dallimit në krahasim me shtetet e tjera aq me konkurruese bëhen firmat lokale në tregun global.

Kushtet e lidhura dhe industritë mbështetëse, duke përfshirë furnizuesit, gjithashtu kontribuojnë në modelin e avantazhit konkurrues të një shteti. Është dëshmuar se fuqia dhe energjia e industrive mbështetëse rrisin aftësinë konkuruese të firmave (Porter 1990). Kjo situatë normalisht ndodh në një nivel rajonal. Vec kësaj konkurrentët e fortë apo të dobët në industritë të cilat ushtrojnë veprimtari në të njëjtën zonë gjeografike stimulojnë aftësinë konkurruese të firmës.

Karakteristikat e tregut të kapitalit ndikojnë në strategjinë e firmës, në strukturën dhe rivalitetin (Porter 1990). Industritë në vendet me një perspektivë afatshkurtër (afatgjatë) në tregjet e kapitalit ka mundësi të jenë më konkuruese se industritë në vende ku investimet janë afatshkurtra (afatgjata). Gjithashtu industri të ndryshme kanë praktika të ndryshme administrimi dhe industritë në vende të fokusuara në një mënyrë të caktuar administrimi mund të jenë më konkuruese sesa ato të një vendi tjetër. Në terma rivaliteti, një konkurrencë më intensive, krijon më shumë risi. Kjo është vënë re në Japoni ku shumë firma konkurrojnë intensivisht në shumicën e industrive. Roli i qeverisë është gjithashtu i rëndësishëm në garantimin që modeli i avantazhit konkurues të shtetit të jetë i vlefshëm. Qeveria ka shumë kanale të vlefshme për të përkrahur të katër faktorët në këtë model si mbështetje të drejtpërdrejtë nëpërmejt financimit dhe jo të drejtpërdrejtë nëpërmjet infrastrukturës, kanalit të taksës së pasurisë dhe edukimit të punonjësve të paspecializuar.

2.3 LIBERALIZIMI TREGTAR SHUMËPALËSH---Një vështrim historik

Objektivi kryesor i organizatave qeveritare e jo qeveritare ka qenë stabiliteti midis vendeve. Për shumë studiues ka qenë e pamundur tregtia e lirë për shkak të mureve të larta tarifore. E parë nën këtë prizëm politikat ekonomike e tregtare duheshin rikonsideruar dhe rihartuar. Në vijim të kësaj ideje u krijuan disa institucione ndërkombëtare që do të koordinonin politikat ekonomike për të garantuar stabilitetin monetar global (Fondi Monetar Ndërkombëtar) dhe do

të nxisnin zhvillimin ekonomik të kombeve nëpërmjet dhënies së kredive për zhvillim (Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, më vonë e njohur si Banka Botërore). Krahas krijimit të organizatave të mësipërme u bënë disa tentativa jo efikase, për të krijuar një Organizatë Ndërkombëtare të Tregtisë, prandaj më vonë u krijua një Marrëveshje e Përgjithshme për Tregtinë dhe Tarifat (GATT). Qëllimi i GATT-it ishte liberalizimi tregtar në nivel global, duke bërë kështu të mundur dhe rregullimin e tregtisë midis kombeve, edhe pse kanë qënë jo të paktat debatet mbi këtë temë midis vendeve nënshkruese, deri në krijimin e më vonshëm, në vitin 1995, të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT). Rezultati i negociatave në kuadrin e sistemit global të tregtisë ka çuar në një reduktim të ndjeshëm të mbrojtjeve tarifore. Nivelet e tarifave doganore në vendet e zhvilluara variojnë (sipas vendeve) në 3-5% me disa përjashtime për sektorë. Ndërsa në vendet në zhvillim mbrojtjet tarifore vazhdojnë të jenë mjaft të larta, ku niveli mesatar i tarifave të aplikuara arrin në mbi 10%. Një dimension tjetër i politikave tregtare është rritja e barrierave jo tarifore e parë kjo si një mjet mbrojtës i industrisë. Rritja e rolit të masave jo tarifore është parë proporcionalisht me rënien e rolit të tarifave doganore. Janë marrë masa që lidhen me lehtësimin e tregtisë. Raundi i Uruguajt i OBT-së e vuri theksin në reduktimin e barrierave tarifore ndaj tregtisë, me qëllim lehtësimin e saj. Dimensioni i Tretë janë marëveshjet bilaterale të tregtisë së lirë.

2.3.1 Tregtia Ndërkombëtare dhe Ekonomia Botërore-- Liberalizimi Tregtar shumëpalësh

Integrimi në ekonominë botërore ka rezultuar një mjet i fuqishëm me anë të të cilit vendet nxisin rritjen ekonomike , zhvillimin dhe uljen e varfërisë. Gjatë 20 viteve të fundit ,rritja e tregtisë botërore ka arritur shifrën mesatare prej 6 përqind në vit , dy herë më shpejtë se sa rritja e prodhimit botëror[35] . Evidentohet në grafikun e mëposhtëm një rënie veçanërisht vitet që pasuan krizën botërore, megjithatë për vitet e fundit të dhënat parashikohen më optimiste duke llogaritur se në 2014 tregtia botërore do të rritej me 4,7%, ndërsa në 2015 akoma më mirë me 5,3%.

[35] Të dhëna të siguruara nga OBT (WTO,2013) faqja zyrtare në linkun përkatës http://www.wto.org/statistics

Figura.3: Rritja e tregtisë botërore



Burimi: OBT

Por tregtia ka qenë një motor i rritjes për shumë më të gjatë . Që nga viti 1947, kur Marrëveshja e Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë (GATT) u krijua , sistemi i tregtisë botërore ka përfituar nga tetë raundet e liberalizimit tregtar shumëpalëshe , si dhe nga liberalizimi i njëanshëm dhe rajonal. Në të vërtetë ,i fundit prej këtyre tetë raundeve (i ashtuquajturi " Uruguay Round ", përfunduar në vitin 1994) çoi në krijimin e Organizatës Botërore të Tregtisë.

Ndikimi i një sistemi tregtar shumëpalësh, ashtu sic është mishëruar në rregullat (futur në vitin 1995) e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT), ka kontribuar në mënyrë sinjifikative në rritje ekonomike , zhvillim dhe punësim. Mosdiskriminimi, transparenca dhe tregtia e ndershme janë parimet kryesore të OBT-së. Vendet në zhvillim kanë prioritete dhe interesa shumë të ndryshme për sa i përket detyrimeve të tyre që lindin si rezultat i integrimit të tyre

ekonomik rajonal dhe për sa i përket varësië se këtyre vendeve mbi tregtinë në bujqësi, në prodhim dhe në shërbime (Schott, 2000, fq. 15).

Një nga mësimet më pak të diskutueshme të ekonomisë neoklasike është se tregtia e lirë rrit mirëqenien agregate duke alokuar në mënyrë eficente burimet brenda vendeve. Megjithatë, tregtia e lirë gjithashtu gjeneron konflikt edhe në shpërndarje: pra , nuk mund të themi nëse do të ketë fitues dhe as humbës.

Integrimi i ekonomisë botërore ka ngritur standardet e jetesës në mbarë botën . Shumica e vendeve në zhvillim kanë ndarë këtë prosperitet ; në disa vende në zhvillim , të ardhurat janë rritur në mënyrë dramatike . Si një grup , vendet në zhvillim janë bërë shumë më të rëndësishëm në botën e tregtisë ,sepse ata tani përbëjnë një të tretën e tregtisë botërore , nga rreth një e katërta në fillim të viteve 1970 . Shumë vende në zhvillim kanë rritur ndjeshëm eksportet e tyre në manifakturë, sektor i cili zë deri në 80 për qind të eksporteve të këtyre vendeve. Për më tepër , tregtia midis vendeve në zhvillim është rritur me shpejtësi , rreth 40 për qind e eksporteve tani shkon drejt vendeve të tjera në zhvillim. Pra një hov të rëndësishëm ka marrë dhe integrimi brenda këtyre rajoneve të vendeve në zhvillim.

Hapat e parë në uljen e pengesave si në bujqësi ashtu dhe në sektorin e shërbimeve u ndërmorrën në raundin e Uruguait ku negociatat filluan në nëntor 1982 nga takimi ministror i anëtarëve të Marrëveshjeve të Përgjithshme mbi Tarifa dhe Tregti (GATT) sesion i cili u zhvillua në Gjenevë, Zvicër. Që nga ajo kohë tarifat industriale janë ulur në mënyrë të konsiderueshme me kalimin e kohës, por me përjashtime, ndërsa subvencionet , kuotat tarifore dhe pengesa të tjera jo-tarifore do të mbeteshin ashtu sic ishin (OBT , 2006) . Problemi qëndron tek fakti që tarifat që kanë vendosur vendet në zhvillim janë përgjithësisht të larta, por panvarësisht kësaj vendet anëtare e kanë për detyrë të reduktojnë tarifat dhe barrierat e tjera jo tarifore. Në fakt negociatat e nisuara që në 1982 u dobësuan për shkak të konfliktit mes anëtarëve në lidhje me fushën e mbulimit dhe karakteristikave të rregulloreve . Mund të thuhet se kërkesat e performancës të eksportit dhe të teknologjisë nuk mbuloheshin nga marrëveshja e Raundit të Uruguait (OBT,2006) .

Qëllimet e marrëveshjeve që në 1986 ishin për të zgjeruar dhe për të promovuar liberalizimin tregtar botëror dhe për të lehtësuar investimet përtej kufijve ndërkombëtarë me qëllim promovimin e rritjes ekonomike e të gjithë partnerëve , veçanërisht për vendet në zhvillim

nëpërmjet nxitjes të konkurrencës së lirë . Tregtia në shërbime nuk u përfshi në këto marrëveshje.

Prandaj , mund të thuhet se këto marrëveshje arritën thjesht të kenë efektin përshkrues të përmbajtjes së kërkesave të brendshme, duke zgjeruar dhe duke siguruar mjete specifike të performancës së eksporteve kontribut ky për investitorët e huaj (Moran , 2000 , fq . 223) .

Deklarata Doha që u krijua në Konferencën e Katërt Ministrore në Doha , Katar në vitin 2001 , siguroi negociata të rëndësishme duke përfshirë zbatimin e çështjeve që lidhen me marrëveshjet aktuale .Në lidhje me bujqësinë , u rikonfirmua qëllimi afatgjatë i cili synonte që të krijohej një sistem tregtar i drejtë dhe i orientuar drejt tregut. Qeveritë e vendeve anëtare janë të përkushtuar për të lejuar akses të konsiderueshëm në tregjet e tyre , për të reduktuar subvencionet e eksportit të të gjitha formave dhe për të reduktuar cfarëdo suporti të brendëshëm që mund të shtrembërojë tregtinë . Edhe cështja e aksesit në tregje të cilat tregtojnë produktet jo- bujqësore u përfshi në Deklaratën Doha dhe në të njëjtën kohë u implementuan dhe negociatat mbi heqjen e tarifave për të gjitha produktet jo - bujqësore .

Objektivi i kësaj skeme është për të eliminuar tarifat dhe barrierat jo- tarifore sidomos në eksportin e produkteve të vendeve në zhvillim . Periudha në dispozicion për marrjen e masave lehtësuese në tregti iu akordua dy vjet për vendet e zhvilluara dhe pesë vjet për vendet në zhvillim .Megjithatë , vendet në zhvillim dhe më pak të zhvilluara mund edhe ta zgjasin këtë periudhë.

Aktualisht , për shkak të mungesës së konsideratës nga ana e vendeve të zhvilluara , ekziston ende një shqetësim i madh për vendet në zhvillim nën deklaratat e Dohas dhe ky preokupim më së shumti përfshin të drejtat e pronës intelektuale të lidhura me tregtinë (trade related intellectual property rights TRIPS). Këto të drejta u implementuan që në vitin 1998, megjithatë sektori më delikat ende është bujqësia, sektor ky i cili ka mbetur pengesë vendimtare për të përfunduar dhe për ta përmbyllur këtë deklaratë. Vendet në zhvillim nuk janë duke i ulur ende aq sa duhet tarifat e tyre për mallrat bujqësore, pavarësisht kërkesave serioze dhe insistuese nga ana e blloqeve të mëdha ekonomike, sic janë SHBA-të dhe BE-ja. Megjithatë, për shkak të shkurtimeve të tarifave shumëpalëshe, vendet më pak të zhvilluara kanë shfaqur me këto masa një preferencë të dukshme për të eksportuar drejt vendeve të zhvilluara. Lehtësimi i Tregtisë do të përparojë vazhdimisht sipas kushteve të Deklaratës

Doha në llogjikën e rritjes së lëvizjes, mbi lirimin dhe pastrimin e mallrave që përfshijnë mallrat në tranzit.

Deklarata Doha mund të cilësohet si nxitësja kryesore për të shtyrë vendet drejt liberalizimit tregtar shumëpalëshe . Megjithatë, kjo negociatë ka përfshirë edhe mjaft pasiguri .Sfidat kryesore kanë të bëjnë me përfitimet e mundshme, analizën e kostove dhe vlerësimin e marrëveshjes , veçanërisht për vendet në zhvillim . Si rezultat , në 2005 lindi nevoja për një raund të ri të negociatave në lidhje me tregtinë. Dhe është pikërisht dhjetori i 2005 që mblodhi në Hong Kong Konferencën e gjashtë ministrore. Shumica e çështjeve të lidhura me tregtinë si për vendet në zhvillim ashtu dhe për vendet e zhvilluara ishin diskutuar tashmë në mënyrë të përsëritur në Deklaratat e mëparshme të Dohas. Kjo negociatë përfshiu çështje të rëndësishme në lidhje me mungesën e transparencës dhe demokracisë në proceset e vendim - marrjes dhe në lidhje me fuqinë e pabarabartë të zhvilluar të vendet në zhvillim që prodhojnë shtrembërim në politikat tregtare .

Si pasojë , aspekte të shumta të tregtisë u rishqyrtuan në këtë raund negociatash . Deklarata Doha u ripërtëri dhe u vendos që të vazhdonin diskutimet të cilat në vitin 2006 rezultuan pak të suksesshme (OBT , 2006) . Në vitin 2007 u mblodh sërish në Potsdam të Gjermanisë dhe negociatat e korrikut 2008 në Gjenevë nuk realizuan dot një kompromis për rregullat në fushën e importeve të bujqësise. Së fundi, Konferenca u pezullua pa afat por gjithsesi vazhdojnë përpjekjet për të organizuar një tjetër në të ardhmen.

2.3.2 Integrimi rajonal dhe marrëveshjet rajonale

Gjatë gjysmës së dytë të 1990, liberalizimi tregtar dhe përqasja e tregtisë së lirë globalisht krijoi një metamorphosis. Aspekti politik u zhvendos larg që kur nisi një proçes shumë i kujdesshëm dhe i ngadaltë ku negociatat tarifore shumëpalëshe u zhvendosën për ti lënë vendin marrëveshjeve më të vogla rajonale dhe dypalëshe - Marrëveshjeve të Tregtisë Rajonale (MTR).

Marrëveshjet tregtare rajonale janë marrëveshje virtuale midis vendeve të cilat kanë si qëllim të rrisin integrimin ekonomik midis tyre dhe të reduktojnë barrierat tregtare. Pothuaj gjithë vendet janë pjesë e të paktën një marrëveshjeje të tillë. Këto vendet bashkëpunojnë së bashku

në një komunitet internacional që qëndron në bazën e këtyre marrëveshjeve, duke arritur kështu një lëvizje më të madhe të mallrave, shërbimeve, njerëzve dhe kapitaleve midis tyre.

MTR nuk janë mjeti i ri i liberalizimit tregtar, historikisht kur prishen marrëveshjet tregtare, zëvendësohen me ato bilaterale ose multilaterale. Këto rregullime në tregti kanë mundësuar që shumë vende të lëvizin drejt tregjeve më të lira për përfitimet e tyre. Në fakt politikë bërësit përballen me shumë sfida në momentin që duan të identifikojnë grupet që përfitojnë nga tregtia, prandaj duhet të hartojnë politika për liberalizimin tregtar sepse gjithsesi efektet në fund për gjithë vendin janë pozitive. Dhe pikërisht politikat tregtare rajonale janë dhe ato që kontribuojnë më së shumti në uljen e varfërisë me anë të këtyre kanaleve:

Së pari, efekti kryesor i integrimit rajonal është ulja e çmimit të mallrave të cilët tregtohen brenda rajonit. Pra rritet kërkesa rajonale duke çuar në një reduktim në çmim, dhe të varfrit si kosumatorë do të fitojnë në qoftë se do të konsumojnë më shumë produkte të tregut intrarajonal. Efekti kryesor i këtij integrimi është ulja e çmimit të mallrave të cilët tregtohen brenda rajonit. Pra rritet kërkesa rajonale duke çuar në një reduktim në çmime, dhe të varfrit si konsumatorë do të fitojnë në qoftë se do të konsumojnë më shumë produkte të tregut intrarajonal. Mirëpo këto efekte pozitive mund të përqëndrohen në ekonomitë e zhvilluara të zonës së integruar, ndërsa për ekonomitë më pak të zhvilluara rezultatet mund të jenë negative.

Së dyti, integrimi rajonal mund të ketë si statikë efektet dinamike të prodhimit. Ekonomitë e specializuara në bazë të avantazhit krahasues në treg, mund të rrisin fitimet shtesë përmes rritjes së konkurrencës dhe efekteve të produktivitetit. Kjo është e rëndësishme veçanërisht në integrimin e thellë ekonomik.

Së treti, integrimi rajonal do të ketë influencë në politikën fiskale të vendit, e cila vihet re në ndikimin e saj në të ardhurat nga taksat. Përvoja ka treguar se të ardhurat tatimore kanë tendencë rënëse në liberalizim tregtar e cila mund të çojë në uljen e shpenzimeve të brendshme në sektorët social.

Së fundi, studimet kanë treguar se të ardhurat e konvergjencës në një marrëveshje të integrimit rajonal varen nga pozicionet e vendeve ekonomike në lidhje me pjesën tjetër të botës. Por shqetësimi më i madh aktualisht është ai nëse marrëveshjet rajonale janë të dobishme për vendet anëtare ?

Edhe pse përhapja e fundit e këtyre marrëveshjeve i ka rritur shqetësimet, (B. Fliess and R. Schonfeld , 2006) që marrëveshje të tilla selektive të tregtisë do të dëmtojnë përfitimet e reformave tarifore globale dhe shkel blloqet tregtare më shumë se tregtia e lirë . Marrëveshjet rajonale janë të dobishme për vendet anëtare në aspektet e mëposhtme :

1. Me uljen ose eliminimin e tarifave midis vendeve anëtare , vendet vetë mund të gëzojnë çmim më të ulët importimi dhe kështu e rrisin tregtinë e tyre të përgjithshme. Për shkak të devijimit të tregtisë që rezulton nga çmimi relativ i ulët , disa vende anëtare mund të rrisin importet e tyre për mallrat të ardhura nga vendet jashtë marrëveshjes para se të bëhen anëtare. .

2. Përveç kësaj , marrëveshjet rajonale mund ti bashkohen edhe negociatave ndërkombëtare të tregtisë. Kështu , duke u bashkuar në një marrëveshje të tillë do të rritet fuqia shkëmbyese e vendeve anëtare në negociatat multilaterale për shkak të madhësisë së zgjeruar të negociatorit .

Kapitulli 3

SHQIPËRIA NË KUADRIN E LIBERALIZIMIT TREGTAR

Marrëveshjet e quajtura "të tregtisë së lirë", diskutohen gjerë në opinionin ekonomik dhe politik, në vendin tonë edhe në vënde të tjera të Ballkanit. Në fakt panvarësisht se i kemi quajtur "Marrëveshje të Tregtisë së Lirë", ato janë "marrëveshje të tregtisë pa tarifa doganore" ose "me tarifa doganore që reduktohen". Këto marrëveshje kanë objektiva të qarta në lidhje me kontribuimin në heqjen e barrierave ndaj tregtisë, për të stimuluar zhvillimin e harmonizuar dhe zgjerimin e tregtisë botërore, eliminimin gradual të kufizimeve në tregtinë e mallrave dhe vendosjen e kushteve të barabarta konkurruese për tregtinë e mallrave. Objektiva të tjera që mund të përmenden janë dhe nxitja e tregtisë dhe e bashkëpunimit midis palëve me vendet e treta, zgjerimi dhe thellimi i bashkëpunimit ekonomik ndërmjet palëve dhe rritja e standardit të jetesës së popujve për të garantuar krijimin e kushteve për nxitjen e mëtejshme të investimeve, veçanërisht për zhvillimin e investimeve të përbashkëta në këto vende/në rajon.

Sipas studiuesve të ndryshëm tregtia e lirë ka qenë një koncept i pamendueshëm për vendin tonë për shkak të mureve të larta tarifore. Për këtë nevojiteshin reforma të thella në politikat tregtare me qëllim reduktimin në maksimum të këtyre tarifave. Marrëveshjet e tregtisë së lirë shihen si mjeti më i arrirë në rajon e me gjerë sepse janë hapi i parë i madh për të lehtësuar tregtinë dhe japin një kontribut të rëndësishëm për të harmonizuar klimën e komunikimit tregtar midis vendeve sidomos me ato të rajonit. Shqipëria është nga vendet më të përparuara në drejtimin e nënshkrimit të marrëveshjeve por gjithsesi përballet me një problem të madh që është pikërisht mungesa e prodhimit për eksport. Shqipëria nuk arrin dot të prodhojë me suficit në shumicën e sektorëve , kjo bën dhe që ajo të mos ndihet në një treg të jashtëm si SHITËS dhe por vetëm blerës sic ka treguar eksperienca e shumë viteve tashmë. Ndër vendet e sukseshme në këtë drejtim mund të përmendim dhe Sllovenínë, Bullgarinë, Hungarinë, Turqinë të cilat e kanë gjetur sekretin e rritjes ekonomike dhe të reduktimit të varfërisë dhe është pikërisht nxitja e prodhimit vendas.

3.1 REFORMAT E POLITIKAVE TREGTARE NË SHQIPËRI- Kronologji

Liberalizimi tregtar luan një rol të rëndësishëm në zhvilllimin ekonomik të një vendi, për faktin se një nga avantazhet kryesore është eliminimi i barrierave tarifore midis vendeve. Padyshim që lëvizja e tregtisë së lirë janë bërë terma të ditës pothuajse për të gjithë opinionin ekonomik, politik, gazetaresk dhe administrativ të vendit tonë, por dhe në vende të tjera të rajonit. Kjo për arsyen se një nga sfidat kryesore të proçesit të Integrimit Europian dhe në veçanti të zbatimit të MSA-së, ka të bëjë me zhvillimin ekonomik dhe me kapacitetin e vendeve aspirante për tu përballur me tregun Europian.

Ekonomia jonë është bërë pjesë përbërëse e nismave për liberalizimin dhe lehtësimet tregtare në rajon dhe më gjerë. Këto nisma i kanë dhënë mundësinë për tu specializuar por gjithashtu kanë kërkuar edhe angazhimin e Shqipërisë në drejtim të rritjes së konkurrueshmërisë. Ekonomia Shqiptare por dhe zhvillimet e tregtisë së jashtme janë karakterizuar me ndryshime thelbësore. Kjo dukej qartë vite më pare. Por tashmë ajo po shkon drejt liberalizimit dhe duke sjellë ndryshime të mëtejshme në ekonominë e saj.

Shqipëria ka nënshkruar një sërë marrëveshje të tregtisë së lirë gjatë dy dekadave. Tregtia është një sektor shumë i rëndësishëm, në zhvillimin ekonomik të një vendi, saqë shpesh konsiderohet si "motorr" i ekonomisë. Për këtë tregtia shihet si një sektor i rëndësishëm në politikat e ndryshme të ndërmarra, duke nxitur aktivitetin tregtar midis partnerëve. Shqipëria aplikon një regjim liberal tregu. Tregtia e jashtme është liberalizuar që në vitin 1990 dhe ndjek standartet e vendosura nga Bashkimi Evropian dhe Organizata Botërore e Tregtisë.

Në fillim të viteve '90 Shqipëria ndërmori rrugën e vështirë të hapjes së ekonomisë së saj nga një ekonomi e mbyllur në një ekonomi të tregut të lirë. Gjatë kësaj kohe lindi nevoja që i gjithë vendi t'i nënshtrohej një regjimi të ri atij të ristrukturimit makroekonomik. Pra lindi natyrshëm domosdoshmëria për reforma që në fakt ishte shumë e madhe duke përfshirë të gjithë sektorët e ekonomisë. Procesi i tranzicionit dhe kalimi i ekonomisë tonë nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi të tregut të lirë është shoqëruar jo vetëm me transformimin e mekanizmave dhe infrastrukturës të funksionimit të tregjeve, por mbi të gjitha me nevojën e zhvillimit dhe krijimit të instrumenteve dhe hapësirave të reja ligjore,

institucionale, ekonomike dhe sociale me qëllim rritjen e efiçencës alokuese dhe përdoruese të burimeve publike dhe private.

Fillesat e Bashkëpunimit të Shqipërisë datojnë në qershor 1991, me fillimin e marrëdhënieve diplomatike Shqipëria-Komuniteti Ekonomik Evropian. Më pas vjen momenti i nënshkrimit të Marrëveshjes së Tregtisë dhe Bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian , pikërisht në 11 maj 1992. Liberalizimi i regjimit tregtar ka filluar që në vitin 1992 (në vitet e para të tranzicionit) me anë të proçesit të liberalizimit autonom që përmbante reforma të rëndësishme liberalizuese si eliminimi i monopolit shtetëror mbi sektorin e tregtisë së jashtme. Fillimisht ndryshe nga vendet e tjera të Ballkanit, Shqipëria nisi intensivisht reformat në importe duke u fokusuar kryesisht drejt importit konsumator dhe kështu u ndryshua sasia dhe struktura e këtij sektori. Eksportet filluan të zvogëloheshin deri në venitjen e tyre. Liberalizimi autonom u përqëndrua edhe në liberalizimin e çmimeve por mbi të gjitha në tregun valutor, me anë të liberalizimit të llogarisë korrente. Filloi në këto kushte të kryeshin transaksione në valutë të huaj me kurse fleksibël këmbimi.

Një datë tjetër e rëndësishme është dhe viti 1999 kur Bashkimi Evropian propozoi fillimin e Procesit të Stabilizim-Asociimit për 5 vendet e Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë edhe Shqipërinë. Në këtë moment u deklarua nga Këshilli Evropian i mbledhur në Feira se të gjitha vendet e përfshira në Procesin e StabilizimAsociimit do të konsideroheshin si kandidate potenciale për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Me nënshkrimin e MTL-ve dhe intensifikimin e përpjekjeve për të përqafuar proçesin e integrimit me BE-në, me dokument paraprijës MSA-në, filloi faza e liberalizimit me vendet e rajonit. Në 1999 Pakti i Stabilitetit për Europën Jug-Lindore dhe BE filluan proçesin që synonte arritjen e dy qëllimeve të varura midis tyre: Stabilizimin dhe integrimin rajonal, dhe integrimin Europian të vendeve të EJL. Nxitja e tregtisë së jashtme u zhvillua nëpërmjet dy iniciativave kryesore: marrëveshjeve të stabilizim-asocimit, dhe marrëveshjeve të tregtisë së lirë (MTL) midis vendeve përfituese të Paktit të Stabilitetit.

Momenti më i rëndësishëm daton në në shtator 2000 kur Shqipëria u bë pjesë e Organizatës Botërore të tregtisë që i dha shtysë për vazhdimin e mëtejshëm të liberalizimit me anë të liberalizimit shumëpalësh. Deri në këtë kohë regjimi doganor kishte karakteristikë nivele të larta proteksioni (si përpjekje për të mbuluar deficitin buxhetor), të cilat u reduktuan në bazë dhe të udhëzimeve të OBT për eliminim dhe reduktim të mjaft barrierave tarifore dhe jotarifore. Dhe që prej vitit 2000 aplikohet regjimi i OBT mbi proçedurën e liçencimit të

importit. Si rezultat i liberalizimit të tregut dhe proçesit të vazhdueshëm të përafrimit të kuadrit rregullator doganor me standartet e sistemit të BE, importi dhe eksporti i mallarve, si rregull i përgjithshëm, nuk varen nga ndonjë autorizim i veçantë. Marrëveshjet bilaterale ose multiraterale në të cilat Shqipëria është palë, mund të vendosin kuota ose kërkesa kontrollesh. Gjithashtu, nevoja për pajisje me liçencë ekziston në rastin e disa mallrave specifikë me qarkullim të kufizuar brenda vendit siç janë mallrat ushtarake dhe strategjike, materialet radioaktive dhe substancat psikotrope, ilaçet etj.

Që nga viti 2000 angazhimi i Shqipërisë në këtë drejtim ishte hartimi i një sërë marrëveshjesh si "Barrierat Teknike të Tregtisë" (TBT), "MasatSanitare dhe Fitosanitare" (SPS), liçensimet dhe ndalimet në importe, etj, dhe përmirësimi i legjislacionit për lehtësimin e tregtisë dhe mbi të gjitha u konkretizua angazhimi me reduktimin e tarifave nën 15%, kur më parë kishte filluar me reduktim nga 40% në 1994, 30% në 1998 deri në 15% në 2001.

Tarifat që do të reduktoheshin gradualisht ishin ato që duhet t'i nënshtrohen një mbrojtjeje tarifore të përkohshme, me qëllim që të mbrohen industritë e prodhimit vendas ndërkohë që ato që do të bëheshin menjëherë zero, ishin tarifat për mallrat josensitivë të vendeve respektive (gjithmonë për mallrat që nuk përfshihen në listat e produkteve nga industritë e prodhimit vendas që duhen ndihmuar); gjithashtu këtu përfshihen dhe koncensione për produktet bujqësore të cilat janë sensitive ndaj importeve nga vendi partner.

Ndërsa për produktet që hyjnë në vendet e BE-së që nga viti 2000 u parashikua heqja e tarifave për tekstilet (import ose riimport) pra me tarifë doganore zero sipas kuotave të caktuara vjetore dhe përmirësimin e shkallës së hyrjes së produkteve bujqësore.

Në 27 qershor të vitit 2001, Shqipëria nënshkroi në Bruksel Memorandumin për Liberalizimin dhe Lehtësimin e Tregtisë me vendet e shtatë vendet e Europës Juglindore (proçesi i kooperimit me Moldavinë filloi më vonë, por edhe ajo çoi në krijimin e marrëveshjeve tregtare), që inicionte negociatat për krijimin e 21 marrëveshjeve të tregtisë së lirë bilaterale që mbulonin rajonin, deri në fund të 2002. Me këtë memorandum u hap dhe rruga për realizimin e një zone të lirë tregtare për të cilin afati maksimal ishte viti 2008.

Në vitin 2003 u hapën zyrtarisht negociatat për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim - Asocimit me Shqipërinë që nënkuptonte një liberalizim të menjëhershëm të regjimit tregtar të vendit për një kategori produktesh ,një liberalizim gradual për kategori të produkteve industriale të konsideruara sensitive për ekonominë e shqiptare, një regjim të posaçëm për

produktet bujqësore dhe të industrisë ushqimore, një rishikim të barrierave jo tarifore tregtare dhe ndalimin e masave të reja të çdo lloji që kufizojnë tregtinë, dhe përmirësime administrative e institucionale në përputhje me acquis communautaire të BE-së. Objektivat e një marrëveshjeje të tillë kanë të bëjnë me: nxitjen e zgjerimit të tregtisë, midis palëve, zhvillimin e aktivitetit tregtar në përputhje me rregullat ndërkombëtare, rritje të flukseve tregtare të vendeve të rajonit të BP në mënyrë të qëndrueshme dhe sidomos konkurrencë të ndershme në fushën e tregtisë midis palëve

Më pas një moment shumë i rëndësishëm ishte dhe ai i vitit 2006, kohë kur dhe u nënshkrua Marrëveshja e Stabilizim Asocimit(MSA), si një arritje e rëndësishme në kuadër të integrimit në BE, në Luksemburg . Si fillim hyri në fuqi një marrëveshje e ndërmjetme në dhjetor të 2006 për krijimin e një zone të tregtisë së lirë midis Shqipërisë dhe Komunitetit Europian në një periudhë kohore 10-vjeçare. Dhe më pas në 1 prill 2009 hyri në fuqi MSA midis Shqipërisë dhe BE-së pra MSA u ratifikua dhe zëvendësoi Marrëveshjen e Ndërmjetme, e cila tashmë është pjesë integrale e MSA. Dhe nën këtë kuadër u vazhdua më tej dhe proçesi i nisur sipas reduktimit të mësipërm tarifor.Të gjitha tarifat e produkteve industriale dhe produkteve bujqësore, pjesë e skemës së liberalizimit, u reduktuan në zero, përveç një serie të disa prej produkteve më të rëndësishme bujqësore, por gjithashtu edhe të disa produkteve industriale, të konsideruara sensitive.

Pas kritikave nga autorë të ndryshëm së Marrëveshjet Tregtare Rajonale nuk janë shumë frytdhënëse për ekonomitë e vendeve të Ballkanit (Kaminski & De La Rocha , 2003; Schiff M, Winters LA ,2003) u mendua të krijohej Marrëveshja e Tregtisë së Lirë së Evropës Qendrore (CEFTA 2006),nënshkruar midis Shqipërisë, Bosnje-Hercegovinës, Kosovës, Moldavisë, Serbisë, Malit të Zi, Maqedonisë,dhe Kroacisë e cila hyri në fuqi në nëntor të 2007 panvarësisht se u nënshkrua që në 19 dhjetor 2006 në Bukuresht.Pra në këtë moment çdo marrëveshje dypalëshe që Shqipëria kishte lidhur me vendet e rajonit u transformuan në marrëveshjen shumëpalëshe CEFTA. Objektivat kryesore të CEFTA-s ndër të tjera, janë eliminimi I barrierave të tregtisë mes palëve, zgjerimi i tregtisë në mallra dhe shërbime dhe nxitja e investimeve, sigurimi i mbrojtjes së duhur të së drejtave të pronësisë intelektuale në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe harmonizimi i dispozitave përsa i përket çështjeve të politikave tregtare,të tilla si: rregullat e konkurrencës dhe ndihmës shtetërore. Ajo gjithashtu përfshin proçedura të qarta dhe efektive për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Figura. 4: Dimensionet e Marrëveshjeve Tregtare Shumëpalëshe



Burimi:Autori

Shqipëria ka gjithashtu një Marrëveshje të Tregtisë së Lirë me Turqinë, të nënshkruar në 2006, e cila ka hyrë në fuqi në maj 2008. Sipas marrëveshjes, nuk do të ketë tarifa për mallrat industriale shqiptare të eksportuara në Turqi dhe tarifat për produkte të caktuara turke do të reduktohen përfundimisht brënda pesë vitesh. Me qëllim rritjen e shkëmbimeve tregtare ndërmjet tyre, lidhur me produktet bujqësore palët i kanë akorduar reciprokisht njëra-tjetrës kuota tarifore.

Në dhjetor 2009, Shqipëria nënshkroi Marrëvshjen e Tregtisë së Lirë edhe me Shoqatën Evropiane të Tregtisë së Lirë (EFTA). Shtetet anëtare të EFTA-s janë Islanda, Zvicra, Norvegjia dhe Lihtenshtajni. Marrëveshja e Tregtisë së Lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shteteve të EFTA përqendrohet në liberalizimin e tregtisë së mallrave. Ato do të shfuqizojnë të gjitha tarifat doganore mbi produktet industriale, përfshirë peshqit dhe produktet e tjera detare. Marrëveshjet dypalëshe për produktet bujqësore ndërmjet shteteve të EFTA-s (individualisht) dhe Shqipërisë bëjnë pjesë gjithashtu tek instrumentat krijues të zonës së tregtisë së lirë ndërmjet të dy palëve. Këtë Marrëveshje të Tregtisë së Lirë me Shtetet e EFTA-s e kanë nënshkruar edhe Serbia, Maqedonia e Kroacia. Këtu është

parashikuar dhe nocioni i akumulimit diagonal, parim në bazë të së cilit ju mundësohet vendeve importuese, që pas një shkalle të caktuar përpunimi, t`i origjinojnë mallrat si të tyre.

Përveç këtyre marrëveshjeve, Shqipëria është integruar dhe në programin GSP i cili ofron trajtim pa doganë për rreth 3.400 lloje të eksporteve nga Shqipëria dhe Kosova. Qëllimi i programit GSP është që t'u japë këtyre eksporteve një natyrë konkurruese në tregun e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA). Këto përfshijnë shumicën e mallrave të prodhuara; lëndët e përdorura në prodhim, bizhuteri, shumicën e llojeve të qilimave, disa produkte bujqësore dhe produkte të tjera të peshkut, si dhe në shumë lloje të kimikateve, mermerit, dhe mineraleve. Kompanitë dhe konsumatorët e SHBA janë veçanërisht të interesuar në blerjen e mallrave përmes programit GSP sepse eksportet nuk ngarkohen me barra tarifore, me të hyrë në SHBA. Shumë artikuj kanë të drejtë për trajtim GSP pa tarifë doganore.

3.2 MARRËVESHJET BILATERALE DHE INTEGRIMI RAJONAL, CEFTA

CEFTA (Central European Free Trade Agreement)është një marrëveshje e tregtisë se lirë në të cilën marrin pjesë tetë vende të rajonit të Ballkanit Perëndimor: Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Mali iZi, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia dhe Moldavia.

Në Janar 2001, në Gjenevë, në Forumin Politik Tregtar mbi liberalizimin tregtar, organizuar nga Pakti i Stabilitetit, Ministrat e vendeve të EJL u përballën me një dilemë: Ose të krijonin një zonë tregtare të lirë duke firmosur një marrëveshje të vetme, nga të shtatë shtetet, ose një rrjet të MTL-ve bilaterale midis tyre. Pra u gjendën në një situatë ku duhej të bënin një zgjedhje strategjike. Në fakt ishte Profesor Messerlin, që atëherë rekomandoi një marrëveshje të vetme e cila do të ishte më e lehtë për vendet, si për tu negociuar dhe për tu administruar, dhe më transparente për bizneset për shkak të uniformitetit të saj. Por për arsye të ndryshme, pjesërisht politike (mungesa e konsensusit) apo edhe ekonomike (diferenca të konsiderueshme në nivelin e zhvillimit ekonomik), vendet e rajonit preferuan marrëveshjet dypalëshe të tregtisë së lirë, në vend të një marrëveshje të vetme rajonale.

Në këto kushte u formua nga vendet e Europës Qëndrore një marrëveshje e tregtisë së lirë (MTL) e quajtur CEFTA. Fillimet e CEFTA-s në fakt janë më të hershme, sepse ka lindur nga një marrëveshje e tregtisë mes Polonisë, Hungarisë, Çekisë dhe Sllovakisë në dhjetor të vitit 1992 dhe hyri në fuqi në korrik të vitit 1994.

Nëpërmjet CEFTA-s këto vende pjesëmarrëse u mobilizuan për t'iu qasur institucioneve politike, ligjore dhe ekonomike të Bashkimit Evropian, duke forcuar ne këtë mënyrë demokracinë dhe ekonomitë e tyre të tregut. Sllovenia iu bashkua CEFTA-s në 1996, Rumania në 1997, Bullgaria në 1999, Kroacia ne 2003 dhe Maqedonia ne 2006. Meqenëse ne 2007 te gjitha palët e mëparshme te CEFTA-s kishin hyre ne Bashkimin Evropian dhe kishin dale nga CEFTA, u vendos qe CEFTA te shtrihej edhe ne pjesën e Ballkanit te mbetur jashtë BE-se.

Në këtë kohë Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia dhe Moldavia kishin nënshkruar një numër te madh marrëveshjesh bilaterale të tregtisë së lirë në kuadrin e Paktit tëStabilitetit për Evropën Juglindore. Këto u zëvendësuan nga një marrëveshje e vetme multilaterale - CEFTA.

Qëllimi fillestar në formimin e CEFTA-s ka qenë për të nxitur demokracinë dhe ekonominë e tregut në rajon pra për të ndihmuar anëtarësimin dhe për të mobilizuar përpjekjet e vendeve në mënyrë që të integrohen në Institucionet e Europës. Mirëpo, CEFTA është shumë më tepër se sa një marrëveshje për tarifat doganore në fakt është një marrëveshje me natyrë shumëdimensionale. Nga këndvështrimi politik, CEFTA është pjesë e përpjekjeve të vendeve të rajonit dhe Bashkimit Evropian (BE) për të krijuar një treg rajonal që mundëson zhvillimin ekonomik dhe që do të kontribuojë eventualisht në rritjen e sigurisë dhe stabilitetit politik në Ballkan. Në fakt, CEFTA është një instrument i para-hyrjes (pre-accession) në BE. Cdo vend i ish-bllokut komunist që është bërë anëetar i BE-së sot, ka qënë më parë anëtar i CEFTA-s. Në te njëjtën mënyrë,cdo vend që është në procesin e hyrjes në BE, është bërë sot anëtar i CEFTA-s. Nga këndvështrimi ekonomik, CEFTA do të ndihmojë zhvillimin ekonomik në rajon me anë të liberalizimit dhe zhvillimit të tregtisë. Eksperienca botërore e ka provuar se vendet që ia mbyllin dyert tregtisë ia mbyllin dyert zhvillimit. Shqipëria e viteve të komunizmit dhe Koreja e Veriut e ditëve të sotme janë shembuj tipike të dështimit të politikave të izolimit dhe mbylljes së dyerve. Që në kohët e lashta, shkëmbimet tregtare kanë qenë faktori më i rëndësishëm i zhvillimit kulturor dhe ekonomik të rajoneve, shteteve e perandorive.Mënyra se si CEFTA do të lehtësojë zhvillimin e tregtisë është nëpërmjet

bashkëpunimit më të ngushtë midis vendeve pjesëmarrëse në nivele politike dhe teknike; harmonizmit të politikave, institucioneve dhe rregullave që lidhen me tregtinë; liberalizmit të tarifave doganore; eleminimit të barrierave jotarifore;dhe, aplikimit të rregullave të favorshme të origjinës.

Tabela 1 : Statusi i MTL-ve bilaterale midis vendeve të EJL

	Shqipëri	Bosnjë-H	Bullgari	Kroaci	Maqedoni	Moldavi	Rumani	Serbi_M
Shqipëri	-	12/04	09/03	06/03	07/02	11/04	01/04	08/04
Bosnjë-H	12/04	-	12/04	01/05	07/02	05/04	12/04	06/02
Bullgari	09/03	12/04	-	03-03	01/00	11/04	07/97	06/04
Kroaci	06/03	01/05	03/03	-	06/97	10/04	03/03	07/04
Maqedonii	07/02	07/02	01/00	06/97	-	01/05	01/04	05/05
Moldavi	11/04	05/04	11/04	10/07	01/05	-	11/97	09/04
Rumani	01/04	12/04	07/97	01/04	01/04	11/97	-	07/04
Serbi-M	08/04	06/02	06/04	07/04	05/05	09/04	07/04	-

Shënim: Tabela është marrë nga www.stabilitypact.org

Nga tabela shihet se vendet EJL kanë krijuar marrëveshje bilaterale deri në vitin që përqasën CEFTA-n, të cilat përfunduan në qershor 2005 pasi u vendos liberalizimi tregtar në këtë zonë. Ajo që vihej re në atë periudhë ishte fakti se panvarësisht marrëveshjeve bileterale deri në këtë kohë , gjithsesi tregtia brënda rajonit ishte akoma modeste. Pra MTL-të kishin rezultuar joefektive në realizimin e objektivave që derivonin nga këto marrëveshje.

Konkretisht që në fillim të 2005, të gjitha flukset tregtare në rajon u realizuan nën rrjetin e MTL-ve të parashikuara nga CEFTA. Praktikisht, këto marrëveshje presupozonin (1) eleminimin e tarifave mbi 90 % të volumit të tregtisë dhe 90 % të linjave tarifore, (2) eleminimin e barrierave jo-tarifore të tregtisë brenda rajonit dhe fuqizimin e tregtisë në shërbime, (3) lehtësimin tregtar, (4) harmonizimin e legjislacionit me atë të BE (veçanërisht për procedurat doganore, ligjin mbi kompanitë, ligjin mbi konkurrencën, standartet, rregullat teknike, etj).

Sfida më urgjente ekonomike që duhej të përballonin vendet e EJL ishte zbatimi i plotë i MTL-ve dhe të siguronin konformitet me Memorandumin e Mirëkuptimit , e cila specifikonte standartet në lidhje me liberalizimin që vendet duhet të zbatonin. Sigurimi i konformitetit të marrëveshjeve me këtë memorandum ishte një sfidë e madhe për vendet dhe kërkonte që qeveritë ti rezistonin presioneve proteksioniste të brendshme.

Një nga pikat kryesore të memorandumit të mirëkuptimit është sigurimi se të gjitha MTL-të kontribuojnë në integrimin e palëve të EJL në strukturat e BE-së.

Sipas një studimi të Messerlin dhe Miroudot (2004) sipas shkallës së liberalizimit marrëveshjet tregtare janë të ndara në tre grupe:

1. Marrëveshjet që plotësojnë kriterin e liberalizimit 90% të volumit të tregtisë dhe 90% të linjave tarifore—ku rezulton se Shqipëria nuk ka kryer marrëveshje bilaterale që ti përmbajë të dyja këto kushte

2. Marrëveshjet që plotësojnë një prej kritereve të 90%--- dhe në fakt vendi ynë mund të marrë pjesë në këtë grup me marrëveshjet bilaterale që ka me BosnjeHercegovinën ,Maqedoninë dhe Serbi-Mali i Zi, dhe me kriterin në fjalë liberalizimi 90% të linjave tarifore

3. Marrëveshjet që nuk plotësojnë asnjë kriter 90%--- edhe në këtë grup Shqipëria zë vend me marrëveshjet bilaterale që ka me Rumanine, Kroacinë dhe Bullgarinë.

Ndërsa për rajonin në tërësi mund të thuhet se një e treta e marrëveshjeve e plotëson kriterin e liberalizimit të 90% të volumit të tregtisë dhe të 90% të linjës tarifore, një e treta plotëson një prej dy kritereve, dhe një e treta e fundit nuk plotëson asnjë kriter.

Në këto MTL fiksohen objektiva të matshëm dhe konkrete,por ka edhe objektiva të vecanta si:

- Eliminimi gradual i kufizimeve në tregtinë e mallrave
- Zgjerimi dhe thellimi i bashkëpunimit ekonomik ndërmjet palëve dhe rritja e standartit të jetesës
- Nxitja e bashkëpunimit me vendet e treta
- Vendosja e kushteve të barabarta konkurruese për tregun e mallrave
- Krijimi i kushteve për nxitjen e mëtejshme të investimeve
-

3.2.1 Dobësitë që kanë shfaqur MTL-të

Kur flasim për Marrëveshje të Tregtisë së Lirë, mbajmë parasysh faktin se përveç anës ekonomike, vendet partnere duhet të angazhohen në reforma edhe në kuadrin politik, strategjik dhe institucional. Përveç kostove, reformat që duhen ndërmarrë përbëjnë kostot më të mëdha, si nga ana monetare e materiale, ashtu edhe nga ajo njerëzore. Ato janë të domosdoshme për tu kryer dhe konsoliduar me qëllim që të kenë një efekt të drejtëpërdrejtë, të ndjeshëm dhe mundësisht të menjëhershëm në zhvillimin ekonomik të vendit.

Kostot e transaksionit tregtar janë më të ulta midis vendeve që kanë kufij të përbashkët, gjuhë të përafërta dhe kultura të përbashkëta. E megjithatë përsëri tregtia midis vendeve të rajonit është akoma më e ulët se potenciali i saj dhe, në disa raste zbatimi i marrëveshjeve bitaterale nuk ka qenë i kënaqshëm.

Ndër faktorët që kanë ndikuar në këtë situatë mund të përmendim: faktorët ekonomiko-strukturorë të cilët përcaktuan ndryshime të thella gjeografike e sektoriale të tregtisë; faktorët historikë, luftërat dhe konfliktet e herëpas-herëshme etnike; problemet të infrastrukturës, veçanërisht ato të lidhura me transportin; përmasat e vogla të ekonomive rajonale si dhe të ardhurat e ulta për frymë të vendeve të rajonit; struktura komplekse të konçesioneve, asimetria e preferencave tregtare, diferencat e sistemeve legale; problemet e menaxhimit të kufijve e të proçedurave burokratike doganore etj.

Si çdo zgjedhje optimale dhe efiçente, edhe nisma e ndërmarre nga Shqipëria për liberalizimin tregtar në kuadër të proçesit të integrimit, është dhe duhet bërë duke krahasuar kostot me përfitimet. Ndonëse kostot shfaqen në periudhë afatshkurtra dhe afatmesme dhe shpesh për këtë arsye bëhen objekt kontestimi, përfitimet janë mjaft të mëdha, sidomos për një vend ende në fazën e tranzicionit.

Një problem tjetër që ka dalë nga rrjeti i MTL-ve është se ato kanë çuar në një strukturë komplekse të konçesioneve dhe të axhendave të ndryshme. Kjo mund të shmanget nqs liberalizimi tregtar realizohet në një rrjet multilateral. Kompleksiteti i marrëveshjeve është përforcuar nga asimetria e preferencave tregtare.

Dobësitë dhe problemet që kanë shfaqur MTL-të, kërkojnë marrjen e masave për rritjen e efektivitetit të integrimit rajonal. Përfitimet e një marrëveshje të vetme do të jenë të rëndësishme: duke siguruar tregtarët dhe investitorët me një rrjet transparent dhe të

vazhdueshëm për marrëdhëniet e biznesit, marrëveshja do të ngrejë fuqishëm aftësinë e rajonit për të tërhequr flukse më të mëdha të IHD dhe stimulon tregtinë rajonale.

3.2.2 Përfitimet e Shqipërisë nga CEFTA?

Megjithatë nuk duhet mohuar roli pozitiv i MTL-ve bilaterale. Përvec rritjes së vëllimit të tregtisë në këto vende, MTL-të kanë luajtur rol në përmirësimet e kooperimit të popujve të rajonit, bizneseve, institucioneve qeveritare dhe atyre joqeveritare. Popujt e vendeve përfitojnë

- ***"Mbrojtje":*** produkte me cilësi të garantuar, standarte më të mira për produktet ushqimore si masa për mbrojtjen e konsumatorit dhe një ofertë më të qëndrueshme produktesh me cilësi. Përfitojnë

- ***"Mallra me çmime më të ulta":*** të cilat vijnë si rezultat i hapjes së tregjeve të brendshme dhe rritjes së konkurrueshmërisë dhe si rrjedhim kjo çon dhe në një rritje të standartit të jetesës.

- Gjithashtu ***"Aktivitet më t***ë ***madh ekonomik":*** i cili sjell rritje të biznesit , për më tepër do të bëj të mundur dhe hapjen e vendeve të reja të punës që është një problem i rëndësishëm për shoqërinë tonë.

- Në terma monetare përfiton ***"Reduktime tarifore të produkteve"*** bujqësore dhe industriale, pra tarifa më të ulta për importet e lëndëve të para, si rrjedhim ulje të kostos për njësi dhe tarifa më të ulta për produkte që eksportohen pra një tregti më e lehtësuar, nxitje e eksporteve.

- Në drejtim të Bilancit Tregtar, kjo nxitje për rritjen e eksporteve pasqyrohet në një **"Bilanc tregtar të përmirësuar"** dhe krijohen mundësi për ristrukturimin e ekonomisë në funksion të produktivitetit dhe konkurrueshmërisë. Një bilanc i përmisuar ka ndikime makroekonomike pozitive që pasqyrohen në defiçitin buxhetor dhe në situatën e borxhit qeveritar.

- Në drejtim të inovacionit ,***"Akses dhe përfitim i teknologjisë moderne":*** e cila sjell edhe rritjen e efektivitetit, cilësisë dhe konkurrueshmerisë së produkteve vendase që do të thotë rritje e avantazheve krahasuese të produkteve shqiptare në tregjet

ndërkombëtare pra krijon një klimë atraktive për investimet e huaja dhe shkëmbim të kulturave të rajonit.

Të gjitha këto perfitime të lartpërmendura kanë një ndikim mjaft pozitiv në rritjen e PBB-së totale dhe asaj për frymë.

Anëtarësimi i Shqipërisë në zonën e tregtisë së lirë CEFTA , ka nxitur që Shqipëria nga një vend evropian dikur i pa njohur të kthehet në një faktor stabiliteti dhe shembull i një zhvillimi ekonomik e dinamik në Ballkanin Perëndimor.

Përfitimet e CEFTA-s mund të shikohen nga disa këndvështrime, nga ***këndvështrimi ekonomik*** ku nëpërmjet Marrëveshjes së tregtisë së lirë përfitimet janë të shumta:

1. plotësimi më i mirë i nevojave të tregut
2. rritje e konkurrencës ekonomike,
3. liberalizimi i tarifave doganore,
4. influencë reciproke midis tregjeve,
5. ulja e kondrabandës
6. influencimi në uljen e çmimeve,
7. nxitje të përmirësimeve teknologjike të prodhimit vendas,
8. mbrojtje e së drejtës intelektuale
9. rritja e eksporteve dhe importeve
10. nxitje e investimeve,

Por dhe nga këndvështrimi politik,sepse duke qënë pjesë e CEFTA-s, Shqipëria është pjesë e mekanizmit të bashkëpunimit rajonal që e promovon

1. zhvillimin ekonomik, ,
2. stabilitetin politik në rajon
3. rritjen e sigurisë
4. fuqinë negociuese të Shqipërisë përballë vendeve më të mëdha të rajonit.

Pra është e padiskutueshme se Shqipëria ka vetëm përfitime nga CEFTA.

3.3. POLITIKA DHE REGJIMI TREGTAR NË KUADËR TË INTEGRIMIT NË BE

Regjimi tregtar në kuadër të integrimit në BE i ka fillesat që tek Marrëveshja e përkohshme midis Komunitetit Evropian dhe Shqipërisë e cila u nënshkruajt më dhjetor 2004 dhe hyri në fuqi më 1 qershor 2009. Marrëveshja e Përkohshme sistemonte çështjet tregtare të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim me qëllim që të përforcohej bashkëpunimi tregtar midis BE-së dhe vendit tonë, rrjedhimisht të arrihej një baraspeshë më e mirë dhe përmirësim në strukturën e tregtisë midis tyre, të zgjerohej vëllimi i vendit tonë dhe të përmirësohej mirëqenia e popullatës. Pra më konkretisht objektivat e paracaktuar të kësaj marrëveshjeje janë :

- ✓ Zhvillimin e aktivitetit tregtar në përputhje me rregullat ndërkombëtare
- ✓ Konkurrencë të ndershme në fushën e tregtisë midis palëve
- ✓ Nxitjen e zgjerimit të tregtisë, midis palëve

Kjo MARRËVESHJE mundëson liberalizmin e plotë tregtar me BE-në. Me anë të marrëveshjes synohej reduktimi gradual i niveleve të tarifave doganore , harmonizimi i legjislacionit me standartet ndërkombëtare dhe lehtësimin e tregtisë. Nga ana tjetër, vendi pranoi një shfuqizim të plotë të kufizimeve kuantitative dhe gradualisht është duke i zvogëluar obligimet e veta doganore për një periudhë 6 vjeçare.

Nën kuadrin e lehtësimit të tregtisë autorë si Ana M. Fernandes, Russell Hillberry dhe Alejandra Mendoza Alcántara, kanë kryer një studim me titull: "Efektet e reformës doganore në tregti – Fakte nga Shqipëria", ku gjenden prova se numri mesatar i ditëve të pritjes në doganë ka rënë me 7% në raport me vitet e kaluara, ndërkohë që probabiliteti i inspektimit të një dërgese ka rënë me 50% dhe më shumë. Ky reduktim i kohës së zhdoganimit, sipas FMN-së, ka prodhuar një rritje 7% në vlerën e importit. Sipas FMN-së, reformat favorizojnë importet nga partnerët preferencialë tregtarë, veçanërisht nga Bashkimi Europian. Shumica e këtij efekti vjen nëpërmjet importeve të rritura nga BE, të cilat rezulton të jenë më të ndjeshme ndaj kursimit të kohës sesa importet nga vendet e tjera. Sipas FMN-së, ka edhe ndryshime në strukturën e tregtisë si efekt i reformës doganore, ku hyjnë rritjet e sasive mesatare dhe uljet e çmimeve për njësi, rritjet e numrit të dërgesave, si dhe e numrit të firmave importuese për të njëjtin produkt, apo nga i njëjti vend. Nga ana tjetër, nga llogaritja del se vlerësimi i rritjes 7% të importit është përafërsisht në përputhje me një reduktim 0,36

pikë përqindje të kostove të tregtisë. Nga aplikimi i kësaj shifre në vlerësimin e importeve në Shqipëri të produkteve industriale, del se reforma solli ulje të kostos dhe kursim në nivelin 12 milionë dollarë gjatë vitit 2012. Zgjedhja e Shqipërisë për këtë studim është e motivuar kryesisht nga ndryshimet e thella dhe të shpejta të procedurave të inspektimeve fizike, që ndodhën gjatë një periudhe shumë të shkurtër kohe. Gjatë periudhës gjashtëvjeçare të studimit, probabiliteti i pakushtëzuar që një dërgesë të jetë subjekt i një inspektimi fizik ra me pothuajse një në katër. Shqipëria ishte unike mes vendeve ish-komuniste, sepse vinte nga një izolim total. Që nga ajo kohë, Shqipëria ka ndërmarrë një sërë reformash të politikës tregtare, duke përfshirë edhe anëtarësimin në Organizatën Botërore të Tregtisë, liberalizimin e tregtisë, dhe nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit me BE-në.

Një faktor tjetër që mbështet reformën e shpejtë ka qenë ambicia e Shqipërisë për të aderuar në BE. Një rol kyç ka luajtur edhe liberalizimi i tarifave doganore. Normat e ulëta të tarifave nënkuptojnë uljen riskut për shmangien e pagesave, rrjedhimisht do të thotë dëm i kufizuar dhe ulje e evazionit.

Në fillimet e viteve 2000, eksportet shqiptare nuk i nënshtroheshin asnjë lloj takse . Me reduktimin gradual të tarifave doganore, duke nisur nga 1 janari i vitit 2006, shkëmbimet tregtare mes Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian u rritën ndjeshëm. Sipas të dhënave nga Ministria e Integrimit, efektet u dukën që dy vjet pas rritjes në vitin 2008, shkëmbimet me vendet e BE-se kanë zënë mbi 66.8% të volumit të tregtisë së jashtme të Shqipërisë[36], ndërsa eksportet e mallrave drejt vendeve të BE-së për vitin 2008, kanë zënë rreth 80 % të totalit të eksporteve, me një rritje prej 11.8% në krahasim me vitin 2007. Aktualisht mund të thuhet se vendet e BE-së kanë masën më të madhe të tregtisë me Shqipërinë dhe treguesi është eksporti ku drejt vendeve të BE-së shkon rreth 65.7% e eksporteve totale të Shqipërisë[37].

Dhe volumi tregtar me BE- në ka patur tendencë rritjeje në terma nominalë edhe në vitet në vazhdim. Vetëm gjatë vitit 2014, sipas INSTAT [38]rezulton se volumin tregtar (eksport + import) më të madh Shqipëria e ka me vendet e BE-së. Për 2014, rezulton se importet e Shqipërisë nga vendet e BE-së zënë 62.85 % të totalit të importeve, dhe eksportet e Shqipërisë në vendet e BE-së zënë 73 % të totalit të eksporteve shqiptare në botë. Në rastin e një rënieje hipotetike të kursit të këmbimit të euros në favor të lekut, bën që mallrat evropiane në Shqipëri të kushtojnë më lirë se më parë. Kjo mund të sjellë një ndryshim të ofertës së

[36] Sipas të dhënave të mbledhura dhe llogaritjeve të autorit
[37]2008-2009 janë vitet e krizës globale
[38] Shiko dokumentin e botuar nga INSTAT "Tregtia e Jashtme, nëntor 2014",

vendeve evropiane për rritjen e eksporteve në Shqipëri, të cilat do të ofronin mundësinë për të ndikuar drejtpërdrejtë në uljen e çmimeve të mallrave, dhe njëkohësisht në rritjen e sasisë së mallrave cilësore në tregun shqiptar. Konsumatori shqiptar është ai që ka mundësinë të fitojë në mënyrë të drejtpërdrejtë ndaj këtij fenomeni.

3.4 PERFORMANCA EKONOMIKE E SHQIPËRISË PËRBALLË PERFORMANCËS SË RAJONIT (EJL) GJATË KRIZËS FINANCIARE

Kriza globale financiare, në të vërtetë ka filluar të tregojë efektet e saj në mes të vitit 2007 duke vazhduar dhe në 2008. Nëpër botë tregjet e aksioneve ranë, institucione të mëdha financiare u rrëzuan ose u blenë nga institucione të huaja, ndaj dhe qeveritë e vendeve më të zhvilluara apo të pasura janë detyruar të krijojnë paketa shpëtimi për të nxjerrë nga vështirësitë sistemet e tyre financiare. Në njërën anë shumë njerëz janë të ndërgjegjësuar se janë vetë ata përgjegjës për problemet financiare, ndërsa nga ana tjetër, një situatë e veshtirë financiare globale do të ndikojë në jetesën e pothuajse të gjithëve në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur. Problemi mund të ishte shmangur, nëse ideologët që po mbështetin modelet aktuale të ekonomisë nuk do të ishin aq të zhurmshëm, dhe të pakujdesur për pikpamjet e shqetësimet e të tjerëve .

Kriza globale u rrit nga një model ekonomik që është ushqyer nga "marrja e rrezikut" dhe "spekulimi" , me standardet e njëanshëme që nuk mund mbikëqyrin efektivisht sjellje të tilla. Integrimi global ka patur kuptimin se ata që kanë në kontroll burimet financiare dhe sistemin e levave politike e ekonomike janë bërë gjithnjë e më të lëvizshëm dhe kanë mundësi të blejnë ku të duan në kërkim të taksave më të favorshme dhe regjime standarde për të investuar.

Krizë jo e vogël u shkaktua në pjesën më të madhe për shkak të instrumenteve financiare si për shembull "fenomeni i sigurimit të kredive" ku bankat grumbullojne (për siguri) kreditë e ndryshme që japin në pasuritë të tjera të shitëshme , pra duke shkarkuar riskun e kredive në kredi të tjera të tilla. Bankat, fitojnë miliona nga interesat e kredive që lëshojnë , por ato janë të bllokuara për dekada të tëra. Kështu ato u shndërruan vetë në kolateral. Blerësi që ofron sigurimin merr pagesat e rregullta nga të gjitha ato hipoteka; ndërsa bankieri shkarkon nga

vetja rrezikun. Ky proçes apo fenomen u pa si ndoshta risia më e madhe financiare në shekullin e 20-të.

Kriza globale financiare ka ndikuar si në tregjet financiare dhe ekonominë reale (p.sh. në prodhimin e mallrave dhe shërbimeve):

Raundi i parë i efekteve të krizës ishte në sektorin financiar, por kjo nuk ishte aq e rëndë meqënëse sistemi financiar nuk ishte i ekspozuar ndaj ndonjë aseti toksik .Ajo që ndodhi ishte se:

- Pati tërheqje nga portofoli i investimeve të huaja
- Pati rritje të normave të interesit
- Pati rritje të nivelit të riskut në sektorin financiar
- Pati shkurtim të kredive konsumatore

Raundi i dytë i efekteve të krizës është mbi ekonominë reale e cila përkeqësoi krizën në sektorin financiar. Efektet e saj po ndihen nëpër tregjet financiare dhe ekonominë reale. Ajo që ndodhi ishte se:

- U ulën çmimet e mallrave;
- U reduktua veprimtaria ekonomike;
- U reduktuan të ardhurat nga fitimi;
- U rrit papunësia;
- U ul GDP-ja;
- U rrit Inflacioni

Në këtë studim kriza është parë si një faktor i rëndësishën në rritjen ekonomike të vendit tonë[39]. Dhe në fakt është me rëndësi të analizohet se si pozicionohet Shqipëria.

Në këtë kontekst është me rëndësi të shihet sesi kanë ecur marrëdhëniet e tregtisë së vendit tonë me vendet e rajonit para,gjatë dhe pas viteve të krizës financiare. Marrëveshjet e tregtisë

[39] Në kapitujt në vazhdim është bërë në analizë ekonometrike ku është përfshirë dhe faktori krizë si variabël Dummy

së lirë mes tetë vendeve të Ballkanit (vendet e CEFTA-s), po mbeten shumë larg qëllimit për të cilin u firmosën disa vite më parë. Të dhënat e tregtisë tregojnë se çdonjëri prej këtyre vendeve zhvillon pak tregti në rajon. Vëllimi tregtar i tyre luhatet mes 10-25% të totalit të tregtisë që ato zhvillojnë në vit. Për t´u mbrojtur nga ndonjë vërshim i mundshëm i importeve, ekspertët e tregtisë tregojnë se pothuajse të gjitha vendet filluan të nxjerrin në lojë forma të tjera penguese, si çmimet e referencave, procedura teknike apo kuota importi për produkte të caktuara.

Shqipëria, por edhe Kosova, duken më të pafavorizuara, pasi më parë në rajon ekzistonte tregu i mirintegruar jugosllav, urat e të cilit janë funksionale edhe sot.

Nga konstatimet edhe të Komisionit Europian, në vitin 2005 tregtia brenda rajonit mbetej ende në nivele të ulta, duke zënë rreth 6% të tregtisë totale. Pra, megjithë hyrjen në fuqi të MTL-ve bilaterale tregtia midis vendeve të rajonit ishtë akoma modeste. Momentet e para të krizës globale e gjetën Shqipërinë dhe gjithë vendet e rajonit,me rritje të kënaqshme ekonomike, nivel të ulët të kredive me probleme, borxh nën kontroll. Megjithatë panvarësisht këtyre treguesve, në katër vitet pasardhëse, të gjitha vendet e rajonit panë përkeqësim të treguesve makro dhe vendi ynë shënon dhe "rekord" në këtë drejtim. Shqipëria (ashtu si Serbia) po mbetet e fundit në garën që kanë nisur vendet e rajonit në ndjekje të Eurozonës, që më në fund ka dalë nga reçesioni. Emëruesi i përbashkët i këtyre rezultateve për të dy vendet është pikërisht borxhi që shënon vlera shumë të larta mbi 60% të PBB-së, por mbi të githa dhe nivele të larta të kredive me probleme. Sipas BERZH këto dy shtete vazhdojnë të përjetojnë rënie të kredisë, ndryshe nga të tjerët, që po e rigjallërojnë kreditimin për bizneset dhe konsumatorët, kjo është dhe arsyeja sepse parashikimi për rritjen ekonomike u rishikua në ulje për 2014-n, vetëm për këto dy vende.

Në fakt vendi ynë ka nivelin më të lartë të kredive me probleme (që po i afrohet 25% të totalit), jo vetëm në rajon, por në të gjithë Europën Qendrore e Juglindore . Në 2008 huatë e pakthyera në afat ishin vetëm 6.5%, ndërsa në 2014 ato u rritën shumë duke treguar atë që pritej: kriza preku bizneset e individët ashtu dhe dhënien e huave të pastudiuara mirë. Këto shifra sipas Bankës së Shqipërisë kapën vlerën 51% që krahasuar me vendet e rajonit është më shumë se dyfishi i Serbisë me 21% (ndonëse 2008 e gjeti me 15.7%)[40]

[40] Burimi IMF 2011

Gjatë viteve 1999-2009 ekonomia shqiptare ka njohur një progres të qëndrueshëm dhe relativisht të kënaqshëm krahasuar me vendet e rajonit. Proçeset e transformimit ekonomik dhe ristrukturimit, si dhe politikat makroekonomike të ndjekura në këto vite kanë rezultuar në një nga ritmet e rritjes më të larta në rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore (EQL).

Që nga fillimi i tranzicionit e deri në vitin 2009 ishim një nga pak vendet në Europë me rritje ekonomike pozitive, por aktualisht treguesit makroekonomikë në vendit tonë evidentohen të jenë më të përkeqësuar se rajoni. Panvarësisht se në në shtator të 2008-s, moment ky që u shfaq dhe kriza globale, Shqipëria dhe vendet e rajonit u gjenden me tregues të qëndrueshëm makroekonomikë, mosmarrja e masave të menjëhershme bëri që vendi të vuajë akoma edhe sot pasojat e krizës, teksa borxhi i rritur publik dhe kreditë e larta me probleme po pengojnë sot zgjerimin e qëndrueshëm.

Teksa kriza filloi ti shfaqë efektet e saj në të gjithë rajonin, Shqipëria u krenua në 2009-n që arriti të shmangë reçesionin (ndër të paktat në Europë, së bashku me Poloninë). Kjo histori suksesi i dedikohet , politikës zgjeruese fiskale, në një kohë që shtetet e tjera të rajonit u treguan më konservative, më shumë sesa nga bazat e një ekonomie të qëndrueshme.

Sipas Ministrisë shqiptare të Financave, për sa i përket borxhit publik shifrën më të lartë e shënoi në 2013 me vlerë 68% të PBB-së[41], në këtë sektor na e kalon vetëm Hungaria me gati 80% të PBB-së, ndërsa vendet e Ballkanit e kanë këtë tregues më të ulët se ne.

Të dhënat e krahasuara dhe të publikuara nga BERZH dhe Komisioni Europian tregojnë se :

1. Për Maqedoninë, borxhi pritet të rritet në mënyrë të moderuar në 39% në 2015-n, nga 36.1% në fund të 2013-s.

2. Serbia pritet që të ketë një rritje të lartë të borxhit publik, e parashikuar në 71.1% në 2015-n.

3. Për Malin e Zi, ky tregues do të shkojë në rreth 60% të PBB-së në 2015, nga 56.5% në 2013-n.

4. Ndërsa borxhi shqiptar sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar në raportin e tij të fundit rajonal nuk pritet të reduktohet, të paktën për një periudhë afatmesme.

[41] Ndërsa aktualisht për vitin 2015 llogaritet rreth 72% të PBB-së sipas INSTAT

Këta tregues të përkeqësuar rrezikojnë të ngadalësojnë rritjen e qëndrueshme afatgjatë të vendit sepse niveli i lartë i kredive me probleme dhe borxhi publik në rritje kanë shtuar brishtësinë financiare të Shqipërisë, por edhe Serbisë, dy vende që "kryesojnë" në këta tregues.Për këtë arsye,sipas të dhënave të krahasuara të Komisionit Europian, këta dy shtete në 2013 kanë reduktuar huanë me bazë vjetore me 2.4%, apo rreth 13.4 miliardë lekë për Shqipërinë dhe 6.9% për Sërbinë. Ndërsa Mali i Zi dhe Maqedonia kanë përjetuar të kundërtën me një zgjerim kredie prej 4.6% dhe 3.6% përkatësisht.

Kjo është dhe performanca më negative, që prej më se një dekade,që nga koha e ristrukturimit të sistemit bankar të atëhershme shtetërore.

3.4.1 Tregtia

Ajo që vihet re është dhe fakti se defiçitet tregtare dhe të llogarisë korrente si për vendet e BP, si dhe më gjerë për tërë rajonin e EJL, janë ende të larta. Kriza Botërore ishte dhe arsyeja që këto defiçite janë përkeqësuar ndjeshëm.Shkaku kryesor që kriza solli këtë impakt në këto balanca është ulja e remitancave.

Sipas raportit të BERZH ,flukset tregtare të vendeve të rajonit janë rritur në mënyrë të qëndrueshme në vitet e pas krizës , duke arritur që eksportet të jenë rritur me afro 17 përqind në vitin 2013, të kryesuara nga një rritje e shpejtë në eksportet serbe. Rritja kryesore në vitin 2013 ka ardhur nga eksportimi i makinerive dhe i pajisjeve të transportit, kryesisht nga Serbia dhe nga Maqedonia. Ndërkohë mineralet e djegshme të eksportuara nga Shqipëria dhe Mali i Zi ishin shumë domethënëse për këto dy vende, ndërsa metalet bazë zunë rreth çerekun e eksporteve nga Kosova në vitin 2013.

Sipas tabelave të raportuara nga Komisioni Europian, eksportet ndaj PBB-së për Shqipërinë në 2013-n arrijnë në rreth 33% të PBB-së, nën nivelin rajonal të krahasuara me Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB). Pavarësisht rritjes së fortë të eksporteve shqiptare gjatë viteve të fundit përsëri Mali i Zi, Serbia,dhe Maqedonia qëndrojnë në vlerën e 10 pikë përqindjeje më të lartë se Shqipëria për këtë tregues. Nuk mund të themi të njëjtën gjë dhe për Bosnjë-Hercegovinën që është i vetmi në rajon, më tregues më të vogël se Shqipëria, me një raport prej 30% të eksporteve ndaj PBB-së.

Figura. 5: Import-Eksporti i vendeve të Evropës Juglindore



Burimi: BERZH

Nga të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, hyrjet valutore dhe flukset tregtare ranë ndjeshëm, megjithatë përjashtuar rënien e eksport-importeve në vitin 2009, vlera e tregtisë me rajonin ka ardhur në rritje të vazhdueshme. Për këtë vit, (deri në muajin tetor) eksporti shqiptar drejt këtyre tregjeve u rrit 41% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ndërsa importet u rritën 26%.

Gjithsesi, pesha që ky rajon zë në totalin e tregtisë sonë të jashtme mbetet e ulët. Sipas të dhënave të tregtisë, pavarësisht se vlera e eksportit dhe importit u rrit mbi 30% gjatë vitit të kaluar, pesha e saj ra me rreth 2 pikë përqindje. Vitin e kaluar pesha e tregtisë me rajonin në tërësi u përkeqësua, pasi u rrit edhe pesha e importit të këtyre mallrave. Vitin e kaluar eksportet në këto tregje ishin më pak se 40% e vlerës së importit. Sipas këtij raporti eksportet shqiptare shënuan rritje të ndjeshme prej 16% për 11-mujorin 2013, por ky zgjerim ka ardhur kryesisht si rrjedhojë e grupmallit "lëndë djegëse, minerale, energji", pra kryesisht shitja e produkteve të papërpunuara të natyrës shqiptare (naftës) dhe nga tekstilet e këpucët, që kanë vlerë të shtuar të ulët, duke i bërë eksportet vendase të paqëndrueshme dhe me pak ndikim në rritjen ekonomike të vendit e hapjen e vendeve të reja të punës.

Ndikimin më të madh në tregti po e japin pikërisht vendet ish-jugosllave. Importi nga këto vende u rrit rreth 5% më shumë se rritja që shënoi importi nga tregjet e tjera në Ballkan. Sipas ekspertëve, këtë rritje e ndihmuan rrjetet e tregtisë me pakicë. Prodhimet serbe e boshnjake patën më shumë akses në treg përmes rrjetit të shitjes "Euromax". Sipas të

dhënave të tregtisë, vetëm produktet e sallamit të importuara nga Bosnja gjatë vitit të kaluar ishin pesë herë më të larta se në 2009-n. Tregjet fqinje, kanë arritur ta shfrytëzojnë tregun tonë më mirë se nga sa përfitojmë ne me eksportet në rajon. Në tregtinë tonë me Kosovën, duket se nuk kemi atë marrëdhënie që transmeton fryma politike e dy vendeve dhe kjo ka të bëjë shumë edhe me strukturën ekonomike të Kosovës, prodhime të lëndëve të para dhe zotërimin që ka hapësira ish-jugosllave, sidomos Serbia. Futja masive e produkteve serbe në Kosovë gjatë këtyre viteve, pa paguar detyrimet doganore, ka bërë që ato produkte të arrijnë në treg me çmime më të ulëta. Kjo pritet të ndryshojë me vendosjen së fundi të parimit të reciprocitetit.

Defiçiti tregar shprehur në lekë, u rrit me 0.3% (-6.4% kur shprehet në euro), duke arritur vlerën 327,668.9 million lekë (ose 2,488 million Euro). Mospërputhja midis defiçitit tregtar në Euro dhe Lekë i atribuohet zhvlerësimit mjaft të konsiderueshëm të Lekut kundrejt Euros, me rreth 7.15% gjatë vitit 2009.

3.4.2 Kërkesa e brendshme e rajonit

Në kontrast, kërkesa e brendshme e rajonit u tkurr në vitin 2013. Duke komentuar këtë tregues, Goldstein shprehet: "Ne do të donim t'i nxisnim vendet e Balkanit Perëndimor për të kaluar nga rritja e nxitur nga kërkesa e brendshme drejt një rritjeje që vjen nga rritja e eksporteve, e cila çon drejt një integrimi më të madh me tregun europian dhe ato botërore. Paralelisht me rimëkëmbjen, ka ardhur koha që vëmendja të përqendrohet në krijimin e një klime investimesh nxitëse të rritjes së mbështetur në eksporte dhe konektivitetit."

Kërkesa e brendshme është vënë më shumë nën trysni nga ulja e remitancave në rajon në vitit 2013, duke reflektuar një rimëkëmbje ekonomike ende të plogësht dhe mbizotërim të papunësisë së lartë në shtetet e BE-së. Më pak vende të reja pune të hapura, ulje të remitancave dhe kreditim të kufizuar në ekonomi, të ardhurat e familjeve dhe fitimet e kompanive nuk ishin në gjendje të nxisnin konsumin e brendshëm ose investimet në rajon.

3.4.3 Rritja ekonomike

Rritja ekonomike që ishtë rikthyer gjatë viteve 2000 me 3.4% dhe disa vende dhe më 7%, bëri të mundur rritjen e PBB-së rajonale me 40% duke përmirësuar konvergjencën e të ardhurave me vendet e BE-së. Këto tregues u përkeqësuan gjatë viteve të krizës duke rrezikuar mirëqënien ekonomike dhe sociale. PBB ne rajon ra me 3.7% në 2008 dhe më pas në 5.9 % në 2009, duke u ndjekur nga një reçession të dyfishtë në 2012 me një rënie tjetër 1.2%. Të gjitha këto erdhën si pasojë e kontraktimit të fortë të kërkesës së jashtme, rënies së remitancave dhe flukseve hyrëse të dobësuara të kapitalit, rritja e PBB-së në Shqipëri mbeti pozitive. Më konkretisht, pasqyrimin e plotë të situatës e tregon dhe rënia e IHD-ve prej 30%, duke u ndjekur nga rënia në volumin tregtare me BE-në, dhe sidomos me Greqinë dhe Italinë. Impakti i krizës në Greqi dëmton ekonominë rajonale, në rënien e dërgesave duke qënë se Greqia është nga investitorët më strategjikë në rajon., duke vonuar dhe integrimin e rajonit në BE.

Në vitin 2013, secili nga të gjashtë shtetet e Europës Juglindore shënoi ritme pozitive rritjeje. Rritje në nivelin 3 përqind ose më shumë u shënua në Kosovë, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në Malin e Zi. Viti i mbarë bujqësor dhe rritja e industrisë kanë mbështetur aktivitetin ekonomik të rajonit në të gjitha shtetet.

Treguesit e rritjes ekonomike pra të Prodhimit të Brendshëm Bruto sipas BERZH në raportin e saj të fundit, u parashikuan të rriteshin butësisht në shifrën 2% për 2014-n [42]sepse shtrëngimi fiskal nën programin e ri të FMN-së do të dëmtojë kontributin pozitiv që do t'i vijë rritjes ekonomike nga rimëkëmbja e vazhdueshme, si e kërkesës së brendshme, ashtu dhe e asaj të jashtme. Nga të dhënat e Instat në fakt parashikimet kanë qënë mjaft të sakta sepse rritja ekonomike ka arritur shifrën e 2.1%, rritje kjo afër mesatares së rajonit të Europës Juglindore, por nën rritjen ekonomike të Maqedonisë dhe Serbisë. Sipas raportit, aktiviteti ekonomik në Shqipëri mbeti i ndrydhur gjatë vitit 2013. Kjo rritje modeste vjen kryesisht nga problemet në Eurozonë dhe veçanërisht ato të vendeve periferike që janë partnerët ekonomikë të Shqipërisë, por gjithashtu dhe vështirësitë e brendshme që lidhen me bilancet e dobëta të korporatave dhe grumbullimin e detyrimeve që qeveria ka ndaj sektorit privat.

[42] BERZH ka rishikuar në ulje parashikimin për rritjen ekonomike shqiptare në 2014-n, në vetëm 0.3%, nga 1.2% që ishte.

Pabarazia kap shifra të frikshme në rajon ku për disa vende në rajon ka një% popullsie të madhe që jeton me më pak se 5$ në ditë si Maqedonia 40%, Kosova 30%, Kroacia me 0.6% dhe më keq pozicionohet Shqipëria me 58% të popullsisë.

Kriza e filluar ne vitet 2008- 2009 thelloi edhe disekuilibrat në ekonominë shqiptare. Pas 10 viteve rritjeje vendet e rajonit në vitin 2009 vuajtën nga reaksionet e krizës së eurozonës. Sistemi financiar u përball me shumë risqe ndaj PBB-së, defiçiti i llogarisë korrente u rrit në 14.9 përqind në vitin 2008, krahasuar me 10.4 përqind në 2007, rritje e shkaktuar kryesisht nga rritja e deçitit tregtar dhe rënies së remitancave. Defiçiti i llogarisë korente financohet nga flukset hyrëse të kapitalit dhe ato financiare, flukse të cilat edhe pse janë të favorizuara nga privatizimi dhe huamarrja publike, përsëri janë të kufizuara në kohë dhe madhësi.

Ndërsa defiçiti fiskal u rrit në 7% të PBB, nga 3% në vitin 2007, borxhi publik arriti në rreth 60% të PBB dhe defiçiti i llogarisë korrente arriti në 15% të PBB.

3.4.4 IHD—flukset e kapitalit

Një alarm tjetër që paralajmëron BERZH, është se kapitali po ikën nga rajoni. Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim pohon se vendet në tranzicion do të kenë një rimëkëmbje të ngadaltë, pavarësisht faktit se ekonomitë e zhvilluara kanë filluar tashmë rritjen. Kjo sepse bankat po "largojnë" paratë nga tregjet në zhvillim , ndërkohë që IHD-të nuk po arrijnë ta kompensojnë këtë fenomen. Në Shqipëri ikën 230 milionë euro nga bankat dhe hynë 260 milionë euro nga Investimet e Huaja Direkte ndërsa për rajonin thekson se për herë të parë që nga viti 2011, fluksi neto i kapitaleve u kthye në negativ në tremujorin e tretë 2013, për herë të parë në dy vjet . Sipas statistikave të bankës qendrore, në aktivet e bankave zëri "Depozita në banka, institucione krediti dhe institucione të tjera financiare" ka shënuar rritje të ndjeshme me 34%, apo 32 miliardë lekë (230 milionë euro) vetëm në tremujorin e tretë në raport me atë të mëparshmin, pas një periudhe prej tre tremujorësh radhazi, kur ky tregues kishte shënuar vetëm rënie dhe bankat ishin orientuar disi te bonot e thesarit të qeverisë shqiptare.Për të njëjtën periudhë, Investimet e Huaja Direkte në vend ishin rreth 260 milionë euro, duke bërë që kapitali neto i mbetur në vend të jetë minimal. BERZH nuk jep të dhëna për flukset dalëse të Shqipërisë në tremujorin e tretë 2013, megjithatë të dhënat e Bankës së Shqipërisë kanë konfirmuar se është e njëjta tendencë si në rajon, me proçesin e deleverage të bankave që u përshpejtua sërish në këtë periudhë. Shpejtësia e tërheqjes së

fondeve nga bankat e huaja u rrit në pjesën më të madhe të vendeve të Europës Qendrore e Juglindore. Ky proçes i vazhdueshëm po shtyn rifillimin e rritjes së kredisë. Shumë nga vendet e Evropës Lindore kanë pasuar rënie drastike të fluksit të IHD-ve në 2010, ndërsa Shqipëria ka thithur më shumë sesa në vitin e kaluar. Pas 717 milionëve EURO në vitin 2009, flukset e IHD-ve në 2010 shkuan në 793 milion Euro. Në vitin 2010 Shqipëria u rendit e dyta me shumën më të lartë të IHD-ve në EJL pas Serbisë ,sipas raportit te investimeve te huaja të AIR 2011. Raporti i fluksit të IHD kundrejt PBB-s është rritur në mënyrë të konsiderueshme. Në vitin 2011 ai arriti në 8,1% kundrejt 3,6% që ishte në vitin 2006.

Shqipëria ka stokun relative më të ulët të IHD-ve ndërmjet vendeve të Europës Juglindore, që është ndryshe nga madhësia relative e fluksit ne Shqipëri në këto vite, që nga viti 2008. Kjo ndodh për faktin se investimet e huaja direkte në Shqipëri janë një fenomen i kohëve të fundit dhe shumica e stokut është akumuluar vetëm në vitet e fundit, ndërsa krahasuar me vendet e tjera, ato kanë pritur IHD për një periudhë të gjatë kohe. Shqipëria ka pasur gjithashtu një rritje ekonomike më të shpejte se sa vendet e rajonit, gjë që ka ulur magnitudën e indikatorëve të IHDve kundrejt PBB-së

3.4.5 Evidenca në Barrierat tarifore

Sistemi tarifor që u aplikua pas miratimit të MTL varion sipas llojit të artikujve ku për produktet industriale kemi heqje të tyre (mallra josensitivë ndaj importit nga vendi partner), Tarifa që reduktohen gradualisht per produktet sensititive (produkte eksporti të ndjeshme ndaj importeve), kjo dhe për të mbrojtur produktet vendase. Tarifa që zbatohen sipas sistemeve aktuale respektive ose tarifa bazë, për produkte sensitive ndaj të cilave aplikohet mbrojtje e plotë tarifore . Gjithashtu nuk zbatohen masa jo-tarifore për importet, me përjashtim të atyre importeve që konsiderohen të rrezikshme për shëndetin publik.Gjithashtu një zë të veçantë kanë konçensionet për produktet bujqësore të cilat janë sensitive ndaj importeve.

Sipas raportit të sekretariatit të OBT-së, që nga anëtarësimi i saj, Shqipëria ka bërë progres të konsiderueshëm drejt liberalizimit dhe riorganizimit të regjimit të saj tregtar. Proçedurat doganore kanë qenë të efektshëme, dhe me futjen e një sistemi të centralizuar elektronik është reduktuar koha e pasqyrimit të të ardhurave doganore . Tarifat janë relativisht të ulëta.

Shumica e linjave tarifore në Shqipëri janë Duty Free, dhe nuk janë të pranishme majat tarifore; niveli më i lartë është 15%. Tarifa mesatare e aplikuar në Shqipëri është më i lartë për produktet bujqësore, në 7.1% (definicion OBT), sesa për produktet jo-bujqësore, në 3.8%. Shqipëria u siguron preferenca tarifore shteteve anëtare të BE-së, Turqisë dhe vendeve të CEFTA-s. Tarifat për vendet e CEFTA-s ndryshojnë, kryesisht për shkak të produkteve bujqësore, pasi mallrat industriale janë kryesisht Duty Free. Norma mesatare për të gjitha produktet nga të gjitha vendet është 2.1%, ndërsa mallrat e klasifikuar si bujqësore (përkufizimi i OBT-së) përballet me një normë mesatare prej 5.8%. Vetëm tregtia me Kosovën është plotësisht pa taksa.

Shqipëria aplikon një TVSH në një normë të përgjithshme prej 20%, për mallrat e importuara dhe të prodhuara në vend. Shqipëria zbaton shumë pak masa jo tarifore. Në përgjithësi, nuk ka importe të ndaluara, me përjashtim të produkteve që konsiderohen të jenë të rrezikshme për

shëndetin publik, dhe licencimi i importit është përdorur kryesisht për qëllime të SPS, sigurinë, mbrojtjen e mjedisit, si dhe për përputhje me detyrimet sipas konventave ndërkombëtare. Nga shtatori i vitit 2013, me anë të një VKM importeve të mbeturinave nuk janë të lejuara në Shqipëri. Shqipëria ka në vend disa regjime të veçanta doganoreqë përmbajnë dispozita ose trajtim të veçanta për eksportet apo ri-eksportet e mallrave të përpunuara në Shqipëri. Legjislacioni për anti-dumping dhe masat kundërbalancuese, si dhe për masa mbrojtëse është prezantuar që nga viti 2007. Këto ligje të reja janë njoftuar nga OBT dhe shqyrtuar nga Anëtarët.

3.4.6 Rimëkëmbja e EJL---- Nxitja e perspektivës afatgjatë

Panvarësisht krizës ekonomike të 2008-2009 dhe reçesionit të dyfishtë të 2012, përsëri Ekonomia e Europës Juglindore (EJG) filloi të rimëkëmbej nga recesioni i 2012-ës duke u rritur mesatarisht me 2.2 përqind në vitin 2013[43]. Lidhur me situatën në të ardhmen, raporti shprehet se rajoni parashikohet të rritet me 1.9 përqind në vitin 2014 dhe me 2.6 përqind në vitin 2015. Ellen Goldstein, Drejtore e Bankës Botërore për Europën Juglindore shprehet se

[43] sipas Raportit të Rregullt Ekonomik për Europën Juglindore (RRrE EJLS) të Bankës Botërore

"Rritja ekonomike u bë e mundur falë kërkesës në rritje për eksportet e rajonit nga shtetet me të ardhura të larta, veçanërisht nga shtetet e Bashkimit Europian (BE)".

Tabela 2 : Rritja reale e PBB-së për Evropën Juglindore

Evropa Juglindore: Rritja reale e PBB-së, në përqindje

	2012	2013	2014	2015
Shqipëria	1.3	0.4	2.1	3.3
Bosnjë dhe Hercegovina	-1.1	1.8	2.0	3.5
Kosova	2.7	3.0	3.5	3.5
IRJ e Maqedonisë	-0.4	3.1	3.0	3.5
Mali i Zi	-2.5	3.5	3.2	3.5
Serbia	-1.7	2.5	1.0	1.5
EJG6*	**-0.7**	**2.2**	**1.9**	**2.6**

Shënim: mesatarja e ponderuar e *PBB-së. Viti 2013 është vlerësim i përafërt. Viti 2014 dhe 15 janë parshikime të stafit të Bankës Botërore..
Burimi: Banka Botërore

Burimi : Banka Botërore

Por ky parashikim zbehet nga rreziqe domethënëse që lidhen me përmbytjet e fundit në rajon. Ajo vijon se "Përmbytjet shkatërruese veçanërisht në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Serbi, për shkak të reshjeve të papara më parë në mes të majit, kanë shkaktuar krizë humanitare, me dhjetëra persona të vdekur dhe me miliona të tjerë të shpërngulur, ose ka ndërprerë furnizimin me ujë ose energji elektrike. Po ashtu, janë shkatërruar shtëpi, janë dëmtur të mbjella dhe gjëja e gjallë dhe është ndërprerë transporti. Meqë këto fenomene janë një fatkeqësi humanitare për disa vende të Europës Juglindore atëherë do të kenë ndikime në rimëkëmbjen ekonomike për disa vite në vijim, të cilat pritet të vlerësohen më tej". Përmbytjet pa dyshim do të kenë ndikim negativ mbi rritjen ekonomike, megjithëse është ende shumë shpejt për ta matur ndikimin e plotë.

Ekonomitë e EJL-ve janë ende shumë larg ekonomive europiane sepse të ardhurat dhe standardi i jetesës është shumë i ulët. Niveli i lartë i kredive me probleme (NPL) dhe papunësia afatgjatë janë elemente kyç për rimëkëmbjen. Niveli i vlerësuar i NPL-ve në Slloveni është rishikuar në rritje në afër 20%, pas rishikimit të fundit të cilësisë së aktiveve nga bankat. NPL ka vazhduar të rritet në Hungari, Kazakistan dhe pjesën më të madhe të

vendeve të Europës Juglindore. Të gjitha këto vende dhe Ukraina kanë tashmë norma të NPL-së afër 20% dhe mbi 30% në rastin e Kazakistanit. Ndërsa normat afatgjatë të papunësisë janë tashmë mesatarisht 3-4 pikë përqindjeje më të larta se përpara krizës në pjesën më të madhe të vendeve të Europës Qendrore e Juglindore.

Ekonomitë e rajonit tonë, tipikisht nuk udhëhiqën nga inovacioni sepse është shumë i shtrenjtë. Prandaj duhet të ndërmarrin reforma strukturore, të cilat mund të lejojnë krijimin e një tregu rajonal konkurrencial të bazuar në specializim teknologjik dhe në inovacionin sepse inovacioni dhe njohuritë përfitohen nga investimet e huaja pra nga avancimi në proçesin e liberalizimit. Investimet e huaja janë të rëndësishme në rritjen e të ardhurave, modernizimin dhe punësimin, rajoni vuan nga aftësia përthithëse. Por investitorët janë mjaft të tërhequr për të investuar në rajon për shkak dhe të karakteristikave si korrupsioni, performanca e dobët e institucioneve , ritmet e ngadalta të rritjes ekonomike, etj.

Megjithatë reformat janë të nevojshmë sepse rrisin efiçiencën e tregjeve nacionale dhe do të rezultojnë në rritjen e produktivitetit të prodhimeve, në mënyrë që, tregjet të mund të arrijnë të alokojnë burimet e prodhimit dhe të mallrave drejt maksimizimit të të ardhurave dhe uljes së kostove. Prodhuesit dhe konsumatorët duke u informuar në mënyrë të shpejtë dhe të barabartë, mund të shmangin sjelljet monopolistike të disa tregjeve dhe të krijojnë kushte për një konkurrueshmëri efektive të të gjithë operatorëve rajonalë.

Për shkak të shkallës së ulët të përdorimit të teknologjisë dhe inovacionit, ekonomia jonë jo vetëm nuk arrin të krijojë rritje të vlerës së shtuar të prodhimeve vendase, por nuk arrin as të krijojë një produktivitet të lartë, për t´i bërë produktet tona të afta që të konkurrojnë në tregjet rajonale. Struktura e eksporteve tona përbëhet kryesisht nga lëndë të para të papërpunuara ose produkte të industrisë së fasonit, të cilat nuk arrijnë të konkurrojnë drejtpërdrejt në tregjet e huaja.

Në dallim nga ne, vendet e tjera të rajonit si Kroacia por edhe Maqedonia kanë rritur përpjekjet për shtimin e investimeve në kapital fizik dhe njerëzor, për të krijuar një avantazh konkurrues të produkteve të tyre në tregjet rajonale. Që produktet shqiptare të konkurojnë me standartin Europian, kërkohet një frymë e re e menaxhimit të strategjive tek biznesi shqiptar, futje e teknologjisë së re, rritje e cilësisë së produktit, administrim më i mirë i riskut të biznesit dhe riskut financiar, orientim më i mirë drejt perspektivave të tregjeve globale dhe kërkesave për zhvillimin e vendit

"Në tërësi, ndërsa rimëkëmbja ka sjellë rritje, shtetet në rajon kanë akses të kufizuar në përkthimin e rimëkëmbjes ekonomike në vende të reja pune," tha Gallina A Vincelette, Ekonomiste Kryesore dhe një ndër autoret e RRrE-së[44] EJL-në[45]. "Papunësia ka qenë shumë e lartë në rajon, me nivel mesatar prej mbi 24 përqind në vitin 2013. Nivelet e vazhdueshme të larta të papunësisë dhe papunësia kronike kanë mbizotëruar ndërmjet grupeve të cenueshme, të tillë si të rinjtë, gratë, dhe personat me aftësi të ulëta."

Në të gjitha vendet e rajonit të Ballkanit, papunësia mbetet më e lartë se mesatarja e normës së papunësisë në BE, pavarësisht rritjes ekonomike dhe qëndrueshmërisë në treguesit makroekonomikë monetarë. Papunësia rëndon sigurinë sociale-ekonomike, dhe mbi të gjitha barrën fiskale. Sipas Prof.As.Dr. Luljeta Minxhozi, "pjesëmarrja e popullsisë aktive në tregun e punës është e kufizuar, çka tregon se tregu i punës është i ngushtë". Minxhozi vëren një ndryshim shumë të madh mes rajonit të Ballkanit dhe vendeve të BE-së për papunësinë e personave të pakualifikuar. Në rajon, papunësia e kësaj kategorie është pothuajse e barabartë me normën mesatare të papunësisë. Në rajon papunësia e personave me edukim të lartë është 50% e atyre me edukim të ulët ndërkohë që në vendet e BE-së, papunësia për të pakualifikuarit është dy herë më e madhe se mesatarja. Sipas Bankës Botërore në rajon 15% e popullsisë ka edukim të lartë ndërsa në BE ky fenomen llogaritet 35%. Për ekspertët, ky tipar tregon se në rajonin tonë mungon kualifikimi. Si në vendin tonë edhe në Kosovë, pjesa më e madhe e të punësuarve janë në bujqësi. Në Maqedoni çereku i të punësuarve janë në industrinë tekstile. Popullsia e pakualifikuar në moshë pune është 6% në Shqipëri e Maqedoni dhe 10% në Kosovë. "Kjo situatë e mban të lartë normën e varfërisë në vend". Rajoni vuan edhe nga një "sëmundje" shkatërruese për kualifikimin dhe cilësinë e punës, që është papunësia afatgjatë. Të dhënat zyrtare tregojnë se gati 80% e personave që kërkojnë punë kanë një-tre vjet që janë jashtë tregut të punës. Në rajon papunësia llogaritet 24% por në disa vende kap dhe shifrën e 30%, sidomos e të rinjve që llogariten 50% të tyre papunë, ndërsa më këq pozicionohet Kosova me 70%.

[44] RRrE EJG përgatitet dy here në vit nga stafi i ekonomistëve të Departamentit për Uljen e Varfërisë dhe Menaxhimin Ekonomik (ECA PREM) të Rajonit të Europës dhe të Azisë Qendrore të Bankës Botërore.

[45] Shtetet e EJL6-ës janë Shqipëria, Bosnjë dhe Hercegovina, Kosova, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia.

Ndërkohë që pretendojmë integrimin e tregut (tregtisë), është po aq i nevojshëm integrimi i tregut të punës. Ekspertët e ekonomisë sugjerojnë që të krijohen strategji të përbashkëta të zhvillimit të këtij tregu: liberalizimi i tij (qarkullimi i lirë) dhe institucione e politika të përbashkëta.

Sipas ekonomistëve, procesi i integrimit të tregut të punës duhet të fillojë nga politikat e harmonizuara të arsimit, njohja e diplomave dhe politikat e përbashkëta për administrimin e profesioneve. Diferencat mes këtyre vendeve janë edhe në politikat fiskale, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në paga.

Sipas raportit, sfidat janë ende të pranishme dhe kërkojnë veprime në sektorët financiarë dhe fiskalë. Zbutja e huave të këqija të larta dhe në rritje, rifillimi i rritjes së kreditimit për bizneset huamarrëse, vendosmëria për përpjekje konsoliduese për të ruajtur bilancin fiskal dhe ulja e borxhit publik do të çonin në përshpejtimin e aktivitetit ekonomik. Për të mbështetur rritjen në rajon, vendet duhet të forcojnë më tej themelet e brendshme makro-ekonomike që ndihmojnë prodhimin dhe rrisin rezistencën ndaj trazirave të jashtme .

Për më tepër, rimëkëmbja ekonomike e kohëve të fundit përbën një mundësi për të rinisur reformat strukturore të nevojitura prej shumë kohe. Përparësitë për rritje dhe për hapjen e vendeve të reja të punës përfshijnë stabilizim makro-ekonomik dhe fiskal, përmirësim të konkurrueshmërisë dhe të konektivitetit, rritje të aftësive dhe të produktivitetit të punës, dhe forcim të qeverisjes dhe të antikorrupsionit.

3.5 KARAKTERISTIKAT E TREGUESVE MAKROEKONOMIK NË SHQIPËRI

Ekonomia Shqipëtare karakterizohet si një ekonomi me përmasa të vogla dhe me probleme të konsiderueshme,e megjithatë ka njohur ndër vite një rritje të kënaqshme. Ekonomia shqiptare gjatë viteve 1993-1998 ka përjetuar rritjen më të shpejtë në GDP reale në krahasim me vendet e tjera në Evropën Lindore. Gros dhe Steinherr (1995) kanë treguar se rritja e ritmit të reformave ekonomike, influencon pozitivisht në shpejtësinë e rimëkëmbjes ekonomike në

ekonomitë në tranzicion. Në raportin e BERZH në vitin 1995 ,ritmi i reformës ekonomike në Shqipëri ka qenë i shpejtë. Në të vërtetë, Hashi dhe Xhillari (1997) arrijnë në përfundimin se suksesi i ekonomisë shqiptare kryesisht mund të shpjegohet me zbatimin e një programi gjithëpërfshirës të privatizimit. Pra, nuk ka gjasa që suksesi i fundit ekonomik i Shqipërisë thjesht mund të shpjegohet me anë të miratimit të një grupi të përshtatshëm të politikave qeveritare. Është e nevojshme gjithashtu të marrin në konsideratë rolin që faktorë specifik për Shqipërinë kanë luajtur në zhvillimin e vendit gjatë këtyre viteve. Për shembull, një pjesë e madhe e popullsisë së Shqipërisë punojnë jashtë vendit dhe dërgojnë para në shtëpi. Kjo tregon se remitancat janë të konsiderueshme dhe janë luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë.

Hapja tregtare ka ndjekur një trend pozitiv por ende të ulët, krahasuar me vendet e tjera të rajonit. Vlerat e hapjes tregtare llogariten si Volum tregtar /GDP, dhe kanë ndjekur një regjim me luhatje të vogëla, ku vihet re një rënie e konsiderueshme vetën në vitin 2000 në masën 7.5 %, më pas në vitin 2003 me një rënie modeste prej 0.6%, për shkak dhe të krizës financiare në vitin 2009 llogaritet një rënie tjetër prej 4%. Viti 2012 që koinçidon dhe më reçesionin e vendeve të rajonit ka dhënë efektet dhe në treguesin e hapjes për vendin tonë që tregon një rënie prej përsëri 4%. Megjithë luhatshmëritë që kanë qenë të ulëta, indeksi i hapjes llogaritet mesatarisht në masën 46.3%[46] për vitet e marra në studim

Figura. 6: Indeksi i hapjes tregtare 1996-2014



Burimi: Instat dhe llogaritjet e Autorit

[46] Llogaritjet e autorit

Ndërkohë nga figura 7 vihet re se hapja me partnerët kryesorë tregtarë për vendin tonë ka treguar luhatshmëri të vogla përveç vitit 2000 ku me BE-në vihet re një zvogëlim i konsiderueshëm që i paraprin dhe futjes në OBT. Hapja me vendet e rajonit llogaritet dhe më e vogla e cila ka ardhur në rritje që pas vitit 2005. Me Greqinë vihet re një hapje konstante pa shumë luhatje ndër vite. Me Italinë dhe BE-në vihet re dhe rritja e hapjes tregtare në vite që korrespondon dhe me rezultatin e modelit në këtë studim.

Figura. 7: Indeksi i hapjes tregtare me vendet më të mëdha partnere 1993-2014



Burimi: Instat dhe llogaritjet e Autorit

3.5.1 Dinamika e eksporteve dhe importeve

Volumi tregtar është një indikator i rëndësishëm i ecurisë së tregtisë, dhe llogaritet si shumë e importeve me eksportet në një vend. Gjatë gjithë viteve të tranzicionit paraqitet një dominancë e importit në Bilancin tregtar për vendin tonë, duke sjellë në këtë mënyrë dhe një deficit tregtar të lartë për të gjitha vitet e marra në studim. Bilanci i Tregtisë në Shqipëri i raportuar nga Instituti i Statistikave (INSTAT) , ka vlerë mesatare prej -15804,76 milionë

lekë nga 1993 deri 2015 . Mangësitë strukturore të Shqipërisë janë faktori kryesor që sjell si pasojë defiçite të qëndrueshme tregtare[47].

Partnerët kryesorë tregtarë të Shqipërisë janë Italia , Greqia , Turqia, Kina, Gjermania , Serbia, Zvicra, Spanja , Franca , Maqedoninë dhe Bullgarinë . Sipas kalkulimeve në termat e volumit tregtar Vendin e parë e zënë vendet e BE-së mesatarisht me 69.17%, më pas vjen Italia me 37.44 %, dhe panvarësisht tendencës në rënie në vitet e fundit në vlera mesatare pasha që zë Greqia në tregtinë e vendit tonë llogaritet 13.3%. Panvarësisht marrëveshjeve të shumta tregtare, tregtia me vendet e rajonit mbetet në vlera shumë të ulëta, mesatarisht nga 1993-2014 llogaritet afërsisht 0.07%.

Figura. 8: Ecuria e tregtisë së Jashtme 2005-2013



Burimi: INSTAT

Në rastin e Shqipërisë, bilanci tregtar ka ardhur shpesh në ulje (importet janë rritur vazhdimisht kundrejt eksporteve). Vlerën më të lartë e ka arritur në 2011 me shifrën -347,107 milion leke , dhe më të ultën në 1994 me shifrën 43,632 milion lekë. Por megjithatë vitit 2013 konfirmon një rikuperim të tij sepse ka shifrën e 266,133 milion lekë që tregon dhe tabela e mësipërme. Përmirësimi I bilancit tregtar ka filluar që në 2011 dhe po tregon një

[47] Të dhënat janë sipas Instat, Tabela tek shtojca :**Treguesit e tregtisë 1993-2014,**

trend përmirësimi të vazhdueshëm kjo dhe për shkak të uljës së mbulimitë të eksporteve nga importet.

Nga analiza e të dhënave shihet se niveli i eksporteve, ka shënuar vlerën e tij maksimale të 20 viteve të fundit gjatë vitit 2013. Eksportet arritën në mbi 246 miliardë lekë, duke u rikuperuar ndjeshëm dhe duke përmirësuar kështu bilancin tregtar të Shqipërisë.

Figura. 9: Ritmet vjetore të rritjes së eksporteve 2001-2014



Burimi: INSTAT

Viti 2009, është një ndër të paktat vite ku janë ulur të dy treguesit krahasuar me vitin e mëparshëm (edhe importet edhe eksportet). Kjo shpjegohet me krizën globale, dhe uljen e kërkesës nga brenda dhe jashtë vendit. Nga grafiku vërejmë se përveç vitit 2009 që eksportet kanë pasur një rënie të konsiderueshme prej -7% , në gjithë vitet kanë një rritje me luhatshmëri të vogël. Viti 2010 shënon një rekord me një rritje prej 55%. E cila është ndjekur nga një rritje më e vogël në vitet pasuese. Në vitin 2014 eksportet janë ulur me 12% më shumë se një vit më parë duke kapur shifrën më të ulët të rritjes së eksporteve (përveç 2009) në këto 14 vitet e fundit. Eksporti duke qenë në nivele të larta ndikon negativisht në normat e rritjes së PBB duke përkeqësuar dhe bilancin tregtar.

Nga ana tjetër,importet kanë pasur tendenca rritjeje me një luhatshmëri apo thyerje në vitin 1997 dhe në vitin 2009, kryesisht për shkak dhe të krizave financiare. Gjithashtu importet kanë shënuar rënie si pasojë e rënies së konsumit të brendshëm prej krizës ekonomike në

vend, por edhe nga rritja e prodhimit vendas të produkteve bujqësore. Importet në fund të vitit 2013 arritën në 512.5 miliardë lekë, duke u zvogëluar 3% kundrejt vitit 2012 dhe njëherësh duke shënuar vlerën më të ulët të tre viteve të fundit.

3.5.2 Ecuria e ekonomisë Shqipëtare vitet e fundit

Sipas Instat në raportin e ecurisë së tregtisë për 2 vitet e fundit, të dhënat më të fundit që publikon Instituti i Statistikave flasin për një situatë relativisht të mirë për ekonominë shqiptare:

Figura. 10 : Import Eksporti i grupmallrave 2013

Burimi: INSTAT

Shqipëria përmirëson bilancin tregtar edhe për vitin 2013, duke përmirësuar në këtë mënyrë shifra të larta të papunësisë në vend. Defiçiti tregtar sipas INSTAT ka pësuar një rënie me 15.2% më shumë në raport me të njëjtën periudhë të një viti më pare. Defiçiti tregtar është pak më shumë se 26 miliardë lekë për 2013. Partnerët kryesorë tregtarë janë Italia (37,2%), Greqia (7,2%), Turqia (7.2%) dhe Kina (6,1%)", përveç BE-së që zë një peshë të konsiderueshme prej 68.3% si partneri jonë më i madh tregtar. Italia mbetet partneri ynë kryesor përveç BE-së me një treg me mbi 60 milionë banorë dhe lidhje të shumta kulturore,ekonomike por dhe gjeografike.

Figura. 11 : Qarkullimi i mallrave në tregtinë e Jashtme 2014



Burimi: INSTAT

Viti 2015 ka nisur i vakët për tregtinë e jashtme të vend. Defiçiti tregtar i janarit rezultoi në vlerën e 18 miliardë lekëve, në rritje vjetore me 0.3%. Shqipëria regjistroi një deficit tregtar prej 20.946,80 milion lekë në shkurt të 2015. Partneri kryesor tregtar vazhdon të jetë Bashkimi Europian, me mbi 61% të volumit të këmbimeve. Kjo do të thotë se, rënia vjetore sipas peshës që zë çdo grup në eksportet gjithsej, kanë patur eksportet e grupeve: "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" me 40,7%, "Prodhime druri dhe letre" me 11,9% dhe "Lëkurë dhe artikujt prej tyre" me 7,1%. Po kështu, rënie vjetore sipas peshës që zë çdo grup në importet gjithsej, kanë patur importet e grupeve: "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" me 34,1%, "Prodhime druri dhe letre" me 25,6% dhe "Lëkurë dhe artikujt prej tyre" me 7,6%. Defiçiti tregtar I muajit shkurt është 21 mld lekë, duke u rritur me 10,9 % krahasuar me Shkurt 2014 dhe 20,0 % në krahasim me Janar 2015.

Eksportet

Sipas INSTAT viti 2013 ka qenë pozitiv në fushën e eksporteve, të cilat shënuan rritje dianmike dhe kapin vlerën e 246 miliard lekë. (1756 mln Euro)., apo 15.6% më shumë në raport me një vit më parë. Rritja me bazë vjetore për eksportet nuk e përkeqësoi bilancin tregtar për shkak dhe të rënies së importeve në vlerën 512 miliard lekë . Rënie më të madhe vjetore ka patur në eksportet e grupeve "minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" me 34,5% dhe "lëkurët dhe artikujt prej tyre" me 7,7%. Raportimi i shifrave të tilla për ekspertët e

ekonomisë nuk janë aspak të mira, pasi një bilanc i tillë tregtar tregon qartë se, varësia e tregut të vendit nga produktet e huaja sa vjen e shtohet. Dhe e gjithë kjo, në mungesë të prodhimeve vendore. Tregjet kryesore për eksportet ishin : Italia , (46. %) Spanjë , (11 %) Kosova, (7 %) Malta , (6 %).

Figura. 12 : Eksporti sipas vendit të destinacionit 2013



Burimi: INSTAT

Viti 2014 ka nisur me rënie të eksporteve dhe në këtë drejtim, përcaktuese ka qenë rënia e grupit "Minerale, lëndë djegëse, energji", që ka udhëhequr rritjen e eksporteve në vitet e fundit. Eksportet e këtij grupi për janarin ranë me 18% kundrejt një viti më parë. Ndërsa në fund të vitit 2014 sipas Raporti i fundit mbi Tregtinë e Jashtme ,eksportet e mallrave arritën vlerën 19 mld lekë, duke u ulur me 10,5 % në krahasim me Dhjetor 2013 . Rënia e këtij grupi megjithatë është kompensuar pjesërisht nga rritja e disa prej grupeve të tjera dhe kryesisht e atij "Tekstile dhe këpucë". Vitin e kaluar, kërkesa e huaj ka qenë shtysa kryesore për rritjen ekonomike dhe qeveria e djathtë parashikonte të njëjtën gjë edhe për vitin 2014. Mospërmbushja e pritshmërive të larta nga eksportet po rezulton në dështim të projeksioneve për një rritje ekonomike më të lartë se vitin e kaluar. Sipas të dhënave mësohet se, eksportet shqiptare edhe pse me një rritje modeste, sërish ato nuk kanë mundur që të ndikojnë në zvogëlimin e defiçitit tregtar. Raporti mes importeve dhe eksporteve në vendin tonë, mbetet gjithnjë në favor të mallrave që vijnë nga jashtë. Eksporti i grupit "Makineri, pajisje dhe pjesë

këmbimi" u ul me 11,3%. Por edhe importi u rrit për këtë periudhë. Raporti mes eksporteve dhe importeve mbetet në favor të mallrave që vijnë nga jashtë. Kjo ka bërë që defiçiti tregtar i këtij viti të rritet, duke shënuar një rritje me 25.2% krahasuar me 2013. Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 69,1% të gjithë tregtisë. Partnerët kryesorë tregtarë janë Italia (36.8%), Turqia (7,2%), Kina (6,5%) dhe Greqia (7,5%), por edhe shkëmbimet kanë pasur tendencë në rënie gjatë kësaj periudhe. Eksportet kryesore të Shqipërisë janë këpucë, veshje , metale , lëndë djegëse dhe lubrifikantë , lëndëve të para , makineritë dhe pajisjet dhe ushqim . Importet kryesore të Shqipërisë janë makineri dhe pajisje , lëndë djegëse dhe lubrifikantë , ushqim , kimikate dhe pijet dhe duhanin .

Figura. 13: Qarkullimi i mallrave në tregtinë e Jashtme 2014-2015



Burimi: Instat

Për sa i përket vitit 2015 . Sipas të dhënave nga Instituti i Statistikave, eksportet për janarin kanë pësuar një rënie me 0.6% ndaj të njëjtës periudhë të vitit të kaluar, si dhe 8% në krahasim me muajin dhjetor 2014. Grupi "Minerale, lëndë djegëse, energji" vazhdojnë që ta thellojnë akoma më shumë rënien e nisur që në vitin e kaluar. Për janarin, eksportet e këtij grupi u tkurrën me afro 41% me bazë vjetore. Luhatshmëria e eksporteve për këto produkte vjen nga ulja e ndjeshme e çmimeve të lëndëve të para të eksportit në tregjet ndërkombëtare, por edhe bilanci i paqëndrueshëm energjetik i vendit. Në muajin Shkurt 2015 eksportet e mallrave arritën vlerën 18 mld lekë, duke u ulur me 12,3 % në krahasim me Shkurt 2014 dhe duke u rritur me 0,3 % në krahasim me Janar 2015. Rritje më të madhe vjetore, sipas peshës që zë çdo grup në eksportet gjithsej, kanë pasur eksportet e grupeve: "Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi" me 75,9 %, "Ushqime, pije, duhan" me 4,6 % dhe "Produkte kimike dhe plastike" me 37,2 %. Rënie vjetore, sipas peshës që zë çdo grup në eksportet gjithsej, kanë

pasur eksportet e grupeve: “Tekstile dhe këpucë” me 5,0 %, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me 39,3 % dhe “Materiale ndërtimi dhe metale” me 0,1 % .

Importet

Importet po rriten me shpejtësi, ndërsa eksportet po ngadalësohen. Ndërsa qartë kuptohet se, vendi jonë po thellon gjithnjë e më shumë raportin mes importeve dhe eksporteve të dhënat e INSTAT-it tregojnë gjithashtu se, vetëm gjatë 2014 importet e mallrave arritën vlerën 47 miliardë lekë, duke dhënë sinjale për rigjallërim të investimeve në vend. Nga ana tjetër, me eksportet që po ngadalësohen, deficiti tregtar po përkeqësohet sërish pas një përmirësimi në 2013, duke u rritur me 8% në raport me tetë mujorin e parë të vitit të kaluar, për të arritur në 178 miliardë lekë (përqindja e mbulimit të importeve me eksporte zbriti në 48.9%, nga gati 50% në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Pothuajse të gjitha grupmallrat kryesore shënuan rritje me bazë vjetore për periudhën janar-gusht. Këtë vit kontributi neto i eksporteve në rritjen ekonomike është më i ulët, sepse në ndryshim nga vitet e mëparshme importet po rriten më shumë se eksportet dhe deficiti tregtar po thellohet. Tregjet kryesore për importin ishin: Italia , (33.1 %) Greqia (8.9 %) Kina (6.8 %) Turqia (6.5 %).

Figura. 14: Importi sipas vendit të origjinës 2013

Burimi: INSTAT

Rritje më të madhe vjetore ka patur në importet e grupeve "tekstile dhe këpucë" me 28,0%, "lëkurë dhe artikuj prej tyre" me 25,8% dhe "produkte kimike dhe plastike" me 23,4%. Rënie më të madhe vjetore pati në importet e grupit "minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" me 4,7%.

Rënie më të madhe vjetore kanë patur importet e grupeve: "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" me 29,9 %, "Makineri, paisje dhe pjesë këmbimi" me 20,5 % dhe "Ushqime, pije, duhan" me 10,9 %.

Edhe për janarin e vitit 2015, një tendencë të ngjashme me eksportet në rënie për janarin regjistruan edhe importet. Sipas INSTAT, në një muaj u importuan mallra në vlerën e 35 miliardë lekëve, në rënie me 0.2% ndaj të njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Edhe në importe kontributin kryesor në rënie e ka dhënë grupi "Minerale, lëndë djegëse, energji", me tkurrje të vlerës së importeve prej 34%. Në muajin Shkurt 2015 importet e mallrave arritën vlerën 39 mld lekë, duke u ulur me 1,1 % në krahasim me Shkurt 2014 dhe duke u rritur 10,0 % në krahasim me Janar 2015. Rritje më të madhe vjetore, sipas peshës që zë çdo grup në importet gjithsej, kanë pasur importet e grupeve: "Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi" me 15,8%,"Ushqime, pije, duhan" 15,4 % dhe "Produkte kimike dhe plastike" 10,6 %. Rënie vjetore sipas peshës që zë çdo grup në importet gjithsej, kanë pasur importet e grupeve: "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" me 37,3 % dhe "Materiale ndërtimi dhe metale" me 8,9 %.

Deficiti buxhetor

Vlen të theksohet se, vetëm për shkak të rënies së të ardhurave dhe rritjes së shpenzimeve, deficiti buxhetor në vitin 2013 shënoi rritje 54 për qind, në krahasim me atë të vitit 2012. Deficiti buxhetor arriti në 65 miliardë lekë, nga 49 miliardë lekë që ishin planifikuar para ndryshimit të buxhetit 2013. Në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto, deficiti shënoi -4.8 për qind, duke shënuar vlerën më të lartë që nga viti 2009. Sipas teorive ekonomike, e gjithë rënia i faturohet një mosgrumbullimit të taksave, pasi ekonomia, pavarësisht se me ritme të ulëta, është rritur në krahasim me vitin 2012.

Të gjitha deficitet po shkojnë në përkeqësim. Edhe të dhënat që raporton Banka e Shqipërisë tregojnë se edhe pozicioni neto i llogarisë korrente regjistroi një deficit prej 299.5 milionë eurosh gjatë 2014. Ai ka ndjekur prirje zgjeruese për të dytin tremujor radhazi, duke u

thelluar gjatë tremujorit në analizë me rreth 31% në nivel vjetor. Sipas BSH, deficiti i llogarisë korrente u vlerësua në nivelin 12.9% ndaj PBB-së nominale. Të gjithë zërat përbërës të llogarisë korrente kanë dhënë kontribut në kahun zgjerues në deficitin e regjistruar, ku peshën më të lartë e zë përkeqësimi i deficitit tregtar në mallra e shërbime.

Drejt rritjes së çmimeve të mallrave dhe zhvlerësimit të lekut

Nëse të dhënat nga tregtia e jashtme vazhdojnë me këto ritme, atëherë Shqipëria rrezikon rritjen e çmimeve për mallrat në vend, si dhe zhvlerësimin e lekut. Ulja e fuqisë konkurruese e ekonomisë shqiptare në raport me mallrat dhe shërbimet e huaja vjen në një kohë aspak të mirë, pasi nevoja për të plotësuar kërkesat e tregut është plotësuar vetëm, duke marrë mallra nga jashtë. Këtë e vërtetojnë shifrat e fundit të publikuara nga Instituti i Statistikave për tregtinë e jashtme . Sipas këtij raporti, vendi ynë ka dërguar më pak mallra drejt vendeve të tjera dhe ka rritur kërkesën për të marrë nga këta të fundit mallra dhe produkte për të plotësuar nevojat e konsumatorëve. Raporti thotë se, janë eksportuar 21 mld lekë mallra drejt vendeve të tjera, duke shënuar ulje të eksporteve me 0,4%, në krahasim me 2013. Shqipëria ka shënuar rënien më të madhe në ofrimin e shërbimeve të tilla drejt vendeve të tjera si grupet "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" dhe "Lëkurët dhe artikujt prej tyre". Ndërsa, ka rritur nevojën për të marë nga jashtë më shumë produkte në grupet "Tekstile dhe këpucë", "Lëkurë dhe artikuj prej tyre" dhe "Produkte kimike dhe plastike". Ndërsa, rënie më të madhe vjetore pati në importet e grupit "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike".

Pozicioni i konkurrueshmërisë të ekonomisë shqitare

Shqipëria ka arritur progres të madh gjatë viteve të fundit. Treguesit ne tabelën e mëposhtme tregojnë një rritje të indeksit me kalimin e viteve deri në 2012 dhe më pas një rënie në 2013 dhe akoma më shumë në 2014. Një tregues i fundit është "*Raporti i Konkurrueshm*ërisë *Globale 2014-2015"* i Forumit Ekonomik Botëror, i cili e rendit Shqipërinë në pozicionin e 97-të nga 142 ekonomi me 3.84 , ndërsa Raporti i vitit 2012-2013 e renditi Shqipërinë në pozicionin e 89-të nga 144 vende/ekonomi me 3.91 dhe ai i vitit 2011--2012 në pozicionin e 78-të me 4.06.

Arsyet e kësaj rënieje këto dy vitet e fundit në treguesit e konkurrueshmërisë ndoshta kanë lidhje dhe me rënien e treguesve makroekonomikë të sipërpërmendura.

Tabela 3 : Indeksi i konkurrueshmërisë 2006-2013

Viti	indeksi
2006	3.07
2007	3.46
2008	3.48
2009	3.55
2010	3.72
2011	3.94
2012	4.06
2013	3.91
2014	3.84
Mesatarja	46.04

Burimi : Banka Botërore, llogaritjet e autorit

Sipas raportit të Bankës Botërore *"Doing Business, 2012*", në "*Lehtësinë e të bërit biznes",* Shqipëria renditet mjaft mirë dhe në "*Marrjen e kredisë*" dhe "*Mbrojtjen e investitorëve",* përmirësohet pozicioni i saj duke e bërë atë ndër vendet më të mirë reformatorë. Sipas raportit të Konkurrueshmërisë Globale të Forumit Ekonomik Botëror, Shqipëria klasifikohet në grupin e vendeve që janë në stadin e dytë të zhvillimit të konkurrueshmërisë (gjithashtu quhet " stadi nxitës i efiçiencës së ekonomisë "). Kur ekonomitë transferohen në fazën e efiçiencës, për pak kohë konkurueshmëria e tyre mbështetet në çmime të ulta, por në cilësinë e mallrave dhe të shërbimeve.

Shqipëria vetëm ne periudhën e fundit 2 vjeçare pas 2012-2013 ka paraqitur rënie në renditje, e cila mund të jetë në një masë të caktuar ndikimi i faktorëve të jashtëm (kriza ekonomike globale). Ndërsa rritja e konkurrueshmërisë së ekonomisë në vitet e mëparshme i dedikohet në një masë të madhe reformave të ndryshme, por që nga ana tjetër që vendi të jetë më konkurrues kërkohet të vihet theksi në faktorët e inovacionit, gatishmërinë teknologjike, përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës dhe konsolidimin e institucioneve. Konkurrueshmëria e bizneseve shqiptare është përmirësuar nga vitit në vit, por si objektiv i rëndësishëm për periudhën 2013-2020 mbetet :Rritja e mëtejshme e konkurueshmërisë së ekonomisë duke përmirësuar vlerësimin nga 4.06 pikë në vitin 2012 në 4.5 pikë në vitin 2020

(sipas raportit të GCI[48]).Synohet që për periudhën 2013-2016, do të zbatohet Programi Strategjik për Zhvillimin e Inovacionit dhe Teknologjisë të SME-ve për periudhën 2011-2016 miratuar me Vendimin Nr. 104, datë 09.02.2011 të Këshillit të Ministrave.

Investimet e Huaja Direkte

Që nga fillimi i tranzicionit është vënë re një tendencë rritjeje e IHD-ve në Shqipëri. Sigurisht vlera e Investimeve të Huaja Direkte ka qënë më e lartë se vlera e Remitancave. Në një hark më të gjatë kohor prej dhjetë vitesh 2002-2012, raporti i këtyre dy vlerave paraqitet tepër interesant. Në 2002- 2006, investimet e huaja direkte qëndronin në vlerë inferiore kundrejt dërgesave nga emigrantët. Në këtë katërvjeçar emigrantët sillnin në atdhe 3 – 4.5 herë më shumë euro seç sillnin investitorët e huaj direkt.

Viti 2006 - 2013 është vit me rritje progresive të vlerave të investimeve të huaja direkte. Ky hark kohor shënon një moment pozitiv për ekonominë vendase. Duke bërë këtë lloj analize krahasuese, se si pozicionohen remitancat kundrejt IHD-ve hulumtohet me kujdes roli i secilit tregues dhe i të dyve së bashku në ekonominë e brendshme. Në vitin 2010 shënohet edhe diferenca më e lartë mes vlerës së remitancave si dërgesa të emigrantëve dhe vlerës së investimeve të huaja direkte.Në fund të vitit 2013, investimet e huaja direkte shënuan vlerën maksimale të 10 viteve të fundit, duke arritur në 923 milionë euro. Rritja shënon një kthesë pozitive për IHD-të pas rënies së vazhdueshme në vitet e fundit. Rritja e shpejtë e investimeve gjatë 2013 ka ardhur si pasojë e disa privatizimeve të realizuara në pjesën e parë të vitit, ku dominon blerja e dy hidrocentraleve nga kompania turke e përpunimit të hekurit, Kurum. Fatura e këtij privatizimi shënonte 110 milionë euro.

Nga ana tjetër, dërgesat e emigrantëve, remitancat kanë zbritur me shpejtësi. Gjatë 2013-ës, remitancat u ulën në 500 milionë euro, duke shënuar vlerën më të ulët të 10-viteve të fundit. Kjo konfirmon rënien e kontributit të dërgesave të emigrantëve në ekonominë vendase, në kushtet kur kriza ekkonomike në Europë, ka ulur ndjeshëm të ardhurat e tyre.

Shqipëria është një nga liderët në thithjen e IHD-ve në Ballkanin Perëndimor. Përmirësimi i dukshëm i infrastrukturës së rrugëve, elektricitetit dhe furnizimit me ujë, përmirësimet e mëdha në shërbimet publike si dhe iniciativat e mira të marketingut kanë tërhequr investitorë

[48] Global Competitiveness Index

kryesorë në fushat e energjisë, hidrokarbureve dhe në infrastrukturë si edhe në fushën e shitjeve me pakicë dhe në industrinë financiare.

Figura. 15: Ecuria e sektorit të Shërbimeve dhe IHD-ve 1993-2014



Burimi : Banka e Shqipërisë, llogaritjet e autorit[49]

Sipas raportit të Bankës së Shqipërisë[50] ,investimet e huaja direkte patën rritje prej 39 % gjatë vitit 2013 krahasuar me vitin 2012, duke kapur nivelin e 923 milionë eurove. Në total, bilanci i pagesave ishte pozitiv dhe si rezultat, rezervat valutore pësuan rritje duke bërë që në fund të vitit të ishin të mjaftueshme për të mbuluar 4.6 muaj importe mallrash e shërbimesh.Në llogarinë e shërbimeve, u regjistrua një tepricë pozitive mes të ardhurave dhe shpenzimeve prej rreth 97 milionë eurosh, rreth 4 milionë euro më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Kontributin kryesor e dha bilanci pozitiv në shërbimet e udhëtimit, që zënë dhe peshën më të madhe në të ardhurat dhe shpenzimet e shërbimeve, me përkatësisht 66% dhe 72% të totalit. Rritja vjetore e të ardhurave gjatë kësaj periudhe është kryesisht pasojë e rritjes së numrit të vizitorëve të huaj me rreth 29%.

[49] Të dhënat janë marrë nga faqja zyrtare e Instat (Instat.gov.al) ndërsa grafiku është realizuar nga autori me programin EViews 7.Sipas tabelës janë hedhur të dhëna për 21 vite ku viti 0 i takon 1993 dhe 21 i takon 2014
[50] NJOFTIM STATISTIKOR, BILANCI I PAGESAVE, 10 Dhjetor 2014

Gjithashtu edhe peshën më të madhe në pagesën e TVSH-së e ka patur sektori i shërbimeve, ndjekur nga sektori i prodhimit. Vihet re zvogëlimi i rëndësisë së sektorit të ndërtimit dhe prodhimit si kontribues i TVSH-së dhe rritja e ndjeshme e peshës së shërbimeve në totalin e TVSH-së, në linjë me ecurinë e aktivitetit ekonomik në vend. Sektorët që kanë pësuar rënie të pagesave të TVSHsë krahasuar me një vit më parë janë: prodhim energjie, prodhim nafte, ndërtim objekti, tregtim karburanti dhe prodhim, duke përmendur ato me më tepër peshë. Në sektorët që janë me pagesë më të lartë të TVSH-së se një vit më parë spikasin grupet "Shërbime" dhe "Telekomunikacion".

Telekomunikacioni është një ndër aktivitetet me dinamike në sektorin e shërbimit në Shqipëri. Ai është zhvilluar kryesisht nëpërmjet privatizimit dhe investimeve pasuese të bëra nga investitorët e huaj dhe në një farë mase edhe nga investimet vendase. Si rezultat i investimeve të kryera pas privatizimit, nga investitorët, numri i abonentëve të telefonisë celulare në fund të vitit 2011, arriti në 5,2 milion. Ky nivel i penetrimit të telefonisë celulare me 187% , është i ngjashëm me vendet e zhvilluara si Gjermania. Prezenca e kompanive të huaja ka bërë që të rritet konkurrenca në treg, duke ofruar shërbime cilësore më të mira, me kosto të ulët dhe të krahasueshme me rajonin.

Një klasifikim i ri në kategorinë e shërbimeve është kategoria "shërbime për përpunim të inputeve fizike të zotëruara nga të tjerët". Të ardhurat e kësaj kategorie shënojnë rreth 70 milionë euro, të cilat janë shërbime që rezidentët I kanë ofruar jorezidentëve gjatë përpunimit të mallrave të zotëruara nga jorezidentët

Industria e shërbimeve financiare ka bërë ndryshime rrënjësore në sajë të zhvillimit të IHD-ve. Hyrja e bankave të huaja si dhe privatizimi i bankave të vendit, ka ndikuar në konsolidimin e sistemit bankar. Në tërësi, bankat e huaja kane luajtur një rol pozitiv, lidhur me efiçiencën dhe stabilitetin e sistemit bankar në ekonomi. Ato kanë fuqizuar menaxhimin e riskut dhe qeverisjen e bankave nëpërmjet nje shpërndarje efiçiente të kapitalit si dhe kanë rritur konkurrencën, duke prezantuar shërbime bankare moderne dhe të sofistikuara. Megjithatë, veçoritë e përgjithshme pozitive që ofrohen nga standardet ndërkombëtare për sistemin bankar, nuk kënaqin akoma të gjitha nevojat e ekonomisë. SME-të kanë një akses të kufizuar në financim nga bankat dhe është e nevojshme që të përmirësohen skemat e

garantimit të kredive. Është e rëndësishme për tu theksuar se niveli i interesit që ju ofrohet SME-ve nga bankat, është akoma i lartë për tu përballuar. Gjithashtu nga bankat kërkohet kolateral, gjë që e bën kreditimin më të vështirë në përfitim të SME-ve.

Sektori i shërbimeve është kontribuesi më i madh i tatim-fitimit, i ndjekur me peshë të njëjtë nga Prodhimi dhe Transporti. Fitimet e kompanive pothuaj në të gjithë sektorët e ekonomisë kanë pësuar rënie për periudhën 12-mujore, duke e krahasuar me një vit më parë. Rënien më të madhe në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë e ka shënuar sektori i ndërtimit me -24.3 %, i pasuar nga sektori i prodhimit me -16.7 %, sektori i transportit me -13.9 % dhe sektori i tregtisë me -13.1 %. I vetmi sektor me rritje është sektori i Shërbimeve me +0.4 %.

Tregues të tjerë

Banka Botërore vlerëson në raportin e saj më të fundit se ekonomia shqiptare ka performuar pozitivisht, pavarësisht krizës ekonomike që po kalon Eurozona. Gjatë vitit 2014 ekonomia ka hyrë në një fazë rimëkëmbjeje, krahasuar me vitin e shkuar, në përputhje me parashikimet. Tregues të ndryshëm dëshmojnë për një performancë pozitive të ekonomisë gjatë vitit 2014. Rritja ekonomike e vitit ka qënë 2.1% dhe është e lidhur me investimet e huaja strategjike por edhe me rritjen e konsumit. Parashikimi i **rritjes reale vjetore të PBB** rikonfirmohet në 3.3% për vitin 2015, në përputhje me parashikimet më të fundit të BB. Në të kundërt me parashikimet për rritjen ekonomike të Europës të cilat janë rishikuar në ulje dhe sipas vlerësimit për vitin 2015 rritja ekonomike pritet të jetë 1.1 % nga 1.8 % që u vlerësua më parë.[51].

Në tremujorin e parë të 2014, ekonomia jonë përshpejtoi ritmin e saj të rritjes në 1.7% nga 1.4% që ishte vitin e kaluar. Ndërsa në tremujorin e dytë rezultoi një rritje të lehtë negative prej -0.6%, e cila i atribuohet në një masë të konsiderueshme asimetrisë (rritjes së ekzagjeruar) të shpenzimeve buxhetore në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Parashikimet e Bankës Botërore janë më pozitive në vitet në vazhdim, ku pritet që rritja ekonomike e Shqipërisë të shkojë në 4% në 2016 dhe 4.5% në 2017.

[51] Ndërsa rritja ekonomike botërore për 2015 parashikohet të shkoj në 3% dhe mesatarisht 3.3 për qind deri në 2017. Aktiviteti më i lartë ekonomik vlerësohet në Shtetet e Bashkuara dhe në Mbretërinë e Bashkuar, e ndikuar kjo prej rritjes së tregut të punës si dhe prej ndjekjes së politikave të favorshme fiskale. Por rimëkëmbja ka qenë dobët në Zonën Euro dhe Japoni si trashëgimitë e krizës së zgjatur financiare

Figura. 16: Ecuria e GDP-së për Shqipërinë 1996-2014



Burimi: FMN, llogaritjet e autorit

Rritja ekonomike është forcuar gjatë vitit 2014. Ndërkohë, treguesit e tjerë ekonomikë të disponueshëm deri më tani, tregojnë për një rigjallërim të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, e në veçanti, e ndjesisë së biznesit dhe konsumatorit. Këto kanë qënë një nga faktorët që ka ndikuar në gjallërimin e ekonomisë. Një mesazh tjetër është se kreditimi është gjallëruar veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit, megjithatë ka qënë ende i ulët.”Përmirësimi I ndjesisë ekonomike të agjentëve vlerësohet të ketë nxitur një kërkesë të brendshme më të lartë, e cila ka qenë ushqyesi kryesor i ekonomisë gjatë kësaj pjese të vitit, duke kompensuar edhe kontributin lehtësisht negativ të kërkesës së huaj neto.

Por pavarësisht treguesve pozitiv të rritjes ekonomike, shqetësim mbetet niveli i ulët i inflacionit, një problem ky që ka prekur në masë vendet e Eurozonës.Norma e **inflacionit,** e ndikuar edhe nga presionet e zbehta inflacioniste prej tregjeve të huaja, mbetet e ulët, poshtë kufirit të poshtëm prej 2% të targetuar nga Banka e Shqipërisë. Inflacioni i ulët në Shqipëri tregon se ecuria ekonomike nuk ka qenë në nivelin e duhur, duke sjellë çmime të ulëta dhe konsum të dobët.Ndërkohë monedha vendase ka qëndruar përgjithësisht e stabilizuar kundrejt valutave të huaja kryesore.

Indeksi i Tregtisë me Pakicë, i cili është një "tregues indirekt" për konsumin e mallrave, tregon një rigjallërim të konsumit. Gjatë vitit 2014 ky indeks në terma vlere shënoi një rritje

prej 7.6%.Vihen re shenja për një farë rigjallërimi edhe të **investimeve private** gjatë kësaj pjese të vitit. Kjo referuar ecurisë së importit të mallrave kapitale, makineri e pajisje dhe materiale ndërtimi, të cilat gjatë periudhës janar-gusht kanë patur një rritje respektivisht prej 8.3% dhe 9.3% krahasuar me një vit më parë.

Ndërkohë **investimet publike** kanë qenë ndjeshëm më të ulta se një vit më parë prej rreth 43% më pak, por stimuli i injektuar në ekonomi prej buxhetit është kompensuar ndjeshëm prej pagesave të detyrimeve të prapambetura. Deri në shtator të këtij viti janë paguar rreth 26 miliardë LEK detyrime të prapambetura të qeverisë ndaj biznesit, e cila ka ndikuar në përmirësimin e likuiditetit të sektorit privat në tërësi. Vlera e shpenzimeve kapitale dhe pagesave të detyrimeve të prapambetura të marra së bashku, që janë injektuar nga buxheti gjatë nëntë muajve të parë të 2014, rezulton rreth 5.6% më e lartë se vlera respektive e së njëjtës periudhë të një viti më parë. Megjithatë, në tërësinë e saj, kërkesa publike gjatë nëntë muajve të parë të vitit vlerësohet të ketë patur një efekt shtrëngues në rritjen ekonomike, e cila reflektohet prej përmirësimit me rreth 29 miliardë LEK të balancës primare. Balanca primare ka njohur një konsolidim të fortë gjatë këtij viti, e cila nga një deficit prej rreth 28.4 miliardë LEK gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2013, ka rezultuar me një tepricë prej rreth 1 miliard LEK gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2014.

Sinjale pozitive kanë ardhur edhe prej **tregut të punës,** i cili në tremujorin e dytë të vitit regjistroi një rënie të normës së papunësisë në nivelin prej 17.7% nga 18.6% që kulmoi një tremujor më parë dhe një rritje të punësimit total.

Treguesit financiar gjithashtu kanë pasur një ecuri pozitive gjatë gjysmës së parë të vitit. Këtu do të veçohej **kredia**. Pas një viti me kontraktim, në korrik të këtij viti, rritja relative në përqindje kundrejt korrikut të një viti më parë kaloi në terren pozitiv prej 0.5%, e cila u pasua nga një tjetër rritje pozitive prej 2.2% në gusht. Në të njëjtën kohë, kjo ecuri e kreditimit në ekonomi është në linjë me raportimin nga sistemi bankar sa i takon lehtësimeve të kushteve të kreditimit dhe rritjes së kërkesës për kredi. Sistemi bankar mbetet mjaft solid, likuid dhe fitimprurës. Megjithatë, një prej pengesave për ecurinë e kreditimit mbeten kreditë me probleme, të cilat vijojnë të mbeten në rreth 24% të totalit të stokut të kredive. Në këtë drejtim pritet të ketë një përmirësim gjatë vitit 2015 dhe në vijim, nisur nga ulja e financimit

të borxhit afatshkurtër nga tregu i brendshëm dhe nga politikat e reja për thjeshtëzimin e procedurave.

Situata **fiskale** ka patur një përmirësim të ndjeshëm gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2014. Të ardhurat janë realizuar në përputhje me planin, dhe ndjeshëm mbi të ardhurat faktike të së njëjtës periudhë të vitit të kaluar, me një rritje prej rreth 13.2% më shumë. Ndërkohë që, deficiti është ulur ndjeshëm me rreth 48% më pak, i ndihmuar edhe nga kursimet në zërat e ndryshëm të shpenzimeve, gjë që pritet të çojë në një reduktim të borxhit publik krahasuar me nivelin që ishte planifikuar në fillim të vitit 2014.

VLERËSIMI I HAPJES TREGTARE PËR SHQIPËRINË-----Modelimi ekonometrik

Ky kapitull mbledh dhe përpunon të gjitha të dhënat e nevojshme dhe, duke përdorur metoda të përshtatshme të vlerësimit, ofron gjetje thelbësore për ndikimin e hapjes së mëtejshme të Shqipërisë mbi tregtinë dhe politikën ekonomike, duke përfshirë edhe rritjen ekonomike. Gjetjet e fundit analizohen pastaj në kapitullin e ardhshëm për të siguruar implikimet politike dhe rekomandimet. Objektivi tjetër kryesor i këtij kapitulli është të përpunohet struktura e modelit dhe proçedurat e vlerësimit që kërkojnë shumë hapa për të marrë rezultatet e vlerësimit. Rruga e parë është përcaktimi i variablave të përfshira në model. Të dhënat duhet të merren nga burime të besueshme; prandaj, janë përdorur disa burime të të dhënave. Këto të dhëna duhet të transformohen në formën e duhur, përpara vlerësimit. Janë përdorur shumë statistika diagnostifikimi në proçesin e vlerësimit për të shpjeguar rezultatet.

Qëllimet e këtij kapitulli janë pikërisht diskutimi i implementimit empirik të modelit të hapjes së Shqipërisë, duke ofruar vlerësime të përshtatshme të parametrave të modelit, dhe duke interpretuar gjetjet. Ky kapitull analizon faktorët që ndikojnë në rritjen ekonomike të vendit tonë si pasojë e proçeseve liberalizuesë të ndërmarra në përputhje me marrëveshjet e tregtisë së lirë . Ky punim përdor një model të ekuacionit gravitacional për të matur elasticitetin e flukseve të importit të mallrave në Shqipëri, lidhur me disa nga faktorët e përmendur më sipër, si me zhvillimet në liberalizimin tregtar,si dhe hidhet dritë mbi politikat ekonomike për kufizimin e defiçiteve tregtare. Analiza ekonometrike e këtij studimi përfshin një grup variablash .

Duke u bazuar në parimet e mësipërme teorike dhe në përvojën studimore, analiza në këtë punim konsiston në trajtimin e tregtisë si funksion jo vetëm i të ardhurave të brendshme (aktiviteti ekonomik), por edhe si funksion të nivelit të liberalizimit të regjimit tregtar.

4.1 METODAT KRYESORE PËR MATJEN E IMPAKTIT MAKROEKONOMIK TË MTL-VE (të hapjes tregtare)

Modelet për vlerësimin e rritjes ekonomike që vjen nga liberalizimi tregtar do të klasifikohen në tre grupe të mëdha.

4.1.1 PEM (partial equilibrium model)

Modeli i Ekuilibrit të pjesshëm është një kusht i ekuilibrit ekonomik i cili merr në konsideratë vetëm një pjesë të tregut , **ceteris paribus** , për të arritur ekuilibrin .

Në analizën e ekuilibrit të pjesshëm efektet e politikave janë të ekzaminuara vetëm në tregjet që ndikohen drejtpërdrejt nga këto politika. Siç përcaktohet nga George Stigler(1971), "Një ekuilibër i pjesshëm është ai i cili është i bazuar vetëm në një gamë të kufizuar të të dhënave , një shembull standard është çmimi i një produkti të vetëm , çmimet e të gjitha produkteve të tjera mbahen të fiksuar gjatë analizës . "

Oferta dhe kërkesa përdoren për të përshkruar efektet e politikave të çmimeve.Teprica e prodhuesve dhe konsumatorëve përdoret për të matur efektet e mirëqënies në vendet pjesëmarrëse në këto tregje. Kjo analizë injoron efektet në industritë e tjera të ekonomisë së vendit ose presupozon që ky sektor është aq i vogël sa ka një impakt jodomethënës në sektorët e tjerë të ekonomisë . Sipas kësaj teorie vende të mëdha quhen ato vende volumi tregtar i të cilave është aq sinjifikativ sa ndryshimet në flukset tregtare të mund të ndikojnë dhe çmimin botëror të kësaj të mire. Ndërsa si vende të vogla do të konsiderohen ato që volumi i tyre tregtar nuk ka sinjifikancë të tillë.
Modeli i ofertës dhe kërkesës është një model i pjesshëm ekuilibër ku pastrimi në treg i disa mallrave të veçanta është marrë në mënyrë të pavarur nga çmimet dhe sasitë në tregjet e tjera. Me fjalë të tjera , çmimet e zëvendësuesve dhe plotësuesve ,si dhe nivelet e të ardhurave të konsumatorëve janë konstante . Kjo e bën analizën shumë më të thjeshtë se sa në një model ekuilibri të përgjithshëm i cili përfshin një ekonomi të tërë .

Analiza e ekuilibrit të pjesshëm merret vetëm me efektet e politikave që krijojnë ekuilibër vetëm në një sektor ose treg të veçantë i cili ndikohet drejtpërdrejt nga këto politika duke

injoruar efektet në tregjet e tjera. Për këtë kjo analizë konsiderohet e dobishme vetëm për tregje të vogla, prandaj dhe nuk është e përshtatshme për modelin e liberalizimit tregtar. Kjo është dhe një nga limitet e këtij modeli ku ndër të tjera mund të përmendim që i mungon aftësia për të studiuar ndërveprimet e gjithë pjesëve të ekonomisë, për më tepër ka rezultuar dhe i pasuksesshëm në shpjegimin e të ardhurave në ekonomi kur lëvizet nga një treg në tjetrin.

Karakteristika kryesore në një model te pjesshëm është që ska nevojë të konsiderojë ekuilibër në të gjitha tregjet me qëllim që të fokusohet në një ose disa tregje dhe sektorë. Kjo gjë e bën më të kapshëm dhe lejon detaje më analitike në modelimin e instrumentave politike. Në modelin më të thjesht të tij Armington (1969) supozon se produktet janë të diferencuar që në vendin e origjinës.

Avantazhi kryesor i këtij modeli është se është i thjeshtë në trajtueshmërinë e aplikimit të analizave matematikore. Kjo i jep studiuesit më shumë fleksibilitet në riaplikimin e llogaritjeve, dhe për shkak të thjeshtësisë i lejon atij të analizojë çështjet specifike më në thellësi, si ato të kompleksitetit të instrumentave të politikave të një vendi apo të sistemit të prodhimit. Pra ky model mund të pasurohet mjaft nga elementë shtesë ose të zëvendësohen me nocione si të mirat e ndërmjetme, strategjitë ose informacioni asimetrik.

Disavantazhet përmbajnë faktin se ky model është i kufizuar në një fushë të veçantë dhe nuk merr parasysh studimin e ekonomisë në tërësi.

Ai i mungon aftësia për të studiuar marrëdhëniet e të gjitha pjesëve të ekonomisë.

Kjo analizë do të dështonte nëse nuk do të merrej në konsideratë *supozimi i pamundur* që studimi të shkëpusë tregun e veçantë nga pjesa tjetër e ekonomisë. Për më tepër që nuk ka qenë i suksesshëm në shpjegimin e impaktit që kanë turbulencat ekonomike në tregje që çon në ndryshime të kërkesës dhe të ofertës, në momentin që lëvizet nga një treg në tjetrin.

4.1.2 CGEM (computable general equilibrium model)

Modelet e ekuilibërit të përgjithshëm të llogaritshëm (CGEM) janë një klasë e modeleve ekonomike që përdorin të dhënat aktuale ekonomike për të vlerësuar se si një ekonomi mund të reagojë ndaj ndryshimeve në politika , teknologji apo faktorë të tjerë të jashtëm.

Një model CGEM përfshin në analizë një bashkëveprim midis importit dhe eksportit dhe më pas konsideron efektet e politikave në shumë sektorë të ekonomisë (CGEM). Ky model përdor kurbat e ofertës për të gjetur ekuilibrin dhe mat mirëqënien me funksione agregate ose me kurba indiference. Përdorimi i një metodologjie të tillë përmirësohet herë pas here me një modifikim radikal: psh, kryerja e ekspertizës në një vend të vetëm në një ekuilibër të përgjithshëm lejon studime të mëtejshme në impaktin e shpërndarjes. Modelet CGE derivojnë nga modelet për planifikimin e ekonomive të vendeve më të varfra[52].

Modelet CGEM janë të dobishme sa herë që duam të vlerësojmë efektin e ndryshimeve në një pjesë të ekonomisë mbi pjesën tjetër. Për shembull, një taksë mbi miell mund të ndikojnë në çmimet e bukës, dhe kështu ndoshta pagat dhe punësimin. Janë përdorur gjerësisht dhe për të analizuar politikën tregtare.

Modelet CGEM gjithmonë përmbajnë më shumë variabla se ekuacionet-kështu disa variabla duhet të vendosen jashtë modelit. Këto variabla janë quajtur ekzogjene; Pjesa tjetër, që përcaktohet nga modeli, janë quajtur endogjen. Zgjedhja se cila variablat janë të ekzogjene mund të shkaktojë polemika. Për shembull, disa modelues mbajnë punësimin dhe bilancin tregtar në vlera fikse; të tjerët lejojnë që këto të ndryshojnë. Variablat e teknologjisë, shijet e konsumatorit, dhe instrumentet qeveritare (të tilla si normat e taksave) janë zakonisht ekzogjene.

Janë shumë të përdorshmëm në vitet e fundit për impaktin që ka liberalizimi i tregjeve ose për një marrëveshje potenciale të DOHA-s.Këto studime kanë nxjerrë një panoramë shumë kontradiktore të këtyre pasojave kështu që kredibiliteti i këtij modeli është vënë në pikëpyetje Këto modele shpesh trajtohen si ‘kutia e zezë” rezultatet e të cilave janë shumë të vështira për tu kuptuar

Përdorimi i modeleve CGEM për analizën e politikave është bërë e përhapur për një gamë të gjerë të aplikacioneve për të dy llojet e vendeve, atyre të zhvilluara dhe në zhvillim (de Melo, 1988). Një model i aplikuar CGEM duhet të ketë karakteristikat e mëposhtme thelbësore (Shoven, 1983):

- preferencat e konsumatorëve dhe funksionet e kërkesës për mallra,

[52] Vendi jonë është në zhvillim, por jo nga më të varfrat, prandaj nuk është zgjedhur si model për analizën ekonometrike në këë studim.

- teknologji të prodhimit në dispozicion për firmat,
- një set me një sërë kushtesh të ekuilibrit

Shumë modele CGEM janë krahasues-statike: ata modelojnë reagimet e ekonomisë në vetëm një pikë në kohë. Për analizën e politikave, rezultatet nga një model i tillë janë interpretuar shpesh se tregojnë reagimin e ekonomisë në një periudhë të ardhshme nga një ose disa goditje të jashtme apo ndryshime të politikave. Rezultatet tregojnë dallimin (raportuar zakonisht në formë qind ndryshim) në mes dy alternativave të ardhshme (me dhe pa goditjen e politikës). Në të kundërt, modele dinamike CGEM eksplicite gjurmojnë secilin variabël nëpër kohë, shpesh në intervale vjetore.

Këto modele janë më realiste, por më të vështirë për tu ndërtuar dhe për ty zgjidhur sepse ata kërkojnë, për shembull, që ndryshimet e ardhshme të parashikohen për të gjitha variablave ekzogjenë, jo për ato të prekur nga një ndryshim i mundshëm të politikës. Ky model ka një problem potencial në qëndrueshmëri sepse variablat që ndryshojnë nga një zgjidhje e ekuilibrit tek tjetri nuk janë domosdoshmërisht në përputhje me njëri-tjetrin gjatë periudhës së ndryshimit.

4.1.3 EGT (endogenous gravity theory)

Modeli i gravitetit fokusohet në përcaktuesit e flukseve tregtare bilaterale, dhe parashikon flukset tregtare bilaterale bazuar në madhësinë e vendeve[53] me një vëmendje të veçantë në faktorët e lokalizimit dhe implikimet e politikave gjeo-politike dhe gjeo-ekonomike. Modeli i gravitetit, i zhvilluar që në vitet 60' nga Tinbergen (1962) është rishfaqur këto vitet e fundit në debatin e multilaterismit kundrejt rajonalizimit[54].

Ky model konceptohet mbi parimin e ligjit të Njutonit, i cili pohon se forca e tërheqjes së dy masave është e lidhur pozitivisht me prodhimin e dy masave dhe negativisht me distancën në katror të tyre . Modeli i gravitetit i tregtisë ndërkombëtare konstaton se[55], tregtia midis dy

[53] Shpesh për të përfaqësuar madhësinë përdorën vlerat e PBB-së
[54] Dhe pikërisht ky rezultat del dhe në këtë studim, ku tregtia për vendin tonë është më frytdhënëse nëse kryhet me BE sesa me vendet e rajonit
[55] Bazuar në ligjin e gravitacionit universal të Njutonit

vendeve është propocionalisht[56] e lidhur me madhësinë e tyre ekonomike (PBB) dhe në përpjestim të zhdrejtë me distancën ndërmjet tyre ose me barrierat e tregtisë mes vendeve.

Forma tipike e modelit jepet si më poshtë:

$$F_{ij} = G(M_i^{\beta_1} M_j^{\beta_2} / D_{ij}^{\beta_3})$$

F ij interpretohen si flukset tregtare, *G* është një konstante, *M* është masa ekonomike e secilit vend i dhe j,dhe *D* është distanca midis vendeve që kryejnë tregti

Modeli është zgjeruar nga autorë të tjerë, të cilët kanë vlerësuar edhe praninë e variablave të tjerë në model, si ata me karakter ekonomik (PBB për frymë, popullsia) edhe ata joekonomikë (kufijtë e përbashkët, ngjashmëritë kulturore etj).

$$T_i^j = A * \frac{GDP\ it * GDP\ jt}{Dij}$$

Ku *T* përfaqëson flukset tregtare nga vendi *i* drejt vendit *j* midis vendeve, *A* është një konstante proporcionaliteti dhe *D* është distanca midis vendeve.

Ky model përfshin shumë variabla që zakonisht aplikohet mbi bazën e të dhënave panel (për disa vende njëkohësisht) dhe kryesisht aplikohet për të vlerësuar efektet e një liberalizimi tregtar mbi flukset tregtare si dhe potencialet tregtare të vendeve deri në përmirësimin e treguesve makroekonomikë apo më thjesht përdoret për të zbuluar statistikat krahasuese të të ardhurave si rezultat i tarifave doganore. Ka qenë një sukses empirik sepse parashikon me saktësi rrjedhat e tregtisë ndërmjet vendeve për shumë mallra dhe shërbime, por për një kohë të gjatë disa dijetarë besonin se nuk kishte asnjë justifikim teorik për ekuacionin e gravitetit [Deardorff, Alan (1998)]. Megjithatë, një marrëdhënie graviteti mund lindi në pothuajse çdo model të tregtisë që përfshin kostot tregtare që rriten me rritjen e distancës.

Ky model përdoret mjaft së fundi në marrëdhëniet ndërkombëtare për të vlerësuar impaktin e traktave apo aleancave në tregti, dhe më konkretisht është përdorur për të testuar efiçiencën e marrëveshjeve tregtare si Marrëveshja e tregtisë së lirë për vendet e Amerikës së veriut (NAFTA) dhe për OBT-në. Për shembull, Frankel (1994) përdori këtë model për të treguar se një marrëveshje tregtare preferenciale në vendet e APEC, ishte natyrshëm konsistente me "ligjin e gravitetit"(parë në një këndvështim ekonomik, siç supozohet edhe në këtë model).

[56] Meqënëse vendet supozohen që janë afërsisht të ngjashme në disponimin e faktorëve të prodhimit

Zakonisht, modelet gravitacionale janë vlerësuar përmes një transformimi linear në mënyrë që të shprehin marrëdhëniet në mes flukseve dhe të dhënave të regresit (GDP). Megjithatë, versione me më shumë variabla të EGT-së janë përdorur - për shembull, për të kuptuar më mirë përfitimet e marrëveshjeve të tregtisë së lirë dhe të zonave të tregtisë së lirë, duke përfshirë MERCOSUR dhe Komunitetin e Andeve (Carrillo dhe Li, 2002), NAFTA (Montenegro dhe Soloaga, 2004), zona e tregtisë të Ballkanit Perëndimor (World Bank, 2007), Zona Monetare të Afrikës Perëndimore (Balogun, 2008), rajoni i Evropës Lindore (Banka Botërore, 2005), dhe rajoni arab Maghreb (PIIE, 2008). Për më tepër, EGT ka ndihmuar për të vlerësuar përfitimet e masave të lehtësimit të tregtisë dhe për të vlerësuar potencialet e tregtisë (Benedictis dhe Vicarelli, 2005).

4.2 ARSYET E ZGJEDHJES SË MODELIT *EGT* PËR MODELIMIN EKONOMETRIK

Që nga futja e tij në fillim të viteve 1960, EGT është bërë një mjet i fuqishëm për të përshkruar tregtinë ndërkombëtare. Disa faktorë që shpjegojnë popullaritetin e qëndrueshëm të këtij modeli janë:

- Intuita e këtij modeli është e thjeshtë por me aftësi të larta shpjeguese;
- Pjesa më e madhe e provave empirike mbështesin qasjen themelore të EGT;
- Akademikë dhe studiues të shumtë (shiko Anderson, 1979; Bergstrand, 1985; Helpman, 1986;Deardoff, 1995) kanë zhvilluar themele të forta teorike që vërtetojnë vlefshmërinë e modelit
- dhe, së fundi, të dhënat për të bërë vlerësimet empirike me anë të EGT-së, të paktën në nivel vendi, janë në mënyrë tipike të besueshme meqënëse këto të dhëna kërkohen nga modeli për harqe të gjata kohore(disa vjet), duke bërë kështu që vlerësimet ekonometrike të jenë të qëndrueshme dhe të fuqishme.

Avantazhi i teorive gravitacionale është trajtueshmëria e tyre. Këto modele japin rezultate ekonometrike shumë pozitive, sidoqoftë shpjegon vetëm eksportet megjithë tentativën jo shumë bindëse të Wall (1999) i cili u përpoq të nxirrte kostot e mirëqënies që vinin nga rastet e proteksionit në tregti. Ai testoi ekonometrikisht një ekuacion jo mikroekonomik, përdori një indeks politikash tregtare me baza të dobëta dhe derivoji efektet në mirëqënie duke aplikuar një rregull proporcioni për efektin e tregtisë. Për ta përmbylluar mund të themi se këto

instrumente analitike janë thjesht plotësuese, jo globale. CGEM është mjaft i kuptueshëm dhe një mjet analitik konsistent për të vlerësuar pasojat e një liberalizimi tregtar: merr në konsideratë efektet e të ardhurave, ndërvarësinë mes tregjeve të produkteve dhe të faktorëve, aspektet diskriminuese të tregtisë ndërkombëtare etj.

Tabela 4 : Karakteristikat e modeleve për matjen e efektivitetit të politikave tregtare

Karakteristikat	Ekuilibri i pjesshëm-PEM	CGE	CGEM	Gravity model-EGT
Fleksibiliteti	***	**	*	**
Masat e realizmit	**/***	**	*	**
Llogaritja për ndërvarësi dhe efekte në të ardhurat reale	*	**	***	***
Instrumentat e politikave komplekse	***	**	*	***
Impakti botëror	*	*	***	**
Implikimet e politikave	***	*	*	***

Shënim: modelet janë vlerësuar me * (më pak I aplikueshëm deri ***(më shumë I aplikueshëm) në terma të aplikueshmërisë së çdo karakteristike të përmendur në tabelë.

Burimi: materiale të mbledhura të autorit

Megjithatë janë mjaft komplekse si modele dhe kërkues në termat e informacionit statistikor. Për më tepër që nuk e reflektojnë plotësisht kompleksitetin e ekonomive kombëtare, sepse modeluesi është i detyruar ta thjeshtësojë përfaqësimin teorik me llogari simultane për marrëdhëniet e tregtisë ndërkombëtare me zona të tjera gjeografike. Nga ana tjetër modeli i ekuilibrit të pjesshëm ofron më pak lidhje llogjike dhe nuk janë gjithëpërfshirës, por i japin modeluesit më shumë liri për të studiuar një aspekt specifik të liberalizimit tregtar. Ky model qartësisht mbulon një fushë të gjerë të çështjeve kërkimore me një metodologji fleksibël dhe të trajtueshme

Duke pasur parasysh përparësitë dhe kufizimet e modeleve të përmendura më sipër,në këtë punim është përdorur modeli i korrektimit të gabimit EGT. Ky model konsiderohet si më i përshtatshmi për analizimin e kërkesës për importe-eksporte dhe faktorëve që ndikojnë në të, për rastin e Shqipërisë. Kjo zgjedhje është bazuar në avantazhin kryesor të modelit, i cili

konsiston në aplikueshmërinë e tij për të shprehur marrëdhëniet midis flukseve tregtare dhe të dhënave të regresit (GDP). Në realitet ekzistojnë shumë versione me më shumë variabla të EGT-së të cilat janë përdorur, për të kuptuar më mirë përfitimet e marrëveshjeve të tregtisë së lirë dhe të zonave të tregtisë së lirë në rastin e shumë marrëveshjeve ndërkombëtare tregtare nëpër botë kryesisht për vendet në zhvillim.

Në vazhdim do të zhvillohet një model ekonometrik i cili do të ofrojë një kornizë teorike për të hetuar këto marrëdhënie. Në varësi të qëllimit të hulumtimit, edhe zgjedhja e llojit të modelimit është mjaft e dukshme.
Modeli i gravitetit(EGT) është i përshtatshëm nëse do të studiohen dhe vlerësohen pasojat e një marrëveshje tregtare shumëpalëshe në prodhim dhe të ardhurat kombëtare(duke përfshirë dhe tregtinë) . Nëse objektivi është ndikimi i liberalizimit tregtar mbi shpërndarjen e të ardhurave, rritjen ekonomike dhe mbi treguesit e varfërisë,atëherë i përshtatshëm është Modeli Gravitacional. Meqënëse objektivi është për të analizuar pasojat nga flukset e tregtisë në nivel kombëtar dhe botëror të një malli të caktuar që karakterizohet nga një larmi e madhe e sistemeve të prodhimit, një model i pjesshëm ekuilibër ose një model graviteti është i nevojshëm, dhe kështu me radhë. Çdo metodë ka avantazhe dhe të meta, dhe duhen mbajtur në mend këto specifika.

4.3 APLIKIMI NË MËNYRË TEORIKE TË MODELIT TË ZGJEDHUR EGT PËR ANALIZËN E SHQIPËRISË.

Ndikimi i hapjes dhe të tregtisë në rritjen ekonomike është dhe fokusi kryesor në shumicën e studimeve . Në anën tjetër, vetëm disa studime empirike kanë hetuar ndikimin e tregtisë, goditjeve të jashtme dhe reformave të politikave tregtare veçanërisht në vendin tonë[57]. Si rezultat,për të ngritur modele për të realizuar një analizë të politikave ekonomike dhe tregtare të përshtatshme , si dhe për të dhënë një kontribut për literaturën dhe politikave në këtë fushë,karakteristikat e dëshirueshme të këtyre modeleve bëhen konsiderata shumë të rëndësishme.
Në këtë model do të kombinohen variabla të përshtatshme dhe të shpjegueshme për politikat ekonomike dhe tregtare. Variablat e zgjedhur janë konsideruar si të përshtatshme sepse ato

[57] Në dijeninë time nuk është bërë ende një studim ekonometrik për Shqipërinë në lidhje me agregatët që analizohen në këtë studim

janë të rëndësishme për ekonominë në nivel makro dhe për tregtinë. Në rastin e një ekonomie të vogël të hapur si Shqipëria dhe vende të tjera në rajonin tonë, variablat si politikat e qeverisë ,ndryshimet në reformat e sistemit financiar, apo kriza ekonomike, duhet të merren në konsideratë, sepse këto variabla prekin tregtinë, rrjedhimisht dhe rritjen ekonomike.. Për më tepër, modelet janë ndërtuar duke përfshirë variablat më të mëdha në rëndësi dhe janë vlerësuar dhe testuar për të marrë modelin përfundimtar të preferuar. Një aspekt tjetër për tu fokusuar është dhe forma e përshtatshme e variablave, sepse lidhet drejtpërdrejt me rezultatet dhe interpretimin e tyre. Më e rëndësishmja, modelet e vendosura duhet të kenë qartësisht justifikim dhe mbështetje të shpjegueshme teorike, sidomos për Shqipërinë.

Modeli i përdorur do të zgjidhet pikërisht EGT (endogenous gravity theory). Ky model parashikon flukset tregtare bazuar në madhësinë e vendit (shpesh duke përdorur matjet e GDP së këtij vendi). Modeli i përdorur nga Tinbergen në 1962 ka formën marrëveshjeve tregtare

$$F_{ij} = G(M_i^{\beta_1} M_j^{\beta_2} / D_{ij}^{\beta_3})\eta_{ij}$$

ku F është fluksi tregtar, M-madhësia ekonomike e vendeve që kryejnë tregti dhe D- distanca midis tyre, ndërsa G është thjesht një konstante. Së fundi η ij përfaqëson termin e gabimit. Ky model është përdorur në marrëdhëniet ndërkombëtare për të vlerësuar impaktin e marrëveshjeve dhe aleancave të ndryshme në tregti, dhe është përdorur gjerësisht për të testuar efektivitetin e organizatave si Organizata Botërore e Tregtisë.

Përqasja tradicionale për të vlerësuar ekuacionin konsiston në transformimin logaritmik të të dyja anëve të ekuacoinit, duke e bërë në formën Log- Log[58]

$$\ln(F_{ij}) = \beta_0 + \beta_1 \ln(M_i) + \beta_2 \ln(M_j) - \beta_3 \ln(D_{ij}) + \epsilon_{ij.}$$

Kjo përqasje ka dhe problemin se nuk mund të perdoret nëse Fij është e barabartë me 0. Gjithashtu në një studim të Santos Silva dhe Tenreyro (2006) është theksuar se vlerësimi i ekuacionit në formën Log-log mund të kryhet me metodën OLS[59] me qëllim që të arrihen

[58] Konstantja G integrohet tek β_0

[59] Ols është përdorur në modelin ekonometrik të këtij studimi, i paraqitur në çështjet në vazhdim të këtij kapitulli

rezultate sinjifikative. Këta autorë e zgjerojnë më shumë modelin duke e sjellë në këtë formë vlerësimin e tij:

$$F_{ij} = \exp[\beta_0 + \beta_1 \ln(M_i) + \beta_2 \ln(M_j) - \beta_3 \ln(D_{ij})]\eta_{ij},$$

4.3.1 Sukseset e modelit

Modeli ka rezultuar një sukses në fushën empirike për faktin se parashikon me kujdes flukset tregtare midis vendeve për një numër të konsiderueshëm të mirash dhe shërbimesh. Në fakt ai vlerëson modelin e tregtisë ndërkombëtare ,për më tepër, modeli i gravitetit është përdorur për të testuar hipoteza të rrënjosura në teoritë ekonomike të tregtisë. Një teori e tillë parashikon se tregtia do të bazohet në faktorin më të bollshëm që disponon një vend sic përshkruhet dhe në modelin Heckscher-Ohlin. Pra më konkretisht vendet që disponojnë relativisht më shumë se një faktor prodhimi do të priren (më saktë do të specializohen) të prodhojnë ato mallra që kërkojnë një sasi relativisht të madhe të këtij faktori në prodhimin e tyre. Shumë ekonomistë në Shkollën e Çikagos asokohe besonin se modeli Heckscher-Ohlin ishte i mjaftueshëm për të përshkruar të gjithë tregtinë, ndërsa vetë Bertil Ohlin ka argumentuar se në të vërtetë bota është më e komplikuar. Studimet e këtyre modeleve në botën reale tregtare kanë prodhuar një numër rezultatesh që nuk përputhen me pritjet e teorive të avantazhit krahasues.

Veçanërisht një studim nga Wassily Leontief gjeti evidenca që një vend si Shtetet e Bashkuara të Amerikes i cili disponon faktorin kapital më shumë se cdo vend tjetër i botës, në fakt eksporton produkte të industrive që kërkojnë intensivisht faktorin punë. Panvarësisht hulumtimeve për të shpjeguar këtë fenomen nga studiues të tjerë, nuk u arrit të gjehet një lidhje midis evidencave dhe teorive ekonomike prandaj dhe ky problem në literaturën ekonomike njihet si “Paradoksi Leontief”.

Një teori alternative e propozuar nga Staffan Lindert, parashikon se modelet e tregtisë mund të përcaktohen nga preferencat e grumbulluara që kanë këto vende. Vendet me preferencat të ngjashme do të priren për të zhvilluar industri të ngjashme. Me kërkesën e vazhdueshme të ngjashme, këto vende do të vazhdojnë të tregtojnë me radhë mallra të diferencuara, por të ngjashme meqë të dy vendet kërkojnë dhe prodhojnë produkte të ngjashme. Për shembull, si Gjermania dhe Shtetet e Bashkuara janë vendet të industrializuara me një preferencë të lartë për automobila. Të dy vendet kanë industri të automobilave, dhe të dy vendet tregtojnë në

masë makina. Vlefshmëria empirike e hipotezës Lindert është disi e paqartë. Disa studime kanë gjetur një ndikim të rëndësishëm të efektit Lindert, por të tjerët kanë pasur rezultate më të dobëta.

Në fakt Lindert nuk paraqiti kurrë një model formal për teorinë e tij, kështu që studimet të ndryshme kanë testuar hipotezën e tij në mënyra të ndryshme.
Elhanani Helpman dhe Paul Krugman kanë pohuar se teoria e përparësive krahasuese nuk parashikon marrëdhëniet në modelin e gravitetit. Duke përdorur modelin e gravitetit, ka rezultuar se vendet që kanë tregtuar më shumë me njëri tjetrin janë ato vende me të ardhura të ngjashme. Helpman dhe Krugman e shohin këtë si dëshmi se këto vende tregtojnë mallra të diferencuara për shkak të ngjashmërive të tyre. Kjo hedh disa dyshime rreth ndikimit që ka teoria Heckscher-Ohlin në botën e vërtetë. Jeffrey Frankel e sheh këtë hipotezë larg propozimeve të Lindert. Megjithatë, ai thotë se Helpman-Krugman është i ndryshëm nga interpretimi i zakonshëm i teorisë së Lindert, por, meqënëse Lindert nuk realizoi dot një model të qartë,nuk duhet neglizhuar plotësisht lidhja midis këtyre dy grupe mendimesh. Alan Deardorff shton mundësinë, që, ndoshta jo drejtpërdrejt, modeli me bazë graviteti mund të rrjedhi nga Heckscher-Ohlin si dhe nga hipotezat e Lindert dhe Helpman-Krugman. Deardorff arrin në përfundimin se, duke marrë parasysh sa shumë modele mund të jenë të lidhur me ekuacionin e modelit të gravitetit, nuk është i dobishëm vlerësimi i vlefshmërisë empirike të teorive. James Anderson dhe Jeffrey Bergstrand për të tejkaluar teorinë ekonomike me testet empirike, zhvilluan modele ekonometrike, të bazuara në teoritë e mallrave të diferencuara, të cilat masin fitimet nga liberalizimi tregtar dhe përmasat e barrierave kufitare në tregti (shih McCallum Border Puzzle).
Për këtë qëllim disa ekonomistë kanë theksuar për mundësinë e tregtisë intra-industriale jo si rezultat i mallrave të diferencuara, por për shkak të " dumpingut reciprok." Në këto modele, vendet e përfshira kanë konkurrencë jo të plotë dhe tregje të segmentuara në mallrat homogjene, e cila çon në tregtinë brenda-industriale meqënëse firmat në konkurrencë joperfekte kërkojnë të zgjerojnë tregjet e tyre në vende të tjera dhe të tregtojnë mallra që nuk janë të diferencuara ende, për të cilat ata vetë nuk kanë një avantazh krahasues, pasi nuk kanë asnjë specializim. Ky model i tregtisë është në përputhje me modelin e gravitetit meqënëse parashikon se tregtia varet nga madhësia e vendit.

Modeli i dumpingut reciprok ka sugjeruar se specializimi dhe modelet e mallrave të diferencuara për ekuacionin e gravitetit nuk mund të shpjegojnë plotësisht ekuacionin e

gravitetit. Feenstra, Markusen, dhe Rose (2001) siguruan prova për dumpingun reciprok duke vlerësuar efektin e tregut të brendshëm në ekuacione të veçanta graviteti për mallrat e diferencuara dhe ato homogjene. Tregu vendas tregoi një lidhje në vlerësimin e gravitetit për mallrat e diferencuara, por tregoi lidhje inverse për mallra homogjene. Autorët tregojnë se ky rezultat përputhet me parashikimet teorike të dumpingut reciprok duke luajtur një rol në tregjet homogjene.

Hulumtimet e kaluara që kanë përdorur modelin e gravitetit kanë kërkuar gjithashtu të vlerësojnë ndikimin e variablave të ndryshme në përshtatje me ekuacionin bazë të gravitetit. Ndër këto, variabla si niveli i çmimeve dhe i kursit të këmbimit kanë treguar në modelin e gravitetit të kenë një marrëdhënie që nuk shpjegohet nga ekuacioni themelor i gravitetit. Sipas rezultateve empirike mbi nivelin e çmimeve, efekti i nivelit të çmimeve ndryshon sipas marrëdhënies që është duke u shqyrtuar. Për shembull, në qoftë se eksportet janë duke u shqyrtuar, një nivel çmimi relativisht i lartë nga ana e importuesit do të rrisë tregtinë me atë vend. Një sistem jo-stokastik i ekuacioneve janë përdorur nga Anderson dhe van Wincoop (2003), që të japin llogari për ndryshimin endogjen në këto terma të çmimeve nga adoptimi i liberalizimit tregtar.

4.3.2 Përmbledhje dhe përpunimi i të dhënave historike

Të dhënat relevante për vlerësimin e modelit përfshijnë: hapjen e Shqipërisë që definohet si tregtia totale ose volume tregtar(EX+IM) pjesëtuar me GDP(hapja ekonomike) dhe variabla të tjera të ngjashme, p.sh. IHD dhe tregtia në shërbimet pjesëtuar me GDP. Ata janë analizuar duke përdorur trendet dhe metodat e analizave grafike. Përveç kësaj,edhe dy variablat e tjera relevante makroekonomikë si PBB dhe marrëdhëniet tregtare me katër vendet apo blloqet partnere kryesorë tregtare janë analizuar me të njëjtat metoda. Këto metoda janë përdorur për të hetuar dhe shpjeguar modelet e rritjes, tregtisë, investimeve të huaja direkte dhe marrëdhëniet e tregtisë me partnerët dhe blloqet e mësipërme. Si pasojë, duhet të ndërmerren metoda sasiore për të shqyrtuar këto marrëdhënie në mënyrën më të saktë të mundshme.

Është e dobishme që para fillimit të procedurave të vlerësimit të bëhet një përshkrim për mbledhjen e të dhënave dhe përpunimin e kryer. Modeli është llogaritur duke përdorur të dhënat vjetore për periudha 1993-2014. Të dhënat mbi PBB dhe mbi variablat makroekonomike të tjera, duke përfshirë investimet e huaja direkte dhe shërbimet në Shqipëri

janë marrë nga të dhënat zyrtare dhe publikimet e ndryshme të Instat, Treguesit e Zhvillimit Botërore (Banka Botërore), Banka e Shqipërisë, IMF (FMN) etj. Edhe volumi tregtar i Shqipërisë me partnerët e saj tregtar është marrë po nga të njëjtat burime. Si volumi tregtar apo dhe të dhënat e tjera makroekonomike janë marrë në milion lekë përveç indeksit të korrupsionit, konkurrueshmërisë të cilat kanë vlerat e tyre nga 0-10[60] dhe ai i hapjes ekonomike me vlera në %. Ndërsa variablat Dummy të vitit të shfaqjes së krizës financiare[61] dhe viti i reformave të sistemit financiar[62] në Shqipëri janë përshkruar me 0-1[63].Këto dy variabla cilësohen si shock-e të jashtme të ekonomisë së Shqipërisë. Ai i reformës financiare merr vlerën 1 në vitin 2004 pas privatizimit të Bankës së Kursimeve, ndërsa ai i krizës financiare merr vlerën 1 pas vitit 2008 (vit ky dhe i shfaqjes së krizës)

Të gjitha variablat janë transformuar në formën e normave të ndryshimit (%) ashtu siç kërkohet nga qasja me modelin EGT (shih Tran Van Hoa, 2004a, 2004b dhe 2008).

4.3.3 Metodat e vlerësimit të modelit

Metodat e vlerësimit kanë një rëndësi të madhe sepse mund të çojnë në rezultate të ndryshme dhe efiçienca e tyre duhet të jetë objektivisht statistikisht e pranueshme. Metoda OLS është përdorur për të llogaritur parametrat e modelit për të marrë rezultatet më të përshtatshme dhe të besueshme. Është e nevojshme për të përcaktuar variablat instrument për të ndërmarrë proçeset e vlerësimit. Këto variabla instrument përbëhen nga GDP , shërbimet si sektori me peshë më të madhe në volumin tregtar, investimet e huaja direkte, indekset dhe tronditjet.Variablat endogjen janë norma e rritjes së PBB-së reale dhe të tregtisë totale[64] me partnerët pjesëtuar me GDP. Ndërsa variablat instrument janë variablat ekzogjenë të modelit.

Ekuacioni i formuar në studim është një ekuacion i reduktuar në formë, ai mund të vlerësohet nga OLS për të prodhuar gjetje të besueshme. Si një ekuacion strukturor , ka nevojë që të vlerësohet nga OLS. Përdorimi i OLS për këtë ekuacion do ta trajtojë atë ekuacion si një rritje konvencionale ku tregtia, investimet e huaja direkte dhe shërbimet janë ekzogjene. Kjo do të prodhojë parametra të njëanshëm dhe jokonsistente ose jo të besueshme.Diskutimi i

[60] Shifra 0 përfaqëson nivele të ulëta korrupsioni/konkurrueshmërie ndërsa 10 shpreh nivele të larta
[61] Nga studime të ndryshme vendet partnere që kryejnë tregti me Shqipërinë kanë prekur krizën financiare në vitet e shfaqjes së saj në USA pikërisht në gjysmën e dytë të 2008 dhe në 2009
[62] Është përllogaritur viti i privatizimit të bankës së kursimeve 2004
[63] Shifra 0 përfaqëson momentin para shfaqjes së krizës dhe shifra 1 pas shfaqjes së krizës
[64] hapja ekonomike që llogaritet si volum tregtar pjesëtuar me GDP

performancës relative nga ex post dhe ex ante bëhet përmes parashikimit gabim katror (mse) dhe është i përjashtuar nga studimi.Testi ADF është përdorur edhe në hulumtimin tonë si sfond për të testuar nivelin stacionar t ekuacion të gjitha variablave për të shmangur problemet themelore ekonometrike.

Testet standarde diagnostikuese, janë përdorur për të interpretuar rëndësinë dhe efikasitetin e rezultateve të vlerësimit. Shenja dhe shuma e parametrave përcakton marrëdhënien dhe ndikimin në mes të variablave të pavarur dhe të varur.

Hipoteza se hapja ka ndikim pozitiv në rritjen ekonomike , dhe variablat e pavarur dhe ekzogjene dhe kanë ndikim të ndryshme mbi tregtinë dhe rritjen , është e pritshme dhe e shqyrtuar. Proçedurat e vlerësimit janë ndërmarrë duke përdorur programin software

E-Views 7.

4.4 DERIVIMI TEORIK I MODELIT EKONOMETRIK

Është e ditur që nga puna e Jan Tinbergen (1962) se madhësia e tregtisë dypalëshe (Flukset) ndërmjet çdo dy vendeve mund të studiohet me një ligj të quajtur" ekuacioni i gravitetit "në analogji me teorinë Njutoniane të gravitetit. Ashtu siç planetet tërhiqen reciprokisht në proporcion të madhësive të tyre dhe afërsisë , edhe vendet e zgjedhin të bëjnë më shumë tregti në proporcion me GDP-në e tyre përkatëse. Fillimisht ekuacioni i gravitetit ishte menduar thjesht si një përfaqësim i një marrëdhënie empirikisht të qëndrueshme ndërmjet madhësisë së ekonomive , distancës së tyre dhe sasisë së tregtisë së tyre .Modele të shquar të tregtisë ndërkombëtare në atë kohë përfshinin modelin e Rikardos , i cili mbështetet mbi ndryshimet në teknologji në të gjithë vendet që të shpjegojnë modelet e tregtisë , dhe modelin e Heckscher - Ohlin si një udhëzues praktik për analizën e politikave të tregtisë. Modeli Heckscher-Ohlin mbështetet në ndryshimet e zotërimit të aktorëve midis vendeve si bazë për zhvillimin e tregtisë midis tyre.Më pas studiues të shumtë arritën në konkluzionin se modelet standarde të Rikardos dhe H-O ishin të paaftë për të siguruar një themel për modelin e gravitetit. Në modelin H-O, për shembull, madhësia e vendit ka pak rëndësi për strukturën e flukseve të tregtisë.

Stabiliteti i jashtëzakonshëm i ekuacionit të gravitetit dhe fuqia e tij për të shpjeguar rrjedhat e ndërsjellta të tregtisë nxiti kërkimin për një shpjegim teorik për të. Nga analizat empirike, ne e dimë tani se shumica e modeleve të tregtisë kërkojnë gravitetin në mënyrë që të funksionojnë. Përpjekja e parë e rëndësishmepër të siguruar një bazë teorike për modelet e gravitetit ishte puna e Anderson (1979). Ai e bëri këtë në kontekstin e një modeli ku mallrat u diferencuan sipas vendit të origjinës (i ashtuquajturi Supozimi Armington) dhe aty ku konsumatorët kanë preferenca të përcaktuara mbi të gjitha produktet e diferencuara.Kjo strukturë do të nënkuptonte se, me çfarëdo çmimi, një vend do të konsumojë të paktën disa prej çdo të mire nga çdo vend.

Të gjitha mallrat janë të tregtuar, të gjitha vendet tregtojnë dhe, në ekuilibër, të ardhurat kombëtare llogariten si shuma e kërkesës së huaj me atë vendase për të mirën unike që prodhon secili vend. Për këtë arsye, vendet më të mëdha importojnë dhe eksportojnë më shumë. Detajimet e mëvonshme kanë treguar se, nga modelet e gravitetit mund të lindin një numër i madh teorish, panvarësisht kritikës së hershme kundër këtij modeli që e konsideron thjesht një mjet ekonometrik pa një bazë teorike .

Bergstrand (1985 dhe 1989) tregon se një model graviteti është një implikim i drejtpërdrejtë i një modeli të tregtisë të bazuar në konkurrencë monopolistike të zhvilluar nga Paul Krugman (1980). Në këtë model, vendet identike tregtojnë mallra të diferencuara sepse konsumatorët kanë një preferencë për shumëllojshmëri. Modelet me konkurrencë monopolistike e kapërcejnë atë karakteristikë të padëshirueshme të modeleve Armington ku mallrat janë të diferencuara nga vendndodhja ose nga supozimi i prodhimit. Deardorff (1998) tregon se një model graviteti mund të lindi nga një shpjegim tradicional i tregtisë mbi porporcionalitetin e faktorëve të prodhimit. Eaton dhe Kortum (2002) arritën të nxjerrin një lloj ekuacioni graviteti nga një lloj modeli të Rikardos, dhe Helpman et al. (2008) dhe Chaney(2008) nxorrën nga teoria e gravitetit një model teorik të tregtisë ndërkombëtare në mallra të diferencuara me heterogjenitet të firmave.

Në një formulim shumë të përgjithshëm, ekuacioni i gravitetit ka formën e mëposhtme:

$$F_{ij} = G(M_i^{\beta_1} M_j^{\beta_2} / D_{ij}^{\beta_3})\eta_{ij}$$

F ij interpretohen si flukset tregtare, G është një konstante, M është masa ekonomike e secilit vend i dhe j,dhe D është distanca midis vendeve që kryejnë tregti.

Në punime të tjera aplikative, modeli shpesh paraqitet më i zgjeruar duke përfshirë variabla, si regjimet tarifore, regjimet të kursit të këmbimit etj.

Sipas Natalja von Westernhagen në librin e saj[65] sqarohet mjaft mirë ndër të tjera dhe se si ka evoluar një model graviteti i përshtatur me modelet e rritjes ekonomike. Sipas saj janë bërë mjaft zgjerime në këtë model edhe nga autorë të tjerë duke i shpjeguar variablat e reja në përputhje me teorinë e rritjes , si më poshtë:

Ekuacioni i gravitetit presupozon se sasia e tregtisë bilaterale midis dy vendeve do të varet nga "madhësia" e vendeve dhe "distanca" midis tyre. Rritja ekonomike ose "madhësia" thekson rolin e GDP[66]-së të të dyja vendeve në shpjegimin e vlerës së tregtisë. Në disa raste të ardhurat dhe popullsia nuk përdoren njëkohësisht në këto modele."Distanca" përfshin si faktorët shtrëngues ashtu edhe ato stimulues."Distanca" shpjegon flukset tregtare duke përdorur faktorë si distanca gjeografike që prek kostot e transportit, kufirin e përbashkët,politikat tregtare[67] që kanë të bëjnë me pjesmarrjen e vendeve në MTL dhe ngjashmëria kulturore(nëse vendet partnere në tregti përdorin gjuhë të përbashkët).Në faktorët stimulues të distancës mund të përmendim pjesëmarrjen në marrëveshje të përbashkëta të integrimit rajonal, lidhjet historike dhe sisteme të ngjashme ligjore.Sipas saj shumë studime ekzistojnë për tregtinë mes vendeve të Europës Juglindore me BE*në të cilat shfaqin qartë se janë partnerë natyralë në tregti. Wang/Winter 1992 gjeti se potencialet e tregtisë midis tyre janë shumë më të larta[68] sesa kryhet tregti deri tani.

Një studim i mëparshëm për Shqipërinë është ai i autorit Alban Pllaha[69]. Analiza e këtij materiali bazohet në një model më të thjeshtuar të gravitetit, të propozuar nga Kaminski dhe de la Rocha (2003), dhe Frankel, Stein dhe Wei (1997)11, për të matur flukset tregtare potenciale ndërmjet Shqipërisë dhe partnerëve të saj kryesorë. Ekuacioni përdor vlera standarde të koeficientëvesi më poshtë:

log Tij = 0.7 log (PBBi * PBBj) + 0.3 log (PBBPFi * PBBPFj) – 0.7 log (Distanca ij).

[65] Systemic Transformation, Trade and Economic Growth: Developments –fq 147

[66] Prandaj në model roli i tregtisë në rritje ekonomike që përfaqësohet nga GDP

[67] Në model është përfshirë variabli ***p*** pikërisht në përputhje me zgjerimet e modelit në përfshirje variablash sic sugjeron dhe literatura

[68] Kjo konfirmon dhe rezultatet e modelit të cilat nxjerrin se potencialet me BE-në për vendin tonë janë edhe më të mëdha për këtë sugjerohet dhe të intensifikohet tregtia me këto vende

[69] "tregtia aktuale dhe ajo potenciale ndërmjet shqipërisë dhe partnerëve të saj kryesorë":--alban pllaha, departamenti i kërkimeve, Banka e Shqipërisë, 2011

Me anë të ekuacionit të mësipërm llogariten sesa do të ishin flukset tregtare potenciale dhe më pas këto rezultate krahasohen me vlerat aktuale të tregtisë për secilin nga vendet. Gjetjet e modelit të gravitetit për tregtinë sugjerojnë se flukset e shkëmbimeve tregtare me Italinë dhe Greqinë janë pranë niveleve të tyre optimale. Vërehet ekzistenca e potencialit për intensifikimin e shkëmbimeve tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe Gjermanisë me të paktën 80% më shumë se nivelet aktuale. Flukset tregtare reale ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të rajonit janë shumë më poshtë niveleve potenciale. Projeksionet e të dhënave të modelit sugjerojnëse Shqipëria mund të intensifikojë flukset tregtare me secilin nga vendet e rajonit (Bosnje – Hercegovinën, Kroacinë, Maqedoninë dhe Serbinë) me të paktën 90% më shumë se flukset ekzistuese.

Në rastin tonë janë shtuar elementë të tjerë si hapja tregtare nën kuadrin e regjimeve tarifore duke e sjellë këtë ekuacion në një formë më të përshtatshme për studimin. Përgjithësisht modeli i vlerësuar EGT konsiston në dy funksione:

1. Funksioni i parë i paraqitur në formën më të thjesht matematikore për lidhjen e studiuar Tregti-Rritje, paraqitet:

$$g = f(t, ks) \qquad (1)$$

Ku g përkufizon të ardhurat e një ekonomie (PBB), t është volumi tregtar dhe ks janë krizat e ndryshme apo shoket (tronditjet) dhe reformat në politika (tregtare në rastin tonë) në një ekonomi. Bazuar në këtë ekuacion lidhja midis hapjes tregtare dhe rritjes ekonomike është analizuar përmes variablit t sipas teorisë tradicionale të tregtisë. Pra më specifikisht presupozohet se në rast se vendi liberalizon tregtinë duke avancuar në hapjen tregtare me reduktim tarifash, i jepet një mundësi e mirë vendeve të specializohen në prodhimin e mallrave me avantazh krahasues duke kontribuar dhe në rritje të konkurrencës dhe më tej të aftësisë konkurruese të vendit që e cila do të rezultojë në rritje ekonomike (Appleyard and Field, 1998, f.38).

Funksioni i dytë për përcaktimin e tregtisë mund të shkruhet matematikisht në këtë formë:

$$t = f(g, p, tr, z, ks) \qquad (2)$$

Ku ***t*** përkufizon eksportet plus importet. ***p*** përmban variablat e tjera ekonomikë si politikat e ndryshme dhe ***z*** si një variabël jo ekonomik. Në këtë studim ekuacioni i tregtisë në rastin e Shqipërisë është zgjeruar duke përfshirë variabla të tjerë që kanë impakt mbi tregtinë dhe

rritjen (**tr).** Më specifikisht këto variabla janë IHD dhe tregtia në shërbime. Këto variabla ekonomikë dhe jo ekonomikë lidhen me zhvillimin dhe rritjen e vendit tonë (shih justifikimin e ekuacionit tek Johansen, 1982; Frankel and Romer, 1999; Otto et al., 2002).

Modeli i mësipërm me dy ekuacione supozon në mënyrë thelbësore se tregtia (t) shumëpalëshe, rajonale dhe bilateral me partnerët e saj jep pasoja të drejtpërdrejta në PBB (g) e vendit. Sidoqoftë nuk mund të lëmë pa përmendur dhe se kjo tregti (t) influencohet dhe nga PBB e Shqipërisë, PBB e partnerëve të saj dhe nga aktivitete të tjera të lidhura me tregtinë (Cope and Helpman, 1993), gjithashtu dhe nga tronditjet e jashtme (ks)[70] dhe reformat politike (p)[71] me partnerët e saj (Tran Van Hoa, 2004a, 2004b).

Për këtë, këto variabla priten të jenë domethënës dhe duhet të përfshihen në modelin që do të vlerësohet dhe testohet. Modelet në këtë formë nuk janë të vlerësueshëm prandaj do të rishkruhen matematikisht dhe stokastikisht[72](me terma gabimi ε_1 dhe ε_2) për implementimin empirik si më poshtë:

$$\Delta g= \alpha_1+ \alpha_2 \Delta t + \alpha_3 \Delta ks + \varepsilon_1 \quad (3)$$

$$\Delta t= \alpha_1+ \alpha_2 \Delta g + \alpha_3 \Delta p + \alpha_4 \Delta z + \alpha_3 \Delta ks + \varepsilon_2 \quad (4)$$

Siç shihet (3) dhe (4) janë respektivisht ekuacionet e rritjes dhe tregtisë, të cilat janë lineare dhe të ndërvarura. Në këto ekuacione janë përfshirë dhe rastësitë të paraqitura në lidhje indirekte. Për të vlerësuar dhe implementuar ekuacionet (3) dhe (4) të modelit pra për të analizuar lidhjen midis tregtisë dhe rritjes ekonomike midis Shqipërisë dhe partnerëve të selektuar në këtë studim, do të përfshijmë dhe dy elementë të tjerë që janë përcaktues në rritjen ekonomike si IHD dhe Shërbime (shih Johansen, 1982; Frankel and Rose, dhe Rose, 2000).

$$\Delta g= \alpha_1+ \alpha_2 \Delta t + \alpha_3 \Delta ihd + \alpha_4 \Delta sh + \alpha_3 \Delta ks + \varepsilon_1 \quad (5)$$

Modeli endogjen i gravitetit [73] është përdorur për të analizuar impaktin që ka liberalizimi tregtar [74] me partnerët e përzgjedhur në rritjen ekonomike të Shqipërisë e cila mund të

[70] Këtu është përfshirë kriza ekonomike financiare që përfshiu botën (si variable dummy)
[71] Në rastin tonë është përfshirë privatizimi i sistemit financiar (si variable dummy)
[72] Stokastike do të thotë vlerësim me marzh gabimi
[73] që është modeli EGT me karakteristikat e veçanta strukturore dhe të zhvillimit të Shqipërisë
[74] Në këtë studim është cilësuar si hapja ekonomike

shprehet në mënyrë më të detajuar për implementim empirik në ekuacionin (5) (shih Johansen, 1982; Coe and Helpman, 1993;Frankel and Romer, 1993;Otto et al., 2002)

$$\Delta t = \alpha_1 + \alpha_2 \Delta g + \alpha_3 \Delta p + \alpha_4 \Delta \text{ind konk} + \alpha_5 \Delta \text{ind korrups} + \alpha_7 \Delta \text{ks eu}_{2008} + \alpha_8 \Delta \text{ks cefta}_{2009} + \varepsilon_2 \quad (6)$$

Nga ky ekuacion mund të thuhet se tregtia e Shqipërisë (me vendet me të cilat ka kryer MTL të ndryshme shumëpalëshe, rajonale) kombinuar me tronditje të jashtme, IHD/GDP (ihd) ,tregtia në shërbime/GDP (sh), presupozohet se gjitha këto do të shkaktojnë ndryshime në rritjen ekonomike të Shqipërisë. Sidoqoftë kjo tregti influencohet gjithashtu dhe nga GDP e partnerëve të saj dhe nga aktivitete të tjera që lidhen me tregtinë (Cope and Helpman, 1993) ose dhe nga reformat politike që ka kryer vendi. Si rezultat mund të përfshihet në mënyrë më specifike në ekuacionin (5) tregtia me vendet partnere si Greqia (t_{gr}), Italia (t_{it}) , Vendet e rajonit (t_{cefta}), dhe së fundi vendet e Bashkimit Europian (t_{eu}). Edhe këto variabla janë të llogaritura si volum tregtar/GDP. Disa variabla në model përveç atyre Dummy (që janë të cilësuara nga 0-1, respektivisht para-pas krizës) janë të shprehura në masë % dhe dy variablat e tjerë si indeksi i konkurrueshmërisë dhe i korrupsionit janë në bazë të koeficientëve. Paraqitja e zgjeruar e ekuacionit (5) me variablat e mësipërm është si më poshtë

$$\Delta g = \alpha_1 + \alpha_2 \Delta t_{gr} + \alpha_3 \Delta t_{it} + \alpha_4 \Delta t_{cefta} + \alpha_5 \Delta t_{eu} + \alpha_6 \Delta \text{ihd} + \alpha_7 \Delta \text{sh} + \alpha_8 \Delta \text{ks eu}_{2008} + \alpha_9 \Delta \text{ks cefta}_{2009} + \varepsilon_1 \quad (7)$$

$$\Delta t = \alpha_1 + \alpha_2 \Delta g + \alpha_3 \Delta rf_{2004} + + \alpha_4 \Delta \text{ind konk} + \alpha_5 \Delta \text{ind korr} + \alpha_6 \Delta \text{ks eu}_{2008} + \alpha_7 \Delta \text{ks cefta}_{2009} + \varepsilon_2 \quad (8)$$

Ndërsa në formën e reduktuar të ekuacionit (6) mund të implikohen edhe faktorët ekzogjenë që ndikojnë në rezultatet e volumit tregtar të vendit tonë si reforma e sistemit financiar [75] (rf_{2004}) si variabël Dummy, indeksi i korrupsionit (ind korr) , indeksi e aftësisë konkurruese të ekonomisë shqiptare (ind konk) dhe si shumë relevante edhe faktorin ekzogjene të shfaqjës së krizës financiarë(si variabël Dummy) respektivisht për BE në 2008(ks eu $_{2008}$) dhe në vendet e rajonit në 2009 (ks cefta_{2009}) . Këto të fundit përveç se në termat e tregtisë, ndikojnë mjaft edhe drejtpërdrejt në rritjen ekonomike për këtë janë përfshirë edhe në ekuacionin (7).

[75] Është marrë viti 2004 që korrespondon me privatizimin e Bankës së Kursimeve

Pra faktori i gravitetit (***ks)*** (shih Frankel and Romer 1999) dhe ai (***p)*** (shih Johansen 1982) janë cilësuar si të dhëna cilësore të serive kohore të cilat paraqesin kriza - tronditjet e jashtme dhe reformat në politikat e vendit (reforma e sistemit financiar) që tregojnë efektin e tyre të përkohshëm dhe permanent në tregti dhe rritje. Të gjithë këto variabla janë përfshirë në këtë model për të na sjellë në mënyrë empirike një model të kujdesshëmm, të pranueshëm dhe të besueshëm për tiu përgjigjur objektivave sasiore empirike të studimit.

Kontributi i hulumtimeve të kohëve të fundit në lidhje me themelet teorike të ekuacionit të gravitetit është rëndësia e nxjerrjes nga teoritë ekonomike , specifikime dhe variabla të përdorur në modelin e gravitetit në mënyrë që të nxirren edhe konkluzionet e duhura nga vlerësimet që kanë dalë nga përdorimi i ekuacionit të gravitetit. Veçanërisht i rëndësishëm ka qenë në këtë drejtim kontributi i Anderson dhe punimi i Van Wincoop's (2003), ku ata tregojnë se një model i mirë-përcaktuar graviteti është vendimtar për kontrollin e shpenzimeve relative tregtare .

Rezultatet e tyre teorike tregojnë se tregtia dypalëshe varet nga shpenzimet relative të tregtisë, psh prirja e vendit j për të importuar nga vendi i përcaktohet nga kostoja e tregtisë të vendit j drejt atij i. Arsyeja për përfshirjen e termave të mësipërm, që siç quhen, ceteris paribus, dy vendet e rrethuar nga ekonomitë e tjera të mëdha tregtare, si të thuash Belgjikë dhe Holandë që kufizohen nga Franca dhe Gjermania, respektivisht, si dhe nga njëri-tjetri, do të tregtojnë më pak mes tyre se sa në qoftë se ata do të ishin të rrethuar nga oqeane (të tilla si Australia dhe Zelanda e Re) ose nga hapësira të gjera si shkretëtirat dhe malet (të tilla si të Republika e Kirgistanit dhe Kazakistani).

Pra, për rastin e Shqipërisë, bazuar në modelin e mësipërm teorik, por edhe në literaturën përkatëse që shpjegon impaktin e proçesit të liberalizimit tregtar në vendet në zhvillim dhe sidomos në vendet e rajonit , si faktorë të rëndësishëm shpjegues të rritjes ekonomike, u konsideruan indeksi i hapjes tregtare, volumi tregtar me vendet partnere të marrëveshjeve të ndryshme tregtare,investimet e huaja direkte, sektori i shërbimeve në tregti, tronditjet e jashtme(që në rastin tonë janë marrë, kriza ekonomike dhe reforma e sistemit financiar) apo dhe tregues të tjere si indeksi i korrupsionit dhe i konkurrueshmërisë. Vlerësimi i ndikimit të këtyre faktorëve është bërë duke përdorur modelin e gravitetit (EGT).

Në studimin e sjelljes së rritjes ekonomike, fillimisht analiza nisi nëpërmjet specifikimit të hipotezave teorike dhe shprehjes analitike, e cila përshkruan këtë marrëdhënie teorike.

4.5 ANALIZA E REZULTATEVE EMPIRIKE

4.5.1 Burimi i të dhënave

Për të vlerësuar me anë të modelit të gravitetit nevojiten të dhënat mbi tregtinë bilaterale, mbi GDP-në dhe mbi faktorë të tjerë që konsiderohen përcaktues të tregtisë bilaterale.[76]

Seritë kohore që mund të përfshihen në këto të dhëna mund të jenë popullsia, GDP reale për fryme, normat e rritjes ekonomike, normat e këmbimit, zëra në buxhetin e shtetit si konsumi,

4.5.2 Ndërtimi i bazës së të dhënave

Vlerësimi me anë të ekuacionit të gravitetit kërkon një organizim të mirë të të dhënave për arsye se të dhënat duhet të përfshijnë një database të gjerë pra përfshirja e disa variablave në një hark të madh kohor. Për këtë arsye dhe numri i viteve në studim në këtë punim është konsideruar një hark kohor prej 21 vitesh. Kjo sjell një avantazh të rëndësishëm sepse e bën vlerësimin të saktë dhe stabël por ka dhe një disavantazh apo pengesë se mostrat e mëdha janë të vështira për të punuar me to dhe kërkojnë përdorimin e një fuqie informatike. Nqs interesi për hulumtim konsiston në faktorët që influencojnë një lidhje të caktuar të tregtisë me këto faktorë dhe efekti që do matet me modelin e gravitetit duhet të përfshijë të gjithë vendet që marrin pjesë në tregtinë me këtë vend. Ekuacionet e gravitetit kërkojnë që të dhënat të jenë panel data.

4.6 METODOLOGJIA

4.6.1 Operacionalizimi i koncepteve në variabla

Skema e operacionalizimit konsiderohet si hallka më e rëndësishme në procesin e kërkimit, lidhur me përkufizimin e një koncepti dhe matjen e tij përmes një variabli, si dhe lidhjen e koncepteve me njëri-tjetrin. Ajo nënkupton kalimin e koncepteve nga bota e teorisë nëvariabla të botës së vëzhgimit, ose të botës së observimit. Po ashtu, ajo ilustron edhe konceptet shkak dhe pasojë të fenomenit në studim.

[76] Të dhëna të tilla gjenden lehtësisht në publikimet e IMF, World Bank etj

Referuar problematikës së kësaj doktorate, konceptet burojnë nga teoria dhe logjika, duke analizuar lidhjen mes tyre në mënyrë abstrakte. Kështu, si teoria, ashtu edhe logjika na sugjeron që rritja ekonomike e Shqipërisë shpjegohet nga hapja ekonomike e vendit me partnerët tregtar, nga kontributi që jep sektori i shërbimeve në ekonomi, nga investimet e huaja direkte në vend si dhe nga disa faktor të tjerë, si për shembull, prezenca e krizës ekonomike, privatizimi i sektorit financiar, aftësia konkurruese si dhe shkalla e korrupsionit. Për më shumë po sqarojmë në vijim:

- *Rritja ekonomike* shqiptare është koncepti pasojë për fenomenin në studim dhe matet përmes variablit të normës së rritjes ekonomike për Shqipërinë. Natyra e kësaj të dhëne është përqindje dhe është simbolizuar me *g*.
- Faktorët shkaktar, ose faktorët e pavarur janë:
    - *hapja e ekonomisë* së[77] Shqipërisë me vendet partnere në tregti. Ky koncept matet si pjesa e hapjes ekonomike në GDP, për çdo partner tregtar të Shqipërisë. Natyra e të dhënës është përqindje dhe llogaritet si raport i shumës së importit dhe eksportin me GDP-në. Duke reflektuar nga natyra e marrëdhënieve tregtare të Shqipërisë me vendet e tjera, gjykohet si mëse e arsyeshme të evidentohen disa partnerë tregtar, të cilët pritet të përcjellin efekte të ndryshme në rritjen ekonomike të Shqipërisë. Konsideruar sa më lartë, në këtë punim janë marrë në konsideratë katër partnerë tregtar:
        1) Greqia, për nga mënyra e marrëdhënieve të ngushta me Shqipërinë sa i përket pozicionit gjeografik, natyrës së lëvizjes së popullsisë, politikës dhe sidomos në lidhje me aspektin ekonomik, atëherë hapja e ekonomisë vetëm me këtë vend është normale të ketë efekte të veçanta në rritjen ekonomike të Shqipërisë. Simboli i këtij variabli është *hapja_gr_gdp*.
        2) Italia, për të njëjtat arsye siç u shkruan për Greqinë, meriton të trajtohet më vete efekti që sjell hapja e ekonomisë së Shqipërisë me të mbi rritjen ekonomike. Simboli i këtij variabli është*hapja_it_gdp*.
        3) vendet e rajonit. Është e arsyeshme të sugjerohet një variabël më vete, i cili përfshin hapjen ekonomike të Shqipërisë me vendetet e rajonit dhe pritet që ndikimi i këtij variabli të jetë i konsiderueshëm mbi rritjen

[77] Literatura sugjeron që modelet e gravitetit përdorin flukset tregtare në analizën e tyre dhe në fakt prandaj përfaqësues i këtij variabli është marrë hapja tregtare meqë llogaritet si volum tregtar/GDP.

ekonomike shqiptare. Simboli për këtë variabël është *hapja_rajoni_gdp*.

4) Bashkimi Evropian, i cili është goxha prezent në marrëdhëniet ekonomike me Shqipërinë, meriton të trajtohet më vete dhe të evidentohen efektet mbi rritjen ekonomike shqiptare që mund të vijnë prej këtij partneri tregtar. Simboli i këtij variabli është *hapja_eu_gdp*.
5) Partnerët tregtar të listuar më sipër janëata më kryesorët me vendin tonë, sepse zënë pjesën më të madhe të tregtisë ndërkombëtare të Shqipërisë. Për të kontrolluar efektin e të gjitha vendeve partnere është integruar një variabël i veçantë që përfshinë të gjithë vendet partnere. Simboli i këtij variabli është *hapja_gdp*.

- *Kontributi i tregtisë në ekonominë* shqiptare. Meqenëse aktiviteti i tregtisë është një zë i veçantë i sektorit të shërbimeve të një vendi, atëherë sektori i shërbimeve është një matës indirekt i tregtisë. Tregtia është një faktor që ndikon mbi rritjen ekonomike dhe këtë efekt përpiqem ta kap përmes kontrollit të variablit të pjesëssë sektorit të shërbimeve në GDP shqiptare, pra i matur si raport i shërbimeve me GDP dhe simbolizuar me*sherbime_gdp*.
- *Investimet e huaja direkte*. Ky është një faktor që buron nga teoria dhe përshtatet për këtë kërkim, pasi investimet e huaja direkte ndikojnë drejtpërdrejt në numrin e bizneseve dhe aktivitetin prodhues në vend. Nga ana tjetër, vet aktiviteti i bizneseve ndikon mbi aktivitetin në tërësi të ekonomisë shqiptare, si rrjedhim investimet e huaja direkt përcjellin efekte mbi rritjen ekonomike. Simboli i këtij variabli është *fdi_gdp*.
- *Shfaqja e krizës* ekonomike në vendet partnere në tregtinë me Shqipërinë. Situatat e krizave ekonomike përcaktojnë rritjen ekonomike, pra krizat ekonomike janë shkaktare të rritjes ekonomike (si koncept). Në fakt, krizat ekonomike ushtrojnë presion edhe mbi hapjen e ekonomisë. Shfaqja e krizave është matur përmes një variablidummy me dy atribute: 0 para vitit të shfaqjes së krizës, 1 pas vitit të shfaqjes së krizës. Këtu është bërë një ndarje:
    1) Vendet partnere të Bashkimit Evropian, këtu është fiksuar viti 2008 si viti kur ka filluar të shfaqet kriza. Simboli i variablit është *kriza_eu*.
    2) Vendet partnere të rajonit, këtu është fiksuar viti 2009 si viti kur është shfaqur kriza. Simboli i këtij variabli është *kriza_rajoni*.

- *Privatizimi i sistemit financiar* në Shqipëri. Në literaturë merret në konsideratë një elementë i tillë dhe konsiderohet si një koncept që ushtron presion mbi rritjen ekonomike. Si vit të privatizimit është fiksuar viti 2004. Para këtij viti, ky variabël merr vlerën 0, pas këtij vlerën 1. Simboli i tij është *priv_sf*.
- *Aftësia konkurruese e ekonomisë shqiptare*. Ky koncept është matur me variablin indeksi i konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare, që është një tregues që raportohet nga organizata ndërkombëtare si Banka Botërore. Simboli për këtë variabël është *ind_konk*.
- *Korrupsioni*. Shkalla e korrupsionit në mjedisin shqiptar pretendohet të përcjellë efekte mbi rritjen ekonomike dhe, duke e integruar në modelimet ekonometrike, pritet të gjurmohen këto efekte. Ai është matur përmes indeksit të korrupsionit dhe simboli i tij është *ind_korr*.

Figura në vijim rend të përforcojë lidhjen e koncepteve me njëri-tjetrin, drejtimin e shkakësisë, mënyrën e matjes së tyre dhe simboli që është përdorur në analiza. Kjo skemë njihet gjerësisht në botën e kërkimit si skema e operacionalizimit të koncepteve në variabla. Në zonën e fundit të saj është kompozuar, deri diku, forma e funksionit që lidh variablin e varur *rritja ekonomike* (*g*) mevariablat e pavarur, që mund të shkruhet edhe kështu :

$$g_t = f\left(\begin{matrix} hapja_gdp_t \\ hapja_gr_gdp_t \\ hapja_it_gdp_t \\ hapja_rajoni_gdp_t \\ hapja_eu_gdp_t \end{matrix}, sherbime_gdp_t, fdi_gdp_t, \begin{matrix} kriza_eu \\ kriza_rajon \end{matrix}, priv_sf, ind_konk_t, ind_korr_t\right)$$

Ku treguesi *t* nënkupton periudhën kohore. Arsyeja se përse variablat e hapjes së tregtisë dhe të krizës janë shkruar në kolonë, është se këto variabla nuk përdoren njëherësh në regres, por secili prej tyre më vete.Variablat e krizës edhe mund të përdoren njëherësh në një regres, sepse, në thelb, ato paraqesin informacione të ndryshme.

Për rastin e teorisë dhe rrafshin logjik jemi të bindur se cili është faktori shkaktar dhe cili është faktori pasojë. Por këtë nuk jemi të sigurt ta themi edhe për rastin e Shqipërisë. Pikërisht për këtë kemi nevojë për shifra dhe modele ekonometrike. Ndërtimi i modeleve dhe regreseve shkon në përgjigje të çështjes nëse qëndrojnë për rastin e Shqipërisë shigjetat që ilustrojnë ndikimin e variablit të pavarur.

Figura. 17: Operacionalizimi i koncepteve në variabla





Figura 18. Skema e operacionalizimit të koncepteve në variabla, matja dhe simboli i tyre

4.6.2 Statistika përshkruese e variablave

Përpara analizës së lidhjes mes rritjes ekonomike dhe hapjes ekonomike të Shqipërisë me vendet e rajonit, gjykohet si e udhës të bëhet një prezantim lidhur me të dhënat e disponuara. Me këtë logjik, tabela në vijim rend të japë një ide lidhur me variablat sasior të përfshirë në analizën konceptuale të bërë më sipër. Statistika përshkruese përmbledh informacion lidhur me mesataren, medianën, maksimumin, minimumin, koeficientin e asimetrisë (skewness) dhe të kurtozit (kurtosis), statistikën e shpërndarjes normale (statJarque-Bera) shoqëruar me probabilitetin e kësaj statistike, shuma e të dhënave të serisë dhe numri i të dhënave.

Figura 19. Statistika përshkruese e variablave sasior

	g	*hapja_gr_gdp*	*hapja_it_gdp*	*hapja_rajoni_gdp*	*hapja_eu_gdp*	*hapja_gdp*	*sherbime_gdp*	*fdi_gdp*	*ind_konk*	*ind_korr*
Mesatarja	0.053	0.069	0.172	0.027	0.312	0.445	0.811	0.049	3.666	27.06
Mediana	0.057	0.066	0.172	0.017	0.325	0.427	0.807	0.042	3.720	27.50
Maksimum	0.135	0.103	0.208	0.051	0.383	0.570	0.970	0.093	4.060	35.00
Minimum	-0.107	0.036	0.151	0.008	0.101	0.335	0.673	0.012	3.070	0.000
Std. Dev.	0.050	0.019	0.017	0.016	0.059	0.069	0.084	0.026	0.307	8.314
Skewness	-1.287	0.034	0.604	0.413	-2.463	0.176	0.246	0.290	-0.586	-2.192
Kurtosis	6.594	2.207	2.279	1.426	9.905	1.831	2.035	1.696	2.560	8.150
Jarque-Bera	17.10	0.501	1.568	2.502	56.96	1.179	0.880	1.526	0.589	30.50
Probabiliteti	0.000	0.778	0.456	0.286	0.000	0.555	0.644	0.466	0.745	0.000
Shuma	1.114	1.306	3.267	0.507	5.936	8.448	14.59	0.884	32.99	433.0
Viti i parë	1994	1996	1996	1996	1996	1996	1996	1996	2006	1999
Viti i fundit	2013	2014	2014	2014	2014	2014	2013	2013	2014	2014
Nr. të dhënash	21	19	19	19	19	19	18	18	9	16

Burimi: llogaritjet e autorit, përpunuar në EViews7.

Konkretisht,

- për serinë e rritjes ekonomike (*g*) zotërohen të dhëna për 21 vite, ku vit i fundit për të është viti 2013. Mesatarja e saj është 5.3% dhe shumë pranë është edhe mediana e saj. Vlera maksimale është 13.5%, ndërsa ajo minimalja është -10.7%, e cila përkon me vitin 1997. Meqë probabiliteti i statistikës Jarque_Bera është më i vogël se probabiliteti kritik prej 0.05, atëherë mund të thuhet se kjo seri nuk shpërndahet normalisht. Rregullimi i tyre do merret parasysh gjatë modelimit të lidhjeve. Një pamje tjetër e kësaj serie është paraqitja grafike më lartë, ku është ilustruar edhe një grafik Boxplot (grafik mustaqesh).

Figura 20. Ecuria në vite e rritjes ekonomike shqiptare

- për serinë *hapja_gr_gdp* raportohen statistikat në kolonën e dytë të tabelës. Numri i të dhënave për të gjithë variablat e hapjes ekonomike është 19. Është e arsyeshme se pse mesatarja e *hapja_gdp* është më e madhe se mesatarja e hapjeve të partnerëve tregtar, sepse te variabli*hapja_gdp* janë përfshirë të gjitha vendet me të cilat Shqipëria kryen tregti, ndërsa te variablat e tjerë të hapjes, në rastin më të mirë, janë përfshirë vetëm disa vende.
- Mesatarja e variablit*herbime_gdp* është 0.811 dhe është shumë pranë medianës. Numri i të dhënave është 18, pra zotërohen të dhëna për 18 vitet, ku vit i fundit është 2013. Grafiku në vijim përmbledh ecurinë në vite të të gjithë variablave tëhapjes ekonomike.



Figura 21. Ecuria në vite e treguesve të hapjes ekonomike. Boshti në të djathtë: hapja_gdp dhe hapja_eu_gdp, boshti në të majtë: seritë e tjera

- Numri i të dhënave për fdi_gdp është po aq sa i sherbime_gdp. Vlera minimale e tij është 0.012, ndërkohë që maksimalja është 0.093. në vijim është paraqitur ecuria në kohë e dy variablave të fundit, shoqëruar edhe me grafikun e densitetit. Është interesante sepse grafiku na sugjeron se ecuria në vite e këtyre dy variablave është me krahë të kundërt. Kështu, ndërsa shohim rritjen e fdi_gdp në vite, sherbime_gdp rezulton me prirje rënëse.

Këtë e konstatojmë edhe te tabela e korrelacionit. Kjo lidhje mes dy variablave mund të ketë ndodhur për shumë arsye, por nuk do të ndalemi te kjo pike.



Figura 22. Ecuria në vite i fdi_gdp(majtas) dhe sherbime_gdp (djathtas), bashkë me grafikët e densitetit

- Për indeksin e konkurrueshmërisë zotërohen më pak të dhëna krahasuar me të gjithë variablat e tjerë, vetëm për 9 vitet e fundit. Përfshirja e tij më modelim mund të hap problemin e përgjithsueshmërisë së rezultateve për gjithë periudhën në studim.
- Statistikat përshkruese të indeksit të korrupsionit raportohen te kolona e fundit. Mesatarja e tij është 27.06 me një devijim standard prej 8.314. Numri i rekordeve për këtë seri është 16, pra për 16 vitet e fundit.



Figura 23. Paraqitja grafike e ind_korr (majtas) dhe ind_konk (djathtas), bashkë me histogramat e tyre

Pjesë e statistikës përshkruese është edhe korrelacioni mes dy serive. Korrelacioni është një dukuri bashkëshoqërimi, që buron nga teoria dhe mund të përkthehet si relacion mes dy serive dhe informon për:

- drejtimin e lidhjes, që shihet nga shenja e koeficientit. Nëse shenja është negative, atëherë themi se lidhja mes dy dukurive është negative dhe nëse njëra dukuri rritet, atëherë dukuria tjetër do të pësojë rënie. Nëse shenja e koeficientit është pozitive, atëherë thuhet se lidhja është pozitive dhe mund të deklarohet se me rritjen e njërës dukuri, pritet që edhe dukuria tjetër të ndjek rritjen.

- fortësinë e lidhjes. Në përgjithësi, pranohet se një koeficient që luhatet:
    - në intervalin 0% –25%, lidhja konsiderohet e dobët;
    - në intervalin 25% – 75%, lidhja konsiderohet me fortësi mesatare;
    - në intervalin 75% – 100%, lidhja konsiderohet e fortë.

Formula e llogaritjes së koeficientit të korrelacionit është:

$$\rho_{X,Y} = \frac{\operatorname{cov}(X,Y)}{\sigma_X \sigma_Y} = \frac{\sum_{i=1}^{n}(x_i - \bar{x})(y_i - \bar{y})}{\sqrt{\sum_{i=1}^{n}(x_i - \bar{x})^2}\sqrt{\sum_{i=1}^{n}(y_i - \bar{y})^2}}$$

Pjesa e poshtme e thyesës përfaqëson prodhimin e devijimeve standarde të dy dukurive të marra në konsideratë, që jep gjithnjë vlerë pozitive. Ndërsa pjesa e sipërme e thyesës është kovarianca e dy dukurive, e cila mund të marrë vlera pozitive dhe negative.

Shpesh herë kërkohet se me sa siguri mund të thuhet se koeficienti i korrelacionit mes dy dukurive është aq sa raporton vlerësimi i formulës. Për t'i dhënë përgjigje kësaj, vlerësohet shkalla probabilitare e koeficientit të korrelacionit.

Në programin kompjuterik EViews7, ky probabilitet mund të vlerësohet për çdo koeficient korrelacioni. Interesohemi për probabilitet sa më të vogël në mënyrë që të thuhet me siguri sa më të lartë se koeficienti përkatës i korrelacionit ka atë vlerë që tregohet.

Më poshtë janë raportuar koeficientet e korrelacionit mes çdo çifti variablash, shoqëruar edhe me probabilitetin. Kolona e parë është theksuar, sepse kërkohet të tërhiqet vëmendja, pasi aty presim të gjejmë lidhjet bashkëshoqëruese mes faktorit të varur/pasojë (*g*) dhe faktorëve të tjerët të pavarur/shpjegues.

Ne do të shtjellojmë lidhjen e rritjes ekonomike (*g*) me faktorët e tjerë dhe këtë bën kolona e parë: shikon marrëdhënien e rritjes ekonomike me të gjithë variablat e tjerë.

Lidhja mes *g*-së dhe*hapja_gdp*-së është negative dhe me fortësi mesatare, por meqë probabiliteti i këtij koeficienti është më i madh se masa më e madhe probabilitare kritike prej 0.1, atëherë themi se ky koeficient mund të marrë edhe vlera të tjera.

Pra nuk mund të thuhet as me siguri 90% se korrelacioni mes dy serive është -0.4679.Lidhja mes *g*-së dhe *hapja_gr_gdp*-së është e fortë dhe pozitive. Nga kjo presim se hapja e tregtisë me Greqinë të ushtrojë presion mbi rritjen ekonomike.

Për më shumë, ky korrelacion mund të deklarohet si i sigurte, për sa kohë probabiliteti i koeficientit është 0.0052, shumë më i vogël se 0.05.Gati e kundërta ndodh me relacionin mes *g*-së dhe *hapja_it_gdp*-së, sepse lidhja është mesatare, por negative dhe porbabiliteti më i madh se 0.1, na sugjeron që këtë koeficient të mos e marrim shumë në konsideratë, sepse mund të marrë edhe vlerë tjetër.

Thuajse të njëjtat konsideratat mund të themi edhe për lidhet e *g*-së me *hapja_rajoni__gdp* dhe *hapja_eu_gdp*.0.5455 është koeficienti i korrelacionit mes rritjes ekonomike dhe kontributit të shërbimeve në GDP. Pra, është me fortësi mesatare dhe me drejtim pozitiv, por i parëndësishëm.

Variabli *g* lidhet negativisht me fortësi mesatare me *fdi_gdp*, meqë koeficienti i korrelacionit raportohet me vlerën -0.5965. Edhe ky koeficient është i parëndësishëm.Relacioni i rritjes ekonomike me aftësinë konkurruese është interesat, sepse është negativ dhe me fortësi të lartë dhe, për më tepër, i rëndësishëm.

Pra, kur rritet indeksi i aftësisë konkurruese, atëherë pritet të ulet rritja ekonomike. Ndërkohë që lidhja me indeksin e korrupsionit është negative, e dobët dhe e parëndësishme.

Interpretimi i këtij të fundit mund të nxisë shumë diskutime.

Tabela 5. Koeficientet e korrelacionit për variablat sasior

	g	*hapja_gdp*	*hapja_gr_gdp*	*hapja_it_gdp*	*hapja_rajoni_gdp*	*hapja_eu_gdp*	*sherbime_gbp*	*fdi_gdp*	*ind_konk*	*ind_korr*
g	**1**									
	-----									
hapja_gdp	**-0.4679**	1								
	0.2423	-----								
hapja_gr_gdp	**0.8678**	-0.4983	1							
	0.0052	0.2089	-----							
hapja_it_gdp	**-0.6171**	0.8924	-0.7411	1						
	0.1031	0.0029	0.0354	-----						
hapja_rajoni_gdp	**-0.4121**	0.9481	-0.4401	0.7753	1					
	0.3103	0.0003	0.2752	0.0238	-----					
hapja_eu_gdp	**-0.5736**	0.9790	-0.5723	0.9144	0.8978	1				
	0.1371	0.0000	0.1382	0.0015	0.0025	-----				
sherbime_gbp	**0.5455**	-0.5064	0.6059	-0.4507	-0.6344	-0.5576	1			
	0.1619	0.2003	0.1114	0.2624	0.0911	0.1510	-----			
fdi_gdp	**-0.5965**	0.6955	-0.4743	0.4673	0.7750	0.6800	-0.6812	1		
	0.1185	0.0554	0.2351	0.2430	0.0239	0.0635	0.0629	-----		
ind_konk	**-0.7833**	0.8760	-0.7456	0.8446	0.8755	0.8811	-0.6385	0.8193	1	
	0.0215	0.0043	0.0337	0.0083	0.0044	0.0038	0.0884	0.0128	-----	
ind_korr	**-0.2838**	0.8374	-0.1644	0.5498	0.9141	0.8077	-0.6107	0.7559	0.7225	1
	0.4957	0.0095	0.6973	0.1580	0.0015	0.0153	0.1078	0.0300	0.0429	-----

Shëmin: Poshtë koeficientit të koerrelacionit është raportuar probabiliteti i këtij koeficienti.

4.6.3 Kontrolli për stacionaritetin e serive: testi i rrënja unitare

Një nga problemet më të mprehta në modelimin e serive kohore është nëse seritë kohore janë apo jo stacionere, apo të qëndrueshme. Neglizhimi i një kontrolli të tillë mund të çojë në deformime të përfundimeve dhe shmangie nga realiteti i fenomenit. Stacionariteti është supozimi i bërë për seritë kohore që integrohen në regresione.

Që një seri të jetë stacionare duhet të plotësohen tre kushte: mesatarja dhe devijimi standard i serisë të jetë konstant dhe autokovarianca për vonesa të ndryshme të jetë e njëjtë. Për kontrollin e stacionaritetit përdoret një test i veçantë ekonometrik, quhet testi i rrënjës unitare (Unit Root Test).

Tabela 6. Testi i rrënjës unitare për seritë që janë përdorur në modelimet ekonometrike

Variabli	Diferenca				Çfarë sugjerohet?
	0		1		
	ADF	Prob	ADF	Prob	
g	0.0898	0.9541	-5.1427	0.0010	Të bëhet diferenca e parë
fdi_gdp	-0.6559	0.8326	-4.4821	0.0038	Të bëhet diferenca e parë
sherbime_gdp	-0.6615	0.8296	-3.6922	0.0164	Të bëhet diferenca e parë
hapja_gdp	-1.3750	0.5708	-5.0289	0.0012	Të bëhet diferenca e parë
hapja_gr_gdp	-0.2935	0.9081	-3.3872	0.0266	Të bëhet diferenca e parë
hapja_it_gdp	-0.2572	0.9118	-6.3053	0.0001	Të bëhet diferenca e parë
hapja_rajoni_gdp	-0.4961	0.8707	-4.4679	0.0032	Të bëhet diferenca e parë
hapja_eu_gdp	-3.9106	0.0090			Të përdoret ashtu siç është
ind_korr	-2.3161	0.1796	-10.0147	0.0000	Të bëhet diferenca e parë

Shënim: Për vonesën është përdorur kriteri SIC.
Vlerësuar me programin kompjuterik EViews7.

Në tabelën e mësipërme është ekzekutuar ky test për 9 seritë/variablat, fillimisht pa bërë diferenca, pra në diferencën 0, pastaj në diferencën e parë. Vetëm seria *hapja_eu_gdp* është stacionare dhe si rrjedhim nuk është e nevojshme t'i bëhen diferenca për ta kthyer në stacionare. Të gjitha seritë e tjera është e nevojshme të provohen diferencat që i kthejnë në stacionare. Shihet se diferenca e parë i kthen ato në stacionare, ndaj te kolona e fundit e tabelës është bërë shënimi "Të bëhet diferenca e parë".

Kontrolli i testit të rrënjës unitare sugjeron që, përveç serisë *hapja_eu_gdp*, të bëhet diferenca e parë e tyre dhe pastaj të përdoren në regresione. Respektimi i këtij sugjerimi na jep të drejtë t'i interpretojmë rezultatet e regresionit, sepse nuk do t'i shmangen realitetit, të paktën në aspektin e rigorozitetit të përdorimit të serive kohore në regresione. Diferenca e rendit të parë nuk e humbet

logjikën e interpretimit, madje, në varësi të serisë, në shumicën e rasteve mbart edhe kuptim ekonomik[78].

4.7 MODELIMI I RRITJES EKONOMIKE ME HAPJEN EKONOMIKE

Për t'i thënë përgjigje çështjes që u shtrua në mbyllje të pjesës ku u fol për kalimin nga bota e teorisë në atë të vëzhgimit do të ndërtojmë modele ekonometrike të tipit regrese shumëfaktorial. Në vijim shqyrtohen me radhë regreset sipas logjikës: shohim ndikimin më vete me secilin vend dhe pastaj pasqyrohet ndikimi i të gjithëve së bashku.

Secili regres që prezantohet në këtë material ka ardhur si rezultat i disa provave pararendëse. Pra janë bërë disa tentativa deri në momentin që është arritur në regresin që prezantohet. Kjo teknikë parapëlqehet sidomos në ato raste ku nuk është i njohur një kontribut teorik për regresin përkatës.

4.7.1 Rritja ekonomike dhe hapja tregtare me Greqinë

Mbështetur në skemën e operacionalizimit dhe të analizës konceptuale, shoqëruar me konstruktet e tyre, me regresin e mëposhtëm vlerësohet lidhja e rritjes ekonomike shqiptare me hapjen ekonomike vetëm me Greqinë.[79]

$$\Delta g_t = c + \beta_1 \Delta hapja_gr_gdp_t + \beta_2 \Delta fdi_gdp_t + \beta_3 \Delta sherbime_gdp_t + \beta_4 kriza_eu_t + \beta_5 kriza_rajon_t + \beta_6 \Delta ind_korr_t + \beta_7 priv_sf_t + \varepsilon_t$$

Tabela e mëposhtme përmbledh rezultatet e modelit të mësipërm, lidhur me koeficientet dhe me shëndetin në përgjithësi të tij.

[78] Diferenca e rendit të parë ndënkupton rritjen nga niveli *t* në *t+1*.
[79] Faktori i aftësisë konkurruese nuk është përfshirë në model, sepse numri i të dhënave është shumë i kufizuar dhe përfshirja e tij e kufizon shumë shpjegimin e rritjes ekonomike.

Tabela 7. Rezultatet e modelit të hapjes së tregtisë me Greqinë

Dependent Variable: *d_g*
Method: Least Squares
Sample (adjusted): 2000 2013
Included observations: 14 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	-0.041539	0.009491	-4.376794	0.0047
d_hapja_gr_gdp	-1.546502	1.255822	-1.231466	0.2642
d_fdi_gdp	0.196541	0.320424	0.613380	0.5621
d_sherbime_gdp	-0.298476	0.086125	-3.465615	0.0134
kriza_eu	-0.031816	0.020195	-1.575443	0.1662
kriza_rajoni	0.011655	0.020721	0.562452	0.5942
d_ind_korr	0.002620	0.000524	5.001613	0.0024
priv_sf	0.037742	0.009286	4.064613	0.0066

R-squared	0.898043	Mean dependent var	-0.008643
Adjusted R-squared	0.779092	S.D. dependent var	0.024053
S.E. of regression	0.011305	Akaike info criterion	-5.831551
Sum squared resid	0.000767	Schwarz criterion	-5.466375
Log likelihood	48.82085	Hannan-Quinn criter.	-5.865354
F-statistic	7.549725	Durbin-Watson stat	2.468164
Prob(F-statistic)	0.012553		

Shënim: Përjashtuar variablat dummy, gjithë të tjerët janë diferencuar në rendin e parë (shenja *d* para).
Produkt i programit kompjuterik EViews7.

Rritja ekonomike shqiptare ka lidhje negative me hapjen ekonomike me Greqinë, me kontributin e sektorit të shërbimeve në GDP dhe me variablin e shfaqjes së krizës në Evropë dhe pozitive me gjithë varaiablat e tjerë. Këtë e kuptojmë nga shenja negative e koeficienteve përpara variablave. Nga ana tjetër, duke gjykuar nga probabiliteti i secilit koeficient themi se vetëm tre variabla janë të rëndësishëm për rritjen ekonomike: kontributi i shërbimeve në GDP, indeksi i korrupsionit dhe privatizimi i sistemit bankar. Një pjesë e informacionit të tabelës së mësipërme mund të integrohet edhe te regresi si në vijim:

$$\Delta g_t = \underset{(0.0047)}{-0.0415} \underset{(0.2642)}{-1.5465}\,\Delta hapja_gr_gdp_t + \underset{(0.5621)}{0.1965}\,\Delta fdi_gdp_t \underset{(0.0134)}{-0.2985}\,\Delta sherbime_gdp_t$$
$$\underset{(0.1662)}{-0.0318}\,kriza_eu_t + \underset{(0.5942)}{0.0117}\,kriza_rajon_t + \underset{(0.0024)}{0.0026}\,\Delta ind_korr_t + \underset{(0.0066)}{0.0377}\,priv_sf_t + \varepsilon_t$$

Rreth 89.8% (R-katrori, ose R-squared) e variacionit të rritjes ekonomike mund të shprehte përmes faktorëve të pavarur, konsideruar këtë formë modeli, që është një nivel goxha i lartë. Statistika e Fisherit raporton se modeli është i mirë, për sa kohë probabiliteti i saj është më i

vogël se 0.02. Për më shumë, këtë e dallojmë edhe nga krahasimi i vlerave faktike me ato të gjeneruara nga modeli në figurën e mëposhtme.



Figura 24. Performanca e modelit përballë vlerave aktuale të rritjes ekonomike

Nga figura e mësipërme, shohim se termi i mbetjes ka një shpërndarje jo sistematike. Kjo na bën të mendojmë se termi i mbetjes së modelit ka shpërndarje normale, duke reflektuar kështu një nga cilësitë e një modeli të mirë. Në fakt, testi përkatës raporton se ky term mbetje shpërndahet normalisht, për sa kohë probabiliteti i statistikës Jarque-Bera është 0.6864, shumë herë më i madh se 0.10. Për më shumë mund t'i referohemi figurës së mëposhtme, shoqëruar me statistikën përshkruese të termit të mbetjes së modeli.



Figura 25. Testi i shpërndarjes normale për termin e gabimit për modelin lidhur me Greqinë

Për të "veshur" një model me besueshmërinë e duhur, në botën e kërkimeve sasiore, preferohet që modeli të testohet për disa "sëmundje" të mundshme, të cilat mund të ndikojnë në shëndetin e tij. Kështu, në vijim janë prezantuar testi i heteroskedasticitetit, testi i korrelacionit serial dhe testi i autokorrelacionit.

Testi i heteroskedasticiteti gjurmon për ndonjë lidhje të mundshme të termit të mbetjes me faktorët e pavarur. Kjo lidhje mund të jetë lineare ose mund të ketë ndonjë formë tjetër. Nëse ekziston lidhja mes termit të mbetjes së modelit me faktorët e pavarur, atëherë rezultatet e modelit mund të jenë të diskutueshme dhe të shmangura nga realiteti i fenomenit në studim. Ekzistojnë disa teste ekonometrike që e kontrollojnë këtë "sëmundje". Këtu është përdorur testi Breusch-Pagan-Godfrey. Meqenëse probabiliteti i të tre statistikave (F-statistic, obs*R-squared dhe Scaled explained SS) është më i madh se 10%, atëherë dilet në përfundim se termi i mbetjes së modelit nuk dëshmon asnjë varësi nga faktorët e pavarur të marrë në modelin e lidhjes: rritja ekonomike – hapja ekonomike me Greqinë.

Tabela 8. Testi i heteroskedasticitetit për modelin lidhur me Greqinë

Heteroskedasticity Test: Breusch-Pagan-Godfrey

F-statistic	1.374573	Prob. F(7,6)	0.3571
Obs*R-squared	8.622971	Prob. Chi-Square(7)	0.2809
Scaled explained SS	1.553324	Prob. Chi-Square(7)	0.9804

Testi për korrelacionin serial të termit të gabimit i vjen në ndihmë procesit të diagnostikimit të modelit. Në teori ekzistojnë disa teste ekonometrike që mund ta kontrollojnë praninë e korrelacionit serial në model. Këtu është përdorur testi LM (Breusch-Godfrey Serial Correlation LM Test). Të dy probabilitetet e statistikave (F-stqtistic 1.3925 me probabilitet 0.3476 dhe Obs*R-squared 5.7465 me probabilitet 0.0565, për më shumë referoju tabelës në vijim) janë më të mëdhenj se 0.05, atëherë mund të pranohet hipoteza bazë se termi i mbetjes së modelit nuk ka korrelacion serial, duke dëshmuar për një shëndet të mirë të modelit.

Tabela 9. Testi për korrelacion serial të termit të gabimit të modelit të Greqisë

Breusch-Godfrey Serial Correlation LM Test:

F-statistic	1.392507	Prob. F(2,4)	0.3476
Obs*R-squared	5.746515	Prob. Chi-Square(2)	0.0565

Ndodh shpesh herë që rezultatet e modelit të jenë të jenë shumë të kënaqshme, por në të vërtetë në ato përfundime mund të ketë influencuar dukuria e autokorrelacionit. Autokorrelacioni është dukuria e varësisë së një serie nga vetvetja. Praktika ekonometrike sugjeron që kjo të kontrollohet përmes koeficienteve të autokorrelacionit dhe testit Ljung-Box, duke u shtrirë në vonesat kohore të serisë. Meqenëse grafiku i koeficienteve të autokorrelacionit është brenda intervalit, pra yjet (*) shtrihen brenda zonës së pikave (referoji kolonës së parë, tabela e mëposhtme), atëherë autokorrelacioni mungon. Po ashtu, meqë probabiliteti i statistikës-Q, për çdo rend vonese, është më i madh se 10%, atëherë duhet të pranohet hipoteza bazë që mohon praninë e autokorrelacionit.

Tabela 10. Koeficientet e autokorrelacioneve të modelit të Greqisë

Sample: 2000 2013
Included observations: 14

Autocorrelation	Partial Correlation		AC	PAC	Q-Stat	Prob
. *| .	. *| .	1	-0.252	-0.252	1.0924	0.296
.**| .	***| .	2	-0.385	-0.479	3.8581	0.145
. | .	. *| .	3	0.022	-0.336	3.8676	0.276
. |* .	. *| .	4	0.209	-0.150	4.8495	0.303
. |** .	. |** .	5	0.242	0.289	6.3037	0.278
. *| .	. |* .	6	-0.272	0.110	8.3774	0.212
. *| .	. |* .	7	-0.138	0.081	8.9882	0.254
. |* .	. | .	8	0.169	0.041	10.049	0.262
. | .	. *| .	9	-0.021	-0.222	10.068	0.345
. | .	. *| .	10	-0.047	-0.288	10.191	0.424

Të gjithë testet e marra në konsideratë rendin të përforcojnë bindjen se modeli i paraqitur këtu për lidhjen e rritjes ekonomike me hapjen ekonomike ka nxjerrë rezultate të besueshme dhe se koeficientet e variablave mund të interpretohen, sigurisht duke gjykuar me rëndësinë probabilitare.

Si përfundim, **rritja ekonomike shqiptare, kur vihet në korrespondencë me hapjen ekonomike vetëm me Greqinë, ndikohet prej kontributit të sektorit të shërbimeve në ekonomi, indeksit të korrupsionit dhe privatizimit të sistemit financiar**. Interesant është fakti se rritja ekonomike ulet me rritjen e hapjes ekonomike me Greqinë, por ky përfundim statistikisht nuk është i besueshëm. Po ashtu, rritja ekonomike ulet në kushtet e krizës që ka prekur vendet e Bashkimit Evropian, por edhe ky përfundim nuk është statistikisht i besueshëm.

Si faktori i hapjes ekonomike me Greqinë ashtu edhe kushtet e krizës shkojnë përkundër me pritshmëritë tona. Pse nuk janë të rëndësishëm? Kësaj pyetje është me rëndësi t'i thellohemi por nuk është objekti i kësaj doktorature.

4.7.2 Rritja ekonomike dhe hapja tregtare me Italinë

Në këtë çështje është shtjelluar e njëjta lidhje që u trajtua në çështjen e mësipërme, vetëm se këtu bëhet fjalë vetëm për hapjen ekonomike me Italinë. Regresi i deduktuar nga teoria, që mat marrëdhënien rritje ekonomike-hapje ekonomike me Italinë është ky:

$$\Delta g_t = c + \beta_1 \Delta hapja_it_gdp_t + \beta_2 \Delta fdi_gdp_t + \beta_3 \Delta sherbime_gdp_t + \beta_4 kriza_eu_t + \beta_5 kriza_rajon_t + \beta_6 \Delta ind_korr_t + \beta_7 priv_sf_t + \varepsilon_t$$

Rezultatet e këtij modeli janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme, shoqëruar me disa statistika kryesore. Përjashtuar variablat dummy (*kriza_eu*, *kriza_rajon* dhe *priv_sf*), gjithë të tjerët janë diferencuar në hapin e parë që të kthehen në stacionarë (për më shumë referoju çështjes së diskutimit të stacionaritetit të serive)

Tabela 11. Rezultate e modelit për rastin e Italisë

Dependent Variable: *d_g*
Method: Least Squares
Sample (adjusted): 2000 2013
Included observations: 14 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
c	-0.033151	0.006204	-5.343409	0.0018
d_hapja_it_gdp	0.382782	0.233072	1.642332	0.1516
d_fdi_gdp	0.049971	0.227481	0.219671	0.8334
d_sherbime_gdp	-0.351495	0.079855	-4.401671	0.0046
kriza_eu	-0.045494	0.017040	-2.669782	0.0370
kriza_rajoni	0.027537	0.015813	1.741430	0.1322
d_ind_korr	0.001917	0.000361	5.316614	0.0018
priv_sf	0.035217	0.008560	4.114248	0.0063

R-squared	0.911884	Mean dependent var	-0.008643
Adjusted R-squared	0.809083	S.D. dependent var	0.024053
S.E. of regression	0.010510	Akaike info criterion	-5.977456
Sum squared resid	0.000663	Schwarz criterion	-5.612281
Log likelihood	49.84219	Hannan-Quinn criter.	-6.011260
F-statistic	8.870335	Durbin-Watson stat	2.680460
Prob(F-statistic)	0.008331		

Nëse merren disa nga informacionet e tabelës së më sipërme, konkretisht nga kolona e Coefficient dhe Prob., atëherë regresi mund të shkruhet me parametrat përkatës dhe me probabilitetin statistikor të secilit si në vijim:

$$\Delta g_t = \underset{(0.0018)}{-0.0332} + \underset{(0.1516)}{0.3828}\,\Delta hapja_it_gdp_t + \underset{(0.8334)}{0.0499}\,\Delta fdi_gdp_t - \underset{(0.0046)}{0.3515}\,\Delta sherbime_gdp_t$$
$$- \underset{(0.0370)}{0.0455}\,kriza_eu_t + \underset{(0.1322)}{0.0275}\,kriza_rajon_t + \underset{(0.0018)}{0.0019}\,\Delta ind_korr_t + \underset{(0.0063)}{0.035}\,priv_sf_t + \varepsilon_t$$

Rezultatet e modelit dëshmojnë se një rritje e hapjes së tregtisë me Italinësjell një rritje ekonomike për Shqipërinë. Kjo shkon në ndryshim me rastin e Greqisë. Por, ky përfundim nuk është statistikisht i rëndësishëm, sepse probabiliteti që shoqëron parametrin pranë variabëlit *hapja_it_gdp* është më i madh se 10%. Raporti *fdi_gdp* lidhet pozitivisht me rritjen ekonomike, që do të thotë se një rritje e *fdi_gdp* pritet të rritet edhe rritja ekonomike shqiptare. Edhe ky parametër nuk është statistikisht i rëndësishëm. E njëjta gjë siç u tha për variablin *fdi_gdp*, ashtu mund të shkruhet edhe për lidhjen e rritjes ekonomike me krizën në rajon.

Kontributi i shërbimeve në rritjen ekonomike shqiptare është negativ, që do me thënë se me rritjen e këtij kontributi, atëherë rritja ekonomike pritet të tkurret, për sa kohë koeficienti para variablit *sherbime_gdp* është me shenjë negative. Prania e krizës së Bashkimit Evropian e ka ulur rritjen ekonomike. Këtë e shohim nga shenja negative e parametrit para variablit *kriza_eu*. Të dy këto përfundime janë statistikisht të rëndësishme, gjykuar nga shkalla probabilitare e parametrave.

Është shumë interesant fakti se indeksi i korrupsionit e rrit rritjen ekonomike shqiptare dhe ky pohim është 99% statistikisht i besueshëm, meqë shenja e koeficientit para variablit *ind_korr* është pozitive dhe probabiliteti i këtij koeficienti është më i vogël se 1%. Edhe privatizimi i sistemit financiar ushtron presion në rritjen e rritjes ekonomike dhe këtë mund ta themi me 99% nivel besueshmërie (referohu të dhënave të tabelës për variablin *priv_sf*).



Figura 26. Performanca e modelit të Italisë

Grafiku i mësipërm bën krahasimin mes vlerave faktike dhe atyre të gjeneruara nga modeli për serinë *g*. Bashkëshoqërimi i ngushtë mes tyre raporton për një shëndet të mirë të modelit dhe për një shpjegueshmëri të lartë të variacionit të *g*-së i parë nga faktorët e pavarur. Ecuria e tillë e termit të mbetjes krijon përshtypjen se ai është shpërndarë normalisht. Kjo përshtypje konfirmohet nga testi i shpërndarjes normale, i cili është përmbledhur në figurën përkatëse tek shtojca: Termi i mbetjes së modelit të Italisë (figura 8).

Pjesë e shëndetit të një modeli është edhe kontrolli lidhur me "sëmundjet" e hetetoskedasticitetit, korrelacionit serial dhe autokorrelacioni. Tabela 4 tek shtojca përmbledh rezultatet e këtyre tre testeve. Te zona e parë e saj është pozicionuar testi i heteroskedasticitetit. Është përdorur i njëjti test si te modeli i Greqisë. Të tre statistikat që i vijnë në ndihmë hetimit të heteroskedasticitetit raportojnë mungesën e tij. Pra modeli nuk vuan nga "sëmundja" e heterosit.

Te zona e dytë e tabelës është vendosur testi që heton për korrelacionin serial në model. Testi LM raporton se për të paktën 95% nivel sigurie, korrelacioni serial nuk është prezent në model. Kjo dëshmon se modeli është i mirë.

Zona në fund e tabelës është mbushur me inferencën e modelit lidhur me autokorrelacionin. Fakti që koeficientet e autokorrelacionit janë brenda intervaleve, tregon se ai mungon. Për më shumë, probabiliteti i statistikës-Q më i madh se 10%, që tregon për mungesën e tij në model. Të tre testet përforcojnë idenë se modeli është i mirë dhe i jep të drejtë kërkuesit që interpretimet e parametrave pranë variablave t'i interpretojë sipas shkallës së besueshmërisë. Sipas testit të

heteroskedasticitetit, korrelacionit serial dhe autokorrelacionit (shih tabelën tek shtojca) arrihet në përfundimin që **rritja ekonomike shqiptare e parë në funksion të hapjes ekonomike me Italinë** nxjerr në pah se:

- Hapja ekonomike me Italinë dhe raporti *fdi_gdp* ndikojnë pozitivisht në rritjen ekonomike, por është statistikisht e parëndësishme;
- Kontributi i sektorit të shërbimeve në GDP ndikon negativisht mbi rritjen ekonomike dhe është e besueshme;
- Periudha kur Bashkimi Evropian u përfshi në krizën ekonomike/të borxhit ka ndikuar negativisht në rritjen ekonomike shqiptare;
- Indeksi i korrupsionit së bashku me privatizimin e sistemit financiar ndikojnë pozitivisht mbi rritjen ekonomike dhe janë statistikisht të rëndësishëm.

4.7.3 Rritja ekonomike dhe hapja tregtare me vendet e rajonit

Me të njëjtën logjikë siç vepruam për partnerët tregtare Greqia dhe Italia, ashtu është analizuar edhe lidha e rritjes ekonomike me hapjen ekonomike me vendet e rajonit, me synimin për të hetuar ndonjë marrëdhënie të mundshme mes faktorëve. Për këtë arsye është formuluar regresi në vijim, i cili është i ngjashëm me dy regreset e mëparshme dhe i vetmi ndryshim është përfshirja në model e variablit *hapja_rajoni_gdp*.

$$\Delta g_t = c + \beta_1 \Delta hapja_rajoni_gdp_t + \beta_2 \Delta fdi_gdp_t + \beta_3 \Delta sherbime_gdp_t + \beta_4 kriza_eu_t + \beta_5 kriza_rajon_t + \beta_6 \Delta ind_korr_t + \beta_7 priv_sf_t + \varepsilon_t$$

Ky regresion i vlerësuar përmes metodës së katrorëve më të vegjël, jep rezultatet e përmbledhura si në tabelën e mëposhtme:

Tabela 12. Produkti i modelit për vendeve e rajonit

Dependent Variable: *d_g*
Method: Least Squares
Sample (adjusted): 2000 2013
Included observations: 14 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	-0.034758	0.006282	-5.533156	0.0015
d_hapja_rajon_gdp	0.840418	0.513845	1.635546	0.1531
d_fdi_gdp	-0.132003	0.216379	-0.610053	0.5642
d_sherbime_gdp	-0.362285	0.081668	-4.436084	0.0044
kriza_eu	-0.053927	0.018342	-2.940042	0.0259
kriza_rajoni	0.042081	0.018537	2.270119	0.0637
d_ind_korr	0.002219	0.000335	6.622513	0.0006
priv_sf	0.033663	0.008683	3.877057	0.0082

R-squared	0.911658	Mean dependent var	-0.008643
Adjusted R-squared	0.808593	S.D. dependent var	0.024053
S.E. of regression	0.010523	Akaike info criterion	-5.974895
Sum squared resid	0.000664	Schwarz criterion	-5.609720
Log likelihood	49.82427	Hannan-Quinn criter.	-6.008699
F-statistic	8.845457	Durbin-Watson stat	2.090465
Prob(F-statistic)	0.008391		

Një pjesë e Informacionit të tabelës së mësipërme mund të integrohet te trajta e modelit matematikor:

$$\Delta g_t = \underset{(0.0015)}{-0.0348} + \underset{(0.1531)}{0.8404}\,\Delta hapja_rajoni_gdp_t \underset{(0.5642)}{-0.1320}\,\Delta fdi_gdp_t \underset{(0.0044)}{-0.3623}\,\Delta sherbime_gdp_t \underset{(0.0259)}{-0.0539}\,kriza_eu_t + \underset{(0.0637)}{0.0420}\,kriza_rajon_t + \underset{(0.0006)}{0.0022}\,\Delta ind_korr_t + \underset{(0.0082)}{0.0337}\,priv_sf_t + \varepsilon_t$$

Hapja ekonomike me vendet e rajonit ndikon pozitivisht mbi rritjen ekonomike shqiptare, meqenëse koeficienti pranë variablit *hapja_rajoni_gdp* ka shenjë pozitive. Kjo mund të justifikojë idenë e përfshirjes së zgjerimi i tregtisë me vendet e rajonit mund të rrisë rritjen ekonomike. Ky koeficient është 0.8404, por mund të ketë edhe vlerë tjetër, sepse probabiliteti është më i madh se 10%.

Kontributi i sektorit të shërbimeve në ekonomi, kriza në Bashkimin Evropian, kriza në vendet e rajonit, indeksi i korrupsionit dhe privatizimi i sistemit financiar janë faktorë të rëndësishëm në qeverisjen e rritjes ekonomike shqiptare, kur trajtohet marrëdhënia me vendet e rajonit. Kontributi i shërbimeve në ekonomi dhe kriza në vendet e Bashkimit Evropian e ulin rritjen

ekonomike, ndërsa faktorët e tjerë e rrisin atë. Koeficientet para këtyre variablave janë statistikisht rëndësishëm.



Figura 27. Performanca e modelit përballë vijës së vlerave aktuale të rritjes ekonomike për vendet e rajonit

Ilustrimi grafik tek shtojca , figura 9 , është bërë për të parë përputhjen e dy serive: serinë e të dhënave faktike të rritjes ekonomike dhe serinë e të dhënave që gjeneron modeli. Përafrimi i këtyre dy vijave, dëshmon për një shpjegueshmëri të lartë të rritjes ekonomike përmes këtij modeli dhe kjo konvergjon me koeficientin e përcaktimit (R-squared), që është 91.17%.

Termi i gabimit të modelit shpërndahet normalisht, siç e ilustron edhe statistika në figurën 9 tek shtojca . Testet e heteroskedasticitetit, korrelacionit serial dhe autokorrelacioni janë përmbledhur në tabelën 5 tek shtojca . Të tre testet dëshmojnë për shëndetin e mirë të modelit.

Si përfundim, **rritja ekonomike shqiptare kur modelohet me hapjen ekonomike me vendet e rajonit** nxjerr në pah se:

- Hapja ekonomike me vendet e rajonit ndikon pozitivisht mbi rritjen ekonomike;
- Kontributi i investimeve të huaja direkte dhe i shërbimeve në ekonomi së bashku me krizën në zonën e Bashkimit Evropian, e tkurrin rritjen ekonomike;
- Indeksi i korrupsionit, privatizimit i sektorit financiar dhe kriza në vendet e rajonit, e rrisin rritjen ekonomike.

4.7.4 Rritja ekonomike dhe hapja tregtare me vendet e Bashkimit Evropian

Lidhja e rritjes ekonomike me vendet e Bashkimit Evropian meriton një vëmendje të veçantë, për sa kohë gërshetohet me një sërë lidhjesh të tjera të aspektit gjeografik, politik dhe ekonomik dhe mbi të gjitha me aspiratën e Shqipërisë për t'u bërë pjesë e familjes evropiane. Trajta matematikore e mëposhtme rend të hetojë për këtë marrëdhënie.

$$\Delta g_t = c + \beta_1 \Delta hapja_eu_gdp_t + \beta_2 \Delta fdi_gdp_t + \beta_3 \Delta sherbime_gdp_t + \beta_4 kriza_eu_t + \beta_5 kriza_rajon_t + \beta_6 \Delta ind_korr_t + \beta_7 priv_sf_t + \varepsilon_t$$

Marrëdhënia e shprehur te regresi i mësipërm është vlerësuar përmes metodës së katrorëve të vegjël dhe rezultatet e metodës janë integruar në tabelën e mëposhtme.

*Ta*bela 13. Rezultatet kryesore të modelit me vendet e Bashkimit Evropian

Dependent Variable: *d_g*
Method: Least Squares
Sample (adjusted): 2000 2013
Included observations: 14 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
c	-0.108590	0.025564	-4.247757	0.0054
hapja_eu_gdp	0.291505	0.097181	2.999603	0.0240
d_fdi_gdp	0.329649	0.212070	1.554434	0.1711
d_sherbime_gdp	-0.313926	0.059416	-5.283569	0.0019
kriza_eu	-0.046698	0.012978	-3.598252	0.0114
kriza_rajoni	0.016737	0.012440	1.345434	0.2271
d_ind_korr	0.000964	0.000469	2.056706	0.0854
priv_sf	0.019841	0.008468	2.343162	0.0576

R-squared	0.948901	Mean dependent var	-0.008643
Adjusted R-squared	0.889285	S.D. dependent var	0.024053
S.E. of regression	0.008003	Akaike info criterion	-6.522340
Sum squared resid	0.000384	Schwarz criterion	-6.157165
Log likelihood	53.65638	Hannan-Quinn criter.	-6.556144
F-statistic	15.91700	Durbin-Watson stat	3.227945
Prob(F-statistic)	0.001747		

E veçanta e këtij regresi në përdorimin e serive kohore është fakti se variabli *hapja_eu_gdp* është përdorur në model ashtu siç është, pa qenë nevoja për t'u diferencuar. Për më shumë lidhur me arsyet e përdorimit të këtij variabli në këtë formë referoju çështjes "Kontrolli për stacionaritetin e serive: testi i rrënjës unitare".

Rezultatet e modelit janë përshtatur në trajtën matematikore si në vijim:

$$\Delta g_t = \underset{(0.0054)}{-0.1056} + \underset{(0.0240)}{0.2915}\, hapja_eu_gdp_t + \underset{(0.1711)}{0.3296}\,\Delta fdi_gdp_t - \underset{(0.0019)}{0.3139}\,\Delta sherbime_gdp_t$$
$$- \underset{(0.0114)}{0.0467}\, kriza_eu_t + \underset{(0.2271)}{0.0167}\, kriza_rajon_t + \underset{(0.0854)}{0.0009}\,\Delta ind_korr_t + \underset{(0.0576)}{0.0194}\, priv_sf_t + \varepsilon_t$$

Rezultatet raportojnë për një lidhje statistikisht të rëndësishme dhe pozitive mes rritjes ekonomike dhe hapjes ekonomike me vendet e Bashkimit Evropian. Kjo do të thotë se mund të sugjerohet një rritje e bashkëpunimit ekonomik me vendet e këtij blloku tregtar, sepse një veprim i tillë shoqërohet me rritjen ekonomike shqiptare.

Në këtë regres del që efekti i kontributit të investimeve të huaja direkte në ekonomi është pozitiv në rritjen ekonomike, por vlera e ndikimit mbetet për t'u diskutuar, për sa kohë vlera probabilitare e koeficientit është më e madhe se 10%.

Kontributi i sektorit të shërbimeve në ekonomi, kriza në vendet e Bashkimit Evropian, indeksi i korrupsionit dhe privatizimi i sistemit financiar kanë një rol të rëndësishëm mbi rritjen ekonomike shqiptare, meqenëse shkalla probabilitare e koeficienteve para këtyre faktorëve është më e vogël se 10%.

Mbivendosja e vijës së modelit mbi atë të vlerave faktike të rritjes ekonomike dëshmojnë për modelin e mirë dhe konvergjon me koeficientin e përcaktimit, që është 94.89%. Modeli është statistikisht i rëndësishëm meqë probabiliteti i statistikës-F është shumë më i vogël se 1%.



Figura 28. Pamja grafike e vlerave faktike përkundrejt atyre të vijës së modelit bashkë me termin e mbetjes

Po të referohemi statistikës përshkruese të termit të gabimit të modelit me vendet e Bashkimit Evropian, shihet se ky term mbetje shpërndahet normalisht, duke e veshur me besueshmëri më të lartë këtë model. Për më shumë referoju figurës 10 tek shtojca.

Tre testet që kontrollojnë praninë e dukurisë së heteroskedasticitetit në model, dëshmojnë se heterosi nuk është prezent në model, meqë të tre testet pranojë hipotezën bazë lidhur me heterosin. Sa i përket korrelacionit serial,(tabela 6 tek shtojca) vetëm testi i Fisherit e refuzon praninë e korrelacionit serial në model. Nëse konsiderojmë vetëm këtë test, atëherë mund të themi se modeli që kontrollon marrëdhënien mes rritjes ekonomike dhe hapjes ekonomike me vendet e Bashkimit Evropian, është i dobishëm dhe statistikisht i vlefshëm për t'u përdorur në analiza.

Si përfundim, **rritja ekonomike shqiptare kur modelohet me hapjen ekonomike me vendet e Bashkimit Evropian** nxjerr në pah se:

- Hapja ekonomike me këto vende ndikon pozitivisht mbi rritjen ekonomike;
- Kontributi i investimeve të huaja direkte në ekonomi, kriza në rajon, indeksi i korrupsionit dhe privatizimi i sistemit bankar ndikojnë pozitivisht mbi rritjen ekonomike;
- Kontributi i sektorit të shërbimeve në ekonomi së bashku me krizën në zonën e Bashkimit Evropian, e tkurrin rritjen ekonomike.

4.8 KRAHASIME DHE KONSIDERATA PËR MODELET E TRAJTUAR

Në katër çështjet e mësipërme janë trajtuar më vete lidhja që ka rritja ekonomike me hapjen ekonomike sipas partnerëve tregtar: Greqia, Italia, vendet e rajonit dhe Bashkimi Evropian. Në tabelën e mëposhtme, janë vendosur vlerat e parametrave të këtyre modeleve shoqëruar edhe me shkallën e tyre probabilitare, e cila nënkupton rëndësinë statistikore për modelin. Kolona e fundit përfshin vlerësimet e lidhjes ndërmjet rritjes ekonomike dhe hapjes ekonomike me gjithë vendet partnere të Shqipërisë, ndaj edhe ai modeli është titulluar si "modeli gjithsej". Në tre rreshtat e fundit të tabelës janë vendosur tre statistika të modelit në tërësi: koeficienti i përcaktimit (R-katrori), i cili shpreh masën e variacionit të shpjeguar te rritjes ekonomike nga faktorët e pavarur në një formë të caktuar modeli dhe merr vlera nga 0 (shpjegueshmëri e ulët) në 1 (shpjegueshmëri e lartë); probabiliteti i statistikës së Fisherit (prob(statistik-F)), e cila raporton për rëndësinë statistikore të modelit të vlerësuar (sa më i vogël aq më i rëndësishëm); statistika Durbin-Watson (statistika DW), e cila kontrollon autokorrelacionin e rendit të parë (pranë vlerës 2 nuk ka autokorrelacion).

Tabela 14. Përmbledhja e modeleve sipas partnerëve tregtar të Shqipërisë

Variabli	Modeli									
	Greqia		Italia		Vendet e rajonit		Bashkimi Evropian		Gjithsej	
	Koef.	Prob.	Koef.	Prob.	Koef.	Prob.	Koef.	Prob.	Koef.	Prob.
c	-0.0415	0.0047	-0.0332	0.0018	-0.0348	0.0015	-0.1086	0.0054	-0.0326	0.0016
hapja_gdp	-1.5465	0.2642	0.3828	0.1516	0.8404	0.1531	0.2915	0.0240	0.1900	0.1133
fdi_gdp	0.1965	0.5621	0.0500	0.8334	-0.1320	0.5642	0.3296	0.1711	-0.0348	0.8718
sherbime_gdp	-0.2985	0.0134	-0.3515	0.0046	-0.3623	0.0044	-0.3139	0.0019	-0.3492	0.0038
kriza_eu	-0.0318	0.1662	-0.0455	0.0370	-0.0539	0.0259	-0.0467	0.0114	-0.0450	0.0329
kriza_rajon	0.0117	0.5942	0.0275	0.1322	0.0421	0.0637	0.0167	0.2271	0.0315	0.0874
ind_korr	0.0026	0.0024	0.0019	0.0018	0.0022	0.0006	0.0010	0.0854	0.0017	0.0042
priv_sf	0.0377	0.0066	0.0352	0.0063	0.0337	0.0082	0.0198	0.0576	0.0318	0.0097
R-katrori	0.8980		0.9119		0.9117		0.9489		0.9188	
Prob(statistik-F)	0.0126		0.0083		0.0084		0.0017		0.0066	
Statistika DW	2.4682		2.6805		2.0905		3.2279		2.3316	

Shënim: Seritë janë kthyer stacionere sipas rastit, duke reflektuar nga testi i rënjës unitare;
Vlerësuar me ndihmën e programit kompjuterik EViews7.

4.9 INTERPRETIMI EKONOMIK

Interpretimi i parë i rezultateve kryesore të vlerësimit është raportuar në këtë seksion.Interpretimi ekonomik konsideron rezultatet kryesore të vlerësimit të paraqitura në seksionin e mëparshëm.Struktura e modelit EGT e përdorur për hapjen tregtare të Shqipërisë në këtë studim përbëhej nga dy komponentë kryesorë dhe konvencional të faktorëve përcaktues si dhe marrëdhëniet ndërmjet tregtisë dhe rritjes ekonomike. Këta komponentë kryesorë dhe marrëdhëniet janë ekzaminuar për 2 vende dhe 2 blloqe në këtë hulumtim. Në lidhje me aspektin krahasues, rezultatet e vlerësimit të modelit EGT janë të pajtueshme me studime të tjera të ngjashme të mëparshme duke përdorur metoda të ndryshme të modelimit të tregtisë-rritjes si CGE, EGT apo studime të tjera sasiore të tregtisë-rritjes (p.sh. Tran Van Hoa, 2004a,2004b). Gjetjet empirike mbi impaktin e tregtisë mbi rritjen ekonomike në të cilin tregtia ka qenë zgjeruar duke përfshirë shërbimet dhe investimet, si dhe krizat, goditjet dhe reforma politike të shpjeguara në seksionin e fundit do të kontribuojë me disa gjetjet ekonomike dhe interpretime të reja dhe interesante.

Gjetjet mund të shihen sikur kanë ofruar mbështetje empirike të negociatave për politikat liberalizuese tregtare, dhe zbatimit në vetëm disa raste të iniciativave të ndërmarra nga Shqipëria nën kontekste shumëpalëshe, rajonale dhe dypalëshe, veçanërisht për Shqipëri-BE.

Sa i përket rezultateve empirike, këto tregojnë se tregtia e Shqipërisë me Partnerët e saj Global siç përcaktohet nga madhësia hapjes kundrejt PBB-së së saj ka disa mbështetje në aspektin e të qenit statistikisht i rëndësishëm për përcaktuesit e rritjes së dobishme vetëm në rastin specifik të një marrëveshje dypalëshe me BE. Ky rezultat mund të mbështetet fuqimisht nga fakti se vlera dhe vëllimi i tregtisë me BE-në është më i lartë(65.7%) në krahasim me atë me partnerë të tjerë tregtarë në këtë studim. Ky pohim mund të jetë i lidhur me prioritetin që i është dhënë tregtisë dhe bashkëpunimit ekonomik nga politikëbërësit në vendin tonë për të fituar përfitime reciproke nga MTL-ja Shqipëri-BE dhe nga aspirata finale e integrimit në BE. Së fundi, mund të thuhet se tregtia ka qenë elementi kyç për drejtimin e ekonomisë Tonë në dekadat e kaluara.

Më konkretisht, mund të thuhet se liberalizimi tregtar i jep benefite Shqipërisë në aspektin e marrëdhënieve dypalëshe Shqipëri-BE. Ndikimi pozitiv dhe i rëndësishëm i hapjes mund të

shpjegohet me EGT për shkak të vlerës së lartë të tregtisë dhe vëllimit tregtar midis tyre siç shpjegohet si nga të dhënat historike të PBB-së.Si rrjedhojë, negociata dhe zbatimi i MTL, duke përfshirë edhe marrëdhënie të tjera të lidhura dhe ekonomike, duhet të jetë vendosur si prioritet të lartë. Variabli Hapja e tregtisë si variabël shkakësor është përcaktuar nga tregtia mbi PBB për të shpjeguar se liberalizimi tregtar nën MTL do të thotë më pak mbrojtje që të rezultojë me më shumë hapje tregtare mes partnerëve.Ndikimi i hapjes mund të shprehet nga EGT nëpërmjet zhvillimit të modelit tregti-rritje simultan. Tregtia në mallra dhe shërbime dhe investime janë përfshirë si karakteristika të rëndësishme të këtij studimi.

Investimet nga të gjitha vendet partnere kanë një ndikim negativ por të parëndësishëm në rritjen ekonomike. Këto rezultate mund t'i atribuohet paqëndrueshmërisë dhe pjesës e vogël të investimeve gjatë periudhës së vlerësimit, dhe që IHD e brendshme janë drejtuar kryesisht në sektorin e prodhimit. Mund të vërejmë që rezultatet empirike të modelit të aplikuar kanë mbështetur parashikimet e spektikëve në lidhje me impaktin që kanë IHD në vendet në zhvillim (Alfaro,2003;Loyroydi et al.2004; Stanisic dhe Jankovic,2007). Ata shprehen se për vendet në zhvillim këto efekte janë të paqarta, si në sektorin e shërbimeve dhe atyre manifakturor efektet mund të jenë jopozitive. Kjo për shkak të klimës së biznesit ku në rast të një klime të dobët investimesh, për shkak të taksave, tarifave, gjobave, korrupsionit dhe nevojës për shërbime shtesë (avokatë, financierë, konsulentë etj.) rriten kostot e transaksionit investues . për më tepër që IHD-të në Shqipëri janë më të përqëndruar në sektorin e tregtisë, dhe stimulojnë kryesisht eksportet që përkeqëson bilancin tregtar dhe rrjedhimisht edhe të dhënat e rritjes ekonomike. Impaktin negativ e kanë kryesisht në performancën e firmave e më specifikisht tek firmat e mëdha të vendit. Pra, ndikimi i IHD-ve të brendshme në prodhim mund të shihet më qartë se sa në GDP totale. Hyrjet e kapitalit të huaj në përmasa që tejkalojnë deficitin e llogarisë korrente , megjithë kontributin pozitiv në përiudha afatshkurtra, mund të sjellin edhe kontribut negativ në tregues të ndryshëm ekonomikë si në konkurrueshmërinë, diferencimin e pagave të punonjësve, mbiçmim të valutës vendase që së bashku nuk e favorizojnë rritjen ekonomike(A.Mançellari, S.Xhepa). Si konkluzion edhe autorë si Carkovic dhe Levine (2002) janë shprehur se faktorët janë ekonomikë dhe social(Moosa Imaad A. 2002) psh IHD mund të sjellin falimentimin e industrive vendase të cilat nuk disponojnë teknologjinë dhe nuk e përballojnë konkurrencën e firmave të huaja që investojnë në vendet në zhvillim.Për shkak të efektit spillover, know-how dhe domestic crowding out firmat tkurren në një moment afatshkurtër duke shkaktuar një korrelacion negativ me rritjen ekonomike.

Një impakt negativ por statistikisht domethënës ka rezultuar edhe nga analiza empirike e sektorit të shërbimeve në rritje ekonomike. Ky rezultat negativ tregon dhe korrelacionin negativ që vihet re nqs analizohen të dhënat e mbledhura për këtë tregues. Vihet re së në shumicën e viteve të marra në studim ndërsa rritja ekonomike ka treguar trend rritës, në të kundërt sektori i shërbimeve këtë trend e ka patur zbritës. Në fakt sipas Instat, Investimet e Huaja Direkte në sektorin e shërbimeve përbëjnë ¾- tën e IHD- ve gjithsej në ekonominë e Shqipërisë. Kjo ndoshta është edhe arsyeja pse edhe shërbimet ashtu si IHD kanë impakt negativ në treguesit e rritjes ekonomike.

Megjithatë, tregtia jo vetëm në shërbime dhe investime, por edhe në mallra mund të konsiderohet si elementet i rëndësishëm ti pothuajse të gjitha negociatave aktuale (MTL), në mënyrë që të rritet performanca ekonomike e Shqipërisë me partnerë të tjerë të MTL-ve.

Përveç kësaj, përpjekja për të përfshirë kornizën e ligjit dhe politikave për të përshpejtuar tregtinë dhe konkurrencën, shërbimet dhe investimet janë ndërmarrë me forcë pothuajse në të gjitha MTL-të e fundit (Tran Van Hoa, 2004a, 2004b).

Modeli i tregtisë në studimin tonë mund të tregojë në mënyrë empirike kontributin e saj të madh në rritjen ekonomike nga tregtia multilaterale dhe bilaterale të vendit tonë me partnerin më të madh aktual në tregti, bazuar në rezultatet e vlerësimit dhe të dhënat historike të serive kohore të dy dekadave të fundit apo më shumë. Gjetjet empirike mbështesin pretendimin se tregtia në mallra është, konceptualisht, element i rëndësishëm i të gjitha MTL-ve dhe marrëdhënieve më të ngushta ekonomike, edhe pse, në mënyrë empirike, ndikimi është pozitiv dhe statistikisht i rëndësishëm vetëm për marrëveshjen dypalëshe Shqipëri-BE. Tipar tjetër i rëndësishëm i modelit EGT të vlerësuar në këtë studim është, specifikimi i goditjeve: krizave apo i variablave të reformës politike. Këto variabla përmbajnë efektet e papritura apo graduale afatshkurtra dhe afatgjata. Ky funksion nuk mund të vërehet me metodat dhe modelet e tjera të lidhura CGE, GTAP[80] dhe GT[81]. Këto goditje dhe reforma të politikave jane përcaktuesit e fundit kryesor ekonomik në Shqipëri.

Së pari ishte Kriza financiare e vitit 2008-2009. Sipas aplikimit të modelit na rezulton se kriza e pranishme në Bashkimin Europian ka një impakt negativ në treguesit e GDP-së në vendin tonë,

[80] Është variant më i ri në matjen tregtisë ndërkombëtare sipas CGEM
[81] Gravity theory (jo me variabla endogjene)

kjo ndoshta dhe për faktin që pjesën më të madhe të tregtisë vendi ynë e kryen pikërisht me këtë treg dhe ishte e pritshme në fakt që kjo krizë të ndjehej dhe në treguesit tonë makroekonomik. Kjo lidhje shfaqet edhe në tregtinë me Italinë, ndërsa në tregtinë me vendet e rajonit lidhja del pozitive duke nënkuptuar se kriza në vendet e rajonit e rrisin rritjen ekonomike në Shqipëri, që do të thotë se vendet e rajonit nuk na infektojnë me krizën e tyre dhe kjo sepse nga të dhënat vihet re se nga 4 partnerët në studim, tregtia me këto vende përfaqëson vlerën më të vogël të tregtisë. Të gjitha këto rezultate dalin statistikisht të rëndësishme, përveç se kur e analizojmë me Greqinë ku lidhja është pozitive si më BE-në por statistikisht e parëndësishme.

Së dyti ishte variabli i institucioneve financiare dhe reforma e vitit 2004 me privatizimin e Bankës së Kursimeve. Kjo reformë u zbatua për të forcuar institucionet e brishta financiare në Shqipëri dhe për të mbrojtur vendin nga krizat financiare që mund të ri-ndodhnin. Sipas gjetjeve empirike, privatizimi i sistemit financiar i 2004 mund të konsiderohet si një reformë thelbësore dhe e rëndësishme për politikat e rritjes ekonomike në Shqipëri, të dobishme në pothuajse të gjitha modelet EGT. Pra ky proçes privatizimi ka ndikuar pozitivisht në rritjen ekonomike sepse i është dhënë frymëmarrje kredisë dhe investimeve në tregjet bankare.

Nga sa më sipër, mund të konkludohet se kur goditjet dhe reformat e politikës janë të përfshira në mënyrë të përshtatshme në model duke përdorur të dhënat e lidhjes tregti-rritje ekonomike në formën e serive kohore, do të përftojmë një efekt serioz në zhvillimin dhe rritjen e një vendi.

Pra si rezultat i gjithë këtyre problematikave që paraqet studimi i rritjes ekonomike në Shqipëri është aplikuar në këtë punim një kombinim i modelit Gravitacional me teoritë e impaktit të tregtisë në rritjen ekonomike. Meqënëse tradicionalisht teoritë e Gravitetit kanë gjetur vend në vlerësimin e flukseve të turizmit dhe deri diku dhe të IHD-ve , për teoritë e rritjes ekonomike autorë të tjerë (Natalja Von Westernhagen)[82] kanë sugjeruar zgjerime me variabla ekonomikë dhe joekonomike të cilat janë marrë për bazë edhe në aplikimin e modelit ekonometrik[83] në këtë studim për ta bërë të përshtatshëm në analizën e impaktit të tregtisë në rritjen ekonomike. Dhe më tej nga kombinimi dhe përfshirja endogjene të variablave me njëri tjetrin arrihet të shihet se liberalizimi tregtar apo hapja tregtare (duke reduktuar apo eliminuar tarifat midis vendeve që kryejnë tregti në bazë të marrëveshjeve të tregtisë së lirë që kanë firmosur), ndikon në rritjen ekonomike të vendit tonë sidomos me partnerin tonë më të madh tregtar që është BE. Nga

[82] Teoria e saj është e detajuar në cështjen e mësipërme të rishikimit të literaturës.
[83] Autorët janë sqaruar më konkretisht në pjesën e rishikimit të literaturës

rezultatet e modelit të aplikuar derivojmë dhe një cështje shumë të rëndësishme që janë potencialet tregtare me BE-në e cila është në përputhje të plotë me objektivat finale të një modeli Gravitacional. Dhe në fakt rezulton se autorë të mëparshëm (Alban Pllaha 2011) kanë studiuar dhe arritur në konkluzionin se sasia e tregtisë me BE-në është më e vogël sesa potencialet tregtare dhe për këtë lind dhe sugjerimi se Shqipëria duhet ti intensifikojë marrëdhëniet tregtare me Bashkimin Europian përderisa kontribuon më së miri në Rritjen ekonomike të vendit.

4.10 INTERPRETIMI EKONOMETRIK

Ky seksion përshkruan interpretimin ekonometrik të gjetjeve tona empirike. Krahasuar me studimet mëparshme të lidhura me modelet tregti-rritje bazuar në teorinë e gravitetit apo teori të ngjashme duket se tregojnë një nënvlerësim të efektit të tregtisë (hapjes tregtare) në rritjen ekonomike të një vendi (shih Tran Van Hoa, 2004a, 2004b, 2008). Është gjetur gjithashtu se vlerësimet 2SLS janë pak më të mëdha se sa vlerësimet OLS[84]. Kjo mund të mbështetet në rastin e përkufizimit të hapjes tregtare si volum tregtar / PBB për modelin tregtar multilateral empirik.

Zbatimi i një metode të përshtatshme vlerësimi është një konsideratë e rëndësishme dhe e nevojshme për të marrë rezultate më të sakta dhe të paanshme. Ky studim merret me vlerësimin OLS . Duhet të theksohet se duke përdorur OLS në mjetet tona të studimit kritik , modeli tregti-rritje është një regresion që shpërfill pra endogjenitetin e tregtisë në rritje dhe rritjes në tregti. Në efikasitetin statistikor dhe këndvështrimin e saktësisë, megjithatë, rezultatet empirike nga ana e OLS hedhin dritë mbi kërkimin për strategjinë e duhur për të përmirësuar teorinë e vlerësimit dhe të parashikimit. Këto konsiderata duhet të fokusohen në efikasitetin më të lartë të vlerësimit të modelit që lidhet me gabimet në specifikim , gabimet e matjes dhe paragjykim apo njëkohshmëria.

[84] Prandaj në modelin subjekt të kësaj teme janë përdorur vlerësimet OLS

KONKLUZIONE

5.1 HYRJE

Hapja e tregtisë është përshëndetur për efektet pozitive në produktivitet, adoptimin dhe përdorimin e teknologjisë më të mirë dhe promovimin e investimeve të cilat janë kanale për stimulimin e rritjes ekonomike. Përveç kësaj, liberalizimi është mbështetur si një kusht i domosdoshëm për uljen e varfërisë. Efekte të tjera pozitive përfshijnë rritjen e lëvizshmërisë së kapitalit, rritjen e lehtësisë e lëvizjes së mallrave dhe shërbimeve (dhe informacionit) përtej kufijve kombëtarë, si dhe përhapjen e normave dhe vlerave globale, përhapjen e demokracisë dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare të të drejtave mjedisore dhe njerëzore.

Në zemër të argumenteve më të mëdha në favor të liberalizimit të tregtisë, është pohimi se do të shkaktojë një rialokim të burimeve drejt sektorëve në të cilat vendet kanë përparësi krahasuese. Megjithatë,ky rialokim i burimeve merr kohë dhe është i kushtueshëm. Përveç kësaj, teoria e tregtisë ndërkombëtare parashikon se liberalizimi tregtar gjeneron fitues dhe humbës, por identiteti i tyre varet nga supozimet që bëhen në lidhje me lëvizjen e burimeve në të gjithë sektorët.

5.2 DISKUTIMI I REZULTATEVE TEORIKE TË GJETURA

Edhe pse një numër i konsiderueshëm studimesh kanë hulumtuar impaktin potencial që mund të ketë hapja e tregtisë në rritje ekonomike ,gjithsesi nuk ka rezultuar e lehtë përpjekja për të përcaktuar lidhjen që kanë këta dy tregues substancial të ekonomisë . Studimet e adresuara tek rritja ekonomike kanë konstatuar probleme të tilla si endogjeniteti i disa variablave të caktuar , ndërsa studimet empirike nuk kanë qenë në gjendje për të ofruar rezultate të qarta në lidhje me ndikimin e tregtisë në treguesit e rritjes ekonomike. Rezultate të shumta tregojnë se tregtia kontribuon në përmirësimin e rritjes ekonomike. Megjithatë, nëse tregtia nuk është e kombinuar me politika adekuate për të balancuar importet kundrejt eksporteve, ajo mund të gjenerojë defiçite të bilancit tregtar dhe të bilancit të pagesave, duke krijuar në këtë mënyrë shkak për ngadalësim ose përkeqësim në rritjen e të ardhurës reale.

Liberalizimi tregtar në shumicën e teorive paraqitet të ketë shumë avantazhe si : avantazhi krahasues, ekonomitë e shkallës, rritja e konkurrencës së ndershme, përdorimin efektiv të lëndëve të para, kosto më të ulët jetese, rritja e mundësive të zgjedhjes së konsumatorit, apo dhe nën kuadrin ndërkombëtar , një qeverisje të mirë dhe lidhje më paqësore me partnerët ndërkombëtar.

Përkundër këtyre avantazheve ekzistojnë dhe disavantazhet në lidhje me këtë fenomen si psh:varësia ekonomike, skllavëria politike, zhvillimi i paekuilibruar, produktet e brendshme, monopolet ndërkombëtare, reduktim në mirëqënie për disa grupe të caktuara dhe vështirësi në aplikim duke qënë se kushtet aktuale në botë nuk përputhen me kushtet që paracakton implemtimi i këtij regjimi tregtie të lirë.

Për më tepër që autorë të ndryshëm kanë nxjerrë si konkluzion që është e dëmshme për vendet më pak të zhvilluara sepse në kushtet e një tregtie të lirë këto vende përjetojnë një bilanc pagesash të pafavorshëm. Megjithatë hulumtime të rëndësishme e kanë kundërshtuar këtë pohim duke argumentuar faktin se vërtet rreth dy të tretat e këtyre fitimeve do të grumbullohen në vendet industriale, por përfitimet që marrin vendet në zhvillim janë mëse i dyfishi i ndihmës që marrin aktualisht nga vendet e zhvilluara, dhe njëkohësisht përfitimi në vendet e zhvilluara është më i madh sesa kur nuk ekzistonte tregtia e lirë me vendet në zhvillim. Ata pranojnë së në fakt nga ky proçes përfitimi më i madh sigurisht u shkon vendeve të zhvilluara.

Në fakt fenomeni i liberalizimit tregtar prek disa sektorë të vendeve në zhvillim nën kuadrin e fazës së tranzicionit të kalimit nga një ekonomi me barriera të larta në tregti, në një ekonomi të liruar nga këto barriera. Rastet më të zakonshme të marra në studim në modelet teorike janë ato për studimin e efekteve në tregun e punës . Studiuesit supozojnë dy raste ekstreme: lëvizshmëri e përkryer e burimeve ose mungesë mobiliteti të burimeve nëpër gjithë sektorët. Në një model ku resurset janë të lëvizshëm në mënyrë përfekte , cilët janë fituesit dhe humbësit që lindin në këtë kontekst?

Të dhënat sipas rishikimit të literaturës për impaktin e liberalizimit të tregjeve në tregun e punës tregojnë se:

1. kohëzgjatja dhe përmasat e tranzicionit janë shumë të ndjeshme për supozimet në lidhje me lëvizjen e kapitalit fizik,.

2. Përgjigja e tregut të punës ndaj liberalizimit është e madhe por tranzicioni mund të zgjasë disa vjet. Nëse kapitali është i lëvizshëm në mënyrë të përkryer ose i palëvizshëm, rreth 95% e rialokimit të punëtorëve përfundon vetëm pas 9 vitesh. Nëse e supozojmë kapitalin të palëvizshëm në mënyrë jo perfekte , në varësi të shkallës të lëvizshmërisë, kjo kohëzgjatje mund të jetë shumë më e gjatë;

3. Punëtorët e punësuar në prodhimin High-Tech para shokut përballen me humbje të konsiderueshme në mirëqenie, sidomos ato me nivel më të lartë arsimor dhe ata të cilët janë më të vjetër;

4. Kostot e lëvizshmërisë duket të jetë më të larta gjatë procesit të përshtatjes së tregut të punës me procesin e liberalizimit.

Analizat në këtë dokument tregojnë se kostot e mëdha të lëvizshmërisë ndër-sektoriale nuk janë në kundërshtim me punësim më të madh dhe me elasticitetin afatgjatë pagave/çmime të vogla . Pas një shoku, pagat mund të shërohen në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme për shkak të një rregullimi të ngadaltë të kapitalit fizik.

Duke iu përgjigjur disa prej këtyre pyetjeve do të jetë shumë informative për qeveritë që janë të gatshëm për të hapur tregjet e tyre ndaj konkurrencës së huaj dhe për të marrë vendime se çfarë lloji reformash duhen ndërmarrë që të mund të maksimizohen fitimet nga tregtia.

Evidencat e viteve të fundit që janë gjithmonë e më në rritje mbështesin pohimin se tregtia ndërkombëtare stimulon inovacionin dhe rritjen e produktivitetit përmes rritjes së konkurrencës. Meqënëse supozohet se vendet prodhojnë të njëjtin grup të varieteteve , hapja e tregtisë i bën tregjet më konkurruese , duke ulur çmimet dhe duke rritur sasitë .

Meqënëse firmat marrin iniciativa në inovacion për reduktimin e kostos , prodhimi i rritur si pasojë e një tregu më konkurrues i shtyn firmat për të bërë inovacion akoma më shumë .

Si pasojë, një reduktim i barrierave tregtare stimulon rritjen duke zvogëluar fuqinë e tregut të firmave vendase . Ky ndikim ndryshon sipas destinacionit dhe origjinës së eksporteve dhe importeve , dhe nëse vendet janë në zhvillim apo të industrializuara.

Ndërsa ka sigurisht arsye për të besuar se tregtia e zgjeruar mund të ndihmojë për të nxitur rritjen në vendet në zhvillim, nuk ka gjasa që tregtia, në vetvete, do të përmirësojë cilësisht gjendjen e vështirë të njerëzve në botën në zhvillim. Në fakt, ka dhe skenare të mundshme në të cilat liberalizimi tregtar mund të çojë në rezultate më të këqija për vendet në zhvillim.
Por realiteti flet ndryshe. Fitimet totale për vendet në zhvillim nga reduktimi i barrierave të tyre janë dukshëm më të mëdha se përfitimet që janë projektuar për të marrë vendet e industrializuara nga reduktimi e barrierave . Fakti që vendet në zhvillim do të fitojnë më shumë nga liberalizimi i tyre sesa vendet e industrializuara nga heqja e barrierave tregtare është një rezultat i parashikueshëm i këtyre modeleve. Në shumicën e sektorëve, barrierat tregtare në vendet e industrializuara janë tashmë të ulëta. Në të kundërt, shumica e vendeve në zhvillim mbajnë barriera shumë më të larta tarifore dhe kuota. Kjo do të thotë se në këto modele, eliminimi i barrierave të vetë vendeve në zhvillim për importin do të ketë shumë më tepër ndikim në ekonomitë e tyre se sa eliminimi nga vendet e industrializuara të barrierave ndaj eksporteve të tyre .

Transformimi global është përdorur si një rrugë,apo mënyrë e shkurtër e përshkrimit të shpërndarjes dhe lidhjes së produkteve, komunikimeve dhe teknologjive rreth botës. Kjo shpërndarje ka përfshirë sferën ekonomike kulturore. Shpejtësia e komunikimit, shkëmbimit, kompleksiteti dhe numri i mjeteve të perfshira, rritja e vëllimit tregtar, risku, japin atë forcë të çuditshme që ne e quajmë globalizim. “Globalizimi” gjithashtu është përdorur për t’iu referuar përpjekjeve të FMN Fondi Ndërkombetar Monetar, Bankës Botërore dhe institucioneve të tjera për të krijuar një treg të lirë global për mallra dhe shërbime.

Mund të themi se procesi i globalizimit është një dukuri e cila për çdo ditë po thellohet dhe po depërton në të gjithë kulturat në mbarë mjedisin që na rrethon. Edhe pse ka disa dukuri negative, thelbi i tij është zhvillues dhe pozitiv. Një prej efekteve tepër pozitive të globalizimit ka qenë zgjerimi i tregjeve lokale në tregjet ndërkombëtare. Kjo ka bërë që ndërmarrjet e mëdha perëndimore të lëvizin biznesin e tyre në vendet që janë më të varfra si Afrika, India, Kina që ofrojnë punëtorë në masë të madhe dhe kosto shumë të ulët krahasuar me koston në vendet e tyre. Kjo në fakt është mirë për ndërmarrjet Amerikane, Gjermane, Angleze por është si një kërcënim për punëtorët në keto vende të zhvilluara sepse po krijohet papunësi, megjithatë në të njëjtën kohë është një avantazh për të ulur papunësinë dhe urinë në këto shtete që janë më pak të zhvilluara ekonomikisht. S'ka dyshim, që risitë teknologjike, veçanërisht në fushën e informacionit dhe të komunikimit, kanë luajtur dhe vazhdojnë të luajnë ende një rol qendror.Jo vetëm mallrat mund të blihen apo shiten pa pasur ndonjë pengesë të madhe, por edhe lëvizja monetare është liruar gati tërësisht nga ndikimi shtetëror. Kapitali gjendet çdokund ku mund të investohet në ndonjë ndërmarrje apo në tregjet financiare të shteteve tjera ku premtojnë fitim të madh. Rrjedhim i kësaj cështje është se shumica e kapitalit që qarkullon në botë,gjatë viteve të fundit, ata vende të cilat e kanë pranuar globalizimin, kanë pasur zhvillim ekonomik, mesatarisht, për 50% më të madh se vendet të cilat kanë qëndruar me kufij të mbyllur.

GLOBALIZIMI është rezultat i disa zhvillimeve dhe proceseve: Internacionalizimi i tregjeve financiare, Decentralizimi dhe Liberalizimi tregtar, Zhvillimi i komunikimit ndërmjet vendeve përmes IT-së, Rritja e investimeve direkte të huaja, Privatizimi i sektorit publik etj.

Shqipëria ka arritur një rritje pozitive ekonomike gjatë viteve të fundit, pavarësisht nga ndikimi i krizës financiare globale.

Ndjekja e makro-politikave dhe reformave të mirë-strukturuara, të fokusuara në privatizim, ndershmërinë fiskale, liberalizimin tregtar, klimën e biznesit, energjisë dhe sektorit financiar, kanë bërë të mundur që ekonomia shqiptare të jetë më elastikja në ekonomitë e Evropës Jug-Lindore.

Në raportet e publikuara gjatë muajit dhjetor 2011, "*Moody's Investors Service"* dhe "*Standard and Poor's",* rikonfirmojnë vlerësimin e tyre për Shqipërinë (B1 nga Moody's dhe B+ nga S&P), si dhe këndvështrimin e tyre afatmesëm si "të qëndrueshëm" për ekonominë shqiptare.

Ata theksojnë se ndryshe nga vendet e rajonit, Shqipëria në 10 vitet e fundit ka demostruar një rritje të qëndrueshme ekonomike në nivelin 4%. Përveç rritjes ekonomike të viteve të fundit, kompanitë vlerësojnë veçanërisht potencialin e ekonomisë shqiptare për të pasur një rritje të qëndrueshme dhe të lartë në vitet në vijim. Në fakt vendi ynë ka paraqitur një histori zhvillimi të suksesshme në shumë aspekte, duke filluar nga përpjekjet intensive të vendosjes së ekonomisë së tregut, reformat në sistemin financiar në përputhje me kërkesat e anëtarësimit në BE e deri tek integrimi më shpejtësi në komunitetin ndërkombëtar europian. Rritja ekonomike këto dy dekadat e fundit ka rezultuar e shpejtë dhe e qëndrueshme dhe ndryshe nga vendet e Ballkanit, Shqipëria ka paraqitur një trend pozitiv rritjeje edhe gjatë krizës ekonomike botërore, panvarësisht rënies së konsiderueshme në vitet 2009-2010(kohë kjo kur u ndienë efektet e krizës dhe në Shqipëri). Rritja mbresëlënse ekonomike e Shqipërisë gjatë dekadës së fundit është një arritje e rëndësishme. Megjithatë, kriza ka ekspozuar një varësi nga dërgesat nga jashtë, një nivel të ulët të diversifikimit të tregtisë dhe nevojën për të rritur konkurrueshmërinë, duke përfshirë edhe tërheqjen e investimeve të huaja direkte. Pengesat për investime përfshijnë të drejtat e munguara të pronës, infrastrukturën ende të pazhvilluar ,korrupsionin e përhapur dhe, përmirësimin e kuadrit rregullator, lehtësimin e tregtisë dhe promovimin e investimeve për rritje përfshirëse dhe të qëndrueshme. Kjo, për të rritur aftësinë konkurruese duke zhvilluar kapacitetet e institucioneve ekonomike, nxitjen e zhvillimit të tregut dhe duke mbështetur futjen dhe zbatimin e politikave në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe ato të BE-së. Në fakt deri më tani, ndikimi i krizës është ndjerë kryesisht në zvogëlimin e nivelit të remitancave dhe tregtisë. Gjatë viteve të krizës dhe pas krizës ekonomike globale (2009-2011), stabiliteti makro-ekonomik në vend ka ndjerë presionet negative të saj, megjithatë është arritur të ruhet në parametra relativisht të kënaqshëm. Gjatë secilit prej viteve 2009-2011 u arrit të evitohet recesioni ekonomik, i cili u përjetua në pjesën dërrmuese të vendeve të rajonit dhe më gjerë, dhe ekonomia shqiptare vijoi të performojë me ritme pozitive rritjeje. Rritja mesatare ekonomike e Shqipërisë gjatë viteve 2000-2008 (periudha para krizës) ishte në nivelin 6.2%, duke qënë mbi mesataren prej 5.3% të vendeve të EQL, ndërsa norma e inflacionit mesatar për këtë periudhë ishte 2.7%, ndjeshëm poshtë mesatares prej 8.5% të vendeve të EQL. Gjatë viteve 2009-2011 (periudha e krizës dhe pas saj) ekonomia e Shqipërisë ka performuar me një rritje mesatare prej rreth 3.1%, dukshëm mbi rritjen mesatare prej 0% të vendeve të EQL, ndërsa inflacioni mesatar ka qënë në nivelin 3.2%, pra poshtë inflacionit mesatar prej 3.7% të vendeve të EQL.

Shqipëria, gjithsesi mbetet një vend në zhvillim më një paqëndrueshmëri të lartë të çmimeve, me një bilanc tregtar të udhëhequr nga importet, me resurse të kufizuara për të përballuar një treg global, me një nivel të aftësisë konkurruese të firmave ende në nivele të pamjaftueshme, me një mjedis jo shumë të sigurtë për investitorët e huaj; për këtë vendi ynë duhet sa më shpejt të të gjejë ekuilibrin në ekonominë e tregut dhe të garantojë konvergjencën strukturore drejt vendeve të Bashkimit Europian. Në Shqipëri, korrupsioni shihet si pengesa kryesore që ndikon në efektivitetin e biznesit. 97.8% e të pyeturve e shënojnë këtë barrierë si kryesoren në pengesat që dëmtojnë sipërmarrjen. Edhe pse vlerësohen disa nga reformat strukturore të ndërmarra nga qeveria, nuk ka ndryshim përsa i përket perceptimit të korrupsionit, krahasuar edhe me vitet e tjera, përkundrazi ka një rritje të këtij perceptimi.

Megjithë nivelin e lartë të rritjes, Shqipëria ende mbetet një nga vendet më të varfëra të Europës, me rreth 25 % të popullsisë që jeton nën nivelin e varfërisë, në krahasim me një mesatare prej mbi 10,000 dollarë në vendet e tjera të rajonit ballkanik. E gjithë kjo sjell një varësi të vendit nga ekonomitë e huaja, qoftë përsa i përket nevojës për import të pjesës më të madhe të mallrave (si rrjedhim me një deficit tregtar negativ), qoftë dërgesave (remitancave) të emigrantëve (rreth 15 % e PBB), të investimeve dhe të huave të drejtpërdrejta (rreth 7 % e PBB) dhe të ndihmave ndërkombëtare.

Gjithsesi vitet e fundit flasin për një bilanc tregtar që ndonëse në vlera negative gjithsesi ka pësuar një trend rënës dhe kjo sepse importet kanë qënë në rënie (që tregon një përmirësim në kushtet e biznesit dhe një gjallërim të prodhimit vendas) por ende ritmi i rritjes së eksporteve është në rënie. Pra për këtë arsye vendi vazhdon të përjetojë deficit tregtar të konsiderueshëm.

Kriza globale ushtroi presion të dukshëm mbi ekonominë shqiptare. Si pasojë e krizës globale, normat e rritjes u ulën ndjeshëm. Rritja reale në vitin 2009, u përgjysmua nga trendi i saj historik, por megjithatë vijoi të ishte pozitive (3.3 për qind e PBB-së), si rezultat i ekspozimit të kufizuar financiar në tregjet ndërkombëtare dhe të një politike fiskale ekspansioniste të iniciuar para krizës. Me lidhje veçanërisht të forta ekonomike e tregtare me Italinë dhe Greqinë, kriza në këto vende u reflektua në uljen e remitancave dhe eksporteve në ekonominë shqiptare, të cilat çuan në një ngadalësim të konsiderueshëm të rritjes ekonomike dhe veçanërisht të të ardhurave buxhetore. Ekonomia ka vazhduar me një normë të moderuar rritjeje prej 3.8 për qind në vitin 2010 dhe 3.1 në vitin 2011. Në vitin 2012 dhe përgjatë vitit 2013, rritja ekonomike është

dobësuar edhe më tej. Norma e rritjes ekonomike u ul në 1.3% në 2012 dhe vijoi të ulej ndjeshëm gjatë 2013. Gjatë nëntë muajve të vitit 2013 rritja ekonomike e vlerësuar prej INSTAT rezultoi në 0.4% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kërkesa e brëndshme vijon të mbetet mjaft e dobët dhe gjasat për një përshpejtim të menjëhershëm të konsumit dhe investimeve private mbeten të pakta. Kërkesa e jashtme ka qenë gjeneratori kryesor i rritjes në dy vitet e fundit, megjithatë, ajo mbetet e kushtëzuar nga zhvillimet e pafavorshme në ekonomitë e eurozonës dhe të një baze jo të diversifikuar eksportuesish, si për sa i takon produkteve, ashtu edhe tregjeve.

Në fakt Shqipëria ka bërë mjaft përparime në treguesit e hapjes tregtare ndër vite dhe modelet për liberalizimin tregtar parashikojnë që ky fenomen të veprojë pozitivisht në zhvillimin e saj, rritjen e mirëqënies apo dhe zbutjen e varfërisë. Për këtë teoritë ndërkombëtare që masin efektivitetin e reformave në politikat e hapjes janë të shumë llojshme. Evidentohen 3 modele të cilat kanë siguruar rezultate të konfirmuar nga realiteti PEM, CGE dhe EGT

Në vija të përgjithshme mund të themi së të tre modelet janë shumë të rëndësishëm dhe përdoren gjerësisht për të vlerësuar impaktet e tregtisë ndërkombëtare që janë një shqetësim për politikëbërësit meqënëse ka shumë debate rreth efiçiencës të marrëveshjeve të tregtisë së lirë. Për këtë nga tabela e mëposhtme shihet se të tre modelet kanë ndryshime të dukshme nga njëri tjetri në termat e avantazheve dhe disavantazheve që ato paraqesin në fushën ku aplikohen.

Modeli i përdorur në këtë studim është zgjedhur EGT sepse në vitet e fundit është përdorur nga mjaft autorë si një mjet i fuqishëm për të përshkruar tregtinë ndërkombëtare. Ky model ka rezultuar mjaft i qëndrueshëm sepse ka aftësi të lartë shpjeguese meqënëse të dhënat në këtë model kërkohen për periudha të gjata kohore duke bërë që vlerësimet ekonometrike të paraqiten të fuqishme.

Megjithatë ky model është mjaft kompleks sepse pranon shumë variabla për vlerësimin e impaktit , prandaj aplikimi i tij kërkon që të thjeshtësohet përfaqësimi teorik me llogari simultane për marrëdhëniet e tregtisë ndërkombëtare me zona të tjera gjeografike.

Tabela 15. Përmbledhja e karakteristikave të modeleve të impaktit të tregtisë ndërkombëtare

PEM		**CGE**		**EGT**	
Zhvilluar nga Alfred Marshall[85]		Zhvilluar nga Leon Walras		Zhvilluar nga Tinbergen	
Lidhet me variabla të pavarur nga të tjerë		Merren në konsideratë më shumë se një variabël/ekonomi		Merren në konsideratë më shumë se një variabël ekonomik dhe joekonomik	
Bazuar në 2 hipoteza **1.Ceteris Paribus** **2.Sektorët e tjerë nuk ndikohen nga ndryshimet në sektorët e tjerë**		Bazohet në hipotezën se sektorët janë të ndërvarur nga njëri-tjetri		Bazohet në hipotezën se tregtia midis dy vendeve është proporcionalisht e lidhur me madhësinë ekonomike dhe joproporcionalisht me distancën	
Çmimet mbeten konstante, të paracaktuara		Çmimet përcaktohen njëkohësisht dhe reciprokisht. Të gjitha tregjet e mallrave dhe faktorëve janë njëkohësisht në ekuilibër		Çmimet përcaktohen njëkohësisht dhe reciprokisht. Të gjitha tregjet e mallrave dhe faktorëve janë njëkohësisht në ekuilibër	
Avantazhet **I thjeshtë dhe i trajtueshëm.** **I jep autorit mjaft fleksibilitet.**	Disavantazhet I kufizuar në një fushë. Nuk lejon studimin e lidhjes ndërsektoriale. Mjaft i brishtë	Avantazhet Të përdorshëm për MTL-të	Disavantazhet qëndrueshmëria	Avantazhet Aftësi të larta shpjeguese Rezultate të besueshme Trajtueshmëria	Jo globale Nuk reflekton kompleksitetin e ekonomisë

Burimi: material të mbledhura të autorit

[85] *Principles of Economics*, në 1881, ku shpenzoi më shumë se 10 vjet për analizën që i bëri marrëveshjeve midis vendeve duke përdorur matematikën

Duke pasur parasysh përparësitë dhe kufizimet e modeleve të përmendura më sipër,në këtë punim është përdorur modeli i korrektimit të gabimit EGT. Ky model konsiderohet si më i përshtatshmi për analizimin e kërkesës për importe dhe faktorëveqë ndikojnë në të, për rastin e Shqipërisë. Kjo zgjedhje është bazuar në avantazhin kryesor të modelit, i cili konsiston në aplikueshmërinë e tij për të shprehur marrëdhëniet midis flukseve dhe të dhënave të regresit (GDP). Në realitet ekzistojnë shumë versione me më shumë variabla të EGT-së të cilat janë përdorur, për të kuptuar më mirë përfitimet e marrëveshjeve të tregtisë së lirë dhe të zonave të tregtisë së lirë në rastin e shumë marrëveshjeve ndërkombëtare tregtare nëpër botë kryesisht për vendet në zhvillim.

5.3 IMPLIKIMET E REZULTATEVE EMPIRIKE *nga zbatueshmëria e modelit EGT për Shqipërinë*

Në këtë kapitull ndërrmerret një analizë empirike, e cila ka si qëllim kryesor vlerësimin e ndikimit të proçesit të liberalizimit tregtar apo të hapjes ekonomike dhe faktorëve të tjerë ekzogjenë,në rritjen ekonomike të Shqipërisë. Kjo analizë empirike është kryer nëpërmjet përdorimit të modelit EGT (Endogenous Gravity Theory Model). Variblat e përfshirë në këtë model, me qëllim shpjegimin e sjelljes së rritjes ekonomike shqiptare përmes variablit së normës së rritjes ekonomike (norma reale e GDP-së), ndahen në dy grupe kryesore: grupi i parë përfshin variablin e varur që masin efektet në performancën ekonomike të tillë si, PBB reale në përqindje, grupi i dytë përbëhet nga variabla të pavarur që masin efektet liberalizuese në tregtinë e jashtme, si hapja ekonomike me partnerët më të mëdhenj tregtarë të vendit (Greqi, Itali, Vendet e BE-se dhe vendet e rajonit),sektori i shërbimeve si matës indirekt i tregtisë, investimet e huaja direkte; shfaqja e krizës ekonomike në vendet partnere, reformat në sistemin financiar, aftësia konkurruese e ekonomisë shqiptare dhe së fundi dhe shkalla e korrupsionit.

Modeli përbëhet nga një bazë të dhënash, në trajtën e serive kohore, duke përfshirë një periudhë kohore prej 21 vitesh (1992-2013). Të dhënat e përdorura janë marrë nga burime zyrtare të besueshmë si Banka e Shqipërisë, Instat, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, FMN dhe Banka Botërore.

Funksioni i rezultuar i liberalizimit të tregtisë(rritjes ekonomike) është një funksion i qëndrueshëm, si në termat e fuqisë shpjeguese, ashtu dhe në nivelin e rëndësisë së variablave. Shenjat e koefiçientëve tëvariablave shpjegues janë në konsistencë me atë çka thotë teoria dhe evidenca të tjera empirike. Testet diagnostikuese tregojnë se modeli ka një formë funksionale të qëndrueshme, mbetjet karakterizohen nga një shpërndarje normale, mungon korrelacioni serial dhe janë homoskedastike.

Variablat e përfshirë në model shpjegojnë rreth 95%-99% (Adjusted R^2 - R^2) të variacionit të rritjes ekonomike.

Analiza vijon në bazë të faktorëve të integruar në regresionet dhe rezultatet tregojnë se:

- *Hapja ekonomike (hapja_gdp)*: hapja ekonomike me Greqinë, krahasuar me partnerët e tjerë tregtar, është e vetmja që ndikon negativisht mbi rritjen ekonomike shqiptare. Por, nga ana tjetër vetëm marrëdhënia me vendet e Bashkimit Evropian gjeneron një marrëdhënie pozitive dhe statistikisht të rëndësishme për rritjen ekonomike shqiptare.
- *Kontributi i investimeve të huaja direktenë ekonomi (fdi_gdp)*: vendet e rajonit japin ndikim negativ mbi rritjen ekonomike, e cila konvergjon edhe me përfundimet e modelit për gjithë vendet partnere të Shqipërisë, të paktën për sa i përket shenjës. Në asnjë regresion nuk del që ky faktor të jetë i rëndësishëm për lidhjen.
- *Kontributi i sektorit të shërbimeve në ekonomi (sherbime_gdp)*: në të gjithë regresionet dëshmohet se lidhja e këtij faktori me rritjen ekonomike është negative dhe me rëndësi statistikore 99% vlera e koeficientit është ajo që prezanton modeli.
- *Kriza në vendet e Bashkimit Evropian (kriza_eu)*: prania e krizës në vendet e bashkimit evropian e ul rritjen ekonomike të Shqipërisë, vetëm kur trajtohet marrëdhënia me Greqinë ky faktor nuk del statistikisht i rëndësishëm. Kjo dëshmohet nga shenja negative e koeficientit para këtij faktori në të pestë regresionet e trajtuar.
- *Kriza në vendet e rajonit (kriza_rajon)*: është shumë interesant fakti se prania e krizës në vendet e rajonit, ndryshe me krizën në Bashkimin Evropian, kontribuon në rritjen ekonomike shqiptare. Vetëm modeli me vendet e rajonit dhe ai me gjithë partnerët tregtar dëshmojnë për një lidhje statistikisht të rëndësishme.
- *Indeksi i korrupsionit në Shqipëri (ind_korr)*: lidhja pozitive qeveris marrëdhënien rritje ekonomike me indeksin e korrupsionit dhe në të gjitha regresionet është 99% statistikisht

e besueshme, përjashtuar atë me vendet e Bashkimit Evropian, që ka 90% nivel sigurie statistikore. Efekti më i lartë i këtij faktori merret nga regresi në lidhje me Greqinë, ndërsa efekti më i ulët vërehet te lidhja me Bashkimin Evropian.

- *Privatizimi i sektorit financiar (priv_sf)*: privatizimi i sistemit financiar ka dhënë efekte pozitive në rritjen ekonomike shqiptare. Kjo kuptohet nga shenja pozitive e koeficientit pranë këtij faktori në çdo regres të tabelës së mësipërme. Për më shumë, në të gjitha rastet vlera e këtij koeficienti është e besueshme mbi 99% nivel statistikor, përveç rastit të Bashkimit Evropian, ku rezulton me një rëndësi statistikore prej 94%. Efekti më i madh shihet te modeli me Greqinë, i cili mund të ketë lidhje me faktin se tre banka e sistemit bankar janë me kapital grek.Opinionistë të ndryshëm sugjerojnë se këto rezultate mund të lidhen dhe me faktin që Shqipëria importon shumë mallra nga Greqia dhe në sektorë shumë kontribues në PBB, gjë e cila përkeqëson bilancin tregtar me këtë vend, bilanc i cili ka impakt të konsiderueshëm edhe në bilancin tregtar me të gjitha vendet. Për më tepër që dhe masat dumping që ka ndërmarrë Greqia në drejtim të Shqipërisë shihen si një shqetësim që mund të ndikojë mjaft në dëmtimin e rritjes ekonomike .

Impakti i politikës së liberalizimit tregtar në rritjen ekonomike është i ndjeshëm. Rritja ekonomike reagon fort ndaj hapjes ekonomike pra shkallës së liberalizimit tregtar veçanërisht me vendet e BE-së.Koefiçenti i gabimit të modelit tregon se mbetja shpërndahet normalisht duke e veshur me besueshmëri të lartë këtë model.

Variabla të tjerë si,kriza në rajon, indeksi i korrupsionit dhe privatizimi i sistemit bankar kanë rezultuar statistikisht të rëndësishëm dhe me madhësi poZitive, duke treguar se: rritja e nivelit të liberalizimit të regjimit tregtar kundrejt tregjeve ndërkombëtare (veçanërisht me vendet e BE-së), shkakton rritje ekonomike në vendin tonë. Ndërsa vetëm variabli i sektorit të shërbimeve dhe i investimeve të huaja direkte ka rezultuar me impakt negativ që do të thotë se së bashku me krizën e Bashkimit Europian, këta sektorë sjellin tkurrje në rritjen ekonomike..

Nga studimi i mësipërm rritja ekonomike doli negativisht e ndikuar nga zëri Shërbime (që është dhe sektori me peshë më të madhe në bilancin tregtar) prandaj dhe përbën një çështje që duhet negociuar më mirë në marrëveshjet e ardhshmë tregtare. Politikë bërësit duhet të përqëndrohen në implementimin e reformave politike të duhura për të stimuluar rritjen ekonomike të

Shqipërisë dhe të mbështesin implementimin e këtyre politikave tregtare të saj me vendet e BE-së.

Ekonomia shqiptare është një ekonomi e vogël, e varur fort nga importi dhe nga volumi tregtar, për këtë duhet të reformojë politikat tregtare dhe ti implementojë në mënyrën e duhur për të arritur këtë qëllim. Situata e veçantë si dhe nivelet e larta të liberalizimit tregtar, shkaktuar nga reduktimi i shumë barrierave tregtare për shkak të hyrjes në OBT dhe marrëveshjeve të tregtisë së lirë,kushtëzuan nivele të larta të hapjes tregtare.

Nga gjetjet e mësipërme mund të konkludohet se hapja tregtare ose liberalizimi tregtar është një katalizator për Shqipërinë në stimulimin e rritjes ekonomike vetëm në disa marrëveshje tregtare (si BE). Për këtë, qeveria duhet të fokusohet në prioritetin e implementimit të Marrëveshjeve Tregtare me partnerët më të mëdhenj të saj duke përshpejtuar proçesin e integrimit me BE(mqs BE është dhe partneri më i madh tregtar me peshe 65.7%) sipas rezultateve empirike. Por tregtia e jashtme e vendit tonë me vendet e Bashkimet Europian është ende nën potencialet e hapësirave që krijon Marrëveshja e Tregtisë së Lirë.

Në një studim shkencor për zhvillimet e tregtisë së jashtme, të publikuar nga Banka e Shqipërisë thuhet se, rezultatet e modelit sugjerojnë se volumet tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të BE-së[86], si Greqia dhe Italia, janë pranë ekuilibrit potencial të mundshëm, ndërsa ekziston hapësira për intensifikimin e shkëmbimeve tregtare me Gjermaninë dhe rajonin. Rezultatet e modelit për shkëmbimet tregtare me vendet e rajonit sugjerojnë se volumet tregtare me këto vende janë shumë më poshtë ekuilibrit potencial. Pra sipas këtij modeli evidentohen dhe potencialet tregtare për vendin tonë rezultat ky në përputhje dhe me objektivat teorike te modeleve të gravitetit. Ekspertët e Bankës së Shqipërisë, nëpërmjet këtij studimi rekomandojnë mundësinë e intensifikimit të shkëmbimeve tregtare të Shqipërisë me vendet e rajonit nëpërmjet përmirësimit të rrjetit infrastrukturor dhe integrimit të mëtejshëm. "Kështu, me anë të aplikimit të plotë të MSA-së, volumet tregtare do të intensifikohen ndjeshëm, jo vetëm me partnerët tregtarë tradicionalë, por edhe me vendet e tjera të BE-së". Në fakt, Shqipëria nuk ka përfituar gjithçka pritej nga tregtia e lirë. Pasi ekspertët kishin parashikuar që të paktën çmimet e importit të uleshin 6 për qind, si rezultat i heqjes së tarifave doganore dhe rritjes së konkurrencës. Por kjo nuk ka ndodhur. Çmimet, përkundrazi janë rritur. Të gjitha studimet analoge për tregtinë e

[86] Në studimin "*TREGTIA AKTUALE DHE AJO POTENCIALE NDËRMJET SHQIPËRISË DHE PARTNERËVE TË SAJ KRYESORË"* Alban Pllaha ,artikull Buletini I Bankës së Shqipërisë 6m-1, 2011

jashtme dëshmojnë edhe për mosshfrytëzim të potencialeve. Vlerat e ulëta të tregtisë ndër-rajonale përbëjnë një dobësi strategjike, jo vetëm për Shqipërinë, por për të gjithë Ballkanin Perëndimor. Iniciativat e Tregtisë së Lirë e kanë përmirësuar disi situatën, por ende ka hapësira të mëdha të pashfrytëzuara edhe me rajonin. Situata mund të përmirësohet sipas ekspertëve, duke maksimizuar mundësitë për eksport dhe dhënien e ndihmës eksportuesve të rinj. Italia është padyshim tregu më i rëndësishëm për Shqipërinë. Por marrëdhëniet e tregtisë me Italinë janë bazuar në përdorimin e fuqisë së lirë punëtore. Ekspertët e vlerësojnë se është një çështje kritike për Shqipërinë, që kontrolli, si i importeve dhe i eksporteve, është pothuajse në duart e palës italiane. Një synim i qeverisë, sugjerojnë ekspertët, është rritja e numrit të kompanive shqiptare që duan të shesin në tregun italian.

Ndërsa tregtia në rajon është shumë poshtë nivelit të dëshiruar, ka disa të dhëna të një ndikimi pozitiv nga marrëveshjet e Tregtisë së Lirë. Kosova është i vetmi vend, me të cilin Shqipëria ka një balancë pozitive. Lidhjet e ngushta dhe afërsia me Kosovën e bëjnë atë një treg të përshtatshëm për të gjithë eksportuesit shqiptarë.

Të dhënat më të fundit të INSTAT-it tregojnë se, Greqia është e katërta në radhë për volumin tregtar me Shqipërinë. E para vijon të jetë Italia, ndërsa e dyta në vend të Greqisë vjen Turqia.

5.4 REKOMANDIME PËR PRESPEKTIVËN

Shqipëria është nga vendet më të përparuara në drejtimin e nënshkrimit të marrëveshjeve por gjithsesi përballet me një problem të madh që është pikërisht mungesa e prodhimit për eksport.

Aktualisht në vendin tonë nuk ka ligj apo ndonjë iniciativë që të favorizoje madje dhe të stimulojë prodhimet e vendit për eksport. Reduktimi dhe heqja e tarifave doganore pas 2008-tës mund të quhet një avantazh në drejtimin e zgjerimit të përmasave të tregut shqiptar,por vetëm potencialisht. Këmbimi i mallrave lirisht kërkon që të dy vendet ti këmbejnë reciprokisht pra ky mbetet tipar i vëndeve relativisht të zhvilluara. Vendet e Ballkanit në fakt kanë çfarë të prodhojnë, të këmbejnë dhe të komunikojnë me njeri - tjetrin. Prandaj në këto kushte lind nevoja e nxitjes së fuqishme të iniciativave dhe investimeve në ato degë e sektorë të ekonomisë

shqiptare, që kanë avantazhet e rritjes e të zhvillimit për ekonominë rajonale[87].Pra vëmendja duhet të përqëndrohet tek investimet e intensifikuara në degët që na favorizojnë dimesionet e reja të tregut rajonal. Përparësi për vendin tonë duhet të jetë stimulimi i prodhimit dhe i eksportit të prodhimeve tradicionale në fushën e bujqësisë, të industrisë agroushqimore, të artizanatit, të turizmit dhe të prodhimeve të traditës.

Problemi këtu qëndron tek fakti që në tregtinë rajonale të vendit tonë nuk ka reciprocitet apo kushte të barabarta tregtare. Për këtë emergjenca kryesore është orientimi i ri strukturor i ekonomisë shqiptare. Situata aktuale e vendit tonë që ka në thelb reduktimin e eksporteve dhe rritjen e shpejtë të importeve të cilat çojnë pa dyshim në përkeqësim të bilancit të tregtisë me jashtë, apo dhe vështirësi në bilancin e veprimeve rrjedhëse me jashtë. Prandaj politikat inkurajuese për përdorimin e burimeve të brendshme duhet të shoqërojnë cdo hap të mëtejshëm të marrëveshjeve të tregtisë së lirë të vendit tonë me vendet e tjera të rajonit.

5.5 KONTRIBUTET NË NJOHURI

Bazuar në rishikimin e literaturës , studime të mëparshme mbi politikat e hapjes në zhvillimin e vendit fokusohen kryesisht mbi ndikimin e hapjes dhe të tregtisë në rritjen ekonomike . Mund të pretendohet se vetëm disa studime empirike kërkimore kanë hulumtuar ndikimin e krizave dhe goditjet apo dhe reformat e ndryshme të politikave në tregti dhe rritjen ekonomike , por asnjë fokus në Shqipëri. Ky është një deficit i rëndësishëm sepse krizat (p.sh. kriza e vitit 1997) ; goditjet (p.sh.kriza globale) dhe reformat e politikave (p.sh. anëtarësimit në OBT në vitin 2000, reforma financiare institucionale dhe bankare të vitit 2004), kanë luajtur një rol të rëndësishëm në rritje . Për më tepër , deri më tani ishin ndërmarrë hulumtime sasior empirike vetëm të kufizuara brenda kontekstit të një ballkani të zgjeruar apo dhe integrimit të vendit tonë në BE. Prandaj , ishte e rëndësishme për të ndërtuar një model të përshtatshëm ekonometrik të hapjes , tregtisë dhe rritjes duke inkorporuar efektet e goditjeve të brendshme apo të jashtme ose reformat e tjera politike për studimin tonë .

Një model i përshtatshëm i hapjes , tregtisë dhe rritjes është ndërtuar nga zgjerimi i teorisë e gravitetit endogjen (EGT) dhe nëpërmjet inkorporimit të goditjeve të jashtme dhe brendshme

[87] Edhe brenda Komunitetit Evropian tregu i përbashkët, i zgjeronte kufijtë paralelisht me reduktimin e pengesave politike dhe me rritjen ekonomike të vendeve antare të Tregut

apo reformat e tjera të politikave dhe të tjera ekonomike dhe jo- ekonomike (p.sh. faktorët socialë , politikë) relevante për të . Një tjetër kontribut në dije është se janë përfshirë ndër të tjera dhe variabla të brendshme dhe të jashtme që janë përdorur në ekuacionin e regresit të stimuluar të lidhjes tregti- rritje si variabël dummy (indeksi i konkurrueshmërisë dhe i korrupsionit) . Implikimet dhe rekomandimet politikës për një treg të vetëm Europian janë të përfshira në këtë pjesë të studimit për shkak të bashkëpunimit të fortë të treguesve ekonomikë shqipëtare me hapjen ndaj tregut europian.

BE-ja është sugjeruar si një treg shumë i rëndësishëm dhe relevant për të rritur tregtinë, rritjen dhe bashkëpunimin ekonomik . Për më tepër , këto implikime dhe rekomandime janë zgjeruar edhe për të mbuluar çështjet MTL bilaterale aktuale. Prandaj , mund të thuhet se studimi përfshin modelimin makroekonomik dhe hulumtimimin bazuar në politika .

5.6 SUGJERIME PËR HULUMTIME TË MËTEJSHME

Për shkak të karakteristikave të suksesshme dhe të dobishme të hulumtimit në këtë punim, aplikacionet për hartimin e politikave praktike , mund të përdoren dhe për ta zgjeruar për kërkime të mëtejshme të tilla si ndikimin i tregut të përbashkët europian, dhe efektet e investimeve dhe liberalizimi i shërbimit në rritjen e vendeve anëtare . Për më tepër , një zgjerim i integrimit të vendeve të rajonit apo një studim i impaktit të reformave tregtare të këtyre vendeve në ekominë tonë , mund të konsiderohen çështje interesante kërkimore në të ardhmen .Në këtë studim analizohet sesi ndikon tregtia në rritjen ekonomike, por literatura sugjeron se këto variabla janë endogjene, për këtë sugjerohet që të studiohet në hulumtime të mëtejshme edhe lidhja rritje ekonomike mbi tregtinë plurilaterale. Modele të tjera të përshtatshme që përfshijnë edhe elementë të tjerë përveç atyre të marrë në këtë studim dhe një shumëllojshmëri e ekuacioneve apo dhe teknikat e vlerësimit të sistemit mund të aplikohen për të studiuar këto çështje . Interesant do të ishte që në studime të mëtejshme të provohet edhe modeli CGEM për të krahasuar dhe rezultatet me modelin EGT të përdorur në këtë studim.

Së fundi, rezultatet e modelit të aplikuar nxjerrin në pah një impakt negativ në rritjen ekonomike të Shqipërisë nga reformat në politikat tregtare me Greqinë, rezultat që shkon përkundër me

pritshmëritë e këtij studimi. Një arsye se pse ndodh kjo mund të jetë subjekt i hulumtimeve të mëtejshme.

Gjithashtu mund të jetë me vlerë dhe analizimi më i detajuar i të dhënave të tregtisë me vendet e rajonit (duke përfshirë dhe karakteristikat ekonomike të secilit vend së bashku me ngjashmëritë) meqënëse në këtë studim rezultoi me impaktin më të vogël në treguesit e rritjes ekonomike të Shqipërisë. Rezultat ky në kundërshtim me teoritë e tregtisë që sa më afër vendet gjeografikisht aq më shumë përfitime do të kishin nga marrëdhëniet tregtare midis tyre.

Referenca

1. Aisbett, E. (2005) Why are the Critics so Convinced that Globalization is Bad for the Poor?, Working Paper No. 11066, National Bureau of Economic Research.
2. Ajit K. Ghose "Trade liberalization and manufacturing employment". EMPLOYMENT PAPER
3. 2000/3 .Employment Sector International Labour Office Geneva
4. Agosin, M.R. (1991), "Trade Policy Reform and Economic Performance: A Review of the Issues and Some Preliminary Evidence," UNCTAD Discussion Papers No. 41 . Geneva: UNCTAD
5. Alarcon, Diana and EduardoZepeda, 1997, "Jobs, technology and skill requirementsin a globalized economy: case study of Mexico", Geneva: International Labour Office, processes.
6. Alfaro 2003, FDI and Economic Growth : the role of local and financial market 2003
7. Anderson, J., van Wincoop, E. "Gravity with Gravitas: A Solution to the Border Puzzle." American Economic Review (2003).
8. Anderson, Kym, and Will Martin (2006), Agricultural Trade Reform and the Doha Development Agenda, New York and Washington
9. Annett A. (2007) "Lessons from Successful Labor Market Reformers in Europe", IMF Discussion Paper PDP/07/01
10. Appleyard D. ,& Field A. " International Economics, 3rd International" ed., McGraw-Hill, New York, 1998
11. Armington, Paul S. (1969) "A Theory of Demand for Products Distinguished by Place of Production," IMF Staff Papers, 16: 159- 178.
12. B. Fliess and R. Schonfeld (2006).Trade in Corformity Assessment Practices and Barriers
13. to Trade
14. Baldwin, R. (2003, "Openness and Growth: What's the Emirical Relationship?", NBER Working Paper, 9578, Cambrige MA
15. Baldwin, Robert E. (2003) "Openness and Growth: What's the Empirical Relationship?", National Bureau of Economic Research ,Working Paper No. 9578.
16. Banka e Shqipërisë (2013), Raporti vjetor 2012
17. Banka e Shqipërisë (2012), Raporti vjetor 2011
18. Barro, R.J., 1991. Economic growth in a cross-section of countries. Quarterly Journal of Economics 5, 181–189.
19. Bergstrand, J.H (1983). "Measurment and Determinants of Intra-Indusry International Trade". Elsevier Sciences and Technology Books.
20. Bergstrand, Jeffrey H. "The Gravity Equation in International Trade: Some Microeconomic Foundations and Empirical Evidence." The Review of Economics and Statistics, Vol. 67, No. 3. (Aug., 1985), pp. 474–481.
21. Bernard, A.B., Eaton, J., Jensen, J.B. and Kortum, S. (2003) 'Plants and Productivity in International Trade,' American Economic Review, 93(4), 1268-90.
22. Bhagwati, J., D. Greenaway and A. Panagariya, 1998. "Trading preferentially: theory and policy," The Economic Journal, Vol. 108, July 1998, pp. 1128-1148.
23. Bhagwati, J., P. Krishna and A. Panagariya (1999) Trading Blocs, Cambridge, Mass.,, MIT Press.
24. Brock, W. A. and Durlauf, S. N. (2001). 'Growth empirics and reality', The World Bank Economic Review, vol. 15 (2), pp. 229–72.
25. Carkovic M. and Levine R.(2002) "does FDI accelerate growth, University of Minesota, Department of Finance 'working paper'

26. : “DOES OPENNESS IMPLY GREATER EXPOSURE?”César Calderón,Norman Loayza, Klaus Schmidt-Hebbel, World Bank Policy Research Working Paper 3733, October 2005
27. Coe, D. T., E. Helpman and A. Hoff maister (1997), “North-South R&D and Spillovers”, Economic Journal. Vol. 107, No. 440: 134-49.
28. Coe, David T. & Helpman, Elhanan & Hoffmaister, Alexander W., 2009. "International R&D spillovers and institutions," European Economic Review, Elsevier, vol. 53(7), pages 723-741, October.
29. Collins, Susan M., 1998, “Economic integration and the American worker: an overview”, in Collins, ed., 1998.
30. Collins, Susan M., ed., 1998, Imports, Exports and the American Worker, Washington D. C.: Brookings Institution Press
31. Deardorff, Alan (1998). "Determinants of Bilateral Trade: Does Gravity Work in a Neoclassical World?". The Regionalization of the World Economy.
32. Dixit, A. and Norman, V. (1980) “Theory of International Trade”, Cambridge University Press.
33. Dixit, A. and Stiglitz, J. (1977) ‘Monopolistic Competition and Optimum Product
34. Dollar, D. (1992), “Outward-Oriented Developing Economies Really Do Grow More Rapidly: Evidence from 95 LDCs, 1976-85,” Economic Development and Cultural Change, 40(3): 523-44.
35. Dollar,D. and Kraay A. (2004) “Trade, Growth and Poverty”. The Economic JournalVol 114(February)pp22-49
36. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, (2012), “ Buletini i Tregtisë së Jashtme”
37. Dollar, David, and Aart Kraay (2001a). “Growth Is Good for the Poor,” Policy Research, Working Paper No. 2587.
38. Dollar. D (2001b), “Trade, Growth, and Poverty,” Policy Research Working Paper No. 2199
39. Frankel, Jeffrey A., and David Romer (1999). “Does Trade Cause Growth?” The American Economic Review, (June) 379-399.
40. Easterly, W. (2001). The Elusive Quest for Growth: Economists’ Adventures and Misadventures in the Tropics, Cambridge, MA: MIT Press
41. EATON, J., AND S. KORTUM (2002): "Trade in Ideas: Patenting and Productivity in the OECD," Journal of International Economics, 40, 251-278.
42. Edwards, S. (1998). ‘Openness, productivity, and growth: what do we really know?’, Economic Journal, vol. 108 (2), pp. 383–98.
43. Eswar S. Prasad, Kenneth Rogoff, Shang-Jin Wei, and M. Ayan Kose “Effects of Financial Globalization on Developing Countries” Some Empirical Evidence,2003, IMF Occasional Papers, #220, International Monetary Fund September 9, 2003
44. Frankel, J.A. and D. Romer (1999), “Does Trade Cause Growth?”, Th e American Economic Review. Vol. 89, No. 3, pp: 379-99.
45. Frankel, J. and Rose, A. K. (2002). ‘An estimate of the effect of common currencies on trade and growth’, Quarterly Journal of Economics, vol. 117 (469), pp. 437–66.
46. Frankel, Jeffery A. Regional Trading Blocs: In the World Economic System. Washington, DC: Institute of International Economics. October 1993.
47. Feenstra, Robert C. and Gordon H. Hanson, 1997, “Foreign direct investment and relative wages: evidence from Mexico’s maquiladoras”, Journal of International Economics, vol. 42, nos. 3/4.
48. Feenstra, Robert C., James R. Markusen, and Andrew K. Rose. “Using the Gravity Equation to Differentiate among Alternative Theories of Trade.” The Canadian Journal of Economics, Vol. 34, No. 2. (May, 2001), pp. 431.
49. Freeman, Richard B., 1995, “Are your wages set in Beijing?”, Journal of Economic Perspectives, vol.9, no. 3.

50. George Stigler 1971 : The Theory of Economic Regulation." *Bell Journal of Economics and Management Science*, " no. 3, pp. 3–18.
51. Grossman, G dhe Helpman, E. (1991),"Innovation and Growth in the Global Economy", The MIT Press, Cambrige MA
52. Grossman, G. (1992) (ed) "Imperfect Competition and International Trade", The MIT Press
53. Hall, R. E. and Jones, C. I. (1997). 'Levels of economic activity across countries', American Economic Review, vol. 87 (2), pp. 173–7.
54. Hall, Robert E., and Charles Jones (1999). "Why Do Some Countries Produce So Much More Output per Worker than Others?" Quarterly Journal of Economics, volume 114 n 1 February, pp. 83-116.
55. Harrison, A. (1991). Openness and Growth: A Time Series Cross-Country Analysis for Developing Countries, World Bank Policy Research Papers No. 809, Washington, DC
56. Harrison, Ann and Gordon Hanson, 1999, "Who gains from trade reform? Some remaining puzzles", Journal of Development Economics, vol. 59,
57. Held, David; Thompson, John B. (1989). Social theory of modern societies: Anthony Giddens and his critics. Cambridge, UK New York, New York: Cambridge University Press. ISBN 9780521278553
58. Helpman, E. dhe Krugman,P. R. (1985),"Market Structure anf Foreign Trade: Increasing Returns, Imperfect Competition and the International Economy", Cambrige MIT Press.
59. Helpman, E., (1987). Imperfect Competition and International Trade Evidence from Fourteen Industrial Countries." Journal of the Japanese and International Economies I: 62-81
60. ILO (International Labour Organization), 1995, World Employment 1995, Geneva.
61. IMF, *World Economic Outlook*, May 1997 'World Bank, Globalization, Growth, and Poverty: Facts, Fears, and an Agenda for Action, forthcoming'.
62. IMF (2008), World Economic Outlook
63. IMF (2009), World Economic Outlook.
64. IMF (2009), World Economic Outlook: Crisis and Recover.
65. IMF Report, 2010,2011,2012,2013,2014.
66. INSTAT, 1993-2014, Publikime
67. International Monetary Fund, Research Department, Washington DC 20431 USA --"How does foreign direct investment affect economic growth?"E. Borensztein , J. De Gregorio , J-W. Lee, Journal of International Economics 45 (1998) 115–135
68. International Monetary Fund and World Bank, "Market Access for Developing Countries' Exports", 2001
69. Irwin, M. Tervio / "Does trade raise income?: Evidence from the twentieth century,"Journal of International Economics 58 (2002) 1–18
70. International Monetary Fund and World Bank, "Market Access for Developing Countries' Exports", 2001." World Bank, Globalization, Growth, and Poverty: Facts, Fears, and an Agenda for Action, forthcoming".
71. IMF (International Monetary Fund), 1997, World Economic Outlook, May 1997, Washington, D.C.
72. Jeffrey Frankel and David Romer, "Does Trade Cause Growth",*American Economic Review*, June 1999.
73. J. Anderson and Martin K.(2006). 'Entrepreneurs on a Dance Floor'. Business Strategy Review 17 (4): pp. 26–31.
74. J. Viner (1950), The Customs Union Issue (London: Stevens and Son).
75. Jenkins, R. (1996), "Trade Liberalization and Export Performance in Bolivia," Development and Change, 27(4), 693-716.
76. Johansen, L. (1982), "Econometric Models and Economic Planning and Policy: Some Trends and Problems", in M. Hazewinkle and A.H.G. Rinnooy Kan (eds.), Current Developments in the Interface: Economics, Econometrics, Mathematics, Boston: Reidel.
77. Johansen , S.(1988), "Statistical Analysis of Cointegration Vectors, Journal of Economic Dynamics and Control", 12, fq 12
78. Johansen , S.(1991), "Estimations and Hypothesis testing for Cointegration Vectors in Gaussian Vector Autoregressive Models", Econometrica, 59, fq 1551-1599

79.
80. Journal of Development Economics, 12, pp. 258-327.
81. Journal of Development Economics, 26 (1): 65-76.
82. Kaminsky, B. and de la Rocha, M. (2003), "Stabilization and Assocation Process in the Balkans: Integration Options and their Assesment", World Bank Policy Research Working Paper 3108
83. Kaplinsky, R. 2000, Globalisation and Unequalisation: What Can be Learned from Value Chain Analysis, Journal of Development Studies, 37 (2), 117-146.
84. Kaufmann, Daniel, Aart Kraay, and Pablo Zoido-Lobatón (1999). "Governance Matters". World Bank Policy Research Department Working Paper No. 2196.

85. Kenichi Ohmae, The End of the Nation-State: the Rise of Regional Economies. New York: Simon and Schuster Inc., 1995.
86. Krueger, A., 1999. "Are preferential trading arrangements trade-liberalizing or protectionist?" in Journal of Economic Perspectives, Vol. 13, No. 4, pp. 105-124.
87. Krueger, A.O., 1997. Trade policy and economic development: how we learn. American Economic Experience?".
88. Krugman, P.R. (1983). "New theories of trade among industrial countries". The American Economic Review, 73(2): 343-347.
89. Krugman, P. (1995) "Growing World Trade: Causes and Consequences", Brookings Paper on Economic Activity, Vol 1.
90. Krugman, P. R. & Obstfeld, M.. (2003). International economics: Theory and policy (6th ed.). Addison-Wesley.
91. Krugman, P.. (1994). Competitiveness—A dangerous obsession. Foreign Affairs, 73(2).
92. Limao, Nuno & Panagariya, Arvind, 2007. "Inequality and endogenous trade policy outcomes," Journal of International Economics, Elsevier, vol. 72(2), pages 292-309, July.
93. Lindert, P., and J. Williamson (2001a). "Does Globalization Make the World More Unequal?" Paper to be presented in a conference on Globalization in Historical Perspective.
94. Lindert, P. and J Williamson (2001b). "Globalization: A Long History." Paper prepared for the ABCDE – Europe conference.
95. Levine, Ross, and David Renelt (1992). "A Sensitivity Analysis of Cross-Country Growth Regressions." American Economic Review, September, 82(4): pp. 942-963.
96. Lloyd, C.B. & S. Desai, (1992), 'Children's living arrangements in developing countries,' Population Research and Policy Review, 11:193-216.
97. Mançellari, Xhepa, 2004, "Përballueshmëria e bilancit të llogarive korente", Konferenca e Bankës së Shqipërisë, (fq 9).
98. Mankiw, N.G, Romer, and Weil, D. N. (1992), " A Cointribution to the empirircs of Economic Growth", Quartely Journal of Economics, 107
99. McCallum, John T. (1995), "National Borders Matter: Canada-U.S. Regional Trade Patterns", American Economic Review 85: 615–623
100. Melo, O. and M.G. Vogt, 1984, 'Determinants of the demand for imports of Venezuela'
101. Ministri e Financave, INSTAT, METE, Banka e Shqipërisë, FMN, dhe Instat database.
102. Moosa Imaad A. "FDI, Theory, evidence and practice", pg. .69, Palgrave,2002
103. Murshed, S. Mansoob (2006), When does natural resource abundance lead to a resource curse?, IIED-EEP working paper 04–01.
104. Mundell, Robert (2000). "A Reconsideration of the Twentieth Century." American Economic Review.
105. Nello, Susan S., The European Union: Economics, Policies and History, Maidenhead: McGraw Hill Education (2009) ISBN 0-07-711813-8
106. OBT, (2006,2007, 2008, 2009), Raporte Vjetore, (www.wto.org)

107. Ocampo, José Antonio and Lance Taylor (1998), "Trade Liberalization in Developing Economies: Modest Benefi ts But Problems with Productivity Growth, Macro Prices and Income Distribution." Economic Journal 108 (8): 1523–46.
108. Oxfam International, 2003, "Paying the Price"
109. Organizata Botërore e Tregtisë OBT dhe ILO (2006) "Trade and Employment. Challenges for Policy Research".
110. Otto, G., Voss, G. and Willard, L. (2002), "Understanding OECD Output Correlations", Seminar Paper, Department of Economics, University of Wollongong, May 2002
111. P. Krishna and A. Panagariya (1999), Trading blocs: Alternative approaches to analyzing Regional and multilateral integration," (Chapter 2)
112. Panagariya A. (2004) "Miracles and Debacles: In Defence of Trade Openness".Columbia University 2004
113. Panagariya, A. (2003), "Miracles and Debacles. In defense of Trade Openness.
114. Panagariya, A., 2000. "Preferential trade liberalization: the traditional theory and new developments," in Journal of Economic Literature, No. XXXVIII, June 2000, pp. 287-331.

115. Peter Lindert and Jeffrey Williamson, "Does Globalization Make the World More Unequal?", NBER Working Paper No. 8228, 2001
116. Peter A. Hall and David Soskice , 2001 ' An Introduction to Varieties of Capitalism'

117. Porter, M E 1990, 'The Competitive of Nations', Harvard Business Review, no. 90211
118. March-April, 1990, pp. 72-91.

119. Pöyhönen, Pentti (1963) "A Tentative Model for the Volume of Trade Between
120. Countries", Weltwirtshafiliches Archiv 90, fq 80-105.

121. Rodriguez, Francisco and Dani Rodrik (1999) 'Trade Policy and Economic Growth: A Skeptic's Guide to Cross-National Evidence',University of Maryland
122. Rodriguez, F., Rodrik, D., 2001. "'Trade Policy and Economic Growth: A Skeptic's Guide to Cross-National Evidence',
123. Rodrik, Rani, 1995. "Trade and industrial policy reform," Handbook of Development Economics, in: Hollis Cheneryâ€ & T.N. Srinivasan (ed.), Handbook of Development Economics, edition 1, volume 3, chapter 45, pages 2925-2982 Elsevier.
124. Rodrik, D., 1999. "Globalisation, social conflict and growth". The World Economy 21, 143–158
125. Romer, Paul (1986). "Increasing Returns and Long-Run Growth." Journal of Political Economy, vol. 94. No. 5.
126. Sachs, J. D. and Warner, A. M. (1995). 'Economic convergence and economic policies', Brookings Papers in Economic Activity, (1), pp. 1–95.
127. Sachs, Jeffrey D., and Andrew Warner (1995). "Economic Reform and the Process of Global Integration." Brookings Papers on Economic Activity, (1), 1-118.
128. Sala-i-Martin, X. (1997), 'I just ran two million regressions', American Economic Review, vol. 87 (2), pp. 178–83.
129. Schiff, M. and Winters, L. A.(2003). "Regional Integration and. Development". Washington,D. C. Sussex European Institute, pp. 1-47. The World Bank.
130. Schott, J J 2000, 'The WTO after Seattle', in Schott, J J (ed.) The WTO after Seattle, Kirby Lithographic Company, Washington, DC
131. SL Baier, JH Bergstrand. "Bonus Vetus OLS:"A Simple Method for Approximating International Trade-Cost Effects Using the Gravity Equation." Journal of International Economics (2009).

132. Steven Matusz and David Tarr, "Adjusting to Trade Policy Reform", World Bank Policy Research Working Paper No. 2142, July 1999.

133. Tran Van Hoa, 2004. "Economic and Financial Crisis Management in Asia: A Critical Analysis," Economics Working Papers wp04-13, School of Economics, University of Wollongong, NSW, Australia.
134. Tinbergen, J. (1962) "Shaping the World Economy: Suggestions for an International Economic" Policy, New York, The Twentieth Century Fund.
135. Thirlwall, A. P. (1992). "A Kaldorian model of growth and development revisited: A rejoinder to Dutt". Oxford Economic Papers, 44: 169-172.

136. Trade Liberalisation in the Doha Development Round, Economic Policy, April 2005
137. "TRADE LIBERALISATION: BOOSTING EMPLOYMENT AND GROWTH", OECD Trade Policy Working Paper no. 107, January 2011
138. OECD 2013" Interconnected Economies:Benefiting from Global Value Chains" OECD publishing
139. UNCTAD (United Nations Conference on Trade and Development), 1999, Trade and Development Report 1999,New York and Geneva.
140. Vika, I, (2006), "Matja e funksioneve të import-eksportit në Shqipëri", Banka e Shqipërisë
141. Wacziarg, R. (2001). Measuring the Dynamic Gains from Trade, World Bank Economic Review Vol. 15, No. 3
142. Wacziarg, R., dhe Welch, K.H, (2003)," Trade Liberalization and Growth. New evidence", Standford and NBER.
143. Winter D, et al. (1999) Activation of the yeast Arp2/3 complex by Bee1p, a WASP. Curr Biol 9(9):501-4.
144. Winters, L. A. (2003). 'Trade policy as development policy: building on fifty years' experience', in (J. Toye ed.) Trade and Development: Directions for the 21st Century, pp. 62–81, Cheltenham: Edward Elgar.
145. Winters, L A, McCulloch, N and McKay, A 2004, 'Trade Liberalisation and Poverty: The Evidence So Far', Journal of Economic Literature, vol. 42, March, pp. 72-115.
146. Wood, Adrian, 1994, North-South Trade, Employment and Inequality, Oxford: Clarendon Press.
147. Wood, Adrian, 1998, "Globalization and the rise of labour market inequalities", Economic Journal, vol.108,
148. September.
149. World Trade Organisation 2006, Understanding the WTO, Geneva, viewed 1 June 2006, http://www.wto.org/english/theWTO_e/whatis_e/tif_e/doha1_e.htm
150. World Bank Reports, 2008,2009…2012
151. World Bank, Globalization, Growth, and Poverty: Facts, Fears, and an Agenda for Action, forthcoming. IMF, World Economic Outlook, May 1997
152. WTO (2012), World Tariff Profile 2011
153. http://madb.europa.eu/madb/statistical_form.htm

154. www.stabilitypact.org
155. Young, A. A. (1928),. "Increasing returns and economic progress". The Economic Journal, 38(152): 527-542.

Tabela 1 : Treguesit e tregtisë 1993-2014

Vitet	Greqi	Itali	Vendet e Rajonit	BE	Volume tregtar Total	Eksportet	Importet	Deficit tregtar
1993	12,658	22,755	3, 656	51,909	**70,835**	12,499	58,336	45,838
1994	14,911	28,257	2,781	51,274	**70,406**	13,387	57,019	43,632
1995	18,193	34,079	2,736	65,497	**84,857**	18,710	66,147	47,437
1996	22,690	52,146	4,210	93,421	120,061	22,001	98,060	76,059
1997	29,056	53,960	3,971	97,620	**116,066**	21,044	95,02	73,977
1998	42,054	74,022	3,406	133,049	**157,375**	31,104	126,271	95,167
1999	44,965	87,794	5,404	169,311	**207,894**	48,430	159,465	111,035
2000	46,226	81,667	7,828	52,768	**194,146**	37,037	157,109	120,072
2001	54,658	91,882	7,878	182,650	**234,251**	44,096	190,155	146,059
2002	51,665	106,963	10,427	193,650	**257,858**	47,490	210,368	162,877
2003	52,267	116,451	8,380	204,968	**280,469**	54,487	225,983	171,496
2004	51,092	122,049	11,150	226,419.10	**298,193**	62,121	236,072	173,951
2005	49,956	124,445	13,129	239,559.40	**328,009**	65,818	262,191	196,373
2006	54,352	140,323	18,532	270,845.00	**376,553**	77,405	299,147	221,742
2007	63,132	166,890	33,647	317,940.30	**473,365**	97,171	376,194	279,023
2008	74,257	186,055	50,461	368,815.00	**552,466**	112,572	439,894	327,322
2009	74,315	176,951	39,758	372,740.10	**533,353**	103,244	431,107	327,863
2010	71,358	216,683	55,298	430,993	**639,315**	161,154	477,768	316,220
2011	67,774	271,043	65,764	498,714	**740,901**	196,896	544,003	347,107
2012	59,578	277,217	70,220	495,155	**741,520**	213,022	528,490	315,468
2013	53,475	284,598	63,965	521,841	**763,703**	246,345	512,528	266,183
2014	60,906	297,454	75,990	528,526	**808,022**	190,000		
Mesatarja	**48,615**	**136,986**	**26425.47619**	**253,076**	**365,892**			
Pesha mesatare	**13.3**	**37.44**	**0.07**	**69.17**				

Burimi INSTAT, llogaritjet e autorit

Tabela 2 : Rritja e GDP-së reale në vitet 1993-2014

Vitet	Rritja reale e GDP-së në %
1994	7.4
1995	13.4
1996	9.1
1997	-10.7
1998	9
1999	13.5
2000	6.7
2001	7.9
2002	4.2
2003	5.8
2004	5.7
2005	5.7
2006	5.5
2007	6
2008	7.5
2009	3.4
2010	3.7
2011	2.5
2012	1.6
2013	1.4
2014	2.1
2015*	3
Mesatarja	5.30

Burimi, Përmbledhje e autorit

Tabela 3 : Rritja reale sipas parashikimeve të Bankës Botërore 2012-2015

RRITJA REALE DHE PARASHIKIMET E BB

	2012	2013	2014	2015
Shqipëri	1.3	0.4	2.1	3.3
Bosnje	-1.1	0.8	2	3.5
Kosovë	2.7	3	3.5	3.5
Maqedoni	-0.4	3.1	3.5	3.5
Mali I Zi	-2.5	3.5	3.2	3.5
Serbi	-1.7	2.5	1	1.5
SEE 6	-0.7	2.1	1.9	2.6
Zona Euro	-0.7	-0.4	1.2	1.7
EU 11	0.8	1.4	2.4	2.7

Burimi: Raporti BB "Rritje e brishtë"

Figura 1 : Treguesit e tregtisë me Kosovën 2008-2013



Figura 2 : Treguesit e eksporteve totale të Shqipërisë



Figura 3 : Eksportet shqiptare sipas destinacionit

Figura 4 : Eksportet shqiptare sipas destinacionit 2013



Figura 5 : Importet shqiptare sipas vendit të origjinës



Figura 6 : Eksportet shqiptare sipas destinacionit 2013-2014



Burimi Instat

Figura 7 : Tregtia shqiptare sipas destinacioneve kryesore

Burimi : Banka e Shqipërisë

Figura 8. Termi i mbetjes së modelit të Italisë



Burimi: Përpunuar nga autori në Eviews 7

Tabela 4. Testet e heteroskedasticitetit, korrelacionit serial dhe autokorrelacionit për modelin e Italisë

Heteroskedasticity Test: Breusch-Pagan-Godfrey

F-statistic	0.503421	Prob. F(7,6)	0.8049
Obs*R-squared	5.180129	Prob. Chi-Square(7)	0.6380
Scaled explained SS	0.507235	Prob. Chi-Square(7)	0.9994

Breusch-Godfrey Serial Correlation LM Test:

F-statistic	1.271147	Prob. F(2,4)	0.3738
Obs*R-squared	5.440310	Prob. Chi-Square(2)	0.0659

Sample: 2000 2013
Included observations: 14

Autocorrelation	Partial Correlation		AC	PAC	Q-Stat	Prob
.*** | . |	.*** | . |	1	-0.392	-0.392	2.6544	0.103
. | . |	. * | . |	2	-0.017	-0.203	2.6600	0.264
. | . |	. * | . |	3	-0.012	-0.123	2.6631	0.447
.*** | . |	**** | . |	4	-0.371	-0.538	5.7477	0.219

. | *** . |	. | * . |	5	0.477	0.080	11.420	0.044
. * | . |	. | . |	6	-0.113	0.030	11.777	0.067
. * | . |	. ** | . |	7	-0.140	-0.269	12.407	0.088
. | . |	. *** | . |	8	0.003	-0.382	12.408	0.134
. | . |	. | . |	9	-0.016	0.069	12.420	0.191
. | * . |	. * | . |	10	0.128	-0.075	13.332	0.206

Burimi: Përpunuar nga autori në Eviews 7

Figura 9. Testi i shpërndarje normale të termit të gabimit, shoqëruar me statistikën përshkruese(për vendet e rajonit



Burimi: Përpunuar nga autori në Eviews 7

Tabela 5. Testi i heteroskedacitetit, korrelacionit serial dhe autokorrelacioni për modelin me vendet e rajonit partnere tregtare me Shqipërinë

Heteroskedasticity Test: Breusch-Pagan-Godfrey

F-statistic	0.449082	Prob. F(7,6)	0.8407
Obs*R-squared	4.813219	Prob. Chi-Square(7)	0.6827
Scaled explained SS	0.424149	Prob. Chi-Square(7)	0.9997

Breusch-Godfrey Serial Correlation LM Test:

F-statistic	0.564846	Prob. F(2,4)	0.6080
Obs*R-squared	3.083167	Prob. Chi-Square(2)	0.2140

Sample: 2000 2013
Included observations: 14

Autocorrelation	Partial Correlation		AC	PAC	Q-Stat	Prob
. *| . |	. *| . |	1	-0.137	-0.137	0.3215	0.571
. **| . |	. **| . |	2	-0.263	-0.288	1.6175	0.445
. *| . |	. **| . |	3	-0.160	-0.273	2.1377	0.544
. **| . |	.***| . |	4	-0.225	-0.470	3.2746	0.513
. |***. |	. |* . |	5	0.402	0.107	7.3007	0.199
. |* . |	. | . |	6	0.112	-0.014	7.6488	0.265
. **| . |	. **| . |	7	-0.243	-0.225	9.5420	0.216
. | . |	. *| . |	8	-0.061	-0.141	9.6809	0.288
. *| . |	. *| . |	9	-0.085	-0.101	10.006	0.350
. |* . |	. *| . |	10	0.151	-0.104	11.285	0.336

Figura10:. Statistika përshkruese e termit të gabimit për modelin me vendet e Bashkimit Evropian



Tabela 6. Testi i heteroskedasticitetit dhe korrelacionit serial për modelin e Bashkimit Evropian

Heteroskedasticity Test: Breusch-Pagan-Godfrey

F-statistic	0.410969	Prob. F(7,6)	0.8651
Obs*R-squared	4.537111	Prob. Chi-Square(7)	0.7162
Scaled explained SS	0.940545	Prob. Chi-Square(7)	0.9957

Breusch-Godfrey Serial Correlation LM Test:

F-statistic	2.188268	Prob. F(4,2)	0.3374
Obs*R-squared	11.39609	Prob. Chi-Square(4)	0.0225